

BIBLIOTEKA

85H-32
P 99

NAUM PRIFTI

AS MËRËD,

AS MËRËD

SKICA DHE TREGIME HUMORISTIKE



8 SH-32
P 93

NAUM PRIFTI

As Mico, as Muço

Skica dhe tregime humoristike



BOTIMET TOENA
Tiranë, 2003

AS MIÇO, AS MUÇO



I pakënaqur nga parimet paqësore të krishterimit, i mërzhitur nga kreshmët e gjata dhe agjërimet e shpeshta, Miçoja vendosi të kthehej mysliman. Moskundërshtimi i së keqes me forcë, nënshtrimi deri në poshtërim, falja e teshave të trupit lipsarëve dhe rrugaçëve, nuk pajtoheshin me temperamentin e tij shpërthyes dhe ai jo vetëm nuk i zbatonte, por kritikonte edhe sivëllezërit e tij të fesë. T'i falje një këmishë të afërmit, kur kishe vetëm dy, mbeteshe vetë pa ndërruar dhe stimuloje parazitizmin. Nervat ia cingriste sidomos këshilla ungjillore t'i ktheje edhe faqen tjetër atij që të godiste, në vend t'ia bëje hundët përshesh, që të mos guxonte të

ngrinte dorë. Sipas tij e keqja kundërshtohet me forcë, jo me lutje e temenara, duke ndenjtur i përlurur si pulë e shushatur. Më mirë përfaqëson islamizmin dhe shpëtonte njëherë e përgjithmonë nga kufizimet poshtëruese.

Shkoi në xhami t'i shprehte myftiut dëshirën e tij. Myftiu, njeri i urtë dhe i dijshtë, e këshilloi ta sillte lutjen me shkrim, ku të deklaronte se po kthehej mysliman pa shtrëngim, me vullnetin e tij të lirë.

- E kam sjellë me vete, - i tha Miçoja duke e nxjerrë letrën prej xhepit.

- Mirë evlat, por e mira është të ndërroni edhe emrin, se e kuptoni vetë... - e këshilloi Myftiu.

- E kam ndërruar, nga Miço e ktheva Muço, - i tha prosliti i ri.

Myftiu e përuroi për zgjidhjen e bukur që kishte gjetur dhe pastaj e porositi të mbante tridhjetë ditë ramazan

- Po kjo pse u dashka? - protestoi neofiti. - Unë pandeha se shpëtova nga kreshmët...

- Duhet, biri im, si provë e përkushtimit tuaj ndaj fesë sonë, - argumentoi myftiu.

- Pranoj, - tha vendosmërisht Miçoja, - fillojmë që sot.

- Që sot nuk mundemi, se ti ke ngrënë një a dy vafte, - vërejti myftiu. - Nesër e tutje po. Unë po e regjistroj emrin tuaj dhe pas një muaji ejani këtu të merrni bekimin dhe t'u fut në xhemiati tonë.

I gëzuar Miçoja i kumtoi vëllait bisedën e zhvilluar me Myftiun. I vëllai, kristian i devotshëm, e paralajmëroi për ndëshkimet e ferrit që e prisnin në botën tjetër nga braktisja e fesë, po Miçoja as nuk u tund, as nuk u lëkund, se mendonte që xhenetin e kishte siguruar me ndihmën e profetit tjetër.

Filloi ramazanan duke respektuar rregullat pikë për pikë, mirëpo papritur të njëzetënëntën ditë i ra pika dhe vdiq. I vëllai, duke ditur dëshirën dhe vullnetin e Miços, shkoi te Myftiu për t'i kërkuar ta varroste me shartet myslimane. Myftiu hapi regjistrin dhe filloi të numëronte me gishta.

- Biri im, mua nuk më del llogaria, - i tha myftiu. -Vëllai juaj nuk i ka plotësuar tridhjetë ditët e ramazanit...

- Ashtu vërtet, po vdekja e papritur nuk e la, - e sqaroi vëllai i Miços.

- Atëherë nuk mund të varroset si mysliman.

- Një ditë mbeti mangut, - arsyetoi vëllai i Miços, - punë e madhe për një ditë!

- Jo, jo, jo! - kundërshtoi myftiu. - Ka qenë vullneti i Allahut, xhene shane hu, që i ndjeri të mos hynte në fenë tonë. Për mua ai vdiq në fenë e vjetër, prandaj drejtohuni te dhespoti.

Vëllai i Miços shkoi te dhespoti ortodoks. Atij i hipën xhindet posa dëgjoi se ç'kërkonte vëllai i Miços.

- Për kë vjen të lutesh? Për atë tradhtar të fesë sonë? Ai është renegat i krishterimit, - iu gërmush.

- Ishte hirësi, - e korrigjoi vëllai i Miços, - po tani vdiq dhe duhet varrosur me ceremoni fetare, sipas nomit të Perëndisë.

- Mos kujtoni se do t'i lutem Zotit tonë t'i falë mëkatet një myslimani? Kurrë! - bërtiti Dhespoti.

- Sipas Myftiut ai vdiq i krishter, meqenëse nuk i mbushi ditët e provës, - arsyetoi vëllai i Miços.

- Unë atë e çregjistрова nga grigja jonë që ditën që vajti te myftiu.

- Si mendon hirësia juaj, ta lëmë pa varrosur? Ta hanë qentë? - e pyeti vëllai i Miços me qëllim që ai ta mëshironte të ndjerin.

- Ta hanë qentë, edhe macet po deshën. Unë nuk u shërbej besimtarëve të feve të tjera! - deklaroi dhespoti duke i treguar derën.

Vëllai i Miços doli në rrugë pa ditur ku të shkonte.

Tani unë pyes: në ç'fe vdiq i ndjeri? U bë Muço apo mbeti Miço? Apo as Miço as Muço?

Tiranë, 1961

O ZOT, NA RUAJ MBRETIN!



Mbreti kishte dalë i prekarejtur nga pallati fill i vetëm, mfshehur, pa shpurë, pa kuaj, pa roje. Donte të shkonte për gjah dhe të ishte krejt i lirë nga salltanetet, servilizmat e oborrtarëve, nga trimat që e ruanin dhe nga shërbëtorët e shumtë që e rrethonin. A mund të jetonte një ditë si qytetar i thjeshtë i mbretërisë së tij?

Mishi i gjahut nuk mungonte kurrë në tryezën e tij mbretërore dhe ai më shumë lakmonte të çmpinte gjymtyrët, se sa të gjuante. Pasi eci një copë herë midis pyllit, duke dihatur ajrin e freskët dhe të shëndetshëm, ndjeu etje, mirëpo nuk e kishte idenë në ç'drejtim të shkonte, në ç'anë ta kërkonte ndonjë burim, a përrua. I besoi fjalës popullore se po të ndiqte një shteg diku do të dilte, prandaj vazhdoi të ecte duke fshirë djersët me shami.

Papritur pa një kasolle të vogël, të mënjanuar nga bota, rrethuar me një gardh të irnosur nga vitet dhe të çngjyrosur nga dielli. Mbreti iu afrua dritares të shihte nëse kishte njeri brenda. Që andej shqoi një grua të moshuar, e cila po falej para ikonave duke thënë me zë të lartë:

- O Zot, na ruaj Mbretin! O Zot, shtoji jetën Mbretit tonë!

Mbreti u befusua nga lutja e gruas së panjohur, në një kasolle të humbur mes pyllit. Ndryshe nga sa llomotitnin kundërshtarët e tij se pakënaqësia po rritej nga taksat e larta, se ekonomia ishte rrënuar dhe varfëria kishte pllakosur mbretërinë, kjo skenë dëshmonte se njerëzit e thjeshtë e adhuronin, populli e donte. Skena nuk mund të ishte e sajuar prej oborrarëve servilë, a e parapërgatitur, mbasi askush prej tyre nuk e dinte zonën ku po gjuante. Kureshtja e nxiti të hetonte pak më thellë përsiatjet e tij, të bindej katërcipërisht se ishte ashtu si mendonte, prandaj vendosi të hynte brenda, të shuante etjen dhe të shkëmbente dy fjalë me të zonjën e shtëpisë. Trokiti lehtë te dera, hyri brenda dhe pasi e përshëndeti plakushen, iu lut:

Një brojcë ujë, po patët mundësi, Nëno!

- Ja, tani! Urdhëro e ulu! - e ftoi të huajin pa u habitur prej vizitës, sepse në kasollen e saj hynin udhëtarë të rastit, gjuetarë e maltarë për të shuar etjen a për t'u mbrojtur nga shiu. Nga çiftja e çanta e krahut dukej si gjuetar, nga çizmet jo, prandaj e zonja e kasolles e pyeti:

- Gjuetar je zotrote?

- Gjuetar, - gënjeu mbreti.

- Po çantën e paske bosh, - vërejti plaka. - nuk të paska ecur sot, se edhe gjahu u shkretua... - Ajo shkoi përfund kasolles dhe hapi

vedrën me dhallë, se për të shuar etjen ajo pije ishte allaj-mallaj. - Të solla një gotë dhallë për të njomur grykën. Kjo na u ndodh, o bir, po me kohërat që kanë ardhur, faleminderit të madhit Zot!

Mbreti e piu dhallin duke falënderuar plakën. Mendja po i rrihte akoma te lutja e saj para ikonave, prandaj e pyeti:

- Vura re se qëparë po i luteshit Zotit t'i japë jetë e shëndet mbretit. Kaq shumë e dashkeni mbretin? Desha të di përse i detyroheni, ose më thjesht ç'të mirë keni patur prej tij?

- Të mira the zotrote? Të këqija po, se të mira s'ka patur kush nga ky mbret... Ç'të numërojë njeriu më parë, taksat e rënda, a detyrimet, a angaritë, a shtrenjtimin e mallrave...

Mbreti hasi një kontradiktë që nuk dinte si ta fthillonte, prandaj vazhdoi:

- Po atëhere pse i faleshit Zotit t'i zgjatë jetën? Pse nuk e lusni t'i japë një damlla a një kolerë?

- Uh, jo, Zoti mos e dhëntë! - Plaka i vajti pranë dhe duke i vënë dorën mbi gju, i kumtoi. - Dëgjo këtu, mor bir, kur ishte në fron gjyshi i këtij mbreti, shtëpinë e kishim plot, mallrat të lira, punëra sa të doje, shkurt fjala rronim për bukuri; kur sundonte i ati i këtij, eh çka, as mirë, as keq; kurse qëkur hipi në fron ky i tanishmi, u bëmë krënd e krunde, tertebull, më ngushtë kurrë s'kemi qenë, - shfreu plaka. - Mirëpo kështu siç ka nisur, keq e më keq po vete, prandaj unë i falem Zotit të na ruajë këtë që kemi mbi krye...

Tiranë, 1963

ÇAKALLI I MULLISIT



Duke shkuar midis pyllit, mullisi gjeti një këlysh çakalli që po dridhej nga e ftohta dhe uria; i erdhi keq për të prandaj e mori nën sjetull dhe e shpuri në mulli. Pasi e lau me ujë të vakur, e fshiu me pece, e ushqeu me qumësht, ia shtroi stromën pranë zjarrit. Këlyshi e mori veten shpejt dhe e shihte të zotin me mirënjohje. Mullisi mendoi ta mbante si manar, me shpresë se një ditë çakalli do ta ruante mullirin më mirë se një qen. E vërteta është se ata i përkasin një fisi dhe nuk kanë ndonjë ndryshim të

madh midis tyre as nga shtati, as nga pamja, veçse ndërsa qentë lehin, çakejtë ulërijnë.

Kohë pas kohe mullisin e brente dyshimi se me të ardhur vera, çakalli do të arratisej në pyll të bashkohej me shokët e tij. Mirëpo, po të donte të ikte, le të ikte, ai lidhur nuk mund ta mbante.

Sapo moti u ngroh, vendi u mbush me blerim dhe pemët gjethuan, çakalli dilte nga porta e mullirit dhe vrapin e linte në pyll. Mullisi e shihte tek largohej pa i ardhur keq, sepse e quante të natyrshme që ai të gjente shokët e vet dhe të rrinte me ta. Mirëpo për çudi, çakalli pasi bridhte gjithë ditën në pyll, në mbrëmje kthehej në mulli pranë të zotit. A nuk kishte mundur të gjente shokët e tij, apo kthehej aty nga ushqimi i bollshëm dhe strofka e ngrohtë, këtë mullisi nuk dinte si ta ndante. Mbase edhe e kishte harruar farefisën e tij, meqë u nda i vogël prej tyre.

Pastaj erdhi dimri. Nga mesi i shkurtit dëborë mbuloi vendin dhe kafshët e egra iu afruan qendrave të banuara për të gjetur ushqim. Një natë, përjashta mullirit u dëgjuan ulurima çakejsh. Çakalli i mullisit që po llupiste racionin e përnatshëm, ngriti kokën dhe curriti veshët. Sapo ulurimat u dëgjuan sërish, nisi dhe ai të ulërinte njësoj si ata.

Mullisit iu duk e pahijshme sjellja e çakallit, prandaj e pyeti:

- Mirë, ata përjashta ulërijnë se s'kanë ç'të hanë, po ti që e ke barkun plot dhe ha sa herë të duash, pse ulërin?

Çakalli e shikoi në sy mullisin dhe iu përgjigj:

- Kështu e kemi për fis. Kur ulërin kryetari, i mbajmë iso të gjithë.

GOMARI ME IKONË



Prifti i fshatit, mori ikonën e Zotit të Gjithëpushtetshëm që kishte porositur te zografi dhe i kënaqur nga puna artistike e piktorit i dha edhe një bakshish, sipër marrëveshjes së shpërblimit. Ikona e madhe me dru ah, e bukur, me ngjyra vezulluese, do ta zbukuronte altarin e kishës së tyre. E hodhi mbi sup dhe pa mënuar mori rrugën e fshatit, mirëpo pa dalë akoma mbanë qytetit, u lodh se piktura qe mjaft e rëndë, prandaj prifti vendosi të priste mbanë rrugës sa të vinte ndonjë pazarak me kafshë. Zoti Zot, po sa ta mbante mbi kurriz, më mirë t'ia bënte barrë dikujt. Gjithsesi Zoti kaluar se kaluar do të shkonte. Sapo pa një bashkëfshatar që po afrohej hipur mbi gomar, prifti iu lut:

- Xha Thimjo, më bën një nder? Merre ikonën e Zotit dhe shpjere deri në fshat. Lëre te dera e kishës sonë dhe po munde lajmëro kandillanaftin ta futë brenda. Të lutem!

- Hiç mos m'u lut, - ia ktheu fshatari me shaka, - se gomari do t'ia heqë të rëndët, jo unë.

- Veç mbaje me kujdes që të mos skërfitet! - e porositi prifti.- Hajt udha e mbarë dhe të qoftë ndihmë!

Fshatari e pa ikonën, bëri kryq tri herë dhe duke zgjatur duart ta mirrte, tha:

- O po qënka i bukur, i paçim uratën! I bukur dhe i rëndë, - shtoi duke e vendosur mbi prehërin e tij, si ta kishte fëmijë kimeti.

Ia ngjeshi thembrat gomarit dhe u nis për rrugë. Fusha krejt e gjelbërt nga grunjërat dhe barërat që kishin buisur me pranverën ndante qytetin me fshatin e tij rrëzë kodrave.

Ikona e pikturuar me ngjyra të forta, lëshonte shkëlqime vezulluese sa herë përthyente dritën e diellit. Fshatarët që tëharnin grurin nëpër arat e livadhet e tyre, shihnin një send të çuditshëm që vezullonte si ylber në prehërin e Thimjos. Për të shuar kureshtjen suleshin drejt rrugës për ta soditur nga afër. Posa dallonin ikonën e Zotit të Gjithëpushtetshëm, ndalonin në vend, uleshin në gjunjë dhe i faleshin me përgjërime duke bërë kryqin.

Gomari po çuditej se një nder të tillë nuk e kishte pritur kurrë. Kishte shkuar me qindra herë asaj rruge, por asnjëherë nuk i kishte parë njerëzit t'i dilnin përpara dhe të përkuleshin me nderim para tij. Nisi të mendohej se cili mund të ishte shkaku i këtij ndryshimi të papritur. Pasi u mendua paq, sa mund të mendohet një gomar, arriti në përfundimin se e nderonin për vetitë e tij të shumta. I zgjuar po, i bukur po, i urtë po, këngëtar i shkëlqyer po, e meritonte t'i përkuleshin dhe t'i binin në gjunjë. Që të tregohej i edukuar dhe t'ua shpërblente përkushtimin, gomari bënte reveranca të zgjatura, ngrinte bishtin përjetë, shpërvilte buzët dhe pëlliste me etikën më të hijshme gomarore.

Thimjoja e duroi tri herë, pastaj i mërzhitur nga ndalesat e gjata dhe fodullëku i tij, ia priti:

- O gomar, mos u krekos kot, se nuk të falen as ty, as mua, po Zotit të Gjithëpushtetshëm që mbaj në prehër!

PAPA SAKOJA MËSON SI LEXOHEJ UNGJILLI

Derisa meshohej greqisht, të krishterët e Remasit hynin në kishë e dilnin prej saj, pa marrë vesh asgjë se ç'thuhej aty nga prifti dhe psalltët, nga ungjilli dhe apostujt. Kështu ata nuk dinin asnjë nga çudibërjet e birit të Perëndisë dhe as vuajtjet e tij para kryqit. Mrekullitë e Krishtit si e ktheu ujët në verë, si ngopi me pesë bukë një turmë gostiarësh, si shëroi ulokët e gjytyrymët, si e ngjalli Llazarin së vdekuri, ata i mësuan nga Papa Sakoja, atëherë kur librat e shenjta u përkthyen shqip dhe sinodhi dha urdhër që shërbesa të kthehej në gjuhën amtare. Natyrisht i besonin të gjitha ato që dëgjonin sipas parimit të njohur: “kanë ngjarë pa tregohen.” Rrëfimet i tërhiqnin më tepër se sa parimet morale të dogmës kristiane, të cilat edhe kur i kuptonin, nuk para u pëlqente t'i zbatonin.

Erdhi e Enjtja e Madhe e Pashkëve, dita kur lexohen dymbëdhjetë ungjij me episode nga jeta, mrekullitë dhe vuajtjet e Krishtit, birit të perëndisë. Besimtarët dëgjonin me vëmendje jetën dhe bëmat e tij midis farisenjve, judenjve e romakëve. I erdhi radha ungjillit të dhjetë ku përshkruhet kapja, gjykimi dhe torturat që pëson Krishti para vdekjes. Turma u mek sa në kishë ndihej edhe fluturimi i mushkonjave të Karavastasë. Papa Sakoja vazhdoi leximin me ton dramatik, se si farisenjtë e kapën Krishtin, i vunë mbi krye një kurorë prej gjembash, si ia mbërthyen duart dhe këmbët me gozhdë, si ia

shpuan gjoksin me shtizë dhe nga gjoksi doli gjak dhe limfë. Besimtarët u patakshën nga lemeritë që po u dëgjonin veshët. Si ishte e mundur ta trajtonin Krishtin në atë mënyrë dhe ai të duronte si të ishte kurrkushi? Për të hequr çdo dyshim, një peshkatar e ndërpreu priftin dhe e luti:

- Prit pak, uratë. Kujt the se ia paskan bërë këto paudhësi?

- Krishtit, - u përgjigj Papa Sakoja.

- Cilit Krisht? Krist Balashit që ruante dhitë e fshatit, apo birit të Zotit? - e pyeti për t'u siguruar.

- Po birit të Perëndisë, o të bekuar, - tha prifti me mallëngjim, - ka vuajtur i madhi Krisht...

- Kush e thotë këtë? - e pyeti një tjetër.

- Ungjilli ... - deklaroi prifti, - e kam të shkrojtur këtu.

Papritur dikush shpërtheu "Gënjen! S'ka mundësi ta nëpërkëmbnin Krishtin ashtu. Kurrën e kurrës." Një tjetër shtoi: "Nuk di ta lexojë Papa Sakoja." "Tallet me ne!" "Na mashtron dhe kujton se e besojmë." "S'bën për prift ky! "Zemërimi u shtua, pastaj shpërthyen sharjet: "Mjekërcjap! Lëngaraq! "Teleshmen!" dhe për të mbrojtur dinjitetin e Krishtit, e vunë përpara Papa Sakon dhe e nxorën nga kisha duke e shtyrë e shkëlmuar.

Mirëpo meqë s'kishin prift tjetër, u detyruan ta mbanin për shërbimet fetare të vitit.

U rrotullua moti dhe erdhi sërish e Enjtja e Madhe, nata e dymbëdhjetë ungjijve. Papa Sakoja arriti te paragrafi i torturimit të Krishtit dhe iu kujtuan sharjet e shkëlmet që kishte marrë, ndaj mbeti një hop mëdyshas. A ta lexonte ungjillin besnikërisht dhe të priste shkëlmime të tjera, apo ta kapërcente atë paragraf? Në çast i shkrepiti në tru zgjidhja më ideale dhe vazhdoi leximin: "...dhe iu sulën farisejtë Krishtit ta kapnin, po ai me nder u bëri glasën se u shpëtoi nga duart dhe iku."

Besimtarët u kënaqën, ndërsa Papa Sakoja mësoi se ishte më e urtë ta lexonte ungjillin ndryshe, se të hante shkëlme të tjera.

Tiranë, 1963

NGUSHËLLIMI



Nga mesi i viteve gjashtëdhjetë, xhaxhai ynë u kthye nga Amerika përgjithmonë, ose sikurse thuhej me terminologjinë zyrtare, u riatdhesua. Kjo donte të thoshte se humbi të drejtën të dilte jashtë shtetit. Që të mos pretendonte se ishte qytetar amerikan dhe të mos kishte mundësi të rikthehej në Kontinentin e Ri, edhe sikur të pendohej, pasaportën amerikane ia mbajtën qysh në doganë. Në vend të saj i dhanë një Letër Njoftimi me kapakë të kuq, si gjithë qytetarëve shqiptarë tetëmbëdhjetë vjeç e lart. Për dreq a nga injoranca e nëpunësit të gjendjes civile, a nga pakujdesia, datëlindja e Xhaxhait qe shënuar: 31 prill 1897. Ai sapo e mori në dorë tha: “Nuk e paskam ditur deri më sot, se prillet në Shqipëri paskan tridhjet e një ditë.” Edhe ne u befasuam nga kjo shpikje kalendarike që turpëronte vendin tonë në sytë e një bashkëatdhetari

LIBRARI
KONKORDIA
NR. INV. 60352

të porsa ardhur. "A t' u themi ta ndërrojnë?" e pyeta. "Edhe 32 prill të jetë, s' më prishet asgjë," tha ai.

Më se një çerek shekulli Xhaxhai e kaloi në Amerikë, si emigrant ekonomik. Gjatë asaj kohe ndryshoi rrobat, edhe pamjen. Nuk ishte më ai mimgalaqi i pocaqisur, me supe të rrëzuara që mbanin mend, por burrë buçkan pa asnjë rru dhë në faqe, me nofulla të forta, qafën me pala dhe me pak bark. Ngjyra bojë trëndafili e lëkurës rrezatonte shëndet, mirëqenie dhe siguri. Ky ndryshim flatroi nënën e tij, se i dukej sikur kishte lindur një div dhe gëzoi më shumë xhaxheshën, për arsye që kuptohen, e vuri në pozitë të keqe vëllain tim, që ishte instruktor partie. Deri më atë kohë ai thoshte se në shtetet kapitaliste punëtorët vuajnë, se janë të uritur, se shfrytëzohen nga pronarët, ndërsa tani kjo lloj propagande stononte nga faktet që shiheshin me sy. Barku i rrumbullt i xhaxhait, lëkura rozë dhe sidomos portofoli i tij xhumbë, pohonin të kundërtën.

Drejt peshimi i dikurshëm i vëllait si propagandist i zellshëm kundër imperializmit amerikan, mori të krisur, ngaqë iu lëkund vetëbesimi, se kampi socialist ishte parajsë dhe ne njerëzit më të lumtur të rruzullit, ndryshe nga ata fatkeqët që shfrytëzoheshin deri në palcë nga regjimet kapitaliste.

Falë kujdesit që tregonte shteti për dietën tonë, me racionimet për një seri ushqimesh, me tallonat dhe me pakësimin e sasisë së yndyrnave, mishit dhe bulmetit, brenda një viti xhaxhai e humbi mbipeshën dhe u bë po aq elegant sa edhe ne.

- Xhaxhai po rimerr tiparet tona, - më tha vëllai një ditë, - dhe mua kjo gjë më gëzon.

Mirëpo gëzimi i tij nuk vazhdoi gjatë, se xhaxhai vazhdoi të firaste nga muaji në muaj. U dobësua, u zhubros, u rru dh e u fishk e si një patlixhan i harruar në diell, i firasi barku dhe tulet dhe një ditë prej ditësh perëndoi sytë.

- Vërtet vdiq, - më tha vëllai, - por mori formë kombëtare...

LEHJE PER SOLIDARITET

Qeni i shtëpisë, duke dëgjuar angullimat ankuese të një këlyshi që vinin nga jashtë, turfullonte egërsisht me qimet e kurrizit të kreshpruara shtizë, duke lehur pa pushim me dhëmbët e duke u tërhuzur sa nga njëra anë tek tjetra të shkulte hurin që e mbante lidhur për të ndihmuar pinjollin e racës së vet. Disa fëmijë po argëtoheshin te vija e mullirit me një këlysh qeni, duke e zhytur në ujë. Ai i shkreti ca nga frohtësia e ujit që provonte mbi lëkurë, ca nga frika, angulliste në kupë të qiellit duke u rropatur të dilte në ledh. Mirëpo sa dilte mbanë, ata e zhytnin sërish, të kënaqur që kishin zbuluar një lodër të re, mbasi ajo moshë nuk e di ç'është mëshira. Ndërsa këlyshi angulliste i tmerruar, ata shkriheshin gazit. Qeni im nuk i shihte se e pengonin muret e avllisë, por kujtjet ankuese të këlyshit i dëgjonte shkoqur, prandaj tërhuzej me vrull duke skërmitur dhëmbët, ndërsa hallkat e zinxhirit vringëllinin vazhdimisht me rrapëllimë. Asnjëherë s'e kisha parë qenin e shtëpisë më të egërsuar se atë mesdite gushti.

U mrekullova nga solidariteti qenëror dhe menjëherë më shkoi mendja te instinktët e forta të racës, te thirrja e të parëve, sikurse e quan Xhek Londoni në tregimet e veriut. Ndjeva kënaqësi që ia zbulova këtë cilësi të çmuar qenit të shtëpisë. Ç'do të ngjante sikur të arrinte të këpuste zinxhirin ose të shkulte hurin? Do t'u vërsulej fëmijëve që po mundonin këlyshin, apo do të futej në ujë për të

shpëtuar pinjollin e racës së vet? Më lindi mendimi ta provoja nëse qeni shtyhej nga instinkti i ndihmës apo i hakmarrjes.

- Po mundohet shumë, i shkreti. Mendoj ta zgjidh qenin, - i thashë kunatit.

- Kurrsesi! Nuk e sheh sa i egërsuar është? - m'u përgjigj në mënyrë kategorike. - Ka rrezik t'i ngulë dhëmbët ndonjë fëmije dhe pastaj do të na hapen telashe...

- Unë mund ta mbaj nën kontroll, nuk do ta lëshoj zinxhirin nga dora, - e sigurova.

- Nuk ta këshilloj... sepse mund t'ju shpëtojë nga duart.

Derisa vazhdonte të lehte me gjithë forcën e gurrmazit, pa u prehur asnjë sekondë, derisa po e kërkonte me aq ngulm, e meritonte t'ia jepja atë kënaqësi.

I vajta pranë, shkula hurin tok me zinxhirin që ta mbaja më lehtë me të dy duart. Sapo e ndjeu se ishte i lirë të vraponte, sa nuk më tërhoqi zvarrë nëpër oborr. Atëherë kujtova kunatin dhe paralajmërimin për rrezikun që përmendi. Qeni u vërsul teposhtë, drejt vijës së ujit, andej nga vinin angullimat ankuese të këlyshit dhe hargalisjet e fëmijëve. Ecja me vrap pas tij pa e lëshuar hurin nga duart duke pritur se çdo të ndodhte kur të vinim te vendi i torturës. Pas dy minutash u ndodhëm pranë grumbullit të fëmijëve. Këlyshi po rropatej të dilte nga ujët me not duke angullitur me frikë, ndërsa fëmijët në të dy anët e jazit të mullirit, qeshnin. Qeni im e pa skenën së afërmi, pa u rropatur të futej në ujë për të nxjerrë këlyshin dhe pa u sulur kundër atyre që e mundonin. I hodhi një vështrim indifirent, njësoj sikur kishte harruar pse kishte lehur aq egërsisht, pa e përfillur aspak rodin e vet, pastaj filloi të nuhaste e të përmirte shpëndrat duke bredhur andej këtej sikur kishte dalë piknik. Si avulloi gjithë ai solidaritet, ku vajti gjithë ajo zhurmë?

Qerrata qen! Lehte vetëm që ta dëgjonin të tjerët...

Tiranë -1968, New York 1998

PSE S'DUKEN DJAJTË TANI?

Mixha Din, një plak imcak, me mjekër të rrallë e të thinjur, me sy të vegjël gjithë rrudha anës e me gojën të futur brenda, ngjante si i dalë nga përrallat. Meqë vuante prej ishiatikut nuk luante prej krevatit, veçse për të shkuar në banjë. Qe lindur e rritur në Kosovë, ndaj historitë që rrëfente i referoheshin gjithmonë vendlindjes së tij. Çdo mbrëmje, sidomos pas darke, rreth krevatit të tij mblidheshin njerëz për të dëgjuar rrëfime, përralla ose ndodhi nga jeta e tij, sepse Mixha Din ishte burim i pashtershëm. Shpesh rreth krevatit të tij, vinin edhe infermierët e rojes kur ishin të lirë. Këto seanca vazhdonin derisa në pavijon shuheshin dritat dhe binte zilja e gjumit.

Një mbrëmje, fare rastësisht, u hap seria e ngjarjeve me djaj e xhinde. Një djalë ziosh nga rrethi i Kolonjës po u rrëfente historinë e xhaxhait të tij nga kobimi me një djall. Ngjarja kishte ndodhur nja shtatë-tetë vjet para lufte. Xhaxhai jetonte në fshat dhe përditë shkonte në pyll për dru. Pyllin e kishin nja tre orë larg, prandaj niseshin me natë që të mos i zinte vapa rrugës. Në mes të natës e paskësh thirrur djalli duke shkërbyer zërin e fqinjit, me të cilin shkonte në pyll. Xhaxhai duke pandehur se po shkonte me fqinjin, e kishte ndjekur pas djallin pa dyshuar se kush ishte. Kaluan dy orë që po udhëtonin drejt pyllit, hipur mbi kuaj dhe agu s'po jepte shenjë. Bunacë e terr gjithandej, dritë kurrkund. Buzë një përroi të thellë xhaxhai e mbajti kalin, se donte të ndizte cigaren.

Dëgjuesit po ndiqnin me ankth udhëtimin e njeriut pas djallit.

“Sapo shkrepri flaka e shkrepse, dalloj se kalorësi që ecte përpara tij, e kishte këmbën leshtore si të cjamin. Atëherë ca nga nata pus, ca nga këmba me lesh, i palli se ai ishte qoftëlargu. Tha se nuk ndihej mirë dhe u kthye nga rruga. Kur arriti pranë shtëpisë së vet, e gjeti

fqinjin te porta duke samarosur kalin. 'A nuk më thirre ti dy orë më parë të shkonim për dru?' e pyeti xhaxhai. 'Je në vete? Unë tani sapo dal nga shtëpia?' iu përgjegj fqinji. Ta kishte futur djalli në përrua, s'do ishte kthyer gjallë xhaxhai," e përfundoi rrëfimin zioshi.

Leksi, kryeinfermieri i pavionit, e pyeti me ironi:

- E pse duhet ta fuste xhaxhain në përrua që ta vriste?

- Pse? Sepse djajtë nëpër përrenj rrijnë, ajo dihet, - ia ktheu zioshi.

- Pallavra! - tha Leksi pa asnjë mëdyshje. - Nga kush kishte frikë djalli dhe pse donte ta vriste?

Zioshi u mbrojti se ngjarjen ia kishte treguar vetë xhaxhai, me hollësi që s' mund të viheshin në dyshim, kurse Leksi i tha se që trillim i krijuar nga fantazia e xhaxhait. Dëgjimtarët s'po dinin cilin të besonin.

- Pse nuk të besohet që ka djaj? - e pyeti mixha Din Laksin.

- Hiç fare! - iu përgjegj kryeinfermieri.

- Po e di që unë kam takuar një djall e madje më ka shërbyer? - deklaroi papritur mixha Din.

Kjo e sfidoi keq njeriun që mbronte shkencën, sepse tani një dëshmitar tjetër sillte përvojën e tij, në të mirë të tezës së kundërt. Aq më tepër që paskesh qenë djall i mirë, kur dihet prej të gjithëve se ata i ke vetëm për paudhësira.

- Më kujtohet si tani, ka qenë ditë e shtunë, sepse një ditë përpara, të xhuma, kisha blerë një këmishë të re, - nisi mixha Din. - Aso kohe punoja shëgert te një furrtar me emrin Shaqe, njeri i mirë dhe i drejtë. Mendova të shkoja të lahesha në banjë para se të hapja dyqanin. Banjën e vetme në Novipazar e kishte Refiku, burrë esnaf nga fjalët dhe sjelljet, prandaj e nderonin të gjithë. Dola prej shtëpisë sapo thyhej nata, se e dija që Refiku e çilte herët banjën për myshtërinjtë. Doemos sa të ndizte zjarrin e të ngrohte ujët, duhej një farë kohe. Në rrugë xhan xhin; dritaret pa asnjë dritë, për fat banja e Refikut hapur. Shtyj pak derën e hyj brenda. I zoti po ngrohej mbi mangall me kurrizin kthyer derës që të mos e rrihte era. "Mirëdita!" e përshëndes unë. Ai diç mërmëriti nëpër dhëmbë me një zë të ngjirur. "S'qenka në qejf Refiku", thashë me vetën time,

po s'ia mora për të madhe, se i gjalli ka gjithfarë hallesh. U zhvesha e fillova të lahem. Ujët akull, po më shkonin bromza. "O Refik, po ala s'e paske ngrohur ujët? Unë po mërdhah," i thashë. "Tash po të bie tjetër," më thotë Refiku dhe pa luajtur prej vendit, zgjat dorën tre metra lart, mbush një sapllak me ujë të ngrohtë dhe ma vë përpara. "Qe ku e ke!" më thotë me zë të ngjerrur. Shoh llërën e tij gjithë



lesh dhe të zezë katran. Habitem si nuk e paskam vënë re se Refiku i paska pasë krahët hata të gjatë dhe gjithë lesh si këmbë ariu. U lava, u vasha, nxora një mexhite të bardhë, ia lashë mbi banak dhe dola. Refiku as e ngriti kokën nga mangalli. Pa shkuar as njëqind metra tej, shoh Refikun që po vjen kundrejt meje. Ç'po ngjet kështu, bëj çudi, një Refik e lashë atje, një po e gjej këtu? E pyes ku po vente. "Të çel banjën e të ndez zjarrin," më thotë. "Po ti o burrë mahitesh kot me mua, se banja ishte hapur dhe unë sapo u lava atje. Qe dhe flokët e lagur... - i them. "Veç në e ka hapur djalli, se unë çelsat i kam me vete", më tha duke m'i tundur para syve. Atëherë u ktheva dhe unë tok me të. Për çudi zjarrin e gjetëm ndezur, mangallin aty, kurse djalli që zhdukur, - e përfundoi rrëfimin mixha Din.

- Ohoho, na kandise, - qeshi Leksi, pastaj vërejti plot seriozitet, - këto janë bestytnira, mixha Din, dua të them trillime, gjëra të kota. Nuk ka qenie të tilla, - vërejti kryeinfermieri për t'u dhënë dërmën besimeve të kota.

- Unë e kam parë me sytë e mi, - ngulmoi mixha. - Djaj ka pasur gjithmonë dhe ata dikur shëtisnin rrugës, dilnin sheshit...

- Po tani ç'u bënë, ku janë, pse nuk duken më? Ke parë ndonjë djall gjatë viteve të fundit?- e mbërtheu me pyetje të njëpasnjëshme Leksi.

Gjindja po priste veshëngrehur përgjigjen e mixhës. A do ta pranonte humbjen apo do të ngulmonte në mendimin e tij?

- Jo, s'kam parë më, po e di pse? Sepse tani ata janë futur në barkun e njerëzve dhe s'ka zot t'i dallojë prej tyre... - e përfundoi rrëfimin mixha Din.

Gjindja rreth e rrotull shpërtheu me të qeshura miratuese.

LETËR NJË MIKU TË SHQIPËRISË NË SKANDINAVI



I dashur Svanson!
Sa i gëzuar ndihem që Shqipëria ka një mik të çmuar nën hapësirat boreale të Skandinavisë! Artikujt që keni shkrojtur për Shqipërinë nëpër gazeta dhe revista i kam përpirë me etje të madhe, si ujin e ftohtë në verë dhe mund të them sinqerisht se jam habitur me disa nga habitë tuaja që keni parë në Shqipëri.

Shkrimet e të huajve na ndihmojnë të vlerësojmë mrekullinë mes së cilës jetojmë, se të themi të drejtën, ne shpesh e harrojmë, se ngrihemi prej shtratit në orën dy a tre të natës, për të zënë radhën e qumështit. Megjithëse tallonat s'po na ndahen dhe radhët për mish e djathë, vezë e zarzavate, janë të gjata, udhëheqësit e partisë krenohen me fitoret e arritura, me përqindjet e realizimit të planeve, me shifrat krahasuese të vitit 1938, aq sa kemi filluar të besojmë se ritmet tona janë më të lartat në botë, pavarësisht nga të ardhurat për frymë.

Ne shqiptarët, siç mund ta keni vënë re, i duam dhe i respektojmë të huajt si asnjë popull tjetër, madje në kodin tonë të mikpritjes largësia gjeografike gëzon privilegje të veçanta. Sipas konceptit tonë, vendi i nderit në sofër i takon mikut më të largët, sepse ai është lodhur më shumë, ka përshkuar rrugë më të gjatë për të nderuar të zotin e shtëpisë. Këtë traditë, për fat të mirë, e ka kultivuar edhe sistemi socialist, qëkur aleatët politikë i zë sa më larg, në anën tjetër të globit. Partia jonë i sajdis miqtë e saj, duke u vënë në dispozicion hotelet më të mirë, plazhet më të bukur, vetura për shëtitje turistike nga Shkodra deri në Sarandë, për t'u treguar sa i pasur e sa bujar është sistemi ynë socialist. Dhe ata pasi hanë e pijnë e pushojnë falas buzë Jonit ose Adriatikut, nuk i kursejnë allelluiat dhe hosanatë për udhëheqësit tanë.

Ne, natyrisht, nuk jemi aq modestë sa të mos vetëlavdërohemi, përndryshe pse do t'i mbanim gjithë ato gazeta e revista, e radiostacione e TV, e një mori rrogetarësh, gazetarë e publicistë të cilët kanë për mision ta zbukurojnë fasadën e rendit tonë. Mirëpo, tani që deklaratat e marksistë-leninistëve të vërtetë, - të cilët, ta themi midis nesh, e kemi të pamundur t'i dallojmë nga të pavërtetët, - u zbardhën dhe nuk i beson njeri, kemi nevojë për miq nga vendet neutrale, për personalitete e publicistë të cilët t'i flasin botës për sukseset tona. Ku ta gjejë vendi ynë një mik si ju që shkruan nëpër gazetat dhe revistat evropiane!

Askush nga miqtë e Shqipërisë nuk e ka kuptuar më mirë se ju, moton e partisë sonë "Bujqësia-çështje e të gjithëve," qëkurse erdhët nga Skandinavia së bashku me gruan tuaj për të prashitur misrin në kooperativën e Zëmlakut. Besa jo dy javë, por edhe dy ditë të kishit punuar, devollinjtë do t'ju mbanin në pëllëmbë të dorës, se deri më sot asnjë i huaj s'i ka ndihmuar ashtu si ju me bashkëshorten tuaj, prandaj dhe ju gostitën me specialitetet e tyre, byrek me armë dhe piper të kuq, gogozhare të mbushura me gjizë dhe fasule pllaqi. Ky fakt tregon se në dejet tuaj vazhdon të vegjetojë gjaku i kreshnikëve të Kalevallës, se jeni pasardhës i denjë i Vikingëve, të etur për

aventura dhe zbulime, ndryshe nga suedezët e sotëm që e kanë mendjen te paratë dhe te diskot.

Posa njohët anët më pikante të realitetit shqiptar, e ndjetë për detyrë t'ua kumtonit bashkëatdhetarëve tuaj dhe mbarë botës, duke shkruar një libër me mbresat tuaja. U befasuat sapo zbuluat se ne qenkemi vendi i vetëm në rruzull pa taksa. I vetmi vend që mbahet pa taksa! E vërtetë si drita e diellit, pohoni ju.

Zot o Zot, edhe taksat kemi mangut ne! Kush të paguajë taksa derisa nuk lejohet tregëtia private, madje as ushtrimi i ndonjë lloj profesioni jashtë sferës shtetërore? Miqtë tuaj skandinavë llogaritin sa do t'u shtoheshin fitimet po të jetonin në Shqipëri, ku do të kishin privilegjin të mos paguanin asnjë taksë, pa u shkuar mendja se do t'ua kishin shtetëzuar pa shpërblim fabrikën, punishten, dugajën apo restorantin duke i lënë karkacull. Kokëçarje financiare nuk kemi; këtë e themi me gojën plot. Ne nuk na shqetësojnë hipje-zbritjet e bursës, luhatjet e tregut monetar, ngritja dhe rënia e vlerës së aksioneve, mbasi kemi lumturinë të marrim njetë rrogën e bekuar të pesëmbëdhjetë ditëshit, pa u merakosur për asgjë tjetër, veçse si të arrijmë të mbulojmë shpenzimet e ushqimit, deri ditën e rrogës tjetër.

Por edhe pa taksa fare nuk jemi. Nuk u informuan se dogana jonë i takson qytetarët të paguajnë 100/100 të vlerës së sendeve që u vijnë dhuratë nga të afërmit e tyre jashtë shtetit. A ka ndonjë shtet në botë t'i detyrojë qytetarët t'i blejnë edhe një herë dhuratat me çmimet e rrjetit tregtar? Edhe bankat u mbajnë të holla qytetarëve, sa herë thyejnë çeqe, po ato quhen "kamatat tona," jo taksa. Për çdo trashëgim pasurie nga çdo vend i huaj, shteti ynë i dashur u mban qytetarve 15% të vlerës, edhe këto si "komisionari," jo taksë. Për këto vogëlsira nuk besoj t'u kenë vënë në dijeni shoqëruesit tuaj.

Raporti midis rrogave të larta dhe të ulëta, pohoni ju zoti Svanson, (s'di si t'u quaj zot a shok?) është një me dy. Fantastike! Çdo suedez që lexon librin tuaj mrekullohet nga barazia e hatashme e sistemit tonë. Biondinet që shesin gazeta në kioskat e Wilhelmsstrasse, apo

burrat që mbledhin lëkurë drerësh nga eskimezët e Laponisë, dashur padashur mendojnë se do të ishte ideale sikur edhe ata të merrnin gjysmën e rrogës të kryeministrit tuaj ose të Mbretit Olaf.

Ju lutem më ndjeni, mbasi këto kohët e fundit, për shkak të bllokadës së egër imperialisto-revizioniste, nuk kam patur mundësi të azhurnohem me të rejat e shkencës së matematikës, se ndoshta ka dalë ndonjë metodë tjetër njehsimi, po për mua që vazhdoj llogaritjet me sistemin e Pitagorës, pjesëtimi më del ndryshe. Ministrat tanë marrin nga 17,000 lekë e lart, Kryeministri 19, Sekretari i Parë 21 mijë, (pas uljes së rrogës me dëshirën e tij, sepse më parë mirrte 30 mijë), kurse shitësit, pastrueset dhe kamarierët nga 3,800 deri 4 mijë lekë të vjetra. Po të pjesëtojmë 21 me 4 a nuk hyn pesë herë dhe diç tepron? Atëherë si na dalka raporti dy me një?

Mik i dashur, të ardhurat e nomenklaturës sonë s'ka ekonomist në botë që t'i llogaritë. Edhe Adamsi me Marksën sikur të ngriheshin nga varri, më kot do të rropateshin. S'ke ide sa të ngatërruara janë, mbasi veç atyre që rrëmbejnë vetë me të dy duart, shteti u paguan qeranë e vilave, bisedat telefonike, ngrohjen, ujin, elektrikun, shoferin, makinën, benzinën, pastruesen, kopshtarin, furnitorin e sa e sa të tjera.

Nuk di sa kushton një televizor bardh e zi në Suedi, po këtu tek ne që ta blejë një kryfamiljar duhet të kursejë katër vjet me radhë nga 100 lekë (të reja), në muaj, pa permendur TV me ngjyra, për të cilin çmimi mendohet të jetë sa një rrogë vjetore mesatare, me konditë që atë vit personi nuk duhet të blejë as çorape, as këmishë, as këpucë, pa le kostum dhe natyrisht s'duhet t'i shkojë as nëpër mend të hajë ushqime me origjinë shtazore a barishtore a të pushojë në ndonjë barakë anës detit.

Konfeksionet tona industriale, nuk shiten as brenda shtetit, pa le jashtë dhe për të liruar raftet e magazinat nga stoqet, s'ka çare tjetër veç t'ua dërgojmë dhuratë vietnamezëve, se ata si më të varfër pranojnë çdo gjë. Ne synojmë të shtojmë eksportin dhe të pakësojmë importin, po deri tani kemi arritur sukses vetëm në krahun e kundërt. Më të rrallë tregëtia jonë sjell prodhime të lira nayloni, të cilat tregu

borgjez i ka hequr nga qarkullimi si antihigjenike, kurse ne që e kemi shërbimin mjekësor falas, nuk merakosemi për higjienën, siç mund ta kesh vënë re sapo ke hyrë në nevojtoret tona.

Sikurse e pohoni edhe ju, tek ne ka qetësi hënore. Doemos, sepse ne sipas shembullit kinez, i ndaluan edhe orkestrinat e lulishteve që jonizonin atmosferën me tinguj gjatë verës. Ju thoni se gëzojmë lirinë e shtypit dhe të fjalës. Kjo është e vërtetë, askush s'na ka ndaluar të lavdërojmë partinë dhe qeverinë, megjithse nuk arrijmë t'i dallojmë, se janë po ata njerëz si andej si këtej. Ne brohorasim edhe kur partia na shkurton rrogat, ose oborret personalë, sikurse ngjau disa vite më parë. Ka popull tjetër të bërtasë nga gëzimi kur ia cungojnë të ardhurat, të drejtat, ose pronën? A nuk është edhe kjo një nga mrekullitë shqiptare?

Këtë letër do t'ua dërgoja në Suedi me postë ajrore, sikur t'i besoja Kushtetutës sonë për paprekshmërinë e korrespondencës personale. E di mirë se çdo letër që hyn a del, lexohet me kujdes nga nëpunësit e ngarkuar me këtë detyrë, të cilët mbajnë shënime të hollësishme në dosjet përkatëse. Këtë ma ka thënë një kushëriri im sigurims që punon në postën e jashtme. Oh, të jeni të sigurt, edhe ju e keni një dosje, sado lajka t'u servirin. E dini se shoqëruesit tuaj që u prezantohen si nëpunës të M. Jashtme, janë oficerë të M. Brendshme veshur civilë?

E quajta të nevojshme t'ju kumtoj disa hollësi në lidhje me vendin tonë, për ta kuptuar më thellë "mrekullinë shqiptare," që t'i keni parasysh në librat e tjerë, se sa për vete jam i bindur se ne vërtet po e mahnitim botën me varfërinë dhe gënjeshttrat tona.

Juaji me respekt.

P.S. Nuk mund t'ua shkruaj as emrin, as mbiemrin, se e di mirë që pa shkuar letra jashtë, mua më kanë futur brenda.

Tiranë, tetor 1987.

BROHORIMA "MADE IN ALBANIA"

Javën e kaluar gazeta "Zëri i Popullit" botonte një kryeartikull kushtuar tregëtisë së jashtme, ku midis të tjerash shkruhej se të gjithë e kemi për detyrë të mendojmë seriozisht për eksportin, të vrasim mendjen si të shtojmë gamën e artikujve tradicionalë, duke e patur të qartë se pa eksport nuk ka import. Ky paralajmërim publik drejtuar qytetarëve se pa shitur s'kemi si të blejmë, më zhyti në mendime të thella, mbasi unë, si qytetar i thjeshtë, jam i ndjeshëm ndaj problemeve që shqetësojnë shtetin. Gruaja, sapo më pa të brengosur, u interesua të mësonte shkakun, po më mirë të mos ia kisha treguar, sepse nisi të më qortonte: "Ti s'ke pse merakosesh as për eksport, as për import. Le ta vrasin mendjen ata që paguhen për atë punë, se mbetën duke bredhur nëpër Evropë si turistë të përjetshëm."

Milëfin e ka me nëpunësit e Tregëtisë së Jashtme dhe me ata të ndërmarrjeve me parashtesa dhe prapashtesa "Imp dhe Ex," si "Agroeksport," "Mineralimpex," e plot të tjera, të cilët shkojnë vazhdimisht jashtë shtetit për të shitur produktet tona dhe kthehen duke mbushur valixhet me rraqe për vete dhe me dhurata për shëfat e tyre. Mirëpo unë mendoj se problemin nuk duhet ta shohim aq ngushtë si gruaja ime. Duke blerë mall të jashtëm, ata gjithsesi ndihmojnë zhvillimin e tregëtisë ndërkombëtare e ndërkohë na japin kënaqësi të soditimit disa modele të hijshme. Le të llomotisin gojët e liga se tregëtia e jashtme mori të tatëpjetën, qëkur ato vende u



pushtuan nga farefisi i nomenklaturës, se gjoja pjesa më e madhe e tyre janë të paaftë. Për nder e kanë gabim. S'ke ide sa të shkathët që janë... Unë po u sjell vetëm një shembull të freskët. Kur partia e vuri si kusht zotërimin e një gjuhe të huaj, ata i siguruan dëshmitë e diplomat brenda javës, me firma e vula nga Institutet dhe Fakultetet, pa mësuar as tre fjalë. Pse nuk i thonë zotësi kësaj?

Tani që eksporti ynë ka pësuar rënie të ndieshme në artikujt tradicionalë si kromi, duhani dhe nafta, të cilat zinin më se 80 % të tregtisë sonë të jashtme, ne si qytetarë të devotshëm, e kemi për detyrë t'i ndihmojmë ekspertët e eksportit me propozime dhe sugjerime konkrete.

Fusha e tregëtisë së jashtme, veç njohjes së kërkesave, do edhe pak imagjinatë, fantazi. Gjithë sekreti qëndron t'i imponohemi tregut kapitalist me cilësinë e mallrave tona, me ambalazhimin tërheqës, sa t'i marrin arkat pa domate dhe kavanozët pa gogozhare dhe kryesorja pas mendimit tim, kryesorja, t'u ofrojmë mallra speciale, të cilat nuk mund t'i sigurojnë në asnjë vend tjetër të botës, sikur t'i kalojnë me radhë meridianët e globit dhe t'u ngjiten e t'u zbriten paraleleve të pesë kontinenteve si shkallëve të apartamentit.

Një artikull të rrallë, për të cilin tregu ndërkombëtar ka nevojë dhe në të ardhmen do t'i rrisë kërkesat edhe më shumë, kam kënaqësinë t'ua rekomandoj unë.

Ne mund të eksportojmë me leverdi brohorima, ovacione, duartrokitje frenetike, sidomos skandime, të cilat janë specialiteti ynë në fushën sonore. Ky mendim gjenial më lindi parmbrëmë, fare rastësisht, duke parë filmin e një regjisorit francez, me famë. Tek po kalonin sekuencat e një demonstrate masive, papritur më ngjau sikur gjithë sheshi Concord i Parisit, gjëmonte me një gojë moton tonë më të përhapur gjatë këtij gjysmë shekulli "-a-i-e-e, -u-e-u-e-e-e-e!" U befasova! Pse bërtisnin shqip dhe jo në gjuhën e tyre? Enigmën e zgjidha dje, duke biseduar me një shokun tim, redaktor në TV. Ladi më tha se regjisorit francez kishte vizituar vitin e kaluar Shqipërinë dhe që mrekulluar me... me se pandehni ju? Me ndërtimet e epokës socialiste, me bukuritë e natyrës, me rivierën e

virgjër? Jo, asnjë nga ato nuk i la mbresa, veç brohorimave tona. Përsosmëria e tyre e kishte mahnitur, sa menjëherë shprehu dëshirën të blinte disa dhjetra metro skandime masive për filmin e tij të fundit. Shefat e Radiotelevizionit shqiptar, për t'u treguar bujarë, ia kishin dhënë falas!!! Idioci me brirë. Gabim trashanik! Si u falka një xhevahir i tillë? Mendo njëherë sa dollarë do t'i kërkonin Kinostudios sonë sikur të blinte diçka të ngjashme nga Cinecitta ose Hollywoodi, ose nga çdo firmë e huaj?

Pa mblidh të lutem, njëmijë e dyqind delegatë në një sallë dhe stërviti të thërresin me një gojë -a-i-e-e, -u-e-u-e-e-e-e! Pa urdhëro të jenë në unison dyzet mijë qytetarë në sheshin Skënderbej? Sikur producenti t'u paguante bërtimtarëve qoftë edhe nga pesë dollarë, që për të është hiçmosgjë, do t'i duheshin dyqind mijë dollarë. Le që europianët e brezit të ri s'dinë të bërtasin, paguaji sa të duash, ndërsa amerikanët vetëm ulërijnë.

As ne nuk e patëm të lehtë ta përvetësonim këtë lloj arti. Na u deshën kushedi sa mitingje, plenumë, konferenca e kongrese derisa u stërvitëm. Falë kujdesit të Partisë së Punës që njehsoi bërtimat me patriotizmin, skandimet me unitetin, ulërimat me devotshmërinë dhe çirrjet me entuziazmin, ne brohorisnim pavarësisht nga kushtet atmosferike, diell a shi, në mjedise të hapura e të mbyllura, në terrene fushore, kodrinore e malore, ditën a natën. As acari, as zhegu i vapës nuk na e priste hovin. Me kohë brohorimat na u kthyen në rëfleks, madje kaq shumë na u rrënjos si zakon, sa edhe nëpër dasmat e mbrëmjet familjare, nuk na shkante mezeja në bark dhe as pijet poshtë gurmazit pa disa ovacione e skandime për partinë.

Asnjë popull tjetër s'ka bërtitur më gjatë, më me ashk e më me stil se ne. Kualifikimi ynë në fushën e skandimeve arriti një shkallë aq të lartë, sa mund ta quajmë profilizim. Fituam një përvojë të pasur, sa mund të na e ketë zili çdo shtet në Lindje dhe në Perëndim. Vërtet nuk kemi dijeni nga zhvillimet e fundit në shkencë dhe ndonjë zell i madh nuk na shquan për punë, nga disiplina çalojmë, ama për thirrje entuziaste, për ovacione e për skandime, s'na e kalon kush, jemi të pa arritshëm, kampionë.

Tani që kemi grumbulluar një stivë brohorimash entuziaste, që nga kopshtet e fëmijëve, shkollat, uzinat, repartet ushtarake, nga sheshet e qyteteve e deri te sallat e kongreseve të Partisë, pse të mos e hedhim në treg një pjesë të tyre? Sado të shesim, përsëri tepron boll për të mbuluar nevojat tona.

Çka duhet për ta hedhur në treg. Pako gjë. Një katalog nga specialistët e zërit për të klasifikuar thirrjet, ovacionet dhe skandimet, sipas terminologjisë klasike muzikore: *moderato*, *sostenuto*, *andante*, *allegro*, *allegretto*, *crescendo*, *allegro vivace*, *marziale* e deri *maestoso*. Do të jetë katalogu më i kërkuar dhe më i rrallë në botë. Dëshironi skandime engjëllore me zëra të bardhë fëmijësh? Urdhëroni! Doni brohorima lirike nga vajzat dhe gratë? Ja tek i keni! Ju pëlqejnë *marziale* nga ushtarakët dhe studentët? Preferoni brohorima parakalimesh? Diçka më solemne? Urdhëroni! Kemi duartrokite frenetike dhe skandime hysterike, më falni historike, nga gjithë kongreset e PPSH. Çmendesh kur i dëgjon. Të furishme, të stuhishme, murpërshkuese, dallgëzuese, madhështore dhe maestre...

Suksesi do të ishte i bujshëm dhe kërkesat të pashtershme, sepse një artikull të tillë s'e ka askush, veç nesh. Brohorimat janë arritja më madhështore e partisë, pasuria më e çmuar që ka krijuar sistemi socialist.

Blini brohorima "Made in Albania"! Më të mira s'keni ku gjeni!

Tiranë, 1989

TREGIME

KU JENI JU, SHQIPONJA?

Grupi i filmit dokumentar “Vendi i shqiponjave,” u mbledh për të shikuar në ekran xhirimet e javës së fundit. Pas vizionimit, regjisori sovjetik Ilia Fjodoroviç Kopalnikov, deklaroi:

- Sekuencat më pëlqyen dhe me këto e quaj të përfunduar procesin e filmimeve në terren. Tani materialin mund t’ia dorëzojmë montazhit, po më parë duhen kompletuar titrat. Djema, - tha ai me zë autoritar, - hapja e filmit duhet të jetë mbresëlënëse dhe e pakonsumuar si ide. Kam menduar gjatë për të dhe së fundi, pas shumë rropatjesh arrita të gjej diçka të bukur dhe specifike. - Prej gëzimit filloi të fërkonte duart. - Tani pres nga ju të më thoni nëse ia kam qëlluar!

Të tre ndihmës regjisorët po e shihnin në gojë.

- Titrat do të shoqërohen me fluturimin e një shqiponje në sfondin e kaltër të qiellit, në mënyrë që të përlijet plotësisht titulli “Vendi i shqiponjave.” Sikur spektatori të mos shohë në ekran asnjë shqiponjë, titulli do të ishte në hava, pa pedestal, pa bazament, kurse po t’i jepet mundësia për të soditur atë shpend madhështor, simbolin karakteristik të vendit tuaj, do të mrekullohet. Kjo hapje premtion emociione artistike për shikuesit, të cilat do t’i mbeten në kujtesë për një kohë të gjatë. Nga ana tjetër fluturimi i shqiponjës drejt qiellit ngërthen një metaforë simbolike, se ashtu sikurse shpendi edhe Shqipëria po arrin lartësi të lakmueshme brenda familjes së shteteve socialiste.

Të tre asistent-regjisorët shqiptarë, Abazi, Nestori dhe Fredi po e dëgjonin si dishepujt profetin, duke u përpjekur të mbanin mend çdo fjalë, për t'i përsëritur më vonë si mendimet e tyre. Ideja që vërtet fantastike: një shqiponjë që rreh flatrat në qiellin e kaltërt, mbi shkrepat e maleve, do të ishte simbolike dhe njëherësh do të jepte peizazhin karakteristik të vendit.

- Madhështore! - u shpreh Fredi me një fjalë.

- Kryevepër! - e vulosi Abazi.

- Ide e shkëlqyer! - e përcaktoi Nestori.

Regjisori sovjetik ua shpërbleu komplimentat duke përkulur paksa kokën. Qëkur "Mosfilm" ia ngarkoi Kopalnikovit misionin e dokumentarit për një vend mik, ai besoi se ky ishte konfirmimi më i mirë i vlerave të tij artistike.

- Vendi juaj, qëkurse mban këtë emër, duhet të jetë citë me kësilloj shpendësh, -tha regjisori i huaj. - Tani çështja është të mos humbasim shumë kohë me këtë sekuencë. A mund të shkojmë diku këtu afër kryeqytetit, të kryejmë xhirimet dhe pastaj të nisim montazhin? - pyeti ai.

- Më duket se në Tiranë nuk ka shqiponja, - vërejti Nestori.

Regjisori sovjetik e shikoi paksa i habitur.

- Të paktën unë për vete, nuk kam parë, - shtoi Nestori si për t'u shfajësuar.

- Nuk keni parë shqiponjë asnjëherë? - e pyeti Kopalnikovi. Pastaj ia krisi gazit. - Oh, ç'shaka e bukur! E quan veten shqiptar dhe s'paska parë shqiponjë?!

- S'më ka qëlluar... - u mbrojt Nestori.

- E pamundur! - tha Ilia Fjodoroviçi prerazi, pastaj menjëherë dyshoi dhe e pyeti: - E keni vërtet apo doni të bëni humor?

Nestori pati një përskuqje të lehtë në fytyrë, sapo ndieua se me atë pohim kishte vënë në dyshim prejardhjen e tij shqiptare, të cilën e kishte trashëguar falas nga paraardhësit.

- Unë kam lindur dhe jam rritur në kryeqytet, - belbëzoi Nestori, - dhe kjo zonë nuk ka shpendë të tillë...

- Sidoqoftë kjo nuk u nderon, - shfaqti keqardhjen regjisori i huaj.-
Ja tek kemi këtu dy bij të denjë shqiptonjash! - tha duke goditur
miqësisht shpatullën e Fredit dhe qafën e Abazit.

Atë çast edhe një bir tjetër i vendit të shqiptonjave, Abaz Kalaja,
u kujtua se gjatë tridhjetepesë vjetëve të jetës së tij, s'kishte patur
fatin të shihte ndonjë lloj shqiptonje mbi kupën e qiellit të fshatit të
tij.

- As unë, sado që jam rritur në fshat, nuk kam parë shqiptonja, -
deklaroi Abazi me një farë turpi.

Regjisori e hetoi mos po fshihte ndonjë mahi.

- Skifterë po, nga ata kam parë. Edhe bufër, edhe laraska... - shtoi
pas pak. - Skifterët hyjnë në familjen e shqiptonjave, apo jo? - pyeti
me një fije dyshimi.

Duke përmendur shpendë kaq të zakonshëm, ai u zbuloi të tjerëve
dijenitë e tij të varfëra ornitologjike, sa regjisori i huaj u pendua që
e kishte pranuar si asistent. Për të dalë nga situata e vështirë,
Kopalnikovi iu drejtua Fredit.

- Ju? Sigurisht po!

- Unë kam parë një shqiptonjë të balsamosur, - pohoi ai me një
krenari të përmbajtur, - por nuk më kujtohet vendi...

U bënë tre shqiptarë që s'kishin parë shqiptonjë të gjallë me sy.
Regjisori, njeri praktik, si gjithë kolegët e tij mbi rruzullin tokësor,
filloi të rrihte kalemin pas dhëmbëve. Pa shkuar një minutë e gjeti
zgjdhjen.

- Djem, - u tha ndihmësve të tij, - duhet të takojmë patjetër ndonjë
specialist, se nuk do të ishte aspak serioze të filmojmë ndonjë lloj
shpendi tjetër. Nuk mund t'i lejoj vetes të rrezikoj prestigjin e fituar
me mundim dhe as të bëhem qesharak përpara kolegëve të mi. Pikë.

- Do ishte mirë të këshilloheshim me drejtorin e Kinostudios, -
sugjeroi Abazi.

- Besoni se ai ka dijeni të sakta për shqiptonjat? - pyeti regjisori.

- Shoku Naskë s'ka dalë kurrë për gjah, por si më i moshuar,
mund të na sugjerojë ndonjë vend, - e sqaroi Abazi.

- Drejtori është specialist për gjithçka, - vërejti Nestori me ironi.

- Si tek ne... - i mbajti havazin Kopalnikovi. - Atëherë shkojmë që tani, - propozoi ai duke u ngritur në këmbë.

* * *

- Ide e bukur! - tha drejtor Naskë Kristidhi. - Shumë e bukur! Të më falni se unë nuk jam i këtij profesioni, por daç besoni, daç jo, një ide të tillë e kam patur në kokë. Më pëlqen shumë, jashtëzakonisht shumë, sepse sikurse e theksova edhe më parë, e bluaja në mendjen time, por nuk e thashë nga modestia. Një shqiponjë duke fluturuar... papapa!

Emocionet i pati aq të forta sa u ngrit prej karriges dhe filloi ecejaket nga kaloriferi te dritarja.

- Veç, - shtoi pas pak duke ngritur gishtin përpjetë, - e di pse u përmbajta? Se shqiponja, ta themi midis nesh, është shpend grabitqar, rrëmben pula, gjela, keca... prandaj fshatarët nuk e duan hiç. Mirë do jetë të pyesim edhe më lart, se mos kushedi... Tani ata sigurisht do ta mirëpresin këtë propozim, por me që skenari i miratuar... hë, nuk e ka këtë detaj, nëse pyesim nuk bëjmë keq, sepse...

Për shkak të cilësive biokimike të trurit të tij, Naska nuk arrinte t'i formulonte mendimet deri në fund. Fjalitë e tij ndërpriteshin pas lidhëzave, tamam aty ku duhet të vazhdonin, duke lënë hapësira të zbrazura, të cilat mund t'i plotësoje si të doje. Për hir të kësaj veçantie, vartësit futeshin në diskutime të pambaruara se çfarë kishte dashur të thoshte drejtori.

- Ku mund të gjejmë një shqiponjë shoku Naskë? - e pyeti Nestori.
- Mos duhet t'i drejtohemi qeverisë?

- Shqiponjë? - pyeti habitshëm drejtori. - Nuk ka lezet t'i shqetësojmë shokët udhëheqës për të tilla vogëlsira, se ata... ou, janë të zënë me probleme të tjera. Përndryshe do mendojnë se ne, domethënë...- Buzëqeshja e tij ironike u dha mundësi vartësve ta plotësonin mendimin për bukuri.

- Kështu pra, ju thoni se nuk duhet shqetësuar qeveria, mbasi problemi nuk është aq i vështirë. - Regjisori me sensin praktik që e karakterizonte u kthye sërish te shqiponja.

- Përkundrazi, fare i lehtë. - Po ce o, keq për shkaba jemi ne? - Pauzë e shkurtër meditative dhe një buzagaz ironik triumfonjës. - Shkoni te ai, more, atje te kafshët, atje more si i thonë... te kopshti... - dhe papritur drejtori heshti.

- ... zoologjik! - i erdhi në ndihmë Abazi.

- Po, zoologjik, - përsëriti Naska duke cokitur gishtin mbi tryezë.

Kopalnikovi e falënderoi për sugjerimin shpëtimtar. Fredi kafshoi buzën prej inatit që nuk i ra ndërmend një gjë kaq e thjeshtë, ndërsa Nestori, nga marazi, nisi të fshinte ballin e djersitur.

- Nesër në orën tetë, ekipi te kopshti zoologjik! - urdhëroi regjisori fytyrëçelur.

* * *

Shqiponja kurrë s'kishte parë vizitorë më të bezdisshëm se atë mëngjez. I vinin rrotull kafazit duke folur pa pushim e duke e shikuar nga të gjitha anët. Ajo, si gjithmonë tregohej mospërfillëse ndaj njerëzve. Me sytë e rrumbullakët herë shihte e përhumbur hapësirën e qiellit, herë i mbyllte përgjumësh pa shfaqur pikë interesemi për vizitorët. Me qëndrimin e saj mospërfillës dukej sikur thoshte: "Pse keni ardhur qysh në mëngjez? Ç'doni prej meje që po më shqetësoni? Mbyllur në këtë kuvli të vogël ku nuk mund të hap as krahët, tani jam katandisur një koleksion zoologjik me trup e flatra të mpira. Edhe ushqimin ma sjellin të gatshëm. E shihni? Ja tek e kam mishin, te dyshemeja e kafazit, veç këtu nuk ndiej uri, prandaj as nuk më shijon."

Pasi e kundroi edhe nga bishti regjisori bëri vlerësimet e rastit.

- Nuk vlen për qëllimin tonë. Më duket mjaft e ngathët dhe e fjetur. Nuk ka sharm, nuk bën figurë. Më shqetëson sidomos qafa e saj e rrjepur si qafë lejleku. Ngjan e shëmtuar.

Shqiponja, si një damë e plakur që i di cenet e saj, i kishte dëgjuar ato fjalë kushedi sa herë nga vizitorët e pasjellshëm, ndaj nuk reagoi.

- Qafën mund t'ia rregullojmë, - tha Abazi.

- Si? Në ç'mënyrë? Me vizatim mbi film? - e pyeti regjisori. - E pamundur. Dyshoj se do të stonojë...

- Me paruke, - e sqaroi Abazi. - Paruken, më sakt një qafore me pendë, mund ta përgatisë grimieri ynë.

Në krahasim me truket e gjithfarsojshme të kinematografisë, ky qe nga më të thjeshtët, mirëpo Vali kundërshtoi duke thënë se qe grimier për njerëzit, jo për kafshët. Qëkur edhe shpendët i quante kafshë, merrej vesh se s'kishte haber nga shqiponjat, ose nuk e kishte idenë si mund të stisej një qafore me pendë të marra hua. Oresti u kujtua për parukierët e teatrit të Operas dhe Baletit. Ata, për fat të mirë, e pranuan misionin, me kusht që t'u paguhej si punë jashtë orarit zyrtar.

Pas dy ditësh qaforja qe gati.

Çdo gjë u përgatit me kujdes për të xhiruar çastin më emocionant, fluturimin e shqiponjës. Kujdestari i kopshtit zoologjik, Potapovi, ish-kolonel kavalerie në ushtrinë e Carit, të cilin era e fatit e kishte hedhur në këtë cep të Ballkanit, i kërkoi grupit të xhiritimit t'ia zëvendësonte shqiponjën e liruar, përndryshe nuk do ta nxirrte nga kafazi. Ata u përpoqën ta kandisnin se lirimi i shqiponjës kryhej për interesa të larta artistike, mirëpo fytyrëngrysuri kujdestar i kopshtit, rusi i bardhë, gjeti një përgjigje të zgjuar. Ai tha se një kopsht zoologjik shqiptar nuk mund të konceptohej pa patur në inventarin e tij, shpendin e adhuruar që hynte në simbolet e kombit. Konflikti u desh të shqyrtohej në kryesinë e Komitetit Ekzekutiv, prej nga varej kopshti. Ata sugjeruan që shqiponjës t'i lidhej një këmbë me filispanjë dhe asisoj mund ta ulnin sërish në tokë pas xhiritimit. Regjisori dhe operatorët argumentuan se nuk ishte e hijshme të lidhej shpendi simbolik dhe për hatër të ideve artistike për ligjej lirimi i saj. Më së fundi u arrit një kompromis: në rast se shqiponja s'do të kthehej me dëshirën e saj në kopsht, Kinostudioja do të paguante dëmshpërblimin e caktuar.

Të nesërmen komplet ekipi shkoi te kopshti zoologjik. Pritej çasti solemn, fluturimi i shqiponjës drejt hapësirës qiellore.

- Kamera gati! - bërtiti Kopalnikov.

Urdhëri që i tepërt se operatorët me vështrimin ngjeshur mbi okularët, i kishin fokusuar qëkur objektivat mbi kafazin e saj. Kujdestari e lëshoi shqiponjën në shesh, mirëpo shqiponja s'dukej të kishte ndonjë synim për t'u arratisur. Liria që i kishin falur i përngjiste pafajësisë që u jepet disa të dënuarve pas vdekjes.

- Duhet trembur, - sugjeroi Nestori, - përndryshe ajo s'ka për të fluturuar as deri në darkë.

Fredi iu afrua shqiponjës nga pas dhe u orvat ta trembte duke përpjekur duart. Nuk pati sukses. Shqiponja e mësuar prej vitesh me njerëzit, e dinte mirë se prej tyre nuk i kanosej asnjë rrezik.

- Duhet goditur me purtekë, - propozoi Abazi.

Goditja u konsiderua barbare, keqtrajtim, e pahijshme për shpendin krenar, prandaj u ndezën diskutime të flakta. Një palë shprehu mendimin se fshikullimi i mbretit të shpendëve që sakrilegi, kurse të tjerët e arsyetonin si nxitje për të fituar lirinë e saj. Fitoi pala e dytë. Një fëmijë hyri në sheshin e rrethuar me mjetet e sofistikuara të teknikës filmike dhe filloi ta fshikullonte shqiponjën nga bishti, që ta kujtonte të fluturonte. Shqiponja i mënjanohej purtekës duke ecur mbi bar ngadalë si një pulëdeti. Pas disa orvatjesh të pasuksesshme, kujdestari i kopshtit zoologjik zbriti në sheshin e betejës, ia rrëmbeu purtekën fëmijës, e theu më dysh dhe deklaroi:

- Lëreni të qetë, dreqi u martë! Nuk do të fluturojë, nuk do të largohet nga kopshti.

Potapovi i prekur nga besnikëria e shqiponjës, iu afrua ngadalë, filloi t'ia përkëdhelte kurrizin me dorë si ta kishte manar dhe në çast e liroi nga qaforja artificiale.

- Prej ngujimit të gjatë shqiponja e ka humbur orientimin, - vërejt i drejtori i kopshtit.

- Dhe veç kësaj ajo është 302 vjeçare, - shtoi rusi i bardhë.

Nga ky kumtim sensacional u mahnitën të gjithë. Pra shqiponja kishte lindur në kohën e Luigjit XIV dhe që akoma gjallë! Duhet patur respekt për moshën e saj mesjetare. Ndërkohë Potapovi mbajti një leksion të shkurtër ornitologjik, pas të cilit njohuritë e regjisorit

dhe të asistentëve rreth familjes së shqiponjave u shtuan ndjeshëm. Ata mësuan se ato ndaheshin në shqiponja mali, fushe e kënete dhe në atë familje të nderuar hynin edhe disa grabitqarë pulash si gjeraku, skifteri, fajkoi. Më madhështorja nga përmasat dhe më e bukur mbetej shqiponja e malit.

- Një e tillë na duhet, - u dha fund diskutimeve regjisori. - Këtu e humbëm kohën kot me një plakushe kënete.

* * *

- E kisha këtë frikë, - tha drejtori i Kinostudios sapo mori vesh disfatën, - se këto shqiponjat e fushës... - dhe menjëherë heshti, pa e mbaruar frazën. Ndihej paksa i pezmatuar që sugjerimi i tij nuk kishte patur sukses.

- Po tani ? - pyeti padurimshëm regjisori.

Drejtori në pozë meditative, me shikimin nga dritarja që binte nga kopshti, dukej sikur sodiste natyrën. Larg si i mbështjellë me një tyl të kaltërt, dukej një pjesë e malit të Dajtit. Të kishte shqiponja atje në ndonjë shkrep? Kush mund ta dinte?

- Te gjuetarët! - tha Naskë Kristidhi duke drejtuar gishtin nga muri. - Vetëm ata e dinë se ku e kanë strofkën shqiponjat e malit. Mbaj mend se kur isha i vogël... - dhe aty kujtimet u ndërprejnë.

Kopalnikovi e admiroi si shpëtimtar, si njeriun që i nxorri nga një situatë pa rrugëdalje. Atë çast u bind se jo të gjithë drejtorët e marrin rrogën kot. Sado e zyrtë dukej situata, mendja e drejtorit e kishte gjetur sërish shtegun e daljes. Klubi i Gjuetarëve, për fat, i çelte dyert vonë në mëngjez por qëndronte hapur deri në orët e vona të natës.

* * *

Pengesat dilnin tamam atëhere kur besohej se qe gjetur zgjidhja. Kryetari i Klubit të Gjuetarëve, Shpëtim Sheldia, tha se ndihej i nderuar nga vizita e njerëzve të artit. Sapo i shpjeguan qëllimin, ai u

përgjigj shkujdesur si shkodran safi: "Shqiponja mali? Sa të duash, mor zot! Unë vetë mund të kem vrarë më shumë se njëqind..." Mirëpo kur filluan t'i kërkonin me ngulm hollësira të njëpasnjëshme se në cilën zonë, në ç'kohë e si i pati vrarë, ai deklaroi:

- Po tani ku me e ditë se ç'lloj kanë qenë, se ato pasaportë s'kanë patur, por që kam vrarë rosa në Lezhë dhe bajza në Divjakë, këtë e di me siguri.

Me bajza e rosakë e rrëzoi pazarin shumë poshtë, po regjisori i huaj e dinte se gjahtarëve dhe diplomatëve nuk mund t'ua shkulësh lehtë të vërtetën, prandaj e ceku problemin nga ana më pikante, duke theksuar se për të huajt Shqipëria dhe vendi i shqiponjave ishin sinonime.

Kryetari i klubit u përgjegj se kjo çështje serioze dilte jashtë kompetencave të tij, prandaj do të konsultohet me Këshillin e Përgjithshëm të Gjuetarëve. Rezultatit do t'ua njoftonte brenda dy ditësh.

Sikurse u mësua nga burime të brendshme, mbledhja e këshillit zgjati mjaft dhe raporti përfundimtar që më se i zymtë. Prej shtatë vjetësh e tëhu asnjë gjuetar s'kishte vrarë, plagosur ose kapur ndonjë shqiponjë. Arsyeya kryesore që se mishi i tyre as nuk hahej, as nuk shitej, prandaj s'kishte pse t'i harxhoje saçmet kot, kurse disa anëtarë kryesie bënë be se në Shqipëri as që kishte patur ndonjëherë asisoj shpendi. Kryetari i Klubit, si gjahtar me përvojë, e dinte fare mirë se ata betoheshin vetëm për gjëra që nuk ishin të vërteta. Pazotësinë e Klubit, Shpëtim Sheldia e kallaisi, duke u thënë artistëve të Kinostudios se gjahtarët nuk gjuanin shqiponja nga respekti që kishin për simbolet e kombit, çka nënkuptonte ndërgjegje të lartë ideopolitike. E dinte dhe ai se justifikimi që mjaft i bukur, por jo bindës, prandaj i shtoi hulumtimet. Duke pyetur shok pas shoku e mik pas miku, mësoi se një gjuetar nga Vermoshi, pesë vjet më parë, vrau një shqiponjë dhe ia pati shitur mësuesit të biologjisë për ta balsamosur. Veç nuk dihej nëse ai gjuetar rronte akoma, apo ishte ndarë nga kjo botë ku telashet pasojnë njëri-tjetrit si stinët. Sidoqoftë emri i Marka Ndue Markut, fshati dhe krahina u shënuan në letrën që iu përcoll Kinostudios.

Xhiksi me ekipin e xhirimit nisi udhëtimin drejt Alpeve te Veriut, ku në çdo shkrep gjeje nga një çift shqiponjash, sipas dëshmime gojore. Atje, te selitë e tyre të përhershme duhet të ishin drejtuar qysh ditën e parë, pa humbur kohë poshtë e lart. Makina ecte me shpejtësi në rrugën e asfaltuar. Tufa zogjsh fluturonin mbi fushë duke iu gëzuar diellit, verës dhe begatisë, ndërsa nëpër grunaja gratë korrnin grurin me drapërinj. Ekipi shpejtonte pa u joshur nga mrizet e burimet e klubit anës rrugës, me merak nëse do ta arrinin gjallë gjuetarin plak.

E deshi fati dhe e mira e artit kinematografik që Mark Ndue Marku, gjuetari i lashtë, të ishte gjallë e shëndoshë. Nuk para dëgjonte, po kjo nuk i prishte punë askujt dhe ca më pak të zotit. Ç'mund të dëgjojë një plak, veç qortimeve të nuseve dhe mallkimeve të plakës? Kësisoj Mark Ndue Marku rronte në botën e tij që ngjante me një film pa zë; megjithatë nga lëvizjet e buzëve i kuptonte fare mirë ato që thuheshin dhe kur dëshironte hynte në bisedë, përndryshe hiqej krejt shurdhan.

Prej kohësh zyrtarët që çatisnin në fshat kërkonin ose sekretarin e partisë, ose kryetarin e këshillit, pa i përfillur të tjerët. Ndërsa kësaj here njerëzit nga Tirana kishin ardhur kastile për të, për të takuar Mark Ndue Markun.

- A je, si je Mark Ndue Marku? - e pyeti Abazi, që e njihte disi më mirë ritualin e përshëndetjeve të malësisë.

- Gjallë prej Zotit, - u përgjigj ai.

- Midis nesh kemi edhe një shok sovjetik, e quajnë Ilia Fjodoroviç Kopalnikov - ia prezantoi Nestori, sepse ashtu ekipi i tyre fitonte më shumë peshë.

- A! - Sytë e Markut shkëlqyen prej habitë e gëzimit. - Prej Ruisë së Carit, a?

Dukej sikur te ai nuk kishte arritur akoma lajmi për revolucionin e Tetorit. Të tre asistentët s'po dinin si ta mbulonin atë gafë politike. Për fat Mark Ndue Marku pyeti:

- Bash për mua ka ardhur ky miku i largët?

- Po, veç për ju, - e qetësoi Nestori.

Marku ndihej i flatruar ndaj i shtriu dorën sërish mikut të largët. Regjisori i huaj përkuli paksa kokën duke e përhëndetur, pa e marrë vesh pse po e tokte së dyti.

- Baca Mark, ne deshëm t'ju themi... - nisi Nestori.

- Jo, - e ndërpreu Marku, - jo, he burrë, kurrë s'keni me më thanë pa e pjek nga një kafe e pa hangër nga një çap bukë me atë ç'ka na fali Zoti.

Njeriu i kulturuar dhe i qytetëruar respekton traditat dhe mënyrën e jetesës së të tjerëve. Dhe miqtë prej Tirane, me logjikën e trurit dhe me sugjerimin e stomakut, e pranuan pa amendamente propozimin e të zotit të shtëpisë. Pasi u ngrit sofa, u shtrua kuvendi. Sipas zakonit, atë e çeli i zoti i kullës.

- Po ju ndigjoj burra, - u tha Mark Ndue Marku. - Nji gja due me ju thanë. Po varet prej meje, quajeni të kryeme, - i siguroi miqtë pas pak.

Duke mbajtur sytë në gojët e miqve, dëgjoi përse ishin munduar deri aty. Pas shpalosjes së problemit, në dhomë ra heshtja. Të gjithë po prisnin padurimshëm të dëgjonin çdo të thoshte Mark Ndue Marku, gjuetari i fundit që kishte mundur të kapte një shqiponjë të gjallë pas Luftës së Dytë Botërore. Derisa po mendohej gjatë, problemi s'dukej aq i lehtë, edhe pas sigurisë së dhënë. Medet sikur të thoshte se ishin munduar kot.

- Qe o miq, rruga ma e mirë. Duhet me pre një berr e me e hudh në përrue, - deklaroi ai. - Shqiponja i merr erë coftinës së largmi e ka me ardh bash si me i dërgue lajm.

Miqtë u hutuan nga ajo që dëgjuan. Regjisori i huaj që s'kishte kuptuar asgjë, pyeti: "shto? shto?"¹

- S'kam ç'ka të shtoj ma, - ia ktheu Marku, duke pandehur se ai fliste shqip.

Nestori qeshi nga keqkuptimi, pastaj e futi regjisorin në temë. Ekipit i doli një pengesë krejt e paparashikuar dhe natyrisht u step. Kush do të paguante paratë e berrit të kurbanit, të cilat nuk figuronin në preventivin e filmit? Po sikur llogaria të mos ua njihte dhe t'ua bënte ngarkim zhdëmtimin? Asistentët u mëdyshën seriozisht. Nga

gjendja e topitur i nxori zëri kumbues i Mark Ndue Markut.

- O Lulash, bëzani Kolës ta ulë tufën teposhtë e pa shkue dielli në shpinë të qiellit, të jeni këtu me berrin e premë.

E pra, për fat të mirë, traditat e bujarisë nuk kishin humbur në malësi. Çdo gjë u përgatit me kujdesin më të madh. Berri u pre, u ngarkua mbi mushkë për t'u transportuar në vendin e caktuar, një dëshmi tjetër se çdo ide e madhe kërkon therorët e saj.

Regjisori, asistentët, operatorët e maskuar prapa shkurreve, rrinin duke përgjuar ardhjen e shqiponjës. Nuk u interesonte as panorama e ashpër alpine, as boranat, as bjeshkët ku dikur mrizonin shtojzovallet, sepse gjithë vëmendjen e kishin përqendruar te hapësira e qiellit. Në fillim mjaft të qetë, kurse me kalimin e orëve gjithmonë e më nervozë, vështrimet e tyre i drejtoheshin Markut. Te përroi kafshët e egra të pyllit po bënin haxhillëk. Natën zbritën e u gostitën me mish ujë të përhimtë, çakej hileqarë, dhelpra turiholla, ditën fajkoe e sorra e korba, vetëm shqiponja nuk denjoi të ngjëronte në atë sofër. Tri ditë e dy netë pritje, vrojtim, tension. Ndërkohë nga berri s'kishte ngelur tjetër, gjë veç ca copëra lëkurësh dhe kockash të bardha, që po thaheshin në diell.

U ther edhe berri i dytë dhe që të dallohej më lehtë, u vendos mbi një sukë.

Këtë herë lanë roje të armatosura me pushkë e çifte, duke u dhënë urdhër të qëllonin çdo bishë a shpend të paftuar, që do të vinte për të rrëmbyer ndonjë llokmë nga mishi i taksur për shqiponjat. Mirëpo ato ende s'po dukeshin. Shqetësimi i asistentëve dhe padurimi i operatorëve po arrinte deri në pikën e shpërthimit. Vetëm Mark Ndue Marku ndihej i qetë, madje i lumtur. Sodiste shkrepat, lugjet, bjeshkët, duke kujtuar kohën e rinisë, betejat me armiqtë, burrat e shquar që kishte takuar, vendet ku kishte gjuajtur dhe falënderonte me gjuhën e zemrës miqtë nga Tirana, të cilët ishin bërë shkak të shkelte atyre viseve në pleqëri e të përmallej deri në lot.

Herë pas here trurin e Nestorit e shigjetonte një mendim tinzar: "Po sikur, sikur të mos duket asnjë shqiponjë? Oh, ç'turp do të jetë për kombin tonë..."

Ditën e katërt në qiellin e kaltërt, një fluturak u duk mbi majën e një shkrep. Po afrohej duke bërë rrathë të mëdhenj, ndërsa krahët i lëvizte ngadalë dhe në disa pika të horizontit cepat e tyre dukej sikur shtriheshin shkrep më shkrep. Heraherës dukej si planer. Mark Ndue Marku e dalloj i pari dhe ua tregoi miqve me gisht, krenar si rrallëkush. Sikur të mos dyshonin nëse ishte vërtet shpendi i pritur, ata do të kishin thërritur në kor si fëmijët: “Shqiponja! Shqiponja!”

Era e këndshme e coftinës dhe ajo e thartirës së djersës së njeriut, i përziheshin shpendit në vrimat e sqepit, pa ditur ç’vendim të merrte, sepse njëra e joshte tjetra e largonte. Pastaj era e mishit fitoi. Shqiponja hetoi me kujdes para se të ulej në sukë. Ndonjë kurth nuk dukej, kurse mishi i shijshëm i coftinës skuqte aty mbi sukë. Shqiponja e hetoi berrin nëse mund ta ngrinte me kthetra, ta shpinte pranë strofkës së saj dhe ta hante me nge, mirëpo dukej tepër i rëndë, atëhere lëshoi disa klithma gëzimi, u ul mbi të, vështroi rrethëqark, pastaj nisi ta shqyente me sqep.

Një zhurmërimë e lehtë, e pakuptuar dhe e panjohur për të, i erdhi në vesh. Duhet t’i shmangej rrezikut, prandaj ngriti kokën dhe vërejti rrethëqark me kujdes. Pa u ngutur, rrahu krahët dhe me atë krenari që i kishte hije, u ngrit fluturim, ndërsa zhurmërima e kamerave rrëfente se shiriti i filmit vazhdonte të vërtitej.


Asistentët u shtendosën, operatorët fshinë djersët, ndërsa regjisori i huaj tha:

- Madhështore!

Sekuenca më e vështirë kishte përfunduar. Ufff!

U gjend një shqiponjë në vendin e shqiponjave!

U GJETËN NALLANET E ALI PASHAIT



Berati, me të përpjetat dhe të tatëpjetat e rrugëve, futur në një ndërsa vëllai im i vogël, Genci, e ngrinte në kupë të qiellit. “S’ka qytet tjetër në botë si Berati, është unikal në llojin e vet,” e mburrte ai. Ndoshta kjo ndjenjë i shkaktohej nga nostalgjia, mbasi prej vitesh jetonte në një qytet pa fytyrë si Lushnja, ku të marrin frymën kasollet, gardhet me zhuka dhe lerat. Unë e ngacmoja të na linte rehat, se akoma nuk dihej nëse Berati quhet “qyteti i një mijë dritareve,” apo i “një mbi një dritareve”? Diskutimi vazhdon prej një çerek shekulli dhe askush s’po i jep një interpretim shkencor, ndërsa për Gencin enigma ishte e zgjidhur. “S’ka dyshim “qyteti i një mbi një dritareve,” mbasi kjo i përgjigjet strukturës arkitektonike dhe pamjes së lagjes Mangalem, ku ishte qyteti i hershëm, kurse dritaret nuk i ka numëruar njeri deri më sot dhe as ka kuptim se numri i tyre ndryshon vazhdimisht.” Sidoqoftë ai e vizitonte vendlindjen vazhdimisht dhe kurdoherë interesohej të mësonte të rejat dhe ndryshimet që kishin ndodhur.

Genti ka mbledhur kushedi sa variante për legjendën e Tomorit dhe Shpiragut. Sipas tij, para ardhjes së sllavëve lumi Osum quhej Teta, çka duket e besueshme, ngase burimet e tij nisin nga tetë përrenj dhe vazhdon të gjallojë në këtë trevë edhe si mbiemër. Sllavët e përkthyen në gjuhën e tyre "Osum" dhe na e lanë peshqesh, ashtu sikurse edhe një mori toponimesh të tjera. Lumëzin e kthyen Çorovodë, Ujbardhën Bellovodë, Dardhën Kreshovë, Arrëzën Rehovë. Argumentet e tij e kanë gjithsesi një bazë logjike, sepse ka plot raste ku gjallojnë të dy variantet si për shembull Vodicë dhe Ujmisht.

Sa herë vjen në Berat, Genci ngjitet te Kalaja në kodër, për të soditur panoramën, për të marrë pak ajër nga lashtësia, sadoqë për mua atje s'ka asgjë interesante. Prej asaj lartësie hapet një panoramë mjaft larushitëse e luginës, por pasi e ke soditur njëherë në pranverë e herës tjetër në vjeshtë, nuk të merr malli ta shohësh më. Mua njëherë, jo.

Disa muaj më parë, drejtori i Muzeut, vari afishe në vendet publike, ku u bënte thirrje qytetarëve të Beratit dhe të fshatrave, ta pasuronin muzeun me objekte të ndryshme, enë, veshje, stoli të vjetra, qendisma e tablo, e çdo gjë që nuk u duhej. Tasi Qabeja u tregua i zgjuar. Duke i njohur mirë psikologjinë e bashkëqytetarët e vet, i joshi duke deklaruar se objekti do të shpërblehej nga një komision që ishte ngritur posaçërisht për atë qëllim. Lajmërimi e nxiti Gencin ta pasuronte muzeun me disa rraqe që nuk hynin në punë prej vitesh. Midis tyre një ombrellë e madhe që as hapej, as mbyllej dhe një palë nallane me sedef të bardhë e dru të kuq. Për ombrellën nuk hasi ndonjë kundërshtin, se ajo ishte hedhur mënjanë me kohë dhe nuk përdorej prej askujt, kurse për nallanet iu desh miratimi i gjyshes. Ajo nuk donte të ndahej prej tyre mbasi i kishte kujtim nga i ndjeri gjyshi ynë. Thoshte se ato ia kishte blerë i shoqi në Izmir, kur ishte nuse e re. Ne s'e kishim parë t'i mbathte ndonjëherë ato lloj nallanesh prej druri të kuq, me pafka sedefi të bardha të futura në të, ca në formë gjysmë hëne e ca si diej dhe ato rrinin kot në sepeten e saj prej më se gjysmë shekulli.

- Si ky dru s'gjen këtu në vendin tonë, - thoshte gjyshja. - Janë prej santali.

Ku e kishte dëgjuar atë fjalë të huaj dhe si e mbante mend, qe për t'u habitur.

Pasi Genci i bleu një palë shoshone fringo dhe një palë lëpitka lëkure, gjyshja u bind t'i nxirrte nga sëndyku, po dhe atëherë me gjysmë zemre, se kushedi ç'kujtime të bukura e lidhnin me nallanet dhe me Izmirin.

- Drejtor më të zellshëm se Tasi, muzeu ynë s'ka patur kurrë, - më tha Genci një ditë. - E mbajnë si të përëndur, se ai sapo dëgjon për ndonjë objekt interesant, niset në këmbë ta shohë me sytë e tij, ku të jetë, në Tomoricë a në Mallakastër. Edhe mbiemri i shkon për detyrën që ka, se duket sikur edhe vetë ka dalë nga historia.

Javën e kaluar, një lajm i botuar në gazetën lokale me titull "U gjetën nallanet e Pashait të Tepelenës," pati jehonë të gjerë. Tani edhe ata që e shpërfillnin Tasin, u detyruan të ndërronin mendim. E reja befasuese pushtoi atdheun, sapo gazeta "Bashkimi" e ribotoi artikullin. Genci e quajti zbulim të madh dhe meritat ia veshi Tasi Qabesë, drejtorit të Muzeut që kishte mundur të binte në gjurmët e tyre. Që nga koha kur ia prenë kokën Ali Pashait në Janinë më 1821, kishin kaluar 150 vjet dhe ishte paksa e habitshme si ishin ruajtur reliket e tij aq gjatë dhe ca më e çuditshme se si arriti Tasi t'i zbulonte. Le ta mbanin nëpër gojë si njeri të fantaksur, pacient rezervë të psikiatrisë, të përëndur.

Turma vizitorësh filluan të vërshonin në muzeum për të shikuar reliket e rralla. Drejtori, duke e ditur vlerën e tyre të madhe, nuk i ekspozoi në vitrinat e sallave, por i kyçi në një nga sirtaret e tryezës së tij të punës, ku mbante disa arturina antike, dy karfica ilire si dhe disa fotografi të Ministrit të Arteve duke vizituar stendat, ku në plan të parë dukej Tasi Qabeja. Vetëm disa të paktë gëzonin privilegjin t'i preknin me dorë. Të tjerëve ua tregonte nga një distancë që përjashtonte çdo rrezik përvehtësimit. Ekspozimin e shoqëronte me një përshkrim erotik, se si Pashai fuste këmbët te

nallanet, merrte një dush me ujë trëndafili dhe pastaj shkante në harem. Talenti i tij prej beqari të stazhionuar gjente fushë të shpërthente lirshëm në përshkrimin e skenave erotike.

Me t'u kthyer nga Lushnja, Genci kërkoi të vizitonim muzeumin, për të parë reliket e çmuara. E drejta, mua s'më hante malli për nallanet e Ali Pashait, se në fund të fundit nuk janë relike e çmuar për një pasha, por e shoqërova, meqë nuk desha t'ia prisja gëzimin.

Për mungesë ciceroni, Tasi e shoqëronte vetë çdo grup vizitorësh, që nga hajati i katit përdhes deri te kati i tretë ku kishte zyrën e tij. Po ashtu edhe asaj të diele. Kaluam pa ndonjë emocion mbi vitrinat me enë bakri dhe rroba të vjetra, të cilat i kishim parë kushedi sa herë. Gencit nuk i durohej sa të shihte nallanet e famshme, mirëpo Drejtori, duke ua ditur vlerën, i mbante me çelës në sirtaret e tryezës së tij, tok me disa arturina antike, dy karfica ilire si dhe disa fotografi të Ministrisë të Arteve kur vizitoi muzeun dy vjet më parë. Aty në plan të parë dukej Tasi Qabeja dhe pas tij një stendë me shpata e këllëçe. Ato objekte përbënin kulmin, ose kajmakun e vizitës së çdo vizitori në Muzeun tonë.

Edhe asaj të diele vazhdoi i njëjti ceremonial. Pasi na futi në zyrën e tij, drejtori u rehatua në karrige, nxori çelësat nga xhepi, hapi një sirtar dhe si rastësisht vuri mbi tryezë disa fotografi ku shquhej Ministri i Kulturës dhe Tasi përballë tij duke i shpjeguar eksponatet. "Ministri mbeti shumë i kënaqur nga vizita," tha Tasi kalimthi. Pastaj nxori disa gjerdanë, varëse dhe byzylykë prej floriri, zinxhirë ergjëndi, duke thënë se femrave ilire u pëlqenin ornamentet prej floriri. "Paskan qenë të zgjuara," pëshpëriti dikush. Padurimi i Gencit sa vinte po shtohet duke pritur të shihte eksponatin më të vyer të muzeut. Çasti i shumëpritur arriti. Tasi duke zgjatur dorën drejt një sirtari, shqiptoi me ton solemn.

- Ja edhe nallanet e Ali Pashë Tepelenës.

Ndërkohë ekspozimin e shoqëroi me përshkrimin e skenave erotike nga jeta e Pashait, sikur të kishte jetuar në sarajet e tij. Nallanet prej duri të kuq po kalonin dorë më dorë. Njerëzit po

habiteshin si me formën e tyre me taka, ashtu me shkëlqimet e sedefit mbi to. Genci i mori ndër duar dhe po i rrotullonte nga të gjitha anët sikur donte të zbërthente ndonjë enigmë. Pafkat prej sedefi të bardhë në formë gjysmë hëne, shndritnin mbi drurin prej santali të kuq, me reflekse vezulluese.

- Të Ali Pashajt janë këto nallane? - e pyeti me ton dyshimtar.

- Po, - i tha Tasi.

- Këtë që kam unë në dorë? - deshi të sigurohej njëqind për qind Genci.

- Po, Ali Pashai u fuste këmbët kur shkonte në harem...

Genci ia preu hovin e rrëfimit duke i thënë:

- Tasi, harrove? Këto t'i solla unë gjashtë muaj më parë. A nuk të thashë se mezi ia shkula gjyshes, mbasi i kishte kujtim nga i shoqi dhe nuk donte të ndahej prej tyre?

Vizitorët filluan të shihnin herë drejtorin, herë vizitorin e zemëruar. Fytyra e drejtorit ndërkohë po merrte të gjitha ngjyrat e ylberit. Ai rrokëzoi diçka se ato ngjanin, por nuk ishin tamam ato, se këto i kishin gjetur në Dishnicë, te familja e një agai, stërgjyshi i të cilit paskesh qenë qehaja i Ali Pashë Tepelenës.

- Ikë or drej me gjithë to! - i tha Genci duke ia lënë nallanet mbi tryezë.

Zbritëm shkallët pa folur.

Disa muaj më vonë dëgjova se ishte gjetur ombrela e Luigj Gurakuqit. Një ombrelë e madhe, më thanë, që as hapet, as mbyllet. Më vajti mendja se do të ishte ajo që i shpuri Genci, tok me nallanet e gjyshes. Ia thashë dyshimin tim vëllait.

- Nga ai ëndërrimtar i fantaksur, mund të priten dhe zbulime të tjera, - ma ktheu Genci. - Ai e ka mani t'ua kushtojë reliket personave historikë për të joshur vizitorë.

FYELLI “MAGJIK” I SHQIPTARIT



Para se të nisej për në Danimarkë ansambli folkloristik “Labëria”, Kamber Sinanaj e tërhoqi mënjanë Xhebro Nikën dhe me hijen që i jepte detyra si sekretar partie, e porositi:

- Xhebro, kujdes, mbaje moralin lart jashtë shtetit. Mos na turpëro!

Xhebroja e mbërtheu me një vështrim të rreptë sekretarin e komitetit.

- Pse, ç'më bëre mua? Shok të vetes? Pusht i dreqit!

Kamberi u mërrtue nga shpërthimi i Xhebro në mes të sheshit, ku dëgjonin dhe veshë të huaj, ndaj u prapësua duke pëshpëritur

nëpër dhëmbë: “Mirë Xhebro, mirë, një fjalë të thashë, nuk të vrava.” Mirëpo Xhebroja ishte prekur në sedër nga këshilla miqësore e një zyrtari që nuk shquhej për moral. I kërceu delli lab dhe e vazhdoi dialogun me zë të lartë. “Je atje ku je, por mos kujto se nuk t’i dijmë hynyeret. Do t’i këndojmë të gjitha sa të qorrollisesh nga posti.”

Kamberi deshi t’i thoshte se firma e tij e kishte futur Xhebron te ansambli Labëria, prandaj e kishte hak t’i sillte një peshqesh të vogël nga jashtë, mirëpo biseda mori ters dhe kësisoj përcjellja u kthye në ndarje.

* * *

Grupi artistik arriti në kryeqytetin e Danimarkës. Hoteli bukuri, qyteti i pastër, rrugët t’i lëpije me gjuhë, jeshillëk nga të gjitha anët, mirëpo përjashta bënte vapë dhe Xhebroja ndiente mall për freskun e maleve të Labërisë, për burimet e staneve dhe veçanërisht për një sapllak me dhallë. U rropat dy ditë me radhë, nëpër kioske, ëmbëltore e supermarkete të blinte një shishe a një gotë dhallë sa për të njomur grykën. Si nuk mundi ta gjente në asnjë cep, iu turr përkthyesit: “E ç’vendë të qytetëruara na qenkan këto, a i vrarë, ku s’gjen një pikë dhallë?” Sevoja i tha se aty mund të provonte pije të tjera freskuese, coca-cola, seven-up, gingerale, apo ananas. Xhebroja ia ktheu: “Mbyty me gjithë to se janë të ëmbëla, sherbet. Në behar asgjë tjetër nuk ma heq etjen, veç dhallit.”

Erdhi dita që “Ansambi Labëria” të jepte shfaqje para publikut. Të gjithë artistët, këngëtarë e valltarë, ishin të shqetësuar se si do të priteshin, ndërsa Xhebro Nika ndihej i qetë. Do t’i binte fyellit ashtu siç dinte, për qejf të tij, ashtu si në fshatin e tij.

* * *

Etnomuzikologu me famë ndërkombëtare, Prof. Jurgen Vanderbild, kishte ardhur së bashku me Shirlin, të fejuarën e tij, për të ndjekur festivalin. Ai, ashtu si dhe disa specialistë të tjerë, donin të shihnin nga afër evolucionin e folklorit të vendeve evropiane

nga dekada në dekadë. Interes më të madh ngjallnin grupet e vendeve të prapambetura, kryesisht të Ballkanit. Për të qe një rast ideal të shpaloste para së fejuarës njohuritë e tij të thella në fushën e etnografisë dhe veglave muzikore. Zoti Vanderbild pas diplomës për shkencat shoqërore, ishte specializuar për etnografi dhe më pas kishte fituar titullin prof. për veglat muzikore popullore. Shtëpia e tij ishte mbushur citë me vegla muzikore nga të katër cepat e dheut. Ai njihte timbrin e tyre, shkallët kromatike dhe frekuencat e kthjera në Herz. Diskoteka me disa mijëra pllaka gramafoni, disqe kompakte, kaseta e videokaseta mund t'ia kishte zili çdo institut folklori. Revista "Stern," e nxitur nga sukcesi që kishin korrur shqiptarët në Dizhon, ku u nderuan me Gjerdanin e Artë, iu lut etnografit të shquar t'u shkruante një reportazh për shfaqjen e tyre dhe ai e mirëpriti ftesën.

Sapo dolën në skenë amatorët shqiptarë, Prof. Vanderbild i pëshpëriti së fejuarës përkrah tij.

- Shirli, e dashur, shqiptarët i ruajnë me xhelozitë traditat e lashta. Sot vendi i tyre është oazi i vetëm në mes të Evropës ku folklori vazhdon të gjallojë si disa shekuj më parë. Adhurimi i tyre për folklorin është paksa jashtë kohës dhe koncepteve tona. Ata e kundrojnë si ledh mbrojtës kundër ndikimeve të muzikës moderne dhe rrymave të saj. Mirëpo a mund t'i përmbushë folklori nevojat shpirtërore të gjithë shtresave dhe moshave të popullsisë? Nuk e besoj. Megjithatë duhet thënë se folklori i tyre ka larmi të madhe dhe tipare origjinale.

- Uau! Po më pëlqejnë kostumet e tyre arkaike, - u shpreh Shirli.

- Studiuesit dhe masmedia i ndjekin me interes, sepse për arsye të pakuptuara, këta rrallë marrin pjesë në takime ndërkombëtare. Nuk përjashtohet mundësia që disa studiues të kenë ardhur posaçërisht për këtë grup, - e përfundoi informacionin profesori.

- Ashtu sikurse edhe ju, - e komplimentoi Shirli.

Sytë e damave u mbërthyen te kostumet fantastike, sa të vjetra aq edhe moderne, me kombinime ngjyrash nga më të ndryshmet. Qeskat me kikirikë, kokoshka, e cefla patatesh mbetën nëpër duart e kavalierëve. Vallet plot gjallëri ishin shpërthim i temperamentit të

tyre mesdhetar. Lëvizjet e vrullshme të meshkujve pasoheshin nga lëvizjet harmonioze të femrave. Programi ishte ndërtuar me shije dhe sens artistik. Vanderbildi si specialist, e ndiente ritmin e brendshëm të shfaqjes. Megjithatë nuk besonte se ritmi do të mbahej deri në fund. Folklori kishte kulme dhe ulje, të cilat s'mund të mënjanoheshin nga asnjë shfaqje. Si për të vërtetuar përsiatjet e tij, spikerja lajmëroi:

- Melodi me fyell. Ekzekuton mjeshtri popullor Xhebro Nika nga Labëria.

- Tani mund të hani kikirikë, madje mund të pini edhe kafe në banakun përtej, - i tha Vanderbildi së fejuarës. - Fyelli ka një timbër të trishtuar, vajtues e disi të çjerrë. Krijon monotoni akustike dhe melodia ndërpritet, ngaqë ekzekutuesi duhet të mbushet me frymë herë pas herë. Kjo është e meta e këtij instrumenti.

Sa mbaroi shpjegimet Vanderbildi, Xhebro Nika doli ne skenë. Tallaganeja hedhur në një krah, kalcet në këmbë, xhufkat e zeza mbi opingat e kuqe, qeleshja me pifth mbi krye, i jepnin një pamje fisnike e burrërore, të ashpër dhe të brydhët. Vuri fyellin në buzë dhe ia filloi melodisë shtruar. Prej fyellit dilnin tinguj që ngjanin me fëshfërimën e erës nëpër gjethet e pemëve, pastaj melodia u bë më e shpejtë, më gazmore, si gurgullimat e ujërave të pranverës nën një qiell të kaltër.

Shikuesit po e ndiqnin Xhebron me kureshtje, aq më tepër se fyelltari me kapele konike me një thimth si antenë sipër, nuk e ndërpriste melodinë për të marrë frymë.

- Jurgen, i dashur, ky nuk po ndërpret melodinë ... - i pëshpëriti Shirlu.

- Nuk besoj të jetë fyell, po diçka që ngjet me të, - tha etnomuzikologu, i befasuar nga instrumenti i panjohur.

Duartrokitje të gjata shoqëruan daljen e Xhebro Nikës nga skena. Vanderbildi së bashku me të fejuarën u sulën pas skenës të shihnin instrumentin e çuditshëm. Po nxitohej ta takonte para se t'ia rrëmbenin lavdinë nga duart shkencëtarët e tjerë, duke përshtuar një instrument të panjohur muzikor. Mezi mundi ta gjente fyelltarin

shqiptar midis asaj turme njerëzish që kërkonin autografe, që donin të fotografoheshin, të shkëmbenin kujtime e dhurata simbolike. Vanderbildi i buzëqeshi dhe Xhebroja po ashtu ia ktheu duke e pandehur të njohur. “Dre, të doli një mik edhe këtu, o Xhebro Nika! E po ku më njohin gjithë, që kaninjtë e mallakstriotë e njer më këtu.”

Sapo miku i dëfteu me gisht fyellin që mbante ngjeshur në brez si shpatë, Xhebroja u ftoh fare. Edhe ky te fyelli e kishte syrin, sado që në fillim iu duk si i njohur. Tani do të pyesë sa kushton dhe fët dorën në xhep për të nxjerrë paratë. E mira që t’ia priste hovin pa e tororisur.

- Nuk e shes! E kam për qejfin tim, - i tha duke i kthyer kurrizin.

Mirëpo Shirli, si gazetare e shkathët, e zuri për krahu fyelltarin dhe e mbajti në vend. Xhebros iu kujtuan historitë për femrat e hazdisura që i kapin meshkujt vetë kur i pëlqejnë, prandaj filloi të thërriste:

- Lëshomë moj lanete, lëshomë gjeç belanë, se më menderose biografinë! - Mirëpo nuk guxonte ta prekte me dorë, as t’ia hiqte krahun, prandaj rrinte si dru. Veç goja e hapur dhe sytë e çakaritur tregonin se ishte gjallë. - O Sevo, ku je o të plastë tëmthi, duku këtu se mbeta keq!

Përkthyesi i grupit erdhi menjëherë, të mësonte ç’e keqe e kishte gjetur Xhebron.

- Merru vesh ç’kërkon nga unë kjo pilivesa, se po më bie të hollët...

Me dy fjalë Sevoja i shpjegoi se burri i saj, specialist për veglat muzikore popullore, donte të shihte fyellin e tij.

- Fyell është a derëzi, ç’do t’i shohë? - pyeti Xhebroja. - Dilma e dashka, ja tek e ka! - E nxorri nga brezi i leshtë dhe ia dorëzoi.

Vanderbildi e mori fyellin, numëroi vrimat, pastaj e vuri në sy dhe e ngriti drejt qiellit për të parë çka fshihte brenda.

- E po nuk u bë dylbi, që ma vë në sy... - e qesëndisi Xhebroja. I huaji se ç’dërdëlliti me Sevon.

- Thotë që nuk ka gjë brenda, - i tha përkthyesi.

- Uuu! Po pse ç'priste të gjente?- bubuti Xhebroja. - Dhe ti m'i thua specialist! Ikë ore, gremisu me gjithë të, se edhe ky fyell qenka.

Ndërkohë profesori i tha së fejuarës sentencën e njohur italiane: "Il trucco che, ma non si vede."¹

- Xhebro, ky specialisti thotë se nuk ka mundësi praktike t'i biesh fyellit pa ndërprerje, prandaj të lutet të hapësh gojën... - e sqaroi Sevoja.

- Jo! - kundërshtoi Xhebroja vendosmërisht. - gojën nuk e hap! Pse, ç'u bëra unë? Kalë? Andej nga ne kuajt dhe qetë shihen nga dhëmbët... Jo!

Mirëpo kundërshtimi i tij ia shtoi më shumë dyshimet etnomuzikologut. Buzëqeshja që këmbyen midis tyre, i dha të kuptojë Xhebrës se s'po i besonin teknikës së tij. Vrullshëm hapi gojën para syve të etnomuzikologut dhe e pyeti:

- Hë? Sheh gjë këtu? - Pastaj mori fyellin e vuri në buzë dhe filloi t'i binte pa ndërprerje, duke marrë frymë me hundë e duke përdorur si rezervë një të bullçisë.

- Virtuoz! - tha Shirli e mahnitur.

- Fenomen i rrallë, - e plotësoi zoti Vanderbild.

- Ç' thotë, mo Sevo?

- Thotë se nuk ka tjetër njeri në botë t'i bjerë fyellit pa ndërprerje si zotrote, thotë se je ekzemplar i rrallë.

- Oh, na rrofsh për dimër, i thua, se për verë jemi vetë. Le të vijë në Labëri të shohë se kështu si unë i bien fyellit edhe kalamajtë. Më qafsh po nuk i the, - e luti Xhebroja. - Një javë e mbaj unë mik në shtëpinë time, me gjithë këtë ftujaken që ka pas.

- Ta pranon Labikja? - e ngacmoi Sevoja

- Labikja e di ç'burrë ka, a i vrarë, - iu përgjegj krenar Xhebroja.

MARKSISTI NË ANALIZËN E SPORTIT



Instruktori i partisë, Krisaf Pelushi, po dremiste mbi tryezë me bërnylin mbështetur mbi një vepër të Leninit. Zilja e telefonit cingëriti fort dhe ai u hodh vrik përpjetë, duke fërkuar sytë. Iu desh pak kohë të kuptonte se po flinte në zyrë.

- Shoku Krisaf? Ju kërkon shoku Servet. Ju lutem mos u vononi!
- u dëgjua në mikrofon zëri i sekretares së kabinetit, Roksana Doraku.

Instruktori iu bind urdhërit. Rregulloi nyjen e kravatës, hoqi poshtë cepat e xhaketës që të mos dukeshin të rrudhura, kapërceu sallonin nxitimthi dhe sakaq u ndodh në paradhomën e kabinetit të Sekretarit të parë. Nëpunësit ishin të detyruar të prisnin në zyrën e Roksanës derisa t'i ftonte shefi i madh. Para disa kohe, Krisafi, duke dashur të shpaloste njohuritë e tij historike, i tha sekretares se Roksana, e bija e Darit të Persisë, u martua me Aleksandrin e Madh, mbretin e Maqedonisë. Mirëpo beqarja e stazhionuar, ia mori ters, se menjëherë iu vërsul: "Shoku Krisaf, mos u jam lutur të më gjeni

ndonjë burrë? Dhe në daç ta dini, unë me mbret nuk martohem kurrë!” Krisafit pati ndjesinë sikur i hodhën mbi kokë një kovë me ujë të ftohtë. Injorantja! Mos pandehte se Aleksandri i Madh ishte akoma gjallë dhe sundonte në Maqedoni? Që atëherë instruktori nuk hapte më biseda fejeje e martese me sekretaren.

* * *

Krisafi qëndronte para Servet Banit, në gatishmëri ushtarake. I vetëdijshëm se do t'i ngarkonin ndonjë detyrë urgjente, u befusua kur Sekretari e pyeti në mënyrë shoqërore:

- Shoku Krisaf, a keni qenë ndonjëherë në Klubin e Sportit?

- Jo, - u përgjigj Krisafi qetë. - Dhe as që e di ku bie...

- Sot do të keni rast ta vizitoni, mbasi Klubi ka analizën vjetore.

- Nuk më intereson sporti, - deklaroi Krisafi. - Atë sektor e mbulon Niçi.

- Kultura dhe sporti janë motër e vëlla, gjë që ju e dini më mirë se të tjerët, - e furçosi Serveti. - Do të shkoni i deleguar nga Komiteti i Partisë.

- Unë? - pyeti i habitur Krisafi, sikur t'i kishin thënë të shkonte në Hënë. - Ç'ne unë me sportin?

- Niçi sëmure, Vasoja me shërbim, Bilbili me lejë, Bexheti me provime, vetëm ti dhe unë kemi mbetur në krye të detyrës.

Një psherëtimë e thellë doli nga gjoksi i Krisafit.

- I deleguar për sportin? Jo! Kurrsesi shoku Servet!

- Habitem, pse e dramatizoni kaq shumë? - i tërhoqi vërejtjen sekretari.

- Doni t'ua them troç, shoku Sekretar? Nuk marr vesh nga sporti. Nuk kam shkelur kurrë në stadium, nuk jam tifoz për asnjë skuadër dhe për asnjë lloj sporti...

Servet Bani u mendua një hop për të gjetur rrugëzgjdhje.

- Nëse nuk do të shkojë askush nga ne, do të na kritikojnë se partia nuk e vlerëson sportin, se nuk kujdeset për të, etj. etj.. madje mund të dërgojnë edhe ndonjë ankesë në Komitetin Qendror. Dhe kjo s'do të ishte aspak e mirë për ne.

- Nuk i njoh problemet e sportit, - kundërshtoi Krisafi me takt.-
Ju a them sinqerisht.

- Nuk po shkoni si arbitër, as si trainer. Për ne, si komitet partie, problemet janë kudo njëloj: edukimi ideopolitik, ngritja tekniko-profesionale, analiza e të metave, zotimet, - i tha Serveti. - Pse mos kujton se Bilbili merr vesh nga teknologjia e sheqerit dhe e lëkurëve? Sheqerin e ha, por s'ma merr mendja të dijë formulën kimike.

Ky argument mjaftoi që Krisafit t'i binte zelli i kundërshtimit.

- Ju u kemi instruktorin më të ngritur nga ana ideopolitike, - e flatroi Sekretari. Askush tjetër nuk i ka konspektuar veprat e Leninit, ashtu si ju. Këtë e dinë të gjithë.

Një ngjarje aksidentale ndihmoi të zbulohej naiviteti i marksistit Krisaf Pelushi. Në një mbledhje kuadrosh një inxhinier pyjesh, midis të tjerash tha se Lenini i kishte cilësuar pyjet "ar i gjelbërt." Krisafit nuk i kujtohej ta kishte hasur atë citat gjatë konspektimit. Egoja e shtyri t'i shfletonte edhe njëherë vëllimet e Leninit nga e para, por mundimi i shkoi kot. Pastaj u kujtua të pyeste inxhinierin për burimin. Ai i tha se derisa Lenini i kishte quajtur naftën "ar i zi," pambukurn "ar i bardhë," edhe për pyjet mund të thoshte "ar i gjelbër." "Si? Ia veshe Leninit kot?" u skandalizua Krisafi. "Po e di ti që mua s'më ka zënë gjumi një javë për ta gjetur atë citat?" Inxhinieri qeshi me naivitetin e Krisafit dhe ngjarja qarkulloi në qytet si anekdotë.

- Atëhere kështu pra, në orën njëmbëdhjetë te Klubi i Sportit. Hë, se për pak harrova. Skuadra e futbollit këtë vit ka kaluar nga kategoria e parë në të dytën dhe ju duhet t'i mëshoni me forcë kësaj pike, - e porositi Sekretari. - Sa për zotimet konkrete, e keni parasysh vetë.

* * *

Krisafi zuri vend në presidium, midis drejtorit të Klubit dhe trainierit të futbollit. Pak më anash ndodhej sekretari i organizatës bazë dhe kryetari i bashkimeve profesionale. Pas referatit, filluan

diskutimet. Me pezmatim Krisafi vuri re se ato silleshin e mbështilleshin rreth varianteve 2 + 4 + 4, ose 4 + 3 + 3, ose 3 + 5 + 2, të cilat sido që t'i mblidhje dhjetë se dhjetë bënin. Asnjëri prej tyre nuk po e lidhte futbollin me plenumin e fundit për bujqësinë. Kjo nuk u falej. Mllef i Krisafit po fermentohej si mushti brenda fuçisë, se ata nuk po përmendnin fare as bllokadën, as rrethimin imperialist e revizionist çka tregonte nivel të ulët ideopolitik. As drejtori më të djathtë, as treneri më të majtë, nuk po shqetësoheshin, çka dëshmonte se edhe drejtuesit kishin rënë në pozita apolitike. Për t'i orientuar diskutimet në hullinë e duhur, Krisafi kërkoi lejë të fliste.

- Shokë! - nisi ai duke vënë dy çepirokët mbi tryezë. - Në gjithë vendin tonë, ka shpërthyer mobilizim i madh për të vënë në jetë detyrat e kongresit. Edhe kolektivi juaj, me organizatën e partisë në krye, ka arritur suksese. Ju kaluat sivjet nga kategoria e parë në të dytën. Ky sukses i madh që e arritët me mund e djersë na gëzon të gjithëve, po ashtu siç na mëson Partia, nuk duhet të flemë mbi dafina se mundësitë janë për më shumë. Me pak përpjekje ju mund të kaloni edhe në kategorinë e tretë...

Tallesh me ta i deleguari, apo përdorte stilin e ironisë si armë? Një sportist ngriti gishtin për të protestuar, a për të kërkuar sqarime. Shoku Krisaf e luti të kishte durim se do të fliste edhe për të metat.

- Unë kam mendimin, se nuk po jetoni sa duhet me situatën... - vazhdoi. - Ua them sinjerisht, edhe pse më vjen keq, por faktet më detyrojnë. Tani në vendin tonë po zhvillohet fushata e zgjedhjeve për Kuvendin Popullor, me parrullën "çdo votë për Frontin Demokratik - plumb për armikun!" Kjo ka kuptim të thellë politik, derisa votën e krahasojmë me plumbin. Në përjasje me këtë ç'mund të thuhet në fushën e sportit?

Pas heshtjes meditative që zgjati disa sekonda, u dëgjua propozimi spontan i futbollistit Mirel Taka.

- Topat tanë - plumb për armikun!

- Kush foli? - pyeti i deleguari.

Mireli u ngrit në këmbë. Nga zhubravitjet e ballit të Krisafit u duk se ai lloj humori me parrullat politike nuk ishte me vend. Ndërsa prisnin të shpërthente rrebeshi i kritikave mbi kokën e Mirelit, i deleguari e miratoi:

- Më pëlqen propozimi juaj, po deri në një farë mase, sepse e kam një rezervë të vogël. Artileria, ku hyjnë topat e të gjitha kalibrave, nuk gjuan me plumba. Kjo ma prish disi përfytyrimin. Në fakt arma e artilerisë, përdor tjetër lloj municioni, - vërejtji Krisafi.

- Topat tanë - gjyle për armikun! - e korrigoji Mireli.

- Kjo po! - u entuziazmua Krisafi. - Shumë bukur! Të lumtë! Tani i re pikës! - Dhe ndërkohë po shihte anash që ta ndante gëzimin me shokët e presidiumit. - Këtë e gjetëm ashtu siç duhet, të shkurtër dhe të fortë.

Mirëpo drejtuesit e klubit nuk shprehën kurrfarë entuziazmi.

- Për mendimin tim, derisa kemi më shumë humbje se fitore, kjo nuk vlen. Atëhere ç'lloj gjylesh qenkan këto? Gjyle preshi! - tha tranier Duka duke u ngritur në këmbë.

Në sallë shpërtheu gazi.

- Ka kuptim metaforik, - ngulmoi Mireli. - Unë kur them topat tanë, nënkuptoj golat.

- Topat tanë, topat tuaj, lëre mënjanë pash Zotin, se njerëzve do t'u vejë mendja atje ku s'duhet, - e ndërpreu Drejtori.

Vërejtja e tij me përqasje seksuale e ftohu menjëherë entuziazmin e të deleguarit. Vajzat sportiste në rreshtat e pasme filluan me kukuku e kikiku. Shoku Krisaf i zgërlaqur, ngaqë treneri e nxori nokaut në fushën ideologjike, ku ai ishte ekspert, ndërhyri për të rivendosur dinjitetin.

- Një gjë duhej kuptuar njëherë e mirë. Pa ngritje të nivelit ideologjik s'mund të ketë ngritje profesionale. Si është kuptuar këtu tek ju bllokada imperialisto - revizioniste? Çaloni shokë, po ua them hapur, mos u vijë keq. Si mendoni ta çani bllokadën ju? Naftëtarët të mobilizuar si asnjëherë, po arrijnë rezultate të larta me parrullën "nafta çan bllokadën," minatorët e kromit, po ashtu dhe ju duhet të mirrni shembull prej tyre. Vriteni pak mendjen, si mund ta çani bllokadën?

- Çfarë të shesim ne? - pyeti një sportist.
- Shesim trainerin e Kombëtares, - propozoi dikush nga mesi i turmës.

- Kush e blen se? - u dëgjua një replikë anonime.

- Si shpjegohet që na rrahin vazhdimisht skuadrat imperialiste dhe revizioniste, megjithëse sistemin politik ne e kemi më të përparuar? - pyeti Mireli.

Fytyra e të deleguarit u dritësua nga pyetja.

- Nuk e ka fajin sistemi, po trainerët tuaj, - u tha Krisafi. - A ka si ruhet ajo derr porte vetëm me një portier? Ua kam thënë me kohë propozimin se porta duhet thurur me katër a pesë lojtarë, gardh, pastaj le të vijë Peleja të bëjë gol. Mirëpo e keqja është se e marrin si humor dhe qeshin.

Sugjerimi u prit me duartrokitje dhe Krisafi u shkri nga kënaqësia që gjeti përkrahës. Dhe ku? Jo te ndërmarrja e Gjelbërim-Pastrimit që mbliidhte plehrat e qytetit, por te Klubi Sportiv.

I deleguari shtjelloi mendimin se pa zotëruar marksizmin, shkencën e shkencave, nuk mund të shutosh sakt dhe as të gjuash drejt në portë.

- Ti, - iu drejtua një djali flokëverdhe, - çfarë ke lexuar tani së fundi?

- "Për ju vajza", - u përgjegj ai i skuqur nga turpi.

Shpërthyen të qeshura, sepse qe pak befasuese që një djalë të lexonte një libër mbushur me këshilla për higjienën personale të vajzave.

- A ka luajtur Marksi futboll dhe nëse po, me cilën skuadër? - e pyeti Majoshi, kapiteni i skuadrës.

Krisafi kërkoi me sy ndihmë nga treneri dhe ai menjëherë brofi në këmbë.

- More shok i dashur, ç' hyn Marksi në analizën vjetore? - protestoi treneri. - Më duket se po dalim jashtë temës...

- Marksizmi hyn kudo, si çelës kopil, tha i deleguari, - u mbrojti Majoshi.

- E drejtë, por atë fjalën kopil, unë nuk e përdora, ndaj kujdes, - e qortoi instruktori.

- Kalojmë te pika e zotimeve, - propozoi drejtori.

Thirrjes iu përgjigjën vetëm sulmuesit, ndërsa të tjerët po rrinin squkë.

- Ti, pse nuk zotohesh? -iu drejtua Krisafi një sportisti që ndodhej në rreshtin e parë.

- Unë jam gjysmëmbrojtës, - u justifikua ai.

Krisafi u kthye nga treneri dhe e pyeti:

- Pse e keni lënë gjysmak atë shokun? Ose bëjeni tamam mbrojtës, ose hiqeni fare.

Krisafi kërkoi të zotoheshin të gjithë, pa përjashtim.

- Edhe unë? - e pyeti portieri, një skërfyell i gjatë në rreshtin e parë.

- Natyrisht, pse ti nuk je anëtar i kolektivit? Së paku nga dy gola për kokë! - e mbërtheu i deleguari.

Atëherë shpërthyen zotimet nga të gjitha anët. Shifra e golave në ndeshjen e ardhme arriti te 19.

- Mirë, - tha Krisafi. - Mesatarisht i bie nga një gol e gjysmë për kokë. Si fillim nuk është keq.

Mbledhja u mbyll me formulën e njohur se qëllimi ishte arritur.

- Analizë si kjo s'kemi patur kurrë, - deklaroi Drejtori ndërsa përcillte të deleguarin.

- Ta themi midis nesh, merita kryesore u takon ju,- e flatroi treneri.

- Partisë, - tha me modesti Krisafi, duke futur në xhep bllokun e zotimeve.

REPORTAZH I FRYMËZUAR NGA DIETAT



Sapo doli në trotuar, Merkuri nxori nga xhepi paketën e cigareve dhe me trishtim vuri re se aty prehej cigarja e fundit, të cilën ose duhet ta pinte rrugës, ose ta ruante për ta shoqëruar me kafënë ekspres. “Kafeja pa duhan, si turku pa iman,” thotë një proverb popullor. Pas dhjetë faqeve të ngjeshura të romanit të ri që kishte shkrojtur atë mëngjes, e kishte hak të çlodhej të takonte ndonjë shok te kafe “Tirana” dhe të shkëmbenin ca llafellufe. “Tirana” ishte nga lokalet më prestigjioze të kryeqytetit në vitet 50 dhe brenda një kohe të shkurtër u kthye si klub intelektualësh. E dinte se atje në çdo orë të ditës do të gjente ndonjë koleg a ndonjë të njohur. Merkuri mendoi të blinte një paketë tjetër në kinkalerinë më të afërme. Futi dorën në xhep për të shikuar sa të holla zotëronte. Gishtat i kapën një

kartmonedhë tre lekëshe. Sado që e afroi para syve, shifrat e saj prej disa trashash nuk ndryshuan. Sidoqë t'i pjesëtonte trelekshi nuk mjaftonte të plotësonte dy dëshirat e tij modeste, një kafe ekspres dhe një paketë cigare. Mërzia iu shfaq mbi çdo fije muskuli të fytyrës.

“Shkrimtar pa një pesare në xhep, je ti Merkur Totoni,” i tha vetes. “Të rroftë emri, lavdia, çmimet që ke marrë. Rropatesh t’u krijosh lexuesve kënaqësi estetike, katarsis, si thoshte gjeniu i antikitetit, Aristoteli, ndërsa veten tënde je i detyruar ta privosh nga nevojat më jetësore. A mund të mbahet frymëzimi lart me xhepin trokë?” Në këso rastesh gjithmonë kujtonte proverbin turk: “shëndeti pa para, është sëmundja më e keqe.” Kjo thënie i dukej jashtëzakonisht realiste për gjendjen e tij. Ç’iu desh Kristofor Kolombit të zbulonte Amerikën dhe t’i sillte Evropës duhanin? U rropat të gjente nga e si kishte ardhur kafeja, por pa rezultat.

Ndërsa po kalonte para ndërtesës së “Zërit të Popullit,” iu kujtua shefi i kulturës. Vehap Shituni e kishte lutur disa herë t’u shkruante një reportazh për gazetën, duke i dhënë dorë të lirë për rrethin ku do të shkonte dhe temën, por Merkuri e kishte shtyrë vazhdimisht për shkak të romanit. E vërteta që se ajo gjini i ishte neveritur, po tani që xhepi i zbrazur lëshonte sinjale alarmi, e pa të arsyeshme të kthehej në redaksi dhe t’i kërkonte shefit një paradhënie për shpenzime udhëtimi e diete. Reportazhi nuk do t’i hante më shumë se tri-katër ditë, duke përfshirë edhe udhëtimin. Merkuri buzëqeshi duke kujtuar reportazhet e rëndomtë të tipit “shih e shkruaj,” të ngjashme si dy pika uji: “Makina jonë shkon mes fushës. Anash duken parcelat e mbjella me grurë të fermës...” “Arrijmë në N., takojmë filanin, ai tha se jeta e tanishme nuk mund të krahasohej me të kaluarën e zezë.” Pra e vliente ta ndërpriste romanin për disa ditë, për të rregulluar gjendjen financiare sa të vinte dita e bekuar e rrogës. Nuk mund të rrinte një javë pa pare xhepi, as t’i kërkonte gruas vazhdimisht lëmoshë.

Vehapi e mirëpriti, për shkak se “ata lart” vazhdimisht u sugjeronin gazetave të afronin firmat e shkrimtarëve të njohur.

Rrethin dhe temën iu lut ta zgjidhte vetë. Ndërsa po mbushte formularin e urdhër-shërbimit, e pyeti:

- Ju mjafton një javë?

- Mjafton dhe tepron, - ia ktheu Merkuri.

Një javë dieta për një reportazh katër pesë faqesh të daktilografuara, të cilin ai mund ta shkruante për dy tri orë, qe me leverdi. Merkurit iu ngroh xhepi me disa kartmonedha të trasha. Tani mund ta qeraste veten me dreka e darka në restorantet më të mirë të kryeqytetit. Ditën e parë mendoi të shkonte në ndonjë rreth të largët ku s'kishte qenë, për të përfutur përshtypje të freskëta dhe interesante, të dytën i lindi ideja të shkonte diku afër kryeqytetit, kurse të tretën i feksi si vetëtimë një zgjidhje më praktike. E pse të lodhej duke shkuar në ndonjë rreth të panjohur? Pse të zoritej duke udhëtuar me autobuzët interurbanë, ose me kabinat e trenave që kutërbonin djersë e duhan, kur reportazhin mund ta shkruante pa dalë nga shtëpia me shembuj, me fakte, me emra konkretë? Dy muaj më parë ai kishte qenë në vendlindje me rastin e një feste popullore. Qe e kotë të vinte sërish në fshatrat e Bregut. Kot do të lodhej, kot. Ç' mund të kishte ndryshuar në fshatin e tij që atëhere? Asgjë. Nga përvoja e tij e gjatë si gazetar, e dinte se fshatarëve u pëlqente t'u vije në gojë fjalë të zgjuara ku shprehnin mirënjohje për partinë. Atyre u pëlqente t'u dilte emri në gazetë dhe kurrë nuk protestonin se nuk ishin fjalët e tyre ato që shkruante gazeta.

Merkuri e vazhdoi festën me dietat e shërbimit, duke porositur pula të pjekura, torta dhe verë, pa dalë nga shtëpia, se mos kushedi e shihte Vehapi, apo ndonjë nga ata të redaksisë së kulturës. Kjo gjendje e lartë shpirtërore e ndihmoi t'i hidhte me shpejtësi në letër mbresat nga vizita në vendlindje. "Në të kaluarën e ngjyemim bukën jo në shëllirë, por në lotët tanë," kjo metaforë gjeniale që shprehte aq bukur varfërinë e thellë të krahinës, e kënaqi shkrimtarin. Pas pak mendoi se do të kishte më shumë efekt sikur këto fjalë t'i vinte në gojën e ndonjë fshatari dhe kështu ia veshi Perik Barbajanit, fqinjtit të tij në fshat. Pastaj edhe Kosta Gjilekën, shokun e tij të fëmijërisë, nuk e la pa gjë. Ai thoshte se dritat elektrike të fshatit të tyre, u

vrisnin sytë armiqve përtej detit dhe Flotës së Gjashtë. Me armiqtë e përtej detit nënkuptoheshin grekët e Korfuzit dhe italianët matanë kanalit të Otrantos.

Reportazhi u botua dhe Merkuri e ndiente ndërgjegjen të qetë se detyrën e kishte kryer. Për të ishte një reportazh i zakonshëm, ndaj nuk priste ndonjë jehonë. U befasua sapo Vehapi i kumtoi se kryeredaktori e kishte lavdëruar në kritikën javore të redaksisë, duke përgëzuar edhe atë që kishte afruar një shkrimtar të njohur si Merkur Toton. Pas konsideratave të kryeredaktorit, shefi i kulturës e siguroi se derën e kishte të hapur edhe për bashkëpunime të tjera.

Pa shkuar njëzet e katër orë, Vehap Shituni e lajmëroi Merkurin në telefon të vinte urgjent në zyrën e tij, për një problem të rëndësishëm. Ç'mund të kishte ngjarë? Pse kjo urgjencë? Mos donin ta nisnin diku me shërbim? Merkuri e la penën mbi fletën e bardhë dhe menjëherë mori rrugën e redaksisë.

Përballë tryezës së shefit, Merkuri pa dy të panjohur.

- Këta shokët nga rrethi i Sarandës kanë ardhur kastile për ju, - i tha Vehapi. Nuk e kishte aspak përzemërsinë e parë as në zë, as në fytyrë.

- Lexuam reportazhin tuaj... - nisi njëri prej tyre.

- Ju pëlqeu? - e ndërpreu Merkuri.

- Në një farë mase... - dredhoi ai. - Po së pari të prezantohemi. Shoku Bajram Sapuni është punonjës i Degës së Brendshme në Sarandë, ndërsa unë jam operativi i zonës, - vazhdoi syziu. - Më quajnë Themë Gogozoti.

- Gëzohem, - tha Merkuri, edhe pse nuk u gëzua aspak nga prezantimi. Ç'dreqin kërkoni prej tij sigurimst?

- Shkruani se jeni takuar me Kosta Gjilekën, - hyri në bisedë Bajrami, duke mbajtur hapur mbi gjunjë gazetën me reportazhin e botuar. "Çdo natë të rinjtë këndojnë e vallzojnë në shtëpinë e kulturës,"- nisi ta lexonte. "Me klubin në mes të fshatit, me dyqan ku blejmë gjithçka na duhet, pa patur nevojë të shkojmë deri në Sarandë. Dritat elektrike u vrasin sytë armiqve tanë përtej detit..." Ai ua tha këto fjalë?

- Po, m'i tha. Pse të mos i thoshte derisa janë të vërteta? - ngulmoi Merkuri.

- Ku e takuat? - ndërhyri syziu.

Mos dyshonin se nuk kishte shkuar në fshat?

- Në klubin e fshatit, - ua përplasi Merkuri.

As kjo përgjigje nuk i kënaqi ata, sepse zijoshi vazhdoi hetimet:

- E mbani mend datën? Sa ditë përpara, sa javë, sa muaj?

- Dy javë më parë, - ua priti Merkuri, - kur shkova me shërbim.

- Si është e mundur? - pyeti Bajram Sapuni.

- Po Perik Barbajanin ku e takuat? -

- Në fshat, ku gjetkë? - u përgjegj po me pyetje Merkuri.

- Ku? Në ç'vend? Te klubi, te kryesia, te lëmi, te depoja? Ku? - e gozhdoi Themiu.

- Pse duhet të shkruaja edhe ku e takova? - u hodh në sulm Merkuri.

- Jo, sigurisht, jo, - e qetësoi Bajrami. - Po i takuat vërtet apo?

- Habitem, pse po e vini në dyshim...

- E di pse? Po i kërkojmë prej disa javësh në fshat e në qytet, në mal e në fushë dhe s'po mundemi të biem në kontakt me ta... - tha Themiu duke palosur gazetën që mbante mbi gjunjë.

Merkur Totoni nisi të lëpinte buzët e thara.

- Mos... mos janë arratisur? - pyeti me zë të mekur.

- Perik Barbajani, po, u konfirmua i arratisur, se foli në radion e tyre pardje duke vjellë vrer kundër pushtetit. "Më keq se sot dhe më të varfër se tani s'kemi qenë kurrë," ka thënë, - e sqaroi sybardhi.

Merkuri nxori paketën nga xhepi dhe u ndau nga një cigare si për ndie zot.

- Të poshtërit! - shfreu Merkuri, - Le atdheun që e tradhëtuan, por ma dhjenë dhe reportazhin!

TAKIME NË SHKALLËT E PENTAGRAMIT

Ndryshe nga kryeredaktorët e tjerë, të cilët nervozoheshin, kur vartësit e tyre shkrimtarë u kërkonin lejën krijuese dhe nxirrnin njëqind e një arsye që të mos ua jepnin, yni tregonte mirëkuptim të plotë për kërkesa të kësaj natyre.

- Lejën? Ta merrni si jo, ju takon, është e drejta juaj si shkrimtar. Kur e doni? Nga java? Shumë bukur! Veç më parë dorëzoni rubrikat që kini në planin e këtij numri dhe lëndën rezervë për muajin tjetër. Lini këtu dosjen me reportazhe, artikuj, intervista dhe pastaj shkoni të kënaqeni ku t'u pëlqejë, në plazh a në bjeshkë... - e duke hapur të dy duart na sikteriste plot mirësjellje.

Shefi deklaronte se nuk e merrte malli për fytyrat tona dhe ne s'e vinim në dyshim sinqeritetin e tij, ngase në mënyrë të ndërsjelltë provonim të njëjtën ndjenjë.

Duke ia ditur huqet e plotësova kushtin e tij, duke gatitur rubrikat që mbuloja për dy muaj. Pasi i sistemova në dosje hyra në zyrën e kryeredaktorit dhe duke vendosur dosjen mbi tryezë, i thashë vetëm një fjalë:

- Lejën!

Më fali një gjysmë buzëqeshje. Nuk e them aspak në mënyrë figurative. Për shkak të ndonjë të mete kongjenitale, a të ndonjë paralize faciale të fituar më vonë, Stefi qeshte vetëm me anën e djathtë të gojës. Ai e shtyri dosjen, pa u bërë kureshtar të shihte përmbajtjen dhe duke fshirë lentet e syzeve me një pecetë, më tha:

- Bëjmë dhe pa këto... Apo mos kujtuat se do t'i linim faqet e revistës të bardha? Kot u lodhët! Megjithatë, më pëlqen stili juaj.

Këto kthesa të papritura ishin brenda natyrës së tij kontradiktore. E nuhata se po rropatej t'i dredhonte kërkesës sime për lejë. Derisa kushtin e kisha plotësuar ç'mund të kërkonte prej meje?

- A mund të sigurosh një shkrim kritik para se të nisesh? - heshti pakëz, me sa duket për të kapur fillin e mendimit të lënë në mes. - E keni parë filmin "Lugina e Kaltër"? Jo? Nuk keni humbur asgjë. Kurse muzika...

Si gazetar me përvojë u mpreha të kapja kahjen e mendimit të tij për kritikën.

- ... muzika qe beter. Nuk lidhej me ngjarjet në ekran, nuk ndihmonte për të zbërthyer idenë. Unë s'marr vesh nga notat, as nga teoria e harmonisë, po nga bisedat e specialistëve në kulluar, më lindi mendimi ta trajtojmë këtë problem në revistën tonë. Do të fitojmë pikë para udhëheqjes, po të botojmë një artikull të fortë problemor. E keqja është se ne s'kemi kritikë të specializuar muzike, prandaj kap ndonjë kompozitor të njohur, dorëzo shkrimin dhe ... mirupafshim në vjeshtë.

Në fund shefi, ashtu sikurse e kishte zakon, lëshoi një paralajmërim kategorik.

- Pa dorëzuar këtë artikull, mos ejani këtu për lejën!

Propozimi në formë urdhëri kategorik, nuk më pëlqeu, ngase e dija sa e vështirë është edhe t'i takosh bashkëpunëtorët në prag të verës, jo më t'i angazhosh, sepse të gjithë e kanë mendjen të ikin me pushime. Një valë proteste po më ngjitej nga rropullitë e barkut, aq më tepër se rubrika nuk i përkiste sektorit tim, por shpejt u kujtova se këto përplasje përfundonin gjithmonë në favor të shefit, prandaj i mbajta argumentet poshtë kordave zanore. Shefi ynë kur nxehej thoshte broçkulla dhe s'di sepse më vinte keq sa herë e vinte veten në pozitë të pahijshme para redaktorëve.

U ktheva te tryeza ime duke u rropatur të sillja në kujtesë ndonjë kompozitor të njohur, për firmën e të cilit të mos ndizeshin diskutime. Vetëtimthi në trurin tim u shfaq vizioni i Nino Çorapit.

Pavarësisht nga mbiemri që të ngjallte idenë e një njeriu konfuz, ai ishte një nga pedagogët më sistematikë në Konservator, shef katedre a diçka më poshtë, pra i plotësonte kushtet e parashtruara nga shefi. U njohëm rastësisht në kampin e Thethit vitin e kaluar dhe dymbëdhjetë ditët e pushimit i kaluam duke treguar anekdota e gazmore. Ninoja ishte i shkueshëm me të gjithë, i sjellshëm, i qeshur, i dashur, ndaj shpresoja se nuk do të ma refuzonte një kërkesë aq të thjeshtë.

Menjëherë u sula drejt Konservatorit. Në vijë të drejtë ndërtesa që fare afër me redaksinë tonë, por edhe me rrugë tokësore nuk ishte larg. U futa në holl dhe po mendoja sa kate duhet të ngjitesha, kur e pikasa duke zbritur nga shkallët. Më priti përzemërsisht, duke u përkulur plot etiketë e duke përdorur pa kursim fjalën “milli moj” (i dashur) shqip-rusisht, sa herë telat e dy gjuhëve kontaktonin në trurin e tij duke krijuar qark të shkurtër. Me dy fjalë i thashë se muzika e filmit “Lugina e Kaltër” kishte ngjallur diskutime jo të favorshme në rrethet artistike.

- Edhe unë ashtu mendoj, i dashur. Muzika e filmit ishte e dobët, jashtëzakonisht e dobët. Sadriu duhet të kishte gjetur një leitmotiv për të lidhur episodet e ndryshme, si Sviridovi te filmi “Skënderbeu,” apo Sollovjev Sedoi te “Kampi i fundit.” Sa muzikë të ëmbël ka ai kompozitor nëpër filma! -Nisi të këndonte me la-la-la, një motiv të njohur nga një film i tij. - Mezhdu proçim, unë mendoj se edhe filmi ka dobësi të mëdha, subjekt artificial, i stisur, personazhe të dhëna njëherë e mirë, pa zhvillim, po sidoqoftë fusha letrare i përket tjetër kujt. Kurse Sasha, - kështu e quanim në Leningrad Sadri Doden,- nuk ka predispozita për atë gjini. E dini nga ka rrjedhur gabimi? Ngaqë u beson shumë forcave të veta. Ambicioziteti është pozitiv deri në një farë mase, më tej... Ka një ligj të pashkruar në art, të njohësh vetevten, të dish për çka je i pirë.

Sa mirë i argumentonte mendimet! Ndihesha i qetë që kisha gjetur njeriun e përshtatshëm.

- Muzika e një filmi duhet të jetë funksionale, të arrijë të zbërthejë emocionet e personazheve edhe kur ata nuk flasin. -Ndërsa shpaloste

mendimet, sytë i vezullonin nga zgjuarësia. - Çdo film ka nevojë për kollonën muzikore, e cila shton dimensionet e filmit, përndryshe çdo të duhej kompozitori?

- Me sa shoh, ju e paskeni gati artikullin. Mjafton të hidhni në letër këto që sapo thatë, - i sugjerova.

- Jo, - kundërshtoi duke vënë dorën përpara si polic trafikur, - ju lutem, mos prisni artikull prej meje. Këto mendime i shkëmbyem në mënyrë shoqërore. Disa herë njeriu pa dashur, ndodhet në pozita delikate, më kuptoni? Sashën e kam shok, kemi studiuar bashkë katër vjet duke ndarë të mira e të këqia, prandaj s'mund të dal kundër tij me kritikë publike. I di pasojat. "Mirë, i dashur, po pse të më diskreditoje në shtyp? A nuk mund të m'i thoshe mendimet mënjanë, shoqërisht?" Këto fjalë pres prej tij. Do të pandehë se po shkelmoj miqësinë tonë, shoqërinë tonë.

- Kritika e argumentuar nuk e prish miqësinë, përkundrazi... - ngulmova.

- Kam frikë se jo. Të parët, kolegët e mi do ta keqkuptonin, duke pëshpëritur: "Ç'pati me Sadriun? Këta dikur kanë qenë shokë të ngushtë..." Vihem në pozitë të keqe, më kuptoni?

- Parimet s'ka pse ngatërrohen me ndjenjat personale, - argumentova me shpresë ta bindja.

- Nuk kemi arritur ende atë nivel kulturor dhe shoqëror, i dashur. Një herë tjetër do të jem i gatshëm t'ju shkruaj, - më tha duke më futur krahun e duke më përcjellë drejt derës.

Lutja ime e fundit që një vështrim përgjërues.

- "Njevazmohno millij,"¹ - tha prerë. Pastaj si duke kërkuar të falur shtoi duke qeshur: - Sikurse e sheh, nuk jemi krejt të çliruar nga mbeturinat mikroborgjeze.

- A keni ndonjë sugjerim kujt mund t'i drejtohem? - e pyeta.

Ninoja u mendua një hop, pastaj më rekomandoi Fred Palokën. Tek zbrisja shkallët e Institutit, dëgjova urimin e kopjuar nga gjuha ruse "gjithë të mirat," po kësaj here shqip.

* * *

Institucioni i Krijimtarisë Popullore me dy mjedise, një zyrë komode për drejtorin dhe një sallë të madhe si hangar me shtatë tryeza për punonjësit e tjerë, ndodhej në katin e dytë. Në atë mjedis të hapur derdhte talentin e tij artistik kompozitori Fred Paloka. Sapo e takova, më prezantoi me dy nga kolegët e vet që u ndodhën aty, i kënaqur që iu krijua rasti t'u fliste për mua dhe sidomos për mbrëmjen e Vitit të Ri që kishim kaluar së bashku në Klubin e Shkrimtarëve. Disa nga anekdotat e rrëfyera prej meje asaj nate kishin patur sukses dhe ai më kumtoi se i kishte përfshirë në repertorin e tij.

- Mirëpo e shoh se kur i rrëfej, nuk qesh njeri, - më tha. - Si shpjegohet?

Harronte se anekdotat nuk tregohen kohë e pa kohë e në çdo vend dhe me çdo njeri. Nuk e dinte se rrëfimi i tyre kërkon predispozitë si nga dëgjuesit, si nga ai që e tregon. Shpesh zgjatimet e panevojshme, ndërhyrjet, shpjegimet, e prishin ritmin, bukurinë dhe efektin, po ashtu sikurse kondensimet e skajshme. Anekdotat dhe gazmoret janë tregimet më të shkurtra humoristike, prandaj kërkojnë mjeshtëri të lartë.


Fytyra e tij ngjyrë trëndafili harmonizohej me këmishën e bardhë dhe kostumin bojë mjalti. Sapo mësoi qëllimin e vizitës sime, më luti që bisedën ta zhvillonim "a parte" në sallon, larg veshëve kureshtarë të dy nëpunësve të tjerë.

- Keni të drejtë. Muzika e filmit duhet ta ndihmojë spektatorin, ta përgatisë për momentet më dramatike, ose t'i rrisë ato. Pse? Sepse magjia e tingujve shpreh ndjenja më të holla se ato që mund të thuhën me fjalë, ose me figura. E keni vënë re sa shpejt përhapen këngët e filmave kur pëlqehen nga spektatorët? Menjëherë sapo dalin nga kinemaja, spektatorët e fërshëllejnë melodinë besnikërisht. Kritika e vlerëson muzikën si komponent aktiv të artit viziv, kundrejt ilustratives, shoqërueses. Në rastin tonë, dua të them muzika e filmit "Lugina e Kaltër" ruan tipare ornamentale, me një fjalë, të jashtme, aq sa edhe një formulues

muzike mund të zgjidhte disa fragmente andej-këtej për të mbushur kolonën.

Fredi fliste me pasion dhe kokën e kishte plot mendime. E falënderova me mend Ninon që më adresoi aty ku duhej.

- Ta themi hapur, muzika e atij filmi çalon jashtë mase, stonon. Dihet, ne nuk kemi kompozitorë për muzikë filmash, prandaj nxitja për kultivimin e kësaj gjinie mbetet detyrë. Nuk më duket gabim që ia besuan misionin Sadri Dodës, kompozitor pa përvojë në këtë fushë. Gabimi i tyre qëndron gjetkë. Te kompromisi, te pajtimi me mediokritetin. Regjisori, apo komisioni, duhet t'i kishte thënë troç: "na fal shoku Sadri, ju u përpoqët, por nuk arritët. Për të ruajtur prestigjin tuaj dhe tonin, do t'ia ngarkojmë një kompozitori tjetër." Sentimentalizmat e dëmtojnë artin dhe autorin.



Mendoja t'ia zbutja pak tonin e ashpër, po së pari duhet të siguroja shkrimin.

- Kur mund të hidhni në letër mendimet që shfaqët? A të vij ta marr shkrimin nga fundi i javës? - e pyeta duke u kthyer në terrenin praktik.

Një re e zymtë u duk mbi ballin e tij të gjerë.

- E dini që s'kam gjetur ende punë për gruan?

Nuk arrija të kuptoja ç'lidhje mund të kishte midis shkrimit që kërkoja unë dhe bashkëshortes pa punë? Mos priste ndërhyrje nga ana ime? Nuk e di si do të reagonte sikur t'i thosha se atë problem po e përballoja edhe unë prej gjashtë muajsh. E gjykova të përshtatshme të theksoja se artikulli nuk do t'i hante më shumë se dy a tre orë.

- Koha s'përbën problem, sepse mund ta shkruaj edhe gjatë orarit zyrtar. As për t'i gjetur punë gruas nuk po nxitohem, ngase fëmijët i kemi ende të vegjël dhe dikush duhet të kujdeset për ta. Besoj se nëna është më e mirë nga kujdestaret e çerdhes, - tha buzagaz. - Por... e dini ku punon shoku Sadri?

- Në Radio, më duket. Nuk di të ketë ndonjë përgjegjësi kushedi se çfarë, - i thashë mospërfillës.

- E keni gabim! Sadri Doda është shef i sektorit të muzikës, - më korrigjoi Fredi. - Unë atje punoj nga pak jashtë orarit, nxjerr si të thuash afërsisht rrogën e gruas. Tani ju e kuptoni vetë... Nuk besoj të më këshillonit të humbas tre mijë lekët që marr mesatarisht çdo muaj nga radioja, - tha duke u munduar të qeshte. - A fola qartë?

Nuk mund t'i kërkoja Fred Palokës një sakrificë aq të madhe, prandaj e ktheva fletën, duke i thënë se mund ta vlerësonte pozitivisht.

- Po më shtyni drejt servilizmit? - vërejti duke buzëqeshur. Pastaj shtoi: - Nuk mund të them të kundërtën e mendimeve që kam, por natyrisht nuk dua të shkatërroj veten ekonomikisht.

Qe e kotë ta shtyja bisedën më tej. Duhet të gjeja ndonjë kompozitor që ta kishte gruan në punë dhe të mos varej ekonomikisht nga honoraret e radios. Duke përsiatur rrethin e të njohurve të mi në fushën e pentagramit, një emër feksi në kujtesën time: Abedin Grifsha. Ai vetë na sugjeroi para disa kohësh të çelnim një rubrikë për veglat muzikore popullore, mirëpo kryeredaktori skeptik tha se jevgjit u bien veglave edhe pa lexuar artikujt e Abedinit.

I telefonova dhe e lamë takimin te zyra e tij, në orën 12:30 të ditës së nesërme.

* * *

Abedini po gatitej të hante sillën. Nga një qese plastike nxirrte sandviçe, djathë, qofte dhe vezë të ziera. Reflekset kuqeverdhë të një molle starkinge dukeshin paksa të mjegulluara brenda saj.

- Ju bëftë mirë! - e urova. - Kaq vonë e hani mëngjesin?

Tha diçka nëpër hundë, pastaj më ofroi një sandviç mbi një letër të bardhë.

- Provoni një sandviç, ju lutem. E di që keni ngrënë, po një mund ta kapërdini lehtë. Nuk janë të blerë.

E provova dhe m'u duk i shijshëm.

- I ka gatuar bashkëshortja ime. Krenohem me Klarën, sepse përnjimend e kam artiste të artit të kulinarisë. Në shtëpinë tonë, ne nuk e ndiejmë nevojën e mjekut. Mos kujton se qesh? Ju them sinqerisht. Kuptimi i ushqimit sot, në epokën moderne, ka ndryshuar. Sot flitet për estetikë kulinare, dega më e re e shkencës. Ushqimi i fëmijëve ndryshon nga ai i të rriturve, çka njerëzit e kanë ditur në mënyrë empirike që në kohët më të lashta, prandaj i mëkonin me muhalebi. Një vajzë a grua që s'do të shtojë në peshë do një meny speciale, ashtu sikurse edhe një person që vuan nga koliti, nga tensioni i lartë, nga mëlçia e zezë. E dini? Ka disa lloje ushqimesh që e ngrejné tensionin...

Biseda me një njeri të informuar, është baraz me leximin e një libri. Për një dekokë mendova se Abedin Grifsha mund të konkuronte me Hashekun për llojet e ushqimeve dhe të gatimeve.

- Shoku Abedin, veç ushqimit të zakonshëm, kemi nevojë dhe për ushqim shpirtëror, - e ndërpreva për ta futur në temë.

Mirëpo Abedini nuk e kishte përfunduar diskutimin për aftësitë e bashkëshortes.

- Nëse në familjen tonë, dikë e zë, me nder barku, - vazhdoi ai, - gruaja gatuan ushqim special për të dhe brenda 24 orësh ai shërohet. Nëse një tjetër bëhet kaps dhe mezi del jashtë, Klara gatuan supa dhe ushqime që përmbajnë fibra. S'ke ide sa të nevojshme janë fibrat për funksionin e zorrëve. Prandaj ju thashë se familja jonë nuk ka nevojë për mjek.

Pas leksionit për rolin e ushqimit në kohën moderne, e pyeta ç'mendim kishte për muzikën e filmit "Lugina e kaltërt."

Fytyra e tij u rrudh si të hante uthullira a thartira.

- Muzika e atij filmi meriton një kritikë të rreptë. Tepër e dobët!
- tha me neveri.

- Kemi menduar të botojmë një kritikë në revistë, - shtova unë.

- Shumë mirë. Kolona sonore ka disa kërkesa të posaçme, të cilat duhen njohur nga kushdo që i futet asaj pune, miku im. Diletantizmi e dëmton artin. A ka kuptim që Estrada e Tiranës të mbajë një rapsod me rrogë? Qesharake. Kur erdhi Krushovi për vizitë, ai thuri një këngë plot lavdërime, ndërsa tani një tjetër ku tallet me të. Neise, të kthehemi në temën tonë. Duke marrë shkas nga muzika e Sadri Dodes, mund të arrihet në disa përgjithësime me vlerë. Keni piketuar ndonjë autor?

Artistët disa herë janë më naivë se kalamajtë.

- Ju, shoku Abedin.

Vuri dy pëllëmbët e duarve përpara si mburojë, u prapësua, ndërsa vështrimi i syve të zez iu mërrtye.

- Nuk mundem. Kurrsesi! - tha kategorik.

- Mos mendoni se do t'u zemërohet autori?

- Nuk merakosem për të. Arti kurrë s'mund të përparojë pa rrahje mendimesh, pa kritika. Nga vetë natyra ai i përket sferës subjektive, prandaj diskutimet pro e kundër kanë qenë dhe do të jenë të përjetshme. Por unë nuk mundem. E dini pse? Jam në pozitë kritike. Si anëtar i komisionit për vlerësimin e muzikës së filmit, kam firmosur t'i jepet Sadri Dodës honorari maksimal, pa e dëgjuar, sepse ditën që shokët e mi shkuan në Kinostudio, unë isha me shërbim jashtë Tiranës. Pas një muaji më sollën në zyrë fletën dhe unë vura firmën krahas të tjerëve. Ç'mund të bëja? Ka nevojë të them më shumë?

Orvatja ime e fundit për ta firmosur artikullin me sigël, ose pseudonim, nuk pati sukses. Buzëqeshja e tij thoshte "jo."

- Vapë, hë? - e ndërroi temën e bisedës. - Keni siguruar ndonjë kabinë në plazh? Mua ma siguron gruaja çdo vit.

Pamja ime e jashtme do të ketë qenë për t'u mëshiruar, qëkurse ai vetë më sugjeroi t'i drejtohesha Mystehak Babaliut, inspektorit të muzikës në Ministrinë e Kulturës. Sugjerim me vend. Shefi do të gëzohej nga firma e një autoriteti ministerial.

* * *

Nga përmasat e trupit, shoku Mystehak e meritonte postin e lartë. Ka lezet të shohësh në krye të drejtorisë një div, sepse njeriu do s' do mendon se qerren e qeverisë mund ta shtyjnë pa u zoritur këta viganë të fuqishëm. Fytyra e gjerë, hunda mishtore, lëkura rozë, tregonin gjendjen e mirë fizike të inspektorit. Në tepen e kokës flokët e rralluar lejonin të shihej lëkura e lëmuar me reflekse të shndritshme, çka kundrohej si shenjë pjekurie nga çdo vizitor. Ndërsa po i flisja për nevojën e ngutshme të kritikës muzikore, pikasa një buzëqeshje në cepat e syve të tij.

- Po këto janë udhëzimet që kam lëshuar unë një vit më parë... - dhe ndërkohë rrumbullakoste fundin e cigares për ta futur te një pipë qelibari bojë kremi.

Po prisja padurimshëm përgjigjen e tij.

- Më vjen keq, jam shumë i zënë. Një material për problemet e muzikës e do sektori, një relacion po e përgatis për kolegjin dhe një tjetër, - e uli zërin që të ishte sa më konfidencial- e do shoku Ministër. Nuk kam vartës, të gjitha problemeve të ngatërruara të muzikës kjo kokë duhet t'u japë rrugë. - Dhe me atë rast përkëdheli tullën e tij. - E dini besoj, sa telashe na kanë hapur këngët sentimentale të ciganëve, si "Vare veten në litar, o Sefo," të cilat dashur pa dashur prishin shijet e publikut.

- Ka mendime se ata po mbushin boshllëkun që ndihet për këngët qytetare, - vërejtja.

- Kush i thotë këto? - më kërkoi llogari. Ata po i kundërvihen revolucionit dhe ne jemi të detyruar të marrim masa. Do t'i ndalojmë me urdhër...

Nxori një bori të gjatë tymi dhe një psherëtimë po aq të gjatë. E vura re mëdyshjen e tij.

- Më janë mërzhitur relacionet, referatet, informacionet. Do të desha t'i shpalos mendimet e mia kritike dhe ta themi pa dorëza, - sërish u përkul drejt meje, - honoraret s'janë për t'u përbuzur.

- Mendimi juaj pritet me interes, sepse jeni autoritet, - e flatrova.

- Mirëpo vendi ku jam, më pengon, ngaqë interpretohen si mendime të dikasterit.

- Firmoseni me emrin tuaj, pa shënuar detyrën, a përgjegjësinë.

- Njëlloj është, bota e dinë ku punoj ... - ma priti. - Ministri nuk lejon instruktorët të shprehen në shtyp as për mirë, as për keq.

- A propo, - e pyeta, - cili është mendimi juaj për muzikën e atij filmi?

Buzëqeshi duke më lojtur syrin.

- Ejani ta dëgjoni në janar, në raportin vjetor.

- Pak si vonë, - i thashë me të qeshur.

Pasi mbylli një dosje të trashë, u ngrit në këmbë.

- Shefat nuk duan kritika, - tha duke anuar kokën andej nga ndodhej zyra e ministrit. - Sa të më qortojnë pse e lejova, pse nuk i thashë vërejtjet kur u vizionua filmi, më mirë... - vuri dy gishta mbi të dy buzët sikur po u vinte drynin.

Mora rrugën e redaksisë i lodhur nga vapa dhe i mërzhitur nga maratona. Shefit ia thashë peripecitë e mia, tok me argumentet që kisha dëgjuar prej secilit. Ai u mendua pak, pastaj më kumtoi idenë që i lindi në kokë.

- E shoh se keni përfituar mjaft nga bisedat me kompozitorët. E dini çka? A nuk i përvisheni ta shkruani vetë?

Qe propozimi më i marrë që kisha dëgjuar. Si të shkruaja artikull kritik për muzikën, kur s'dija të dalloja as shtatë notat muzikore? Druhesha se lexuesit do të qeshnin me mua, po ndërkohë nuk doja ta humbisja lejën. I thashë shefit: "kam nevojë të mendohem pak më gjatë, me qetësi."

Pas njëzet e katër orësh e ndava mendjen të shkoja në zyrën e kryeredaktorit dhe t'i thosha: "Daç ma jepni lejën, daç jo, muzika e atij filmi s'ka për t'u kritikuar."

SA PËR VITRINË

Drejtori i uzinës, kushedi për ç'arësye, nuk po tregohej aspak mirëdashës me ne. Si gazetarë të revistës "Ylli," i vetmi organ i ilustruar, ishim mësuar të na prisnin mirë kudo që shkonim, jo se kishin ndjenja miqësore ndaj nesh, po nga dëshira që të shihnin veten e tyre, ose ndërmarrjen ku punonin në faqet e shtypit.

- Përse thatë se keni ardhur? - pyeti me dyshim të dukshëm.

- Duam të botojmë një reportazh të ilustruar te revista "Ylli" për uzinën tuaj.

- Në uzinë nuk mund të hyni kurrsesi! - tha vendosmërisht.

U detyrova të nxirrja nga portofoli fletëshërbimin e redaksisë me firmë dhe me vulë që të bindej se destinacioni ishte Kurbneshi dhe ia lashë mbi tryezë. Edhe Leoja kreu të njëjtin veprim. Na vinte pak rëndë kur na kërkonin fletë-shërbimet, por tek e fundit qe një formalitet i nevojshëm.

- Këto s'më duhen gja, - tha pa denjuar t'u hidhte sytë.

U krijua një pushim paksa nervoz, se nuk po e kuptoja ç'mund të kërkonte më shumë identitetin tonë.

- Do të merrni fotografi brenda uzinës? - pyetjen ia drejtoi fotoreporterit.

- Sigurisht, prandaj kam ardhur i ngarkuar, - tha duke i treguar çantën. - Kjo është detyra ime.

- Kurrresi! E kemi të ndaluar. Nga jashtë, fotografoni sa të doni, nga brenda jo! Në asnjë mënyrë.



- Më falni, se nuk po arrij t'ju kuptoj, shoku... - ndërhyra unë.
- Prengë Kaçinari, - e plotësoi ai.
- Disa gazeta kanë botuar reportazhe dhe fotografi nga uzina juaj,
- i kundërshtova me shpresë se argumenti do ta bindte.
- Ju thashë, e ke-mi të nda-lu-ar, - ngulmoi duke i veçuar rrokjet.
- Kinostudioja ka xhiruar një kinozhurnal brenda uzinës, apo jo? - vazhdova unë.
- Ata e kishin lejën me vete, - ma preu drejtori.
- Ju mund të na pajisni me lejë...

Nuk deshi të përgjigjej a nuk dëgjoi, s'e mora vesh, prandaj ia përsërita kërkesën.

- Lejët nuk i lëshoj unë, - ma priti, - ato merren te Dega e Brendshme, në Rrëshen.

- Ne prej andej erdhëm dhe mund t'i kishim marrë, po ta dinim. Mos duhet të kthehemi sërish? - e pyeta qëllimisht që ta vija në pozitë.

- Ta merr mendja, - ma priti.

- A mund t'u telefonojmë? Ata e dinë që jemi, sepse një oficer i degës na shoqëroi deri në agjensi dhe u kujdes të na hipte në kamion, - ngulmova unë.

Nisi të mendohej. M'u duk sikur u zbut, sepse e mori vetë në telefon Degën. Çështja e lejës, u rregullua brenda dy minutash. Sjellja e Prengë Kaçinarit, po më dukej e vrazhdë, në mos tekanjoze. Mos vallë ndonjë gazetar e kishte kritikuar publikisht drejtorin e uzinës dhe tani ishte mërzhitur me të gjithë?

* * *

Uzina nga jashtë e nga larg dukej mjaft e bukur, ndërsa brenda ishte e zymtë dhe e trishtuar. Prenga na shoqëronte në çdo hap. Kryeinxhinieri na shpjegoi se koncertati i bakrit përftohej me anë të flotacionit. I lashë mënjanë hollësitë e procesit teknologjik, sepse për to lexuesi nuk kishte pikë interesi. Më mirë të shkruaja për njerëzit duke qëmtuar ndryshimet psikologjike të kapërcimit nga një shoqëri mesjetare në epokën moderne. Këtë mund ta arrija duke

vizituar familjen e ndonjë punëtori, që kishte zbritur nga kullat e zymta të malësisë dhe tani jetonte në apartament. Në Kurbnesh ishin ndërtuar nja pesë a gjashtë ndërtesa katërkatshe. A ishin të kënaqur nga jetesa në qytet, me ujë të rjedhshëm, me lavaman e banjo brenda dhe me dritare të mëdha, në vend të frëngjive? Shpresoja të takoja ndonjë të moshuar që të më rrëfente ngjarje interesante nga e kaluara, mekanizmin e kuvendeve, rolin e bajraktarit në fis, etj. Ia shfaqja dëshirën drejtorit dhe ai menjëherë thërriti pranë një punëtor.

- Fran, - i tha, - këta gazetarët e Tiranës kanë dëshirë të vizitojnë familjen tuaj.

M'u duk sikur ai u step, po drejtori s'i la rast për vërejtje.

- Për lejë mos ki merak. Lëre turnin dy orë përpara dhe nis.

Pjesa tjetër e bisedës midis tyre u zhvillua me pëshpërime.

* * *

Sapo iu afruam apartamentit ku banonte Fran Përtena, fqinjët e dhanë lajmin që nga dritaret: "Po vijnë. Janë te sheshi," sikur ne të ishim udhëheqës, e jo dy gazetarë të thjeshtë. Me sa dukej vizita jonë në familjen e një punëtori të thjeshtë, përbënte kuriozitet.

Pjesëtarët e familjes së Franit, i ati, e ëma, një nuse e re me një fytyrë pa shprehje dhe dy fëmijë, u vendosën rresht në sallonin e hyrjes së përbashkët, sikur prisnin krushqit.

U futëm në apartamentin e tyre standard me dy dhoma e një kuzhinë. Na futën në dhomën e pritjes. Duhet ta pranoj se ishte pajisur mjaft mirë dhe me shije. Në mes një tryezë e vogël, në anë të murit një tryezë katërkëndëshe me sofrabez dhe sipër saj radioja e mbuluar me një qëndismë dore. Disa shishe birre mbi tryezë dëshmonin se për vizitën tonë ishin dashur shpenzime suplementare nga buxheti i familjes. Minderet anës të mbuluar me qilima natën shërbenin për të fjetur fëmijët ose pleqtë, kurse çifti e kishte dhomën e gjumit më vete. Derën e saj e kishin lënë hapur dhe kalimthi pashë shtratin bashkëshortor me një jastëk të madh në krye si ato që marrin nuset tiranase për pajë. U befasova më shumë teksa në dhomën e

pritjes pashë një riprodhim të tablosë romantike të Gjinevrës, në mes të pyllit, me flokët e lëshuar deri te beli. E kisha parë atë pikturë në fshatin tim, dhe në çast m'u kujtua edhe historia që rrëfehej për të. Gjinevra arratisej në pyll për t'i qëndruar besnike burrit dhe më vonë me ndihmën e disa kafshëve bashkohej sërish me burrin. Nuk ma mirrte mendja ta gjeja Gjinevrën edhe në Mirditën e varfër e luftarake.

Mendova t'u lutesha të mos i hapnin shishet e birrës, po sapo kujtova këshillën e një shokut tim: "lëre të zotin e shtëpisë të bëjë ashtu si di e ashtu si do," u përmbajta.

Leoja u çlirua duke hequr nga supet dy çantat e rënda me aparate dhe unë ndoqa shembullin e tij. Vura se se çanta ime dhe jastëku mbi minder kishin afërsisht të njëjtën ngjyrë, bezhë.

- Tamam si në qytet, - tha Leoja. - Bile as në qytet s'e gjen një dhomë të pajisur kaq mirë.

Plaku buzëqeshte duke rrotulluar syrin e vetëm, si ta shihte dhomën për herë të parë. Qilimi, dritaret me dy palë perde, disa jastekë të vegjël në qoshet e mindereve, gjithçka dëshmonte se nusja i kishte duart të arta.

E pyeta plakun nëse ndiente mall për fshatin.

- Jo, - më tha, - nuk më merr malli.

- Ku është më mirë, këtu apo në fshat? - e pyeta.

- Po të kesh haje, kudo mirë është, - tha plakuri.

Disa përpjekje për ta nxitur të tregonte ndodhira të hershme, nuk patën sukses. Vallë ku e kishte humbur syrin, në ndonjë betejë me armiqtë, apo nga ndonjë sëmundje?

Leoja papritur pyeti:

- A ka peshk ky lumi këtu pranë?

Pyetja s'kishte ndonjë farë lidhje me bisedën, prandaj Frani u duk paksa i turbulluar. Ishte në natyrën e Leos të pyeste për çdo gjë që i shkrephte në kokë në mes të bisedës, si për shembull: "Të ketë njerëz në Mars? Mua s'ma merr mendja." E dija se pyetjet e këtij lloji, ishin shpërthime të zëshme të monologjeve të brendshëm të Leos.

- Ka, - iu përgjigj Frani, - por ne gjithmonë peshkun e blejmë në shitore. E po gëzuar, pini nga pak se po ngrohet birra.

Kishin shtruar edhe meze, djathë e vezë të ziera. Djathi ishte i shijshëm, veçse kishte një erë aq të fortë, sa kushdo mund t'u binte pas gjurmëve edhe pa ndihmën e qenit.

Plaku duke mbështetur bërrylin, rrëzoi përtokë një pjatë, e cila sakaq u nda më dysh. Syri i vetëm i tij u pikëllua.

- S'ka gjë, - e qetësoi djali, - kemi pjata plot.

- Mirëpo kur prishet servisi, kujtdo i vjen keq... - ndërhyra unë.

- Blejmë servis tjetër, - tha Frani.

- Kur thyhet diçka, thonë se familja merr lajm të mirë, - tha Leoja.

- Besa jo, - tha plaku. - Na e kemi për keq.

Leoja u ngrit të fotografonte apartamentin modelor duke i rregulluar njerëzit e familjes pranë radios, nga njera anë plakun me nusen, nga ana tjetër Franin me nënën. U tha të buzëqeshnin dhe drita e blicit shkëlqeu si vetëtimë. E dija diçiturën e saj: "Familja e Fran Përtenës duke dëgjuar radion në orët e pushimit. " Të tilla fotografi ishin rutinë e përditshme, në kohën kur radiot në malësi ishin të rralla. Pasi mori dhe disa fotografi të tjera, më tha se mund të iknim.

Kur u ndamë prej tyre, vumë re se fqinjët e Përtenajve nëpër dritare që soditnin largimin tonë.

U kthyem në hotel. Leoja u zhvesh e ra të flinte nja dy orë. Unë s'kisha gjumë prandaj mendova të lexoja ndonjë tregim nga vëllimi "Rrugët e Fatit" të O. Henrit. Më pëlqente ai humorist me ngjarjet e tij të jashtëzakonshme dhe fundet e papritura. Vura re se nuk kisha as libër, as çantë.

- Leo, e kisha çantën kur dolëm nga shtëpia e Franit?

- Mos u merakos për një vjetërsirë, - qe komenti i Leos.

U kujtova se e kisha lënë te minderi i familjes Përtena. M'u desh të merrja rrugën sërish për te apartamenti i tyre. Trokita dy tri herë në portën e jashtme, derisa u kujtova se ajo ishte e të gjithëve dhe e askujt. Ktheva dorëzën dhe hyra në sallon. Një grua me veshje qytetare, shkoi përpara meje duke mbajtur një radio ndër duar. Dera

e apartamentit të Përtenajve ishte e hapur dhe unë hyra brenda. Një vajzë po mblidhte jastëqet kapicë, ndërsa një tjetër po hiqte nga krevati kuvertën. Perde s'dukeshin më në dritare, as të rëndat, as kurtinkat. Edhe radioja edhe sahati qenë zhdukur, Gjinevra kishte ikur me gjithë kornizë. Një grua e moshuar bërtiste pa mirësjellje, duke i rënë tryezës me grusht:

- Dua pjatën që më keni thyer. Pjatën, pjatën...

- Tash po ta blejmë një pjatë, - e siguroi nusja e shtëpisë.

- Jo një pjatë por kompletin, se e prisha për shkakun tuaj.

Plaku me syrin e vetëm kundronte me mospërfillje fqinjët që po e zhvishnin apartamentin e tyre dhe ndërkohë rrallonte mezetë që kishin tepëruar. Dikush i ra në sup dhe e kujtoi të ngrihej se do të merrte karrigen.

Çantën time s'e kishte lojtur askush nga vendi. E mora dhe dola jashtë.

Në darkë takova rastësisht në restorant Paulinin, mjekun e Kurbneshit, shokun tim të shkollës. Na pyeti si e kishim kaluar ditën. I thashë se ishim për vizitë te familja Përtena.


- Te Zef Përtena? - pyeti. - Te ai plaku që e ka dëmtuar syrin duke gjuajtur peshk me dinamit?

M'u kujtua pyetja e Leos nëse lumi i tyre kishte peshk dhe hutimi që pësuan at e bir. Ndoshta pandehnin se Leoja pyeti qëllimisht, po unë betohem se as atëherë, as tani Leoja s'di gjë për atë incident.

Mëria e drejtor Prengë Kaçinarit kundër gazetarëve e kishte burimin te një ngjarje e jashtëzakonshme. Disa kohë më parë, dy diversantë u paraqitën në zyrën e drejtorit si gazetarë dhe ai i priti me nderime, madje i qerasi me kafe e konjak. Ndërsa priste t'i dilte emri në gazetë, njëri prej tyre dha një intervistë nga stacioni "Evropa e Lirë" ku midis të tjerash tregoi edhe vizitën e tyre në Kurbnesh dhe bisedën që kishin patur me drejtorin. Prengën e shembën me kritika për mungesë vigjilence, e paralajmëruan se do ta përjashtonin nga partia dhe do ta pushonin nga detyra si drejtor.

- Një javë nuk e nxori hundën nga shtëpia, - komentoi Paulini. - Deri tani vazhdon të jetë drejtor, por të shohim sa do ta mbajnë, - e përfundoi komentin ai.

NGUSHËLLIMTARËT E PANJOHUR



Ardit Shkumba, sa u fut në zyrë, vari pardesynë në portmanto, Anxorri prej xhepit paketën e cigareve, çakmakun dhe u ul në kolltuk. Nuk i punohej dhe as nuk dinte nga t'ia fillonte. Sapo ishte kthyer nga një udhëtim pesëditor në Austri dhe qelizat e trurit të tij ishin të ngarkuara me mbresat e udhëtimit. Pesë ditë në Vienën e mahnitëshme, të pasur me muzeume e parqe, me objekte turistike, me ishullin e stërgjatë të Danubit në mes të qytetit, me lokale luksoze që emetonin muzikë nga tri gjenerata Shtrausësh, kishin qenë si një festë e gjatë. Drejtori i TVSh shfrytëzoi mjeshtërisht një ftesë nga Telefunken WIENA për shkëmbim përvoja me kolegët austriakë, por qysh në séancën e parë u bind se përvoja jonë nuk i hynte në punë askujt, prandaj nuk e nxorri referatin nga xhepi. Për të mos e humbur kohën kot, përfaqësuesi shqiptar vendosi ta kthente

shërbimin në vizitë turistike. Para se të largohej, bleu një suvenir për vete dhe disa dhurata të porositura nga gruaja dhe kalamajtë. Tani, si gjithë atyre që ktheheshin nga Evropa perëndimore, do t'i duheshin dy-tri ditë sa të mblidhte veten e të futej në hullinë e problemeve të përditshme.

Paketa "Pall Mall," ngjyrë ari dukej dyfish nga pasqyrimi mbi sipërfaqen e tryezës. Pranë saj, si një ushtar besnik, rrinte çakmaku bojë mjalti, me anagramin A. Z. që u korrespondonte afërsisht inicialeve të Ardit Shkumba. Mund të thoshte se fabrika e kishte ngatërruar paksa porosinë e tij, duke e kthyer "S" në "Z," çka konfondohej shpesh në gjuhën gjermane. Njësoj si bosët dhe ambasadorët e perëndimit edhe ai kishte çakmak me anagramin e tij.

Arditi vdiste që ta merrnin si të huaj, sepse i dukej vetja më pranë botës së qytetëruar, kulturës perëndimore. Kur ishte student, tre vjet e kishte mbajtur rrotull qafës një shall për shkak të etiketës "Milansport," edhe pse nuk ishte ndonjë firmë e njohur. Me kalimin e viteve shalleve dhe kravatave u kishte rënë vlera. Rivaliteti dhe konkurrenca shoqërore në institucionin e tyre qe spostuar te çakmakët me gaz butan.

Vendin e nderit për disa kohë e mbajti çakmaku petashuk i Agron Bexhetit, pastaj supremacia kaloi te Andon Rruga, i cili pruri nga Kosova, një çakmak me bateri, "Made in Singapor," që sipas tij kushtonte sa një frigorifer. Natyrisht deklaratën e tij jo të gjithë e besonin, por sidoqoftë çakmaku ngjalli zilinë e snobistëve për elegancën dhe finesën. Fama e tij u shua nga një çakmak me "shintilë" të firmës DGT, që solli Bert Lala nga Zvicra. Atij nuk i pëlqente ta përkthente shqip "me shkëndijë," se asisoj ia ulte vlerën dhe meritat. Sipas Bertit, çakmaku ishte i garantuar për dhjetë mijë shkrepje. Sipërania e tij vazhdoi dy muaj, derisa Gjergj Strugari i mahniti duhantihithësit me çakmakun elektronik taivanez. Sapo të prekje me mollzën e gishtit një sumbull bojë mjegulle, flaka shpërthente automatikisht. Tani Arditi e brente kureshtja të shihte si do të vlerësohej çakmaku i tij, çfarë shkalle do të zinte, në ç'rang do të vendosej.

Andon Rruga u fut në zyrë për ta mirëseardhur dhe për të firmosur një shkresë. Arditi, si gjithë të sapokthyerit nga jashtë, i ofroi një cigare nga paketa "Pall Mall," pastaj ia ndezi me çakmakun e ri. Tok me vezullimin e flakës së kaltër, në zyrë u dëgjua melodia e "Tangos së Artë." Andoni nuk mundi ta përmbante admirimin e vet.

- Çakmak me muzikë?! Ua! Mrekulli e teknikës së shekullit!

Arditi i tregoi mekanizmin. Një shigjetë e vogël lëvizej nga krahu i djathtë në të majtin dhe pastaj sa e shkrepje, tok me flakën shpërthente edhe muzika.

- Sinkronizim i shkëlqyer! Ky çakmak ua kalon të gjithëve. Unë për vetë dorëzohem pa kushte, - deklaroi Antoni.

Pasi la mbi tryezën e drejtorit shkresën me emrat e ekipit të RTV që do të filmonte Kongresin e Gruas, Antoni u largua. Arditi u krodh në një gjendje e vagëlluar midis gjumit dhe meditimit. "Kongresi i grave, - llafologji bajate," tha me mend. Disa trokitje në derë e nxorën nga përumbja. Gjergji, redaktori i programacionit, u fut me vrull. Pyetja e tij e parë, e befasoi.

- A mund ta shoh atë mrekullinë?

- Nga e more vesh? - u habit Arditi dhe natyrisht u gëzua që fama e çakmakut po përhapej më shpejt nga sa e kishte menduar. I shkujdesur kapi çakmakun, shkeli sustën dhe melodia e "Tangos së artë" mbushi hapësirën e drejtorisë.

- Sigurisht japonez, - tha Gjergji, meqë ata shquheshin për miniatura elektronike.

- Austriak, - e sqaroi Arditi.

Gjergji po e vërente me kujdes nga të gjitha anët.

- Ta merr mendja, se Viena ka tradita për muzikë, nuk e quajnë kot kryeqytet e muzikës në Evropë. Sa përpara ka shkuar bota! Kurse ne vazhdojmë të prodhojmë shkrepse me thirrjen patriotike "Mbroni pyjet nga zjarri," edhe pse një në dhjetë fije mezi arrin të ndizet. E keni vënë re idiocinë e uzinës "Misto Mame"? Mbi çdo kuti shkruan "shkrepse," sikur të ketë frikë mos e marrin për djathë bebe. Kuti të shëmtuara. Kurse austriakëve, shih ku u shkon

mendja, ta servirin muzikën me çakmak në çdo mjedis. Do të dëgjosh muzikë? Fap e shkrep. Do ta ndalosh? Fap shigjetën në anën tjetër.

- Jo, nuk ndalohet. Po nisi, vazhdon plot shtatëdhjetë e gjashtë sekonda, - i shpjegoi Arditi.

- M'u duk më e gjatë...Me këtë çakmak unë qysh tashti shkoj te Dajti, për t'u shitur pak tangërllëk të huajve. Nuk zotërojnë vetëm ata sende luksi moderne. Ka më bukur se ta ndezësh cigaren duke dëgjuar muzikë? Na e mori mendjen çakmaku dhe për pak harrova pse erdha. Ju thanë se Lavdies i ka vdekur i ati?

- Cilës Lavdie? - pyeti drejtori, - se këtu kemi nja tre a katër Lavdie.

- Laborantes që punon në montazh. Mbiemrin e ka Malaziu a Guraziu, nuk ia di saktësisht.

Drejtori u mundua t'i kujtonte fytyrën.

- Kërkon lejë? Pesë ditë i takojnë me ligj, - tha Arditi duke u futur tërësisht në lëkurën e drejtorit.

- Lejën e mori qëkur ishit në Vienë, se nuk mund ta linin pa varrosur sa të ktheheshit ju. Më duket se tani u bë një javë që ka vdekur. Mendoj se do të ishte mirë t'i shkonim për një vizitë ngushëllimi në shtëpi?

- As mos e diskuto, - e përkrahu drejtor Arditi. - Fjala popullore thotë: "Në dasmë prit t'ju ftojnë, në vdekje shko vetë."

- Takohemi te Sahati, nesër në orën njëmbëdhjetë.

Drejtori padashur ftilloi me mend kontrastet e jetës. Ndërsa ai shëtiste nëpër parqet dhe bulevardet e Vienës, hante e pinte në restorante luksoze, flinte në jastëk me pupla, i ati i Lavdies kishte ikur nga kjo botë pa ditur gjë as për novitetin e ri shkencor, çakmakët me muzikë.

* * *

Të nesërmen, sapo u takua me shokët e tij te Sahati, Arditi pyeti nëse e dinte njeri adresën e Lavdies.

- Përafërsisht, - u përgjegj Gjergji. - E ka andej nga blloku "Miqësia," diku pranë Andon Rugës.

- Ju lutem qëndroni seriozë, jo shaka, jo barceleta, jo qeshje.

- Të gjithë luajmë nga pak, edhe pa qenë aktorë, - komentoi Vilsoni.

Pranë bllokut "Miqësia," operatori Bashkim Sharra pyeti:

- Për ç'miqësi ka lindur ky bllok?

- Për miqësinë shqiptaro-kineze, - i tha Gjergji. - Nuk e besoni? Vemë bast po deshe.

- E pa cilësuar duket panbotërore, - vërejti Bashkimi.

- Me cilët shtete ka miqësi vendi ynë tani? - pyeti Vilsoni.

- Me marksistë-leninistët e vërtetë, - ia priti Gjergji.

- Marksistët janë grupe politike, jo shtete, - kundërshtoi Vilsoni.

- Jo biseda politike në rrugë - i këshilloi drejtori, pastaj pyeti: - Çfarë thuhet kur shkohet për kryeshëndoshë? Ne të rinjtë, s'e kemi idenë.

- Thuaj një gëzuar dhe kaq mjafton, - tha Vilsoni.

- Ky është rrotë, - tha Gjergji, - për nder, rrotë. Si u thënka gëzuar në ngushëllim?

- Ka qenë ndonjë prej jush te apartamenti i Lavdies? - pyeti drejtori. Asnjë nuk u përgjigj. Arditi sikur nxirrte konkluzionet e një diskutimi, vazhdoi. - Kjo tregon vdirjen e traditave. Tani rrallë e vizitojmë njëri-tjetrin.

- Presim raste të veçanta, - shtoi Gjergji, - fejesë, dasmë, dekorime, marrje titujsh...

- Kot nuk shkohet për vizitë, - vërejti Vilsoni. - Iku moda e qëmotshme "po shkojmë sonte nga filani për një kafe." Kush është aq i ngeshëm sa ta humbë mbrëmjen kot?

- E shihni se edhe piktorët thonë ndonjë herë gjëra të mençura? - e shigjetoi Gjergji skenografin

Blloku "Miqësia" me apartamente katër e pesë katesh, të vendosur paksa në mënyrë asimetrike, pa ndonjë arsye, ishte mjaft i madh.

Ecnin kuturu me shpresë të shihnin ndonjë lajmërim vdekje nëpër shtyllat e betonit a në ndonjë mur. Së fundi u detyruan të pyesnin disa fëmijë që po luanin me top, mos e dinin ku kishte ndodhur një vdekje.

- Te kjo shkalla këtu, - u tha një djalë duke ua treguar me gisht.
- Paskemi ardhur sak aty ku duhej, - tha Gjergji.
- Intuita pranohet edhe nga shkenca, - e përforcoi Vilsoni.

Ngjitën shkallët dhe u futën te dera e apartamentit që gjetën hapur. Sipas traditës së re, ata që kishin dasmë a mort, i mbanin dyert hapur. Duke pëshpëritur nëpër buzë “ngushëllime,” u dhanë dorën të përzishmëve. Televizori dhe radioja ishin mbuluar me copë të zezë, si shenjë se edhe ato objekte do të mbanin zi për të ndjerin. Pak e çuditshme, që edhe Lavdia, punonjëse e TV, e kishte pranuar këtë zakon fshatar të prapambetur.

Mbi tryezën e mesit, si në çdo vakijet, kishte plot paketa cigaresh me filtër e pa filtër. Një burrë me syze kapi një paketë, u ofroi mysafirëve me radhë cigare, pastaj mori një për vete. Arditi, për t’u treguar mirënjohës, nxitoi t’ia ndizte cigaren me çakmakun e tij. Sa e shkrep, tok me flakën shpërthyen tingujt e “Tangos së Artë”. Melodia gazmore në dhomën e përzishme tingëllonte skandaloze. Arditi e rراسi menjëherë në xhep dhe u rropat ta mbyste muzikën me kollitje. Përpjekje e kotë, se kolla zgjati veç pak sekonda, e pastaj vazhdoi muzika e gëzuar. Shtatëdhjet e gjashtë sekondat s’kishin të mbaruar. U provua edhe njëherë sa e drejtë është teoria e Ajnshtajnit për relativitetin e kohës. Atmosfera në dhomë u rëndua. Një plak duke mermëritur nëpër buzë thoshte “maskarallëk,” “paturpësi” dhe disa fjalë të tjera të atij kallëpi. A vihej me muzikë atje ku kishte mort? Një turp i tillë nuk ishte dëgjuar. S’po dukej as Lavdija që të fillonin ndonjë bisedë e të çliroheshin nga gjendja e tensionuar.

- Lavdija, besoj se u mërzit shumë, - tha Gjergji sa për të hapur një bisedë.

- E keni fjalën për të shoqen? Nuk e quajnë Lavdie, por Sanie, - e sqaroi një burrë me syze. - Domosdo që u mërzit, se të ndahesh nga bashkëshorti...

- Gjergji pyet për të bijën, - i erdhi në ndihmë drejtori.

Atë çast sollën kafetë tradicionale dhe biseda u ndërpre. Lavdia nuk doli r'i takonte as pas kafesë. Ndoshta e fyer nga profanimit i shokëve të punës, qante në ndonjë skutë.

- Mos punoni te Uzina e Postës? - e pyeti burri me syze Gjergjin.
- Ju kam parë disa herë atje.

- Xhirimet na shpijen kudo, - ia ktheu Gjergji pa dhënë shpjegime plotësuese.

- Të "Kinostudios" jeni ju?

- Ne jemi të televizionit, - i tha Vilsoni.

Ndërkohë burri me syze përpiquej të gjente lidhjen midis Televizionit dhe të ndjerit shpërndarës poste, kunatit të tij, që kishte vdekur një javë më parë.

Duke zbritur shkallët, Gjergji i tha drejtorit:

- Lavdia do të jetë zemëruar, derisa nuk na doli. Me të drejtë. Ngushëllim me muzikë ...

- S'di si r'i kërkoj të falur, - tha Arditi.

- E menderosëm... - shtoi Vili.

Sapo dolën jashtë hyrjes, takuan Andon Rrugën që kthehej nga tregu, me dy rrjeta mbushur me fruta e zezavate.

- Po ju ç'deshët këtej? - i pyeti ai kolegët e tij.

- Ishim për ngushëllim te Lavdie Guraziu, - i shpjegoi shkurt Gjergji. Ai po e

shihte në sy pa arritur ta kuptonte. - Te Lavdia jonë pra. A nuk i vdiq i ati para një jave?

Andoni sikur të vinte nga një botë tjetër, vërejti pallatin, hyrjen, shkallët për t'u orientuar.

- Lavdia banon dy blloqe më tej, ngjitur me pallatin tim, - i sqaroi Andoni.

- Po ne ku ishim? - pyeti Gjergji duke i rënë ballit me dorë.

Që nga ballkonet e të ndjerit shpërndarës poste, disa njerëz vërenin me kureshtje ngushëllimtarët e panjohur.

MUNGESTARI MË I RREGULLT

Ekisha parashikuar se Xhovi do ta pësonte një ditë. Jo se jam profet, jo se zotëroj aftësi të veçanta për të parathënë ngjarjet, por sepse e kishte mbushur kupën. Madje për mendimin tim, e duruan pak si tepër. Po bëhen trembëdhjetë muaj, qëkurse Komiteti Ekzekutiv e emëroi përgjegjës të vatrës së kulturës në Kodras dhe fshatarët nuk e njohin akoma as si fytyrë. Ai vjen në fshat dy herë në muaj, më tre dhe tetëmbëdhjetë, ditën kur ndahen rrogat. Edhe aq nga halli, sepse llogaritarja e seksionit nuk pranoi t'ia dërgonte rrogën në shtëpi me mandat postar. Rrogat e sqaroi ajo ndahen me bordero, në çdo qendër pune dhe nuk mund t'i shkelte rregullat financiare. Kësisoj Xhovi Pumbaku vinte në Kodras paradite, fuste rrogën në xhep dhe kthehej andej nga kishte ardhur. Ishte pak ta quaje mungestar, qoftë edhe të rregullt, sepse ai praktikisht e kishte braktisur punën dhe çështja e tij ishte problem në mjediset e kulturës dhe te të dy komitetet.

Disa përgjegjës kulture që s'kanë as gjysmën e shkollës së Xhovit, bëjnë çmos ta justifikojnë rrogën dhe emërimin. E çelin vatrën dy-tre orë pasdite, u ndajnë gazetat pajtimtarëve, shkruajnë me gërqele ndonjë parrullë mbi llamarinat e ndryshkura, kurse Xhovi hiç, nuk zinte punë me dorë. Unë, si shok i tij, i kisha dalë nga borxhi më se njëherë, po pse merrte vesh ai?: “Sa të jetë ai kulufi atje ku është, nuk e gjen gjë Xhovin,” më përgjigjej. Fliste për veten e tij si për një

person të tretë, ndërsa kuluf quante dajën e tij, drejtor drejtorie në Ministrinë e Jashtme. Pa turp fare e thërriste “kuluf”, qen stani.

E këshillova:

- Së paku shpërndaj shtypin, sa për t’u zënë sytë se po merresh me diçka.

- E kam parim të mos kryej punën e të tjerëve, - ma preu.

- Pse, e kujt qenka?

- E Ministrisë së Komunikacionit dhe postës, e atyre që paguhen për atë detyrë.

- Meqë na përkitka interpretimi, përmbajtja, zgjidh ndonjë artikull interesant, shko te ndonjë brigadë në fushë dhe ua lexo, - i thashë.

Ai nisi të qeshte.

- Këto janë forma të vjetëruara të kohës së analfabetizmit, - tha me përbuzje.- Leximet kolektive në një kohë kur çdo familje ka radio, televizor, s’kanë kuptim. Ke mbetur prapa, - më qortoi.

Një farë të drejte e kishte, sepse shumë forma të kulturës masive, të kopjuara nga Bashkimi Sovjetik, në kohën e lulëzimit të miqësisë politike, tani stononin, mirëpo kush guxonte të ngrihej kundër tyre?

Të premten e kaluar erdhi në Kodras një letër nga Komiteti me Nr. Protokollit dhe me pesë vula sipër, të shtunën krisi edhe telefoni: “Lajmëroni përgjegjësin e vatrës së kulturës, shokun Xhovi Pumbaku, të paraqitet në Komitetin Ekzekutiv ditën e hënë, ora 12.00.” Drejtori i shkollës i tha shefes së kuadrit se Xhovin e kishin në qytet, ndërsa Burbuqeja iu gërmush: “Ti zbato urdhërin, mos mëso të tjerët.” Drejtori m’u lut t’ia shpija Xhovit letrën në dorë dhe unë e pranova. Edhe pa e hapur, e dija përmbajtjen e zarfit me pesë vula.

- Ç’i thua ti kësaj? Pse me kaq urgjencë? - më pyeti Xhovi, sapo ia dorëzova.

- Mos u hiq naiv! Ti e di shkakun,- ia përplasa.

- Jo, për nder të familjes, nuk e di, - ngulmoi.

Donte të luante me mua, apo shtirej? Jam i sigurt se Kryesia e Komitetit e ka thërritur në raport për ta qortuar për mungesat, e

ndofta do t'i komunikojnë edhe pushimin nga puna. E natyrshme. Edhe unë në vendin e tyre, atë do të bëja.

- Pse, mos pandehe se do të paguanin përjetësisht kot? - e pyeta.
- Sot do të zdrugatin paq, do të bëjnë fërtele. Boll të duruan trembëdhjetë muaj.

- Ti ia fut kot, se unë po vazhdoj të kërkoj të drejtën time, mbasi transferimi im ishte i padrejtë, - Arsyetimet e tij shpesh herë ishin stropio, të paparashikueshme.

- Nuk merret rroga duke dredhur zinxhirin nga klubi në klub, me varavingo nëpër qytet. Tani do t'ua nxjerrin nga hundët, - e paralajmërova.

Për çudi brenda meje ndesheshin dy ndjenja të kundërta. Ndjenja e drejtësisë më thoshte se Xhovi e meritonte ndëshkimin, gjeti atë që kërkonte dhe askush nuk i pati faj. Unë që shkoja në Ujmisht, ditë për ditë, pesë kilometra më tej pse nuk ankohesha? Transferimi i tij qenkesh i gabuar, imi jo. Gabim pa gabim, shko atje ku të caktuan, kryej punën që të kanë ngarkuar dhe pastaj kërkoe të drejtën me rrugë pushteti, e po s'e gjete atje, edhe me rrugë partie. Na qenka fyer zotëria e tij se ia zuri vendin e shoqja e Sekretarit të dytë. Ta merr mendja. Pse, mos do të shpinin Sidolën në fshat dhe të linin beqarët në qytet? Sipas Xhovit gabuan se i ndërruan profilin nga mësues kimie në përgjegjës kulture. Posi! Se mos i mbetej hatëri Mendelejevit që u transferua një mësues kimie në fshat.

Xhovin e gënjente mendja se nuk mund ta transferonin, për shkak se paska një dajë me pozitë të mirë në Tiranë, drejtor drejtorie në Ministrinë e Jashtme. Ai shkon jashtë shtetit sa herë të dojë, merr kë do pas, dërgon delegacione për të blerë viça e mëshqerra, sapun e oriz. Sipas Xhovit Simoni e paska mik të vjetër Nexhip Krastën. Të gjitha këto i mësova prej gojës së tij kur po diskutoheshin variantet për t'i hapur vend Sidolës. Komiteti nuk i mori në konsideratë lidhjet nepotiste të Xhovit dhe ia ngriti lecat nga qyteti. Një ditë kur po ktheheshim nga Kodrasi, e pyeta nëse i qe ankuar dajës për transferimin. Ma kapërceu mbytyrazi sikur i paskesh thënë të priste

e të mos mërzitej. As nuk e besova hiç. Dajë Simoni e kishte përcjellë me trastë bosh, mbase duke e qortuar se tani që kishte dalë vendimi me firmën e Kryetarit të Komitetit, s'mund të bëhej kurrëgjë.

Edhe unë mësues biologjie isha. Sa mirë ma ngjeshën mua, duke më thënë se po më dëgonin në fshat mes luleve, fluturave, kërmijve e kandrave, që të zhvilloja profilin tim, e mbase bëja dhe ndonjë zbulim shkencor. Më premtuan sa të hapej vendi i parë, do të më kthenin në qytet, mirëpo të lënë gratë e oficerave? Shtatë persona lëvizin komiteti për të emëruar drejtoreshë biblioteke gruan e komandantit të kufirit.

Ndjenja tjetër ishte keqardhja. Ndoshta jam pak sentimental. Do ta shkelmojnë të ziun Xhovi dhe kushedi ku do ta degdisnin. Sado e çuditshme të duket, prej Xhovit pata një përfitim të tërthortë. Më lavdëronin që e hapja vatrën e kulturës çdo mbrëmje dhe shpërndaja shtypin gjashtë ditë në javë.

Xhovi shpresonte ta mbronte autoriteti i dajës, në Ministrinë e Jashtme. Ma tha vetë kur diskutohej emërimi i Sidolës. Kushdo mund të ikte nga shkolla e qytetit, ndërsa ai kurrë. Një ditë, kur po ktheheshim nga Kodrasi, e pyeta nëse i qe ankuar xhaxhait për transferimin. E kapërceu pa më thënë asgjë konkrete. Daja e kishte përcjellë pa i dhënë shpresa, ose ndoshta e kishte qortuar se s'mund të ndërhynte pas vendimit të Komitetit. Kryetari ynë i Komitetit, Nexhip Krastës ia ngriti lekat Xhovit pa përfillur lidhjet nepotiste. M'i lumtë! U tregua parimor.

Meqë të hënave e kisha pushim, e përcolla Xhovin deri te hyrja e Komitetit Ekzekutiv, pesë minuta para se akrepat të puqeshin njëri mbi tjetrin te 12. Ora 12! Ora kur ndahet paraditja me mbasditen, mesnata nga dita e re, viti i ri me vitin e vjetër, shekulli me shekullin, një epokë me një tjetër. Simbolikisht 12-ta rrëfen fundin e diçkaje.

U ula te një stol i lulishtes përballë komitetit. Kushedi ç'po hiqte i ziu Xhovi nga nëpunësit e vrenjtur të komitetit, kushedi si e përvlonin shikimet e mbushura plot qortime e mëri. A do të rrinte dhe përballë tyre i shkujdesur si princ dhe moskokëçarës si fëmijë tekanjor, apo fshinte djersët me shami nga sikleti dhe lëpinte buzët

e zhuritura nga kritikata? Me mend radhitja bombardimet me pyetje e me kritika nga anëtarët e kryesisë së Komitetit.

“Çfarë aktiviteti keni organizuar qëkur u emëruat në Kodras, ju shoku Xhovi? Sa grupe artistike keni ngritur? Sa mbremje festive keni dhënë për kooperativistët e dalluar?”

“Ju si kuadër me shkollë të lartë, keni horizont dhe ne me të drejtë, prisnim më shumë nga ju. Deri tani nuk keni bërë asgjë. Kjo shkujdesje nuk ju falet.”

“Ju shoku Xhovi Pumbaku praktikisht e keni braktisur detyrën. Jeni sjellë vërdallë në qytet me pretekste të kota.”

“Shokët e tu në fshatra më të largët, në zona më të thella, i kanë qëndruar punës mbi krye. Duhet të merrje shembull prej tyre, ndërsa ti s’e ke çarë kokën.”

“Ku e ke tabelën e emulacionit socialist? Ku i ke fotografitë e të dalluarve? Mungesat e tua të pajustificuara janë shfaqje të huaja, prirje dembelizmi e parazitizmi. Ndërgjegje prej të riu revolucionar e quan ti këtë? Jo, jo, mos ul kokën, por përgjigju këtu!”

Do ta ndëshkonin, sigurisht. Më e pakta që transferimi në ndonjë zonë më të thellë, që të mos kishte mundësi të kthehej brenda ditës. Ose mund ta dërgonin për riedukim në qeramithanë që të gatuantë tjegulla me gabelët. Ndoshta do t’i komunikonin pushim në vend. Sidoqoftë pa masë ndëshkimore nuk do të shpëtonte. Me këto përsiatje u ngrita nga stoli dhe fillova të endem në udhëzat e lulishtes.

Doli më shpejt nga sa e prisja, duke mbajtur në dorë një zarf. “Komunikimin e pushimit,” mendova duke i hedhur një vështrim shkitazi.

- Shkojmë shkundim ndonjë gotë? - Nuk ishte pyetje, por propozim.

Sytë i shkëndijonin si t’i kishte hipur temperatura 44 gradë Celsius. I shkreti donte të gjente ngushëllim te gota.

- Shkojmë, - i thashë. Ndieja një farë lehtësimi që i ndodhesha pranë në ato çaste të vështira. - I kam nja treqind lekë, - shtova.

- Edhe të mos kishe duhet t’i gjeje për shefin tënd.

Për ç’lloj shefi e kishte fjalën?

- Ke përkrah inspektorin e kulturës së rrethit, - më kumtoi. - Nuk e beson? Urdhëro shkresën e emërimin! - Nxori nga zarfi vendimin e komitetit ku thuhej se shoku Xhovi Pumbaku emërohej inspektor kulture, me rrogë mujore 780 lekë. Nisi të më tregonte si u zhvillua takimi. - Xhipja (Nexhip Krasta për të ishte Xhipe), më priti në zyrën e tij. Pastaj erdhi Burbuqja, shefja e kuadrit dhe ai karabushi, Beqoja, shefi i arsimit. Xhipja tha: "Kemi nevojë për njerëz nga baza, që i njohin problemet. Përvoja e tyre e çmuar, do të ndihmojë përparimin e kulturës në rrethin tonë. Për këtë arsye Kryesia e Komitetit vendosi emërimin e shokut Xhovi Pumbaku inspektor kulture." Buqaja më dorëzoi shkresën. Uf, ia marrsha të ligat, sa të butë e kishte dorën! - Nga dashuria për të puthi majat e gishtrinjve të dorës së tij. - Pastaj edhe ai trapi, shefi i arsimit, më uroi suksese.

- Si është e mundur? - Më shpëtoi padashur një pyetje idiote që mund të fyente sedrën e Xhovit. Ai për fat, nuk e mori për keq.

- Pse habitesh? Gabimin e tyre rregulluan, - arsyetoi me mënyrën e tij origjinale.

Ishim afruar te dera e rostiçerisë, prej nga vinte aroma e shishqebapit me rigon dhe ai po më shtynte butësisht drejt hyrjes.

- Naim, sot do të qeras unë, vartësve u vjen radha më vonë, - tha sapo në tryezë erdhën dy kriklla birre. - Inspektor, si të duket?

- S'ka ku të vejë më mirë... Tani mund të bredhësh me makinë...

- Phë... kush i duron përditë ato fytyra... - tha me mërzi.

Pas një jave, duke shfletuar gazetat, më tërhoqi vërejtjen një lajm i vogël me kornizë në faqen e parë. Njoftohej nisja e një delegacioni të Ministrisë së Jashtme për në Hollandë, të cilin e kryesonte Nexhip Krasta, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të rrethit tonë. M'u kujtua daja i Xhovit në Tiranë, kulufi i Ministrisë së Jashtme.

“DANTEJA DHE SHEKSPIRI NË HALLVAXHIJAS”

Ky qe titulli i një shkrimi që zinte tri kolona, në faqen e dytë të gazetës “Rinia.”

Ngela i befusuar nga e papritura e këndshme. Danteja i hyjnishëm, pararendës i Rilindjes Evropiane dhe Shekspiri i paarritshëm, dramaturgu i madh, kishin shkelur që të dy, në kohë të ndryshme, në atë fshat të humbur të Myzeqesë. Kush e kishte zbuluar ngjarjen e bujshme? Sigurisht ndonjë dijetar shqiptar, duke kërkuar nëpër arkivat e pasura të Evropës. Nuk ishte krejt e pamundur, se historia përmend kushedi sa Perandorë të Bizantit dhe të Romës, që kanë përshkuar viset tona kush me kalë, kush me qerre, disa me shpura pompoze gjithë luks, e ca tërë zhul e djersë nga rruga e gjatë. A nuk u ndesh Cezari me Pompeun këtu në Iliri për të zënë fronin e Romës? A nuk erdhi Justiniani për të parë me sytë e tij vendin ku duheshin ndërtuar kështjellat? Edhe Fred Mjekërkuqi, që njihet ndryshe si Frederik Barbarosa i gjermanëve, këtej kaloi me kryqtarët drejt lindjes për të çliruar vendet e shenjta nga islamët dhe pavarësisht se nuk pati sukses, gjurmët i la kudo. A nuk zbriti Bajroni disa shekuj më vonë, në anëdetin tonë e pastaj u fut thellë deri në sarajet e Ali Pashë Tepelenës, duke mbetur i mahnitur si nga mjekra e tij e gjatë, ashtu dhe nga bujaria e plakut?

Dihet se anglezët të shtyrë nga kureshtja dhe shpirti i aventurës, kanë shkelur çdo skutë të botës. A nuk ishin ata që u futën mes xhunglave të frikshme e të panjohura të Afrikës dhe Australisë? A

nuk rrezikuan jetën në ishujt e Paqësorit, madje disa prej tyre e përfunduan rrugëtimin në kazanet e gjellës të kanibalëve? Ndofta Shekspiri i madh kishte ardhur në brigjet e Mesdheut për banja deti, a për të kërkuar subjekte ekzotike. Ndryshe pse do t'i vendoste ngjarjet e komedisë “Nata e Dymbëdhjetë” dhe të asaj tjetrës që s'më kujtohet titulli, në brigjet e Ilirisë? Kurse Dantja Arbërinë, e kishte afër, si derën e fqinjit. Dihet se kur shpërtheu lufta midis guelfëve dhe gibelinëve ai e braktisi Firencen dhe ndoshta për t'u shpëtuar kundërshtarëve erdhi u fsheh në një cep të Myzeqesë. Biografët e tij nuk përmendin se kapërceu ndonjë det, po se mos ata i dinë të gjitha. Po qe se Dantja dhe Shekspiri kishin ardhur në Hallvaxhijas, ku siç e dëshmon emri, hallva ishte specialitet i tyre, nuk mbetet asnjë dyshim se të dy do ta kishin lakmuar keq atë lloj ëmbëlsire. Tekat e njerëzve të mëdhenj janë të gjithfarësojshme.

Këto po meditoja prej titullit, ndërsa kur u turra nëpër rreshtat të lexoja hollësisht lidhjet e Dantes dhe Shekspirit me Hallvaxhijas, u zhgënjeva. Çështja qe pak më ndryshe nga përsiatjet e mia. Në Hallvaxhijas nuk kishte shkelur personalisht as Dantja, as Shekspiri, por shkrimtari ynë i mirënjohur Petrit Korona, i ftuar nga shtëpia e Kulturës për një takim me lexuesit. Shkrimtari u mrekullua nga pyetjet e thella, me karakter estetik e filozofik që kishin teptisur njëra pas tjetrës, sa iu krijua mbresa se ndodhej në auditorët e fakultetit të Filologjisë e jo midis kooperativistëve që sapo kishin lënë shatin, kosën a drapërin. Në artikull ishin renditur edhe disa nga pyetjet e lexuesve: “Cilat janë pikat e takimit midis mendësisë së Dantes dhe të Shekspirit?” “Pse Rilindja Evropiane e çmon Danten si prekursor të saj?” “Te cilat tragjedi shfaqen më qartë pikëpamjet përparimtare të Shekspirit?” “Ç'përfaqëson Ferri si rrymë filozofike?”

Për të kënaqur lexuesit e zellshëm të Hallvaxhijasit, shkrimtari e shtrydhi trurin aq fort, sa disa pika djerse i dolën edhe mbi ballin e gjerë. I entuziazmuar nga pyetjet që dëgjoi, ndieu disa pickime qortuese në ndërgjegjen e vet që i kishte braktisur takimet me lexuesit si formale, të mërzitshme, me pyetje bajate që nuk ngjallnin interes.

Pa shih ç'përparim i hatashëm brenda një periudhe të shkurtër dy-tre vjeçare! Shembull vetëfolës ishte ky fshat në pllajën lindore të Karatoprakut, përballë kënetës së dikurshme të Tërbufit. As gjatë darkës së bollshme myzeqare me dy biba të pjekura, që u therorizuan për nder të vizitës së tij, as gjatë natës kur ra të flinte i nanuritur nga këngët e guguftuve, nuk iu fashitën mbresat e takimit. Përgëzoi përgjegjës in e Shtëpisë së Kulturës, Pipi Goranin për punën e tij të shkëlqyer me librin, ndërsa ai buzëqeshte me modesti. Le ta dëgjonte kryetari i kooperativës dhe sidomos sekretari i partisë, shoku Vasil Kozmai, që thoshte lart e poshtë se Pipoja kalonte me dhjetëra libra nëpër duar, po vetë nuk lexonte asnjë.

Me t'u kthyer në Tiranë, Petrit Korona shkroi një reportazh nga mbresat e takimit me lexuesit hallvaxhijas, i befusuar nga pyetjet e tyre të thella. Danteja dhe Shekspiri atje ishin si njerëzit e shtëpisë dhe lexuesit nuk i zinte gjumi natën për të gjetur ndryshimet e koncepteve midis tyre. Petrit Korona si shkrimtar me natyrë impulsive, i derdhi shpejt në letër ndjenjat dhe mendimet e tij nga takimi pikant dhe pasi u mendua pak dhe menjëherë ia dërgoi për botim gazetës "Rinia."

Falë titullit intrigues dhe përmbajtjes ideore, shkrimi u pëlqye në sferat e larta. Në konferencën dyjavore pranë KQ, drejtori i shtypit e lavdëroi artikullin, sepse aty konfirmohej me shembuj konkretë ngritja e pa shembullt kulturore e brezit të ri, falë kujdesit të vazhdueshëm të partisë. Kryeredaktorin e gazetës "Rinia" s'e mbante vendi nga gëzimi që kishte siguruar një bashkëpunëtor të kualifikuar, një shkrimtar të njohur, megjithëse nuk kishte kurrfarë meritë e tij, se Petrit Korona e kishte shpënë shkrimin në redaksi pa ia kërkuar kush.

Do ta kisha besuar deri në amëshim si të vërtetë, se hallvaxhijasit ishin lexuesit më të thekur të Dantes dhe Shekspirit, sikur dora tekanjoze e fatit të mos më kishte hedhur mësues po në atë fshat, më 1967. Si shumë nga kolegët e mi, edhe unë shfaqja dëshirën të largohesha "vullnetarisht" nga Tirana, për të njohur bazën, tabanin, për t'u freskuar, sepse e dija se drejtorja e shtypit e kishte emrin tim

në listën e atyre që duhet të hiqeshin nga redaksitë e gazetave ose revistave. Pra, ishte më mirë të ikja vetë, duke tundur flamurin e devotshmërisë, se sa të më transferonin me urdhër.

Po hynte tetori, muaji i letërsisë dhe arteve, muaji i takimeve të artistëve me lexuesit. Përgjegjësi i zellshëm i Shtëpisë së Kulturës, Pipi Gorani hartoi një plan madhështor me dymbëdhjetë pika, sepse edhe ai, si gjithë myzeqarët, ua kishte marrë dorën për bukuri. Më kumtoi se midis të tjerash kishte planifikuar të thërriste një shkrimtar të njohur nga kryeqyteti. Kjo, sipas tij, ishte pika më e rëndësishme. Tha se kishte shkrimtari e kishte pranuar ftesën, madje kishin fiksuar edhe datën.

- Njëmbëdhjetë pikat e tjera i kam si qofte me rigon, mund t'i kapërdij lehtë, kurse takimi i shkrimtarit Maliq Buxhaku me lexuesit ka telashe, do goxha punë, është me spec, - shtoi.

- Maliq? Sikur e kanë quajtur Qemal, - vëreja unë.

- Emrat e shkrimtarëve, për djall, nuk i mbaj mend fare, - u shfaqësua Pipoja. - Ke patur rast të takohesh me të? E njeh? - më pyeti.

- Si jo, jemi kolegë... - iu përgjigja.

- E di, po a e njeh nga afër? - Ku rrihte pyetja e tij dhe ku synonte? Për fat nuk më la të mendohesha gjatë. - Ia thotë gotës? Njëherë ftuam një shkrimtar myzeqar, Jovan Ndini, por ai për dreq nuk pinte as raki, as verë, as konjak, as kafe, as cigare. Vetëm ujë, mirëpo a ngrihen shëndete me ujë? Sekretari i partisë më porositi të mos ftoj më shkrimtarë të tillë, prandaj pyes unë.

E sigurova se Qemal Buxhaku pinte piqe me ngjyra dhe pa ngjyra, sido që të ishin. M'u duk se u qetësua.

- Tani më duhet të marr autorizim nga kryetari për nja gjashtëpula...

- Nuk besoj të hajë më shumë se një pulë, - vëreja unë.

- Po ne të tjerët? Të bëjmë sehir si i ha pulat Maliqi? - vërejti Pipoja. - Edhe gjashtë më duken pak, por po t'i kufizojmë të ftuarit, besoj mjaftojnë.

Përvoja e Pipos për organizim pritjesh ishte e hatashme, se pastaj përmendi një autorizim për raki, një tjetër për djathë të freskët nga baxhoja dhe të fundit për disa arka me rrush nga vreshta.

- Rrushtë do t'i sjellë brigadierit i frutikulturës atë mbrëmje, - tha Pipi.

Ditën që do të zhvillohej takimi, erdhi në shkollë qysh në mëngjes. Sa herë ndihej i shqetësuar njërin sup e lëvizte vazhdimisht. Atë ditë supi i tij s'po gjente rehat nga tiku nervor. Supi i lëvizte pa pushim nga një tik nervor.

- Sot e kemi... - më kumtoi. - Mos harro se je për darkë.

- Unë? - e pyeta me habi. - Më mirë ftoni drejtorin e shkollës.

- Juve u takon për ndihmesën që keni dhënë e që do të jepni, - tha paksa në mënyrë enigmatike. - Darkën e vumë në vijë, pulat ia shpura Uranisë në menci dhe për fat gjeta nja tre kilogram peshk nga Dajlani. Për të gjithë nuk mjafton, po të paktën kreu i tryezës të jetë plot. Rrushtë i sjell Tili Voda me karrocë.

Pse po m'i thoshte të gjitha ato hollësi, apo që të kuptoja sa telashe jashtëartistike ka jeta e një përgjegjësi kulture?

- Edhe pjesëmarrjen e kemi siguruar. Fola me agronomin dhe më premtoi se do të japë urdhër t'i lëshojnë nga puna dy orë përpara, me kusht të vinë në mbledhje.

- Urdhër?

Ai buzëqeshi ngaqë pyetja iu duk naëve.

- Pse vinë ndryshe ata? Nuk afrohen gjëkundit, veç për mbrëmje vallzimi... Ngordhin për ato të shkreta. Edhe po ua mbylle derën, futen nga dritarja, kurse për aktivitete të tjera... të pëlcastin buzën.

Akoma nuk po e kuptoja qëllimin e vizitës së tij.

- Drejtori i shkollës premtoi të dërgojë nxënësit e klasës së tetë dhe të shtatë, fundja le të vinë dhe ata të së gjashtës. Janë të vegjël dreqërit, po le të mbushin sallën andej nga fundi, se është turp të jetë gjysma bosh...

E përgëzova që i kishte përmbushur të gjitha detyrat.

Ai buzëqeshi djallëzisht duke ngritur njerën vetull përpjetë.

- Ka mbetur diçka e vogël, - tha duke nxjerrë gishtin tregues përpara, - shumë e vogël, prandaj erdha tek ti.

Myzeqarët t'i marrin krahët urtë e butë, pa u ndierë. Tani e kuptova pse kisha hyrë në listën e të ftuarve për darkë.

- Folë! - e nxita. - Ç'do prej meje?

- Ato pyetjet, - më tha duke kaluar gishtin mbi pëllëmbën e dorës së majtë sikur po shkruante.

- Cilat pyetje? - u befasova unë.

- Ato pra që do t'i drejtojmë shkrimtarit, si e quajnë kukudhin, Maliq a Meleq.

- Qemal, - e korrigojova unë. - Por nuk besoj se hallvaxhijasit kanë nevojë për pyetjet e mia. Ata e lanë pa mend shkrimtarin Petrit Korona disa vite më parë, me pyetjet për Danten, Shekspirin, letërsinë klasike. Apo nuk keni qenë këtu?

Pipoja nisi të zgërdhihej si t'i kujtohej diçka e harruar.

- Atëhere këtu kryente punën fizike kritikë Zamir Zioshi. Gjasme punë, se në fakt gjithë ditën rrinte në klub duke pirë. Atje e takova dhe unë. I vura përpara një dopio raki dhe ai tak-fak m'i renditi nja shtatë a tetë pyetje, pastaj unë ua ndava atyre në sallë dhe kjo që e gjitha.

Nuk më kishte shkuar mendja për një prapaskenë kaq origjinale.

- Mund t'i telefonoj Zamirit te Pallati i Kulturës në Lushnjë, - tha me një farë mërzie Pipoja, - por derisa kemi shkrimtarin tonë këtu...

Sytë e tij më luteshin t'ia plotësoja kërkesën dhe unë pranova. U mendova seriozisht të gjeja pyetje mbresëlënëse, të spikatura, me kuptim të thellë për dukuri të letërsisë kombëtare dhe ndërkombëtare, për të ngritur më lart lavdinë e lexuesve hallvaxhijas, po që se edhe Qemal Buxhaku do të befasohej sa të hidhte në letër mbresat e atij takimi.

I PLOTFUQISHMI NDAN KËSHILLA DHE SHPULLA

A të orë e kisha bosh dhe meqë jashtë rigonte shi, s'mund të vija as në klub, as në dhomën time. Në orarin tim javor, ora figuronte e bardhë, ose "dritare" si u thonë arsimtarët në zhargonin e tyre. Përnjimend hapësirat e lira në orar ngjasonin si dritare të një godine pesëkatëshe. Shkolla jonë nuk kishte "dhomë mësuesish," për shkak se u shtua një klasë e paparashikuar, prandaj arsimtarët ishin të lirë të shëtisnin në natyrë, ose nëpër shitoret e tregtisë. Vendosa të prisja duke ecur përmes korridorit kot së koti, deri sa të binte zilja.

Nga njëri krah i korridorit ishin dyert e klasave të mësimit, në krahun tjetër dritaret. Duke kaluar para çdo klase, doja s'doja, dëgjoja për disa sekonda copëza nga ligjërimet e mësuesve. "Dimë nga mësimit e mëparshme se dy brinjët e bazës takohen te... Mao Ce Duni i Kinës së... Te Bagëti e Bujqësi... rritet kafeja, kakaoja dhe bimë të tjera tropikale... Skenderbeu luftoi 25 vjet, revizionizmin sovjetik... PPSH vuri themelet... e Naim Frashërit..." Nga përzierja e fragmenteve të mësimeve dilnin kuptime alogjike dhe silogjizma fantastike, aq sa fillova të argëtohem me lojën që zbulova.


Papritur dera e klasës C-5 u hap dhe në korridor doli drejtori i shkollës, pas tij i plotfuqishmi i zonës "Kokorja" dhe në fund nëndrejtoresha, Urani Shkoza.

Nia më pyeti:

- A dëshiron të vish me ne? Po të jesh i lirë, eja, - ngulmoi ajo.
- Po ju keni dalë për kontroll, apo jo?

- Jo, jo. "Kokorja" po u shpërndan këshilla nxënësve në prag të pushimeve. Eja, - më ftoi duke buzëqeshur sikur linte të kuptohej se do të argëtohesha.

Nuk e di nëse e quanin Sheraf apo Sherif, sepse të gjithë prapa krahëve e thërrisnin me nofkën "Kokorja," për shkak të kapeles ruse



që mbante në kokë edhe kur e liruan nga ushtria. Çmobilizimi e kapi në Degën e Brendshme të rrethit me gradën major. Oficeri madhor u bë kurban i ushtrisë shqiptare në kohën kur shpërtheu fushata për çarmatimin botëror, ai ishte një nga të “nëntë mijëshit,” e oficerëve pa shkollë, të graduar çdo tre katër vjet për shërbim vjetërsie. Majorit pa zanat e pa shkollë i propozuan të mblidhte plehrat e qytetit me karrocën e komunales, mirëpo atij iu duk poshtëruese të hipte mbi një qerre plehrash dhe t’i sëllonte kalit me kamzhik si gabelët e tjerë. Vërtet ishte zeshkan, i gjatë, i thatë, por nuk mund të njësohej me turmën e gabelëve. E hodhi poshtë me përbuzje propozimin, ashtu sikurse sugjerimin të kthehej në vendlindje. Sapo mësoi se oficerëve të liruar që vendoseshin në fshat, kooperativa ua ndërtonte shtëpinë falas, ai shfaqti dëshirën të ngulej në kooperativën e Çukasit, fshat anës detit, ku mund të gjuante edhe ngjala e peshq me grep e me rrjetë. Kooperativa i fali gjysmën e ndërtesës së postës, ku Sherafi shijonte lumturinë bashkëshortore mes gjelbërimit të fushës dhe zhurmës së përherëshme të shtatë fëmijëve. Pas një viti u pa se Sherafi nuk ishte i zoti për punë fizike. Nga brigada e arave u largua duke vënë si shkak dhimbjen e mesit, nga peshkimi iku se lagështija i acaronte reumatizmen, kurse nga pyjorja e përzunë, se filloi të jepte urdhëra duke spostuar përgjegjësin. Kësisoj gjithë ditën e kalonte në klubin e fshatit, duke pirë kafe e duke bërë muhabet me pensionistët.

Pas një viti, të Plotfuqishmin e zonës, një farë Reshati, e pushuan nga detyra për paaftësi. E vërteta ishte pak më ndryshe. Reshati ra viktimë e pasionit të tij, për të vizituar femrat, gjasme për të mbledhur informata, në kohën që meshkujt ndodheshin jashë shtëpisë. Atëherë Dega e Brendshme, për të mos e lënë vendin bosh, u kujtua për majorin në lirim dhe kësioj “Kokorja” u emërua përkohësisht i Plotfuqishëm. Rikthimi në detyrë e gjallëroi menjëherë, si me magji. U çelefit, lustroi çizmet, veshi xhakëtën ushtarake, (pantallonat i kishte) e zbukuroi kapelen kozake me një yll të kuq dhe shkante rrugëve me kokën lart, sa çdo pjesë e trupit të tij dukej sikur thoshte: “E shihni? Më kthyen në detyrë, sepse m’i njohin meritat.”

Sipas rregullit, sapo grupi hynte në klasë, mësimi ndërpritej dhe nxënësit ngriheshin në këmbë, për të nderuar mysafirët. “Kokorja” u jepte shenjë me dorë të ulëshin dhe pastaj ia niste ligjëratës. Për shkak se gërmën “s” e shqiptonte “sh,” ligjërata e tij merrte ngjytime komike. Mënyra si u drejtohej ishte mjaft origjinale.

- Ti, i biri i Nazifit dhe ti tjetri, i biri i Rishtanit! Ju nuk shilleni mirë, bëni prapëshira, keni vjedhur mana, jeni futur nëpër kopshtet e të tjerëve për kashtraveca. Kashtravecat do t’u mbeten nëpër dhëmbë, she o t’u gjobit, jo ju, she ju jeni trokë, po prindërit tuaj, do ua përçëlloj kurrizin.

Në shkollën tonë mjat nxënës vinin nga fshatrat rrotull dhe natyrisht nuk mund të rrinin pa provuar dardhat, kumbullat, manat dhe bostanet kur ato ua bënë me sy nga kopshtet e fqinjëve.

“Kokorja” e niste ligjëratën me këshillime dhe e përfundonte me kërcënime, të cilat nuk pajtoheshin kurrkund me pedagogjinë. Ky ritual u zhvillua thujtë në njëjtë në tre klasa, derisa arritën te e gjashta B. Aty Kokorja e përfshiu me një vështrim të rreptë gjithë klasën dhe pa mënuar hyri në temë.

- Ju duhet të dëgjoni mëshueshit, të dëgjoni prindërit, t’i ndihmoni dhe të shilleni mirë kudo, jo vetëm në shkollë, she këtu rrini urtë nga frika, she mosh u thyejnë notën në shjellje e ku di unë ç’janë ato të tjerat. More, përshe u kanë dërguar në shkollë? Po nuk e dini, ua them unë, të nxëni ment. Disha nga ju, ëhë, sh’janë në terezi fare. Ja e shikoni, këtë? - tha duke e drejtuar gishtin te një nxënës në rreshtin e parë të bankës pranë dritares. - Ky është më i prapi, më i ligu i të gjithëve, më sherret se njëqind gabelë bashkë.

Nxënësi uli kokën dhe e vuri mbi llërë, sikur ta zinte turpi që po e demaskonin në sy të klasës. E njihja Shkëlzenin dhe e doja, mbasi ishte i urtë dhe kurrë nuk kisha patur ndonjë problem me të. As në këshillin pedagogjik emri i tij s’qe përmendur as për mirë, as për keq. Pse po e sulmonte i Plotfuqishmi me cilësime të këqia të shkallës sipërore?

- Ngrihu, ngrihu në këmbë, të të shohin dhe këta të tjerët ç’shurrat ke. Poshi, poshi, rri shi i turpëruar tani, po mua nuk ma hedh dot

she të njoh mirë. Ky, - vazhdoi ligjëratën demaskuese Kokorja, - shillet keq me nënën, nuk i bindet për asnjë punë, torturon motrën e vogël.

Mbeta paksa i shokuar nga informacionet e hollësishme që kishte mbledhur i plotfuqishmi për jetën familjare të Shkëlzenit. Nga e si i dinte sjelljet e tij brenda familjes? Çfarë agjentësh kishte futur? Nuk thuhej më kot se sigurimi i fuste hundët në skutat më intime.

- Këtij foli sha të duash, qortoje sha të kesh qejf, nga një vesh i hyjnë nga tjetri i dalin, she e ka kokën bosh. Këtij sh'ka ç'i bën ash pushteti, ash partia, se edhe me hekura ta lidhësh, brenda njëzetekatër orësh ka borxh të çlirohet e të dalë.

Drejtori miratonte çdo fjalë të Kokores dhe buzëqeshte i kënaqur, Nia dukej indiferente, ndërsa unë u shqetësova seriozisht. Nuk mund ta fyente nxënësin kokëbosh dhe ta trajtonte si keqbërës, si kriminel. Ç'kuptim tjetër mund të kishin fjalët se edhe po ta lidhje me zinxhirë, ai lirohej. Një fjalor i tillë nuk mund të përdorej në klasë. Ishte antipedagogjike

- Dil këtu, - e urdhëroi i Plotfuqishmi, - të të shohin mirë edhe këta të tjerët!

Shkëlzeni doli ngadalë, duke ecur pakëz shtrembër, kokëulur, mbathur me një palë këpucë të mëdha, bojë hiri nga balta e tharë prej kohësh. Mbi baltën e hirtë dalloheshin disa 10 të bardha me forma e drejtime të ndryshme, të shënuara me shkumës.

- Ç'i ke ato dhjeta në këpucë? - e pyeti rreptë Kokorja.

- M'i shkrojti Jovani, - tha Shkëlzeni duke treguar me dorë shokun e bankës.

- Pooo! Jovaaani! She nuk je i zoti t'i marrësh në regjistër dhe i merr në këpucë. Po unë o të bëj njeri ty, o për zotin, sh'të lë të gjallë.

- Dhe duke thënë ato fjalë ia sëlloi dy shpulla në të dy faqet.

Klasa u mek. I skandalizuar nga akti i Kokores, iu afrova nëndrejtoreshës dhe e pyeta:

- Ç'bën kështu ky? Është në vete? Si i godit nxënësit në klasë?

- E ka djalin e tij, - më pëshpëriti Nia duke buzëqeshur, - me të le të bëjë ç'të dojë...

XHAKOJA , SHOKU IM I STANIT



Xhako Suljoti dhe unë ruanim tufëzën e fshatit, milnim dhentë, fshihnim kakërdhitë, zjenim qumështin, lanim enët, me një fjalë kryenim të gjitha punët që do mirëmbajtja e një stani dhe përpunimi i bulmetit. Brigadieri na lavdëronte se ia kishim marrë dorën zanatit, megjithëse ishim të rinj, po ne s'na pëlqente të plakeshim dhenarë në stan, të veçuar nga bota, larg nga qejfet e shoqëria. Sapo u liruam nga shërbimi ushtarak, kërkuam punë nëpër ndërmarrjet e qytetit, me shpresë të zinim një cak, të mësonim ndonjë profesion dhe t'i linim shëndenë kooperativës, mirëpo nuk na eci. Kryetari nuk na lejoi, se gjasme kooperativa kishte nevojë për krahë pune, ndonjë mik të fortë në zyrat e qytetit nuk e patëm dhe kështu mbetëm në fshat. Pastaj doli problemi se zanatet tradicionale ishin braktisur dhe se asnjë nga të rinjtë nuk pranonte të bëhej çoban, samarxhi, farkëtar, saraç e ku di unë. Kjo e shtyri KQ të Rinisë t'u dërgonte udhëzimet organizatave të rinisë, të përtërinin traditat blegtorale. Nismën, doemos, e përqafoi edhe organizata jonë. Si përfundim propozuan që Xhakoja dhe unë të ngjiteshim në stan për të veruar me tufëzën. Përkohësisht thanë

ata të presidiumit, se pastaj do të na zëvendësonin të tjerët, mirëpo ndonjë afat nuk caktuan.

Njëherë në javë brigadieri ynë, Miço Shtufi, ngjitej për të parë tufëzën dhe prodhimet tona të stanit. Xhakoja, si zot shtëpie ia shtronte sofrën plot, pastaj ulej edhe vetë pranë tij që ta shoqëronte. Të vinte lezet ta shihje Miçon sa shpejt i zhdukte poshtë gabzherit llokmata e djathit të freskët, hurlen e shakullit, gjalpin e pakripur, kosin dhe ajkën. Ne kishim merak mos ma bajalldisej dhe na mbetej deng në kasolle, ndaj i rrija pranë me pagurin e ujit gati, po stomaku i tij ngjante me mokër mulliri. Pasi dëndej mirë e mirë me bulmet, pinte një sapllak me ujë të ftohtë nga burimi i Lajthizës dhe bëhej fill.

Të mos i futemi në hak, ai gjithmonë thoshte:

- Mbani shënim dëmin dhe ma zbrisni nga kuota e familjes, se socializmi kështu e ka, çdo gjë me llogari.

Khako Suljoti ia kthente:

- Fjalë është ajo, shoku Miço? Ju e keni detyrë të ngjeroni prodhimet, për të vlerësuar cilësinë. Helbete, ne si blegtorë të rinj, nuk i kemi mësuar të gjitha të fshehtat e zanatit. - Ai drej Xhako t'i ngulte kunjat urtë e butë, pa e kuptuar fare.

- Pastaj, po t'i llogaritim me kalem zarzavatet që prutë, jemi fit e fit, a kushedi edhe ju detyrohemi gjë a gjë, - shtonte Xhakoja duke i treguar trastën me qepë e hudhra të njoma, domate e speca të freskëta.

Të mos tregohemi të padrejtë. Miçoja, sa herë ngjitej në stan, e mbushte çantën me prodhimet e stinës dhe pasi futej në kasolle nxirrte çeshitet duke thënë: "Bagëti e Bujqësi ka thënë Naim Frashëri." S'dinte asnjë varg nga poema e njohur, por në praktikë e zotëronte mjaft mirë. Sa herë piqnim sipër prushit piperka kobuska me tul dhe i hanim të shoqëruara me pak djathë a gjizë, na shijonin njëlloj si të ishin mish i pjekur.

- U kam blegtorë të mirë, - na thoshte. - Rinia i ra pikës kur u besoi këtë detyrë, se ju e përvetësuat shpejt zanatin. Edhe im atë kështu thotë: "Kërrabën e lashë në duar të sigurta."

Për ata të organizatës që na e ngjeshën atë detyrë, ne s'kishim fije respekti, kurse Xha Ndinin e donim, se ai na mësoi si kullandriset stani. Dy javë punoi tok me ne, pastaj u largua, për arsye moshe dhe shëndeti. Kërrabën e la në kasolle që ta kishim kujtim prej tij dhe ta kujtonim ndonjëherë, pa thënë se po e kalonte stafetën në duart e brezit tjetër. Kërraba për atë ishte mjet pune, jo simbol. Atë e varëm në shtyllën që mbante kulmin e kasolles me kashtë dhe atë e shihnim të parën kur zgjoheshim dhe të fundit kur mbyllnim sytë.

Një mëngjes gushti, ndërsa Xhakoja po ndizte zjarrin për të zjerë qumështin dhe unë po laja bidonët te burimi, Miçoja poflisi në stan. Çantën s'e kishte me vete, çka tregonte se kishte ardhur nxituar, ose nuk donte të shijonte asgjë nga nënprodhimet e qumështit. Pa hyrë mirë në kasolle na thërriti t'i vinim pranë.

- Ku jeni me planin, sa e keni përmbushur? - na pyeti sikur të zbriste nga hëna. - Më sillni pasqyrën e javës së fundit!

Xhakoja hapi arkën ku ruante një shishe me vodkë, nxori ca salcë kosi që e ruanim për mysafirë të nderuar dhe si e mbushi misurin plot, ia vuri përpara.

- Kërkova pasqyrën, - tha brigadieri duke shtyrë tej misurin me salcën e bardhë si krem paste.

- Kur e pak gurmazin, fjalët shkasin më lehtë, - ia priti Xhakoja.

Pata frikë mos Miçoja nxehej nga kunji i Xhakos, prandaj menjëherë i zgjata fletën me të dhënat.

- Jeni shumë prapa! - na qortoi duke i rënë fletës me gishtrinj si të ishte def.

- Mos të bie drita ters dhe po e lexon arabisht? - ia nguli Xhakoja një thumb tjetër. I doli në krah dhe nisi ta sqaronte. - Kjo kollona e parë ka shifrat e planit, kjo tjetra realizimin. Plani gjashtëmbëdhjetë litra në ditë, realizimi njëzet e dy.

Herët e tjera po me këtë sasi qumështi, na kishte lavdëruar, ndërsa atë ditë shpërtheu:

- Ju nuk jetoni sa duhet me situatën!

- Jemi larg, o Miço... Këtu në stan as Soseja nuk vjen, jo situata,
- ia ktheu Xhakoja.

Soseja ishte kurvicka më e njohur ndër pesë kantieret e sharrave të Bishnicës. Ajo ishte shpirt njeriu. Ua hiqte shoferave mërzinë duke i shoqëruar deri në skutat më të largëta në ato rrugë të mënjanuara dhe ata natyrisht ia shpërblenin kohën dhe mundin me para të thata në dorë, ose me qerasje në klub. Pandeha se krahasimi i situatës me Sosën, do ta zemëronte brigadierin, por ai u hoq sikur s'e dëgjoi.

- Me këtë sasi nuk arrijmë të plotësojmë nevojat e anëtarëve as deri në dhjetor, kurse në tetor dhentë shterrojnë. E morët vesh tani?

- Unë akoma jo, se me këtë vesh dëgjoj gjysmat e fjalëve. - Xhakoja i doli në krahun tjetër. - Tani ma thuaj edhe një herë!

- Kryesia vendosi mbrëmë të furnizohen dy familje çdo ditë me nga njëzet litra qumësht. Anëtarët duan ta zënë djathin vetë, tha kryetari. E kuptove tani? - iu gërmush Xhakos.

- Me këto dhen që kemi, apo do të na e shtoni tufëzën? - e pyeti Xhakoja.

- Kur të na pjellin mushkat! - ia ktheu Miçoja me ironi.

- Mirë o shoku Miço, po duhet të na tregosh edhe mënyrën...

Prisja me kureshtje këshillat e brigadierit.

- Atë gjejini vetë! - tha Miçoja.

- Thashë se mos ti, si brigadier, di ndonjë metodë të re... - e ngacmoi Xhakoja dhe fap syrin mua.

- Mbajini në kullotë më gjatë, jepuni kripë, milini dy herë ditën dhe... këto mjaftojnë, - tha brigadieri duke u ngritur nga stoli. - Mos harroni të hartoni listën.

- Nuk do ngjyesh pak hurle me hudhër? - e pyeti Xhakoja. - Hudhra e ul tensionin dhe mund të bisedojmë më shtruar.

- S'ka bisedime, ky është urdhër! Çdo ditë dy familje, - deklaroi brigadieri.

Piu ujë te burimi i Lajthizës dhe iku tatëpjetë furishëm, ashtu siç kishte ardhur.

- I qenka ndezur stomaku nga kritikata, - vërejta unë.

- Nuk thua koka?

Khakoja nisi të kruante zverkun. Sa herë e brente ndonjë hall, dora i shkonte padashur te zverku. E pashë si hahej me veten e vet. Edhe natën nuk fjeti, u përpëliti në shtrat e një copë herë të madhe doli jashtë në livadh. Në mëngjes i propozova të shkonim në kryesi, sepse ishte rasti më i mirë të jepnim dorëheqjen dhe tufëzën le ta merrnin barinj të tjerë, më të zot nga ne.

Khakoja buzëqeshi tinëzisht.

- Urdhëri duhet zbatuar. Nuk besoj ta kemi vështirë, mbasi burimi ka ujë boll. Ia fillojmë që sot, një bidon te shtëpia e Miços, një te im atë. Le ta blejë ujët e Lajthizës dy herë me shtrenjtë se ujët e Glinës. Hallall e pastë!

Mbushëm bidonat buzë më buzë, "një nga dhija, dy nga vija" dhe pritëm të vinte kafshari. E ndihmuam Kikinë të ngarkonte bidonët, e porositëm ku t'i shpinte dhe i uruam rrugë të mbarë. Ai i hipi kalit dhe u nis tatëpjetë duke fërshëlyer.

* * *

Të nesërmen pa gdhirë dëgjuam një hingëllimë kali pranë stanit. Kush mund të kishte ardhur aq herët?

- Bobo, Ndini Shtufi po turfullon, - më pëshpëriti Xhakoja.

I doli përpara për ta përshëndetur.

- Mirmëngjes Ustabash Ndini! Shyqyr që u hapën rrugët dhe dole të na shohësh.

Xha Ndini nuk denjoi as t'ia kthente përshëndetjen.

- Kërrabën! Më jepni kërrabën! - ulëriti.

Khakoja u fut në kasolle, zhvari kërrabën nga kunji dhe ia dorëzoi të zotit.

- Urdhëro! - i tha i qetë. - Për këtë qenke munduar deri këtu? Na dërgoje lajm të ta sillnim në shtëpi.

- Boll hirra që më dërguat...- shfreu me ironi Xha Ndini. - Më kënaqët, dy nga vija e një nga dhija. Edepsëzë! Pse qumësht i thoni këtij? Qumësht? - Hapi kapakun e bidonit, futi brenda kërrabën

dhe pastaj e nxori menjëherë. Kërraba mbeti e lyer si me llak të bardhë nga ajka e qumështit. Ndini nuk u besonte syve, ndaj futi gishtin. Edhe gishti u lyros.

- Të tillë qumësht i dhatë Kikisë, apo e pagëzoi rrugës? - pyeti.

- Xha Ndini, ti brigadierin e blegtorisë e ke në shtëpi, pse pyet botën? - ia ngjeshi Xhakoja.

- As katër kile djathë s'dolën, - turfulloi ai.

- Xha Ndini e do qumështin safi, ashtu si qëmoti, - m'u drejtua Xhakoja, - sepse nuk e di që shkenca thotë se lyra është e dëmshme, sidomos për pleqtë. As ne nuk e dinim, po për fat na e mësoi brigadier Miçoja. Kusurin tani ti e di vetë. Për të ruajtur shëndetin Xha Ndini, jo gjë tjetër. Të betohem, për atë kërrabë që mban në dorë.

Sytë e Xha Ndinit shkonin si sovajka sa nga Xhakoja tek unë.

- Shkova pashë dhe qumështin që shpure te yt atë, - i tha Xhakos.

- Palavi edhe atje, hirrë e ujë... Gjene mirë që s'paski faj ju, se do t'ua kisha thyer kërrabën pas tuleve... Miçoja, më dëgjoi si po turfulloja dhe iku, u zhduk, shkoi fjete nga vjehërri, po sonte ku do vejë?

U fut në kasolle, e vari kërrabën te shtylla dhe pastaj u ul me ne.

- E di që më merr malli për këto vende? - tha duke shikuar peizazhin.

- Xha Ndini, a thua do të kenë sukses tufëzat dhe arëzat? - e pyeta unë dhe menjëherë u pendova, sepse pyetja kishte karakter politik.

- Do të kalojë dhe kjo valë si të tjerat... - tha pa e fshehur përbuzjen.

Të nesërmen Miçoja u ngjit në stan. Hyri në kasolle, zbrazi çantën me zarzavate e fruta dhe pyeti nëse mund t'i bënim vend për të fjetur.

- Vetëm për sonte, apo të shtojmë dhe një krevat tjetër? - e pyeti Xhakoja.

Miço Shtufi nuk iu përgjegj, veç luante kokën sikur të thoshte me vete: "Hej, ç'na gjeti!"

VARIANTI I 13

Në Ministrinë e Arsimit-Kulturës, të gjithë nëpunësit dinë të lexojnë pa përjashtim, ndërsa për të shkruar a i gjen a nuk i gjen tre-katër veta. S'e kam fjalën për letra dashurie dhe për posulle të ndorme, po për ato lloje që ka nevojë dikasteri, si referate, raporte, relacione, diskutime, artikuj, intervista, përshëndetje, nekrologji, etj. Gama e tyre është mjaft e gjerë dhe e llojllojshme, prandaj duhet talent që t'i sajosh si duhet. Një nga "shkruesit" më të dalluar është kolegu im i zyrës, Remzi Metalia. Çdo javë ai shkruan për të plotësuar kërkesat e shefave që ka mbi kokë. Të gjithë ata e bombardojnë me lutje e urdhëra. Që nga kryeinspektori deri te ministri, secili për hesap të vet, sapo u kërkohet të relatojnë diku, të flasin nga ndonjë podium, a të përshëndesin ndonjë forum, te Remziu përplasen; ai është limani shpëtimtar. Kjo e veçon Remziun nga instruktorët e rëndomtë të dikasterit, të cilët e kundrojnë me zili dhe njëkohësisht me mëri. Ai e di se kolegët e tij prapa krahëve e quajnë "Demkë," sipas prototipit që zbuloi Dritëro Agolli te romani "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo." Nuk ua merr për keq, madje i përkëdhelet sedra, mbasi pesha specifike e kategorisë së Demkave ka ardhur duke u rritur në shoqërinë tonë. Për shkak të porosive të shefave, të cilët e ngarkojnë vazhdimisht me detyra, Remziut pothuajse nuk i mbetet fare kohë të merret me punët e sektorit të tij. Pastaj në analizat gjashtë mujore a vjetore shefat e kritikojnë Remziun për zvarritje, sikur të mos ishin ata vetë që e ndërpresin. Më vjen të qesh dhe të protestoj

sa herë dëgjoj kritika të tilla paradoksale. Pse nuk ngrihej t'ua përplaste në fytyrë shkakun, t'i gozhdonte pas murit me fakte? Rri si tuaf, madje bën dhe autokritikë të fortë, duke premtuar se në të ardhmen do t'i ndjekë problemet sistematikisht, ndërkohë që e di se gjendja s'ka për të ndryshuar asnjë thërrime. Vonë e kuptova se ai e njihte më mirë se unë logjikën e ministrisë dhe mendësinë e shefave. Bëju qejfin sa për të kaluar vahun dhe pastaj vazhdo tragën tënde.

Nëpunësit e rinj, (ku hyj edhe unë), vazhdimisht porositen nga prororët të përfitojnë nga përvoja e më të mirëve, nga stili dhe metoda e tyre e punës. Unë për vete si model zgjodha Remziun. Më të mirë s'kisha ku të gjeja. S'di sepse më mpihej truri, sa herë më ngarkonin të konceptoja qoftë edhe një shkresë të vogël. Tre ditë me një faqe. Sa e përfundoja, e ndieja se s'kisha qullosur gjë, mbasi në letër nuk kishin dalë tamam ato mendime që bluaja në kokë. Konsultohesha me Remziun dhe ai si magjisttar, sapo e lexonte, e gjente ç'kisha dashur të thosha. Si arrinte ta kuptonte? Djalli e merr vesh. Ç'është e vërteta, kur kishte kohë, më ndihmonte jo vetëm me këshilla teorike, por edhe duke e redaktuar shkrimin me laps në dorë.

- Të punosh në dikaster, - më tha një ditë, - nuk është njëlloj si të shesësh zarzavate. Duhet saktësi në ndjekjen e problemeve, përpikmëri dhe sidomos ndërgjegje. Në sytë e publikut fjala jote peshon. Për mua çdo inspektor i dikasterit është ministër për sektorin që mbulon. Kë sektor mbulon ti? Të estradave? Atëhere ti je ministër i estradave...- e përfundoi shpjegimin duke vënë gishtin në tëmth dhe duke tundur kokën e mbushur plot mendime.

Megjithëse imagjinatën e kisha mjaft të zhvilluar, nuk arrija ta përfytyroja veten ministër, për arsye se nuk kisha veturë, vilë, roje personale, zyrë me paradhomë dhe asnjë vartës nën vete.

Remziun tani e kanë urdhëruar të lërë çdo punë të sektorit dhe t'i kushtohet plotësisht hartimit të referatit, që gjasme duhet urgjent. Në dikasterin tonë spekulohet kaq shumë me urgjencat, sa ato e kanë humbur me kohë kuptimin. Do të ishte më praktike të na thuhej çka nuk është urgjente.



Stilolapsi i Remziut shket mbi letrën e bardhë, duke kthyer në simbole grafike mendimet e lindura brenda kafkës së tij, të cilat mund t'i lexojë nga çdo njeri që zotëron 36 germat e alfabetit shqip. Herë-herë pushon, tret vështrimin jashtë dritares, te palmat e oborrit, mendohet, diç nomatis nëpër buzë dhe sërish nis të shkruajë. Mbi lëkurën e lëmuar të çaçkës së kokës, pasqyrohet i zvogëluar sa një sumbull poçi elektrik i tavanit të zyrës, aq sa ngjan si llambushkë e nderur nga biorrymat e trurit të tij. Fytyra e përskuqur nga frymëzimi, sytë e lëngëzuar që digjen prej etheve të krijimit, përqëndrimi maksimal, dëftejnë se Remziu është kredhur tërësisht në thellësitë e referatit.

Pas katër ditësh plot tension, Remziu lëshon stilolapsin mbi tryezë, shtriqet duke vënë duart në mes dhe më kumton:

- E përfundova! Më duket se referati ka dalë i mirë. Jo i mirë, por shumë i mirë, modelor, - e korrigjon veten pas pak. - Tani mund të shkojmë të pimë një kafe.

Mbledh fletët, shënon me laps të kuq në krye të faqes "urgjent" me dy vija poshtë dhe ia dorëzon Nerminit për ta zbardhur. Nermini është kryesekretarja e sekretarisë.

Remziu preferoi të shkonim në një lokal larg dikasterit.

- Çdo pune njeriu duhet t'i përkushtohet me maksimumin e mundësive të tij, duke shkruar energjitë mendore për analizë dhe deduksion. E di ku qëndron sekret i referatit, ose i çdo raporti a relacioni? Te koherenca. Nuk duhen fjalë të rralla, as fraza të bukura, sikurse i kërkon letërsia artistike. Në një referat zyrtar ato mbeten mish i huaj, madje tingëllojnë qesharake. Kryesorja, duhet patur kujdes si të mbarështrihen mendimet, prandaj lind nevoja të hartohet një lloj strukture, arkitektura e kompozimit. Le ta themi në mënyrë më të thjeshtë, më praktike. Unë gjithmonë e ndaj relacionin a referatin në blloqe, probleme të përmbajtjes, organizative dhe administrative. Pse i pëlqejnë shefat referatet e mia? Sepse unë i përmbahem temës me rigozitet. Dhe domosdo, - shtoi duke përzierë kafënë me lugë, - t'u gjesh shijën shefave. Pa këtë, nuk vlen asnjë nga ato që ju thashë. Si puna e kafesë, njëri e do mesatare, tjetri me pak, tjetri të ëmbël.

Remzi Metalia qe enciklopedi e shkresurinokracisë.

Të nesërmen e pashë duke lexuar shkrimin e vet, për të hequr a shtuar ndonjë germë lënë mangut a futur tepër nga daktilografisteja. Ndërsa lexonte, luante dorën në erë, sikur i thoshte vetes: “Të lumtë! Sa bukur e ke thënë! Kryevepër!”

- Jam i sigurt se shefi do ta pëlqejë, - shfaqti mendimin për referatin e tij Remziu.

* * *

Një kokë e bukur, rrethuar me flokë të dendur dhe me dy sy të shndritshëm si perla të zeza, u duk në hapësirën midis derës dhe kornizës.

- Shoku Remzi, ju kërkon shefi, - tha zëri melodioz që nga dera.

Fytyra e Remziut shndriti për një grimë. Duke futur anët e këmishës brenda pantallonave, si ushtarët kur rregullojnë uniformën, doli nga dera.

Sa herë vjen Violeta, Remziu nxjerr nga arsenali disa komplimenta për hijeshinë e saj dhe sapa ajo largohet, thotë: “Është e bukur dreqka. Dëgjoni parashikimin tim. Dikush do të bjerë viktimë e bukurisë së saj në këtë dikaster. Këtu do të jemi! Keni për të parë.” Ai vetë nuk shpresonte se mund t’i afrohej një bukurie të tillë. I vetëdëshëm se natyra ia kishte kufizuar mundësitë e afrimit me seksin tjetër për shkak të fytyrës asimetrike, ku pjesa më voluminoze e hundës prirej nga e djathta, Remziu nuk shkonte përtej soditjes platonike. Nga ky shkak Violeta e dëgjonte me mospërfillje, gati e bezdisur nga komplimentet e tij. Më pas, gjeti një zgjidhje origjinale, ia mirëpriste kortet pa e shikuar në fytyrë, sipas thënies popullore, “zërin ta dëgjofsha, sytë mos t’i pafsha,” çka ishte një kompromis për krenarinë e saj. Ndryshe nga herët e tjera, atë ditë Remziu nuk e përfilli hiç, sikur të kishe hyrë korrieri, apo Caja me shtupë, për të pastruar dhomën.

- Po ky ç’pati? - më pyeti Violeta.

- Sot e ka mendjen te vlerësimet e shefit për referatin, - i thashë.

- Uh, i ziu! - e mëshiroi Violeta. - Jakupi ia kishte nxirë faqet anash me shënime.

Remziu u kthye në zyrë me fletët e referatit në dorë.

- Shoku Jakup ka disa vërejtje të vogla, - më tha pa e pyetur, i zhgënjyer nga takimi. - Ndonjë sfumim, ndonjë theksim, po në përgjithësi e pëlqeu shumë. Sugjeroi të shtoj dhe nja dy probleme. Në fakt, nuk i vura me dashje, për të mos e rënduar me probleme. Vërejtje të lehta, rregullohen shpejt.

Remziu u ul në tryezë për të rritur peshën specifike të referatit me problemet e sugjeruara nga shefi. Pasi shtoi disa faqe të tjera, pasi grisi, shqepi e qepi disa paragrafë, zbriti në sekretari dhe ia dorëzoi Nermunit për ta ridaktilografuar. Herën e dytë Jakup Ftuja e miratoi pa asnjë vërejtje dhe urdhëroi Remziun t'ia përcillte drejtorit.

Pas dy ditësh drejtor Sehat Mëngjarashi e përgëzoi Remziun për referatin, i tha se ishte i përkryer, veç ai do të dëshironte të evidencohet më gjerësisht veprimtaria e dikasterit të tyre dhe lidhjet me bazën.

- Më falni, - protestoi Remziu, - ka dy paragrafe ku...

Drejtori ia preu shpjegimet në mes.

- Shoku Remzi, thashë të evidencohen. Derisa referatin e mbajmë ne, është e natyrshme të vemë në dukje arritjet tona.

Remziu përkuli kokën.

- Punë të mbarë! - e uroi drejtori pa u ngritur në këmbë.

Pas ripunimit të dytë ku u theksua veprimtaria e Ministrisë, për revolucionarizmin e jetës, sipas orientimeve të Plenumit të Qershorit, referati iu përcoll zëvendësministrit, shokut Mane Balashi. Ai vërejtje se referati ishte rënduar me një mori problemesh, ndaj duhej lehtësuar. Prej tij Remziu u kthye i nervozuar.

- Nuk po i marr vesh. Çfarë kërkon njëri, e kundërshton tjetri... Shefi thotë shtoi problemet, ky pakësoi...

Megjithatë Remziu iu nështrua sugjerimeve të zëvendës ministrit, mbasi mendimi i tij peshonte më shumë se i vartësve. I lehtësoi problemet edhe pse i vinte keq që po i sakrifikonte pa arsye. Gjithsesi pas ripunimit, i dha të drejtë Mane Balashit, se tani referati ishte më i ngjeshur, më i qartë, pa humbur nëpër meandrat e problemeve të dorës së dytë e të tretë.

Pas çdo ripunimi dosja që mbante mbi tryezë me kopjet e referatit sa vinte e fryhej.

Herën e dytë zëvendësministri e shfletoi kalimthi, duke parë sa e si ishin plotësuar udhëzimet e tij.

- Shoku Mane mbeti i kënaqur pas ripunimit. S'kishte as vërejtje, as sugjerime, - më kumtoi Remziu, - por tani na doli një hallkë e re. U dashka ta lexojë këshilltarja juridike e Ministrisë, shoqja Minola, gruaja e policit. E kuptoni? - Remziu nuk po mundohej ta fshihte ironinë për këshilltaren juridike, që sipas tij e mirrte rrogën kot, sepse Ministria nuk hapte kurrë gjyqe. - Shoku Mane tha se duhen mënjeluar telashet e mundshme juridike.

Deshi s'deshi Remziu iu kthye edhe njëherë referatit duke patur parasysh vërejtjet e Minola Sedatit. Arriti në përfundimin se ajo nuk ishte aq tarallake sa e kishte pandehur.

Akoma nuk dihej kush do të kishte nderin ta lexonte referatin. Remziu zakonisht nuk pyeste kurrë për gjëra që s'i takonin. Detyra e tij ishte ta shkruante, ta dorëzonte të daktilogruar dhe të hiqej mënjana. Mirëpo kësaj here interesimi për referatin ishte paksa i jashtëzakonshëm, sepse shefat kërkuan ta lexonin së dyti. Spiralja u përsërit. Në çdo shkallë që ngjitej, referatin e rrëzonin nokdaun. Jakup Dervishi, shefi i tij, sugjeroi të shkurtohej tek-tuk që të dilnin më në pah problemet, drejtor Mëngjarashi tha se nuk tingëllonin mirë vetëlavdërimet, se kjo nuk ishte etike, se mund t'i kritikonin nga lart, ndërsa zëvendës Ministri Mane Balashi kërkoi të shtoheshin dy-tre probleme gravitacionale. Duke e korrigjuar, Remziu shfrynte duke u ankuar se ashtu si po ia kërkonin tashti, e kishte patur në variantin e gjashtë a të shtatë. Sapo hapte fletët në tryezë, zinte turfullonte sikur ato të ishin spërkatur me ndonjë lëndë kimike teshtitëse.

- E shoh, sa të jem unë këtu, vërejtjet s'kanë për të mbaruar, prandaj po marr lejën e zakonshme, - më tha pas variantit të dymbëdhjetë. - Shefen e kuadrit e lajmërova, nesër nisem.

Mirëpo pas dy ditësh hyri në zyrë me fletët e referatit në dorë.

- Nga dole? - e pyeta. - Ti sikur more lejën...

- Ma ndërpre në... më thirrën urgjentisht, - tha pa e përmbajtur zemërimin nga dështimi i planeve për pushime larg dyerve të dikasterit. - E lexoi Ministri dhe vërejti se duhet të shtoj diçka për Plenumin IV. Ka të drejtë. Më duket se kisha një paragraf në variantin e parë, po pastaj se si u hoq nuk e mora vesh. Nuk jam në gjendje të gjykoj, më janë bërë lesh e li mendimet.

Iu fut ripunimit me furi, gris këtu e nxi aty, prish paragrafe e ngjit me spillë, për ta sistemuar sipas vërejtjeve të fundit.

- Po ia shpie Nerminin për daktilografim, - më tha kur po dilte nga zyra. - Të lutem të hënën qysh në mëngjes dorëzoja zëvendësministrit kopjen e parë. Besoj se nuk të vjen rëndë ta kryesh këtë shërbim të vogël, mbasi unë do të vij vonë.

Nga toni e kuptova se qe mjaft i nervozuar.

Të hënën, sapo shkela në zyrë, u kujtova për porosinë e tij. Përpara se të vija poshtë në sekretari, hapa dosjen me variantet e referatit. Për fat Nermini e kishte sjellë, kështu nuk ishte nevoja të zbrisja 64 basamakë shkalle. Mora kopjen e parë, trokita në zyrën e zëvendës ministrit dhe ia dorëzoja në dorë.

- Pse nuk e sollti vetë Remziu? - më pyeti ai.

- Do vijë pak më vonë mbasi kishte një punë urgjente jashtë dikasterit dhe, - e sqarova zëvendësin.

Remziu erdhi rreth orës dhjetë. E vura re se ishte inatosur, aq sa sytë s'mund t'i mbante në një vend.

- Po ti, o burrë, as kaq gjë s'mund ta bëje? Ti sikur edhe më premtove... - m'u gërmush.. - Unë të porosita...

- Nuk po të kuptoj, - i thashë me ndërgjegje të qetë.

- Të mirrje kopjen nga sekretaria dhe t'ia shpije shokut Mane...

- Atë punë kreu të parën sot në mëngjes. Ia shpura në zyrë dhe ia lashë në dorë.

- Çfarë i shputë? Unë tani sa i mora të katër kopjet nga Nermini, ja ku i kam - m'u hakërrye duke më tundur tufën e fletëve para syve.

- Unë hapa dosjen, gjeta një kopje të pastër dhe pandeha se e kishte sjellë Nermini, - e sqarova duke i shkoqur fjalët një nga një.

Sapo hapi dosjen, Remziu i ra ballit me dorë.

- Obobo, çfarë skandali! - bërtiti. - I keni shpënë variantin e parë, të parin fare, pa i ndryshuar asnjë presje. Shoku Mane do të tërbohët sapo ta lexojë, do të më qortojë se po tallem me të...

Mbeta i vuvosur.

- Përgjegjësinë do ta mbash vetë, - m'u kthye serioz. - Jo, për ideal, me shefat nuk bëhen shaka të tilla. Kjo do t'u kushtojë shtrenjt.

M'u kujtua thënia e Leka Gungës se sot pjesa më e ndjeshme e trupit është prapanica, jo zemra. Qëndrimi i ashpër i Remziut kundrejt meje lidhej me rrezikun se mund t'ia hiqnin karrigen e zyrës.

Papritur në derë u dëgjuan disa trokitje të lehta, formale dhe shoku Mane hyri brenda duke mbajtur në dorë kopjen e referatit fatkeq. Remziu me pamje të vrerosur, para se të shpërthente ai, nisi të belbëzonte:

- Shoku Mane, e di si? Ndodhi një...

Zëvendësministri e ndërpreu duke i thënë.

- Nuk ka nevojë për shpjegime. Më tha Neimi se do të vonoheshit pak. Sa për referatin shoku Remzi, mendoj se i plotëson të gjitha parametrat e kërkuara. Tani arritëm atje ku deshëm. Çdo gjë ka gjetur vendin e saj, problemet dhe konkluzionet janë të qarta, detyrat po ashtu, përgjegjësia e plotë, dhe ...s'ka ç'duhet më shumë. Na falni se kësaj here ju bezdisëm pak më tepër me vërejtje e sugjerime, por sikurse e sheh, ishin të nevojshme. Edhe shoku Ministër nuk kishte asnjë vërejtje. Shaptilografojeni urgjent në njëzet kopje dhe jepjani korrierit t'ua shpërndajë anëtarëve të kolegjumit.

Remziu herë shihte zëvendësministrin, herë mua. Të më falënderonte për gabimin e bërë padashur, nuk i dukej e hijshme, të qëndronte si memec nuk shkonte, prandaj u mjaftua të shqiptonte diçka pa kuptim:

- Thashë unë...

NGJALA



Për shkak se dikasteri kishte shumë nëpunës e pak mjedise, shefi u detyrua ta ndante zyrën me dy vartësit e tij, më konkretisht me mua dhe Xhovanin. Kjo i jepte dorë të kontrollonte më lehtë hyrje-daljet tona, të inspektonte çdo çast me se merreshim, por njëkohësisht edhe atë vetë e linte zbuluar. Donim s'donim, ne dëgjonim dialogjet e tij në telefon dhe me njerëzit që vinin të ankoheshin për hallet e tyre. Gjithsesi ai gjeti një zgjidhje origjinale: e ndau zyrën në mënyrë asimetrike, duke mbajtur 3/5 për vete dhe kusurin për ne. Tryeza e madhe me xham të trashë 5 milimetrash sipër, aparati i telefonit, kalendari javor, dollapi ku ruante dosjet e rëndësishme, shkresat sekrete, udhëzimet, komodina me makinën daktilografike, të gjitha ishin në anën e tij. Kësisoj kushdo që hynte në zyrë e kuptonte menjëherë se ku duhej të drejtohej.

Çdo mëngjes Asti kryente ceremoninë rituale të hapjes së dollapit. Çelësin e tij, tok me vulën e dyllit e mbante me vete në një rreth me

zinxhir, ana e lirë e të cilit spërdridhej dy tri herë pas thilesë së brezit. Kësisoj s'kishte asnjë mundësi që ta harronte çelësin diku, a mos qoftë e thënë ta humbiste dhe pastaj të jepte llogari për mungesë vigjilence. Së pari ai hiqte spangon në formë X mbi flegrat e dollapit, fiksuar në pesë vende me dyllë të kuq, me siglën e tij personale, pastaj nxirrte me radhë shkresat, dosjet, evidencën.

Pas pak kohe zbulova një nga ato dinakëritë e vogla prej nëpunësi. Puna në dikaster ishte me hope. Ditët e javët e ngarkuara, alternoheshin me ditë të qeta pa asnjë ngarkesë. Mund të rrije gjithë shtatë orë mbi tryezë duke dremitur, ose e teratisur mendjen kot. Sa herë s'kishte asnjë punë për të kryer, Asti nxirrte mbi tryezë më shumë dosje se zakonisht, aq sa midis tyre dukej si i zhytur në një det shkresash. Kushdo që hynte do ta mëshironte se si po e përballonte atë mori problemesh. Kjo ishte taktika e tij mbrojtëse kundrejt Drejtorit ose Zëvendës ministrit, të cilët shfaqnin shenja pakënaqësie posa shihnin nëpunësin të prehej para një tryeze bosh.

Kthesat e tij ishin fenomale dhe zotësia e tij për t'u shpëtuar qortimeve, e admirueshme. Nuk kam parë nëpunës më të shkathët se Asti Taraboshi, ai ishte "ngjalë" që të shkiste nëpër duar dhe nuk mund ta kapje as me gjethe fiku. Njëherë Esati, drejtori ynë, e vuri para një dileme të vështirë. Një grup artistik kishte kryer disa shkelje financiare dhe përgjegjësi justifikojë se ishte konsultuar me Astin. "U keni thënë ju?" e pyeti Astin ai. Asti Taraboshi e mohoi kategorikisht. "Domethënë kanë vepruar kuturu, më kokën e tyre, kurse ju si kryeinspektor e kishit detyrë t'u thoshit si të vepronin." "U kam thënë, si jo, jo njëherë po disa herë," u mbrojt Asti. "Po pra, ia ktheu Drejtori, këtë dua të di edhe unë, u ke thënë a po s'u ke thënë?" Asti e pa se rrëshqitja nuk eci, prandaj ngriti dorën lart dhe u largua duke protestuar: "Ou, ou, i ke thënë, s'i ke thënë, ç'janë këto?" Esati i shkoi mundimi huq sepse nuk mundi ta zbrëthente përgjigjen e tij ekuivoke.

Atë vit, -duhet të ketë qenë 1975,- Ministria hapi një kurs gjashtëmujor për regjisorë teatrosk kukullash dhe natyrisht barra më e madhe ra mbi drejtorinë tonë. U desh të përballonim një vëllim

të madh pune për të siguruar pjesëmarrësit nga rrethet, klasën ku do të zhvillohej mësimi, programin, pedagogët, konviktin, mención, etj. Falë energjive të përbashkëta të shefit, misioni u kurorëzua me sukses. Aktiviteti u fut nëpër raporte e referate si sukcesi më i madh i Ministrisë dhe shefin e lavdëruan për zellin dhe kujdesin që tregoi.

* * *

Pas disa trokitjeve të drojtura, dera u hap dhe në zyrë u fut kursanti për regjisor i dërguar nga rrethi i Lushnjës, Durim Veliu. Sapo e pa, shefi e pyeti qortimshëm:

- Prapë ti?

- Prapë, - u përgjegj me drojtje Durimi, duke qëndruar në mes të zyrës, i gatshëm të kthehej mbrapsht. - Më falni për shqetësimin. Po të jeni i zënë, vij më vonë.

Shefi e ftoi me dorë t'i afrohej tryezës së tij.

- Si është puna? Pse u mundove?

- Nuk dëgjojnë të ma japin rrogën, - e sqaroi Durimi.

Problemin e tij e dija edhe unë. Pas mbarimit të fakultetit për gjuhë frënge, Kujtim Veliu shpresonte të emërohej mësues në ndonjë nga shkollat e mesme të Lushnjës, a së paku në ndonjë shtatëvjeçare, mirëpo shefi i seksionit e la jashtë kuadrit, për të rregulluar një mikeshën e tij. Sa për të larë gojën, e emëroi përgjegjës kulture në një nga shtatë Çermat midis Shkumbinit dhe ish kënetës së Tërbufit, i sigurt se ai nuk do ta pranonte detyrën jashtë profilit. Durimi, e pranoi. Pas disa muajsh, Lushnjës iu kërkua të dërgonte një person të përshtatshëm për regjisor kukullash dhe seksioni i Arsim-Kulturës u kujtua për Durim Velion. Gëzimi i tij s'kishte kufi, sepse iu duk sikur me këtë akt, sikur ata po rregullonin emërimin e gabuar të shtatorit. Vërtet i mbyllën derën e arsimit, por i hapën një derë më të madhe, atë të artit. Kot e përfllitnin shefin e arsimit, Dhosi Llozin, si autoritar, qylaxhi, servil dhe feminist.

Pas një muaji kursantëve u erdhën rrogat me mandatposta nga rrethet përkatëse, ndërsa Durimit jo. Do të qe ndonjë gabim i rastit dhe të hollat do t'ia kishin rezervuar në llogarinë e seksionit meqë

nuk i dinin adresën. Të premtën pasdite Durimi i hipi trenit për në Lushnjë dhe të shtunë që në mëngjes trokiti te zyrat e arsim-kulturës. Llogaritari e qetësoi se tani e tutje rrogën do ta mirrte nga shkolla. Të hënën Durimi takoi drejtorin e shkollës, i cili e akulloi sapo i tha se ata nuk kishin fonde për kursantët. “Zgjidhe çështjen në Ministri,” e mësoi ai, “ata që ju kanë sjellë këtu, duhet ta dinë kush duhet t’ua japë rrogën.”

Asti, e sqaroi se rregullorja e përcaktonte qartë: kursantët paguhen nga rrethet. Me këtë argument Durimi shpresoi se do ta fitonte të drejtën, ndërsa llogaritarit të arsim- kulturës i kërcyen kacabujtë sapo e pa te dera. “Ç’kërkon ti këtu? Ikë more djalë dhe mos na mërzit më se ti nuk figuron as në borderotë e fshatit, as në të qytetit. Zhduku!”

Durim Veliu u përplas sërish në Ministri, për të zgjidhur nyjen e ngatërruar. U ndodha në zyrë kur ia parashtrroi ankesën shefit. Asti Taraboshi e udhëzoi të shkonte në Lushnjë dhe ta kërkonte të drejtën e tij pa iu dridhur qerpiku. “U thuaj t’ua japin çekun në dorë. Mos prano sorollatje,” qenë fjalët e tij të prera. Mirëpo ardhja e tij sërish në Ministri rrëfente se problemi kishte mbetur aty ku ishte, pezull, as në qiell, as në tokë.

Shefi u kthye nga unë për ta ndarë zemërimin që i shpërtheu përbrenda.

- Ç’bëhet kështu? - pyeti me inat. - Rrethet e vogla s’e çajnë kokën fare për ligjet. As i njohin, as nuki zbatojnë. U the ashtu si të porosita unë?

- Një për një, - e siguroi Durimi.

- Po ata?

- Më thanë se më kishin zëvendësuar...

- Tjetër gabim nga ana e tyre, gabim i rëndë, do të thosha. Nuk mund të emëronin tjetër, për sa kohë vazhdoni kursin, - konkludoi shefi. - Për kurset që vazhdojnë deri në një vit, kursantët paguhen nga qendrat e punës, - shqiptoi shefi sikur lexonte rregulloren. - Ua the?

- Ua thashë.

- E pastaj?

- Nuk mund të japim dy rroga për një vend pune, thanë - vazhdoi kursanti sikur t'i vinte turp që arsyetimet e shefit nuk ishin përfillur nga rrethi.

- Ua përmende urdhërin e Ministrit numër 10, apo u drojte mos i vije në pozitë se nuk njohin udhëzimet? Kështu apo jo? Je drojtur, pohoje pa të ardhur turp, - vazhdoi Asti. Dukej se sedra e tij ishte lënduar keq nga disa nëpunës provincialë që nuk njihnin as udhëzimet e Ministrit përkatës.

- Nuk na duhet ne, thanë...

- Si? Pse republikë më vete është Lushnja? - shfreu Asti, duke u kthyer me vrull nga dollapi. Hoqi spangon me dyllë të kuq, nxori çelësin dhe pasi e hapi flegren, gërmoi nëpër disa dosje derisa gjeti broshurën që kërkonte. Shfletoi faqen ku ishte udhëzimi numër 10 dhe ia lexoi Durimit paragrafin për trajtimin, pagesën dhe ushqimin e kursantëve.

- Merrni parasysh se kam gruan dhe dy fëmijë për të ushqyer. Nuk jam beqar, shoku shef. Në këto kushte unë detyrohem ta braktis kursin.

- Në asnjë mënyrë! - ia preu shefi, - Ka vendim qeverie për të ngritur teatro kukullash në çdo rreth. Dhe urdhërat zbatohen, nuk diskutohen.

- Tre muaj pa rrogë, s'janë pak, - tha i dëshpëruar Durimi, i gatshëm ta sakrifikonte artin për stomakun. - Si do të shkokolepset kjo çështje?

- Më fal që ta them, por ti s'ke ditur të luftosh, - e qortoi shefi.

- Urdhëri i Ministrit ka fuqi ligjore. Nuk e kanë këtë udhëzim? Ta gjenin ku të ishte, se prandaj paguhen nga shteti. Nuk u bind llogaritari? Të shkoje te shefi. S'u bind shefi, të vije te prokurori e t'i denoncoje për shkelje ligji. Po që se dhe ai të përcillte, ta hidhje në gjyq seksionin. Pasi t'i përvlohej bytha shefit nga gjykata me ndonjë rrogë nga xhepi i tij, le ta mësonte ç'janë ligjet dhe si duhen zbatuar. A nuk ua thashë këto një për një javën e kaluar?

Këshilla e Astit për ta hedhur seksionin në gjyq, shtyhej nga motivi për të mbajtur lart autoritetin e Ministrisë dhe të Ministrisë nga disa provinciale kokëfortë.

- Nuk mund të lihet një kuadër pa rrogë për faj të burokracisë. Mos u shqetësohi, do të flas unë me shefin, - e qetësoi Asti. Formoi numërin e centralit dhe kërkoi ta lidhnin me rrethin e Lushnjës.

Siç ngjet rrallë herë, centrali e lidhi pas dy minutash.

- Alo Lushnja? Më jepni pak shefin e seksionit të arsim-kulturës.

Me mikrofon në dorë, duke pritur lidhjen, fytyra e Astit e shprehte dukshëm zemërimin që i vlonte përbrenda. Po të mos e gjente Dhosi Llozin "çështja e kursantit Kujtim" do të shtyhej dhe më pas do të harrohej. Për çudi shefi u ndodh në zyrë megjithëse ora po vinte dy.

- Alo, shoku shef? Ti Dhosi je? - iu drejtua shoqërisht. - Jam unë Asti, Asti pra, Asti Taraboshi nga dikasteri, derisa e dashke me mbiemër. - Shefi qeshi dhe duke e mbuluar mikrofonin me dorë më tha: - E kam mik të vjetër. - E hoqi dorën nga mikrofonin dhe u fut në temë. - Shoku Dhosi, habitem si nuk e zgjidhët çështjen e rrogës së atij kursantit? Ka tre muaj pa rrogë tjetri. E de, e, të Kujtim Veliut a Valiut, të regjisorit të kukullave. Atij i takon, sepse urdhëri Nr. 10 i Ministrisë përcakton... Si? Ka marrë vendim Komiteti? Ashtu hë? Edhe atje? Ashtu hë? Shoqja Liljana the? Oh, ç'po më thoni... kjo s'më pëlqen hiç. Jo, jo, jo! Kurrsesi nga ne. Ashtu hë? Shumë keq, shumë keq. Ajde mirupafshim, mirë... - E vuri mikrofonin në vend duke e përplasur me inat.

Kursanti u ngrit në këmbë të dëgjonte përfundimin e bisedës midis dy shefave.

- E paske ngatërruar vetë, - e qortoi Asti. - Si more, je ankuar në prokurori, hë, paske dashur t'i hedhësh edhe në gjyq, hë?

- Po, sikurse më porositët...

- Unë? S'ua kam dhënë kurrë një porosi të tillë. Kurrsesi! Pse mos u çmenda unë t'ju këshilloj të ngreni padi kundër seksionit, kundër shtetit? Jam instruktor ministrie, punonjës shteti, shkurt faja. Nuk e ditke ti akoma se të kujt janë gjykatat tek ne? Ke vepruar

kryekëput gabim, hiç mos e zgjat, pranoje. Komiteti ka marrë vendim për atë emërim. Tani s'mund të çemërojnë atë dhe t'ju riemërojnë juve. A do të ktheheni në fshat pas kursit? Jo. Atëherë çfarë kërkoni? Ju s'keni hiç të drejtë...

- Ta lë kursin përgjysmë? - e pyeti me frikë se mos zyrtari zemërohej edhe më tepër.

- Punë për ju, - ia preu shkurt.

Tani ishte Asti që njihja, cinik dhe arrogant, i prirë t'i prapësonte të gjithë ata që trokisnin në zyrën e tij për halle të ndryshme. Donte të çlirohej sa më parë nga kursanti që e kishte futur në telashe me autoritetet e rrethit, sidomos me shoqen Liljana. Qe implikuar edhe vetë si idiot duke e këshilluar t'i drejtohej prokurorisë dhe gjyqit. Sytë e shefit rrëshqitën drejt meje duke pritur miratim për kthesën 180 gradshe. Qëllimisht as e miratova, as e kundërshtova.

Kursanti fërkoj ballin si të largonte ndonjë pejzishkë merimange.

- Ty s'të takonte fare të vije në kurs, - u hodh në sulm Asti.

- Pse s'më takonte? - u habit Durimi.

- Se ti e ke kryer fakultetin. Ky nuk është kurs pas Universitar. Si e ditke ti? - e mbërtheu shefi.

Se nga ç'thellësi ligësie e nxori këtë argument, e di vetëm i zoti.

- Unë nuk erdha vetë, ishin ata që më caktuan, - u mbrojt Kujtimi.

- Ku të duash, me mua s'ke më punë, - ia priti shefi.

Durimi doli i mërzitur nga zyra.

- Ç'tipa! - tha me përbuzje Asti duke shikuar nga dera. - Emërimin e atij e paska urdhëruar shoqja Liljana, tha shoku Dhosi, ndërsa ky vjen e kërkon qiçra në hell, - ishin fjalët e fundit të shefit tim.

Liljana Përpunja, sekretarja e I e Komitetit të Partisë ishte një nga gratë me pozitë të lartë në nomenklaturën e partisë.

- Tani ku të përplasem? - pyeti. - Si do t'i vejë filli rrogës sime?

Shefi nuk denjoi t'i përgjigjej. I kthehu krahët dhe e nguli kokën mbi dosje. Kujtimi hoqi një psherëtimë të thellë nga shpirti dhe doli i mërzitur nga zyra.

NUK DUA ASGJË - JAM DERI NË FYT

Sa hyri në derën e rostiçerisë, Rasimi kreu rikonjicionin e S lokalit në të dy krahët, duke vëzhguar tryezat dhe klientët, sikur po kërkonte dikë. Sapo na diktoi, buzëqeshi, ngriti të dy duart lart triumfalisht dhe përparoi drejt nesh.



- Po ku jeni, more shokë? Sa më thanë që ishit këtu, erdha me një frymë t'ua takoj. - Se kush e kishte informuar për vendndodhjen tonë, nuk e tha. - E merr malli njeriun për shokët e vjetër.

Toni u ngrit në këmbë të përfaqonte kolegun, të cilin s'e kishte takuar prej vitesh, unë i zgjata dorën, ndërsa Gjon Valshi, sado që u mundua të dukej i qetë, nuk mundi ta fshihte bezdinë nga prania e tij. E kisha vënë re se edhe disa nga të njohurit e mi në atë qytet, silleshin ftohtë me të dhe përpiqeshin ta mënjanonin. Në sytë e tyre ai nuk gëzonte pikë konsiderate, kushedi për ç'shkak. Në qytetet e vogla simpatitë dhe antipatitë dalin më në pah, për arsye të mungesës së hapësirës dhe distancës.

Rasim Haxhiun e njoha së pari nga shkrimet e tij dhe mund të them se një kohë kam patur simpati për të. Më dukej gazetar i zgjuar dhe me temperament, prandaj u gëzova kur e emëruan korrespondent special të një gazetë qendrore. Në qiellin e gazetarisë shqiptare emri i tij shkëlqeu si një meteor dhe po aq shpejt u zhduk. U zbulua se Rasimi shkruante artikuj me emra të shpikur dhe pastaj me autorizime të sajuara, përvetësonte honoraret. Këto skandale morale dhe financiare, Drejtoria e shtypit nuk ia fali dhe e liroi nga detyra pa ceremoni. Rasimi u kthye në gazetën lokale, atje ku ishte para se të fillonte ngjitjen. Këtë rrotullim prej 360 gradësh Rasimi e paraqiste me ngjyra bojë rozë, si largim vullnetar nga kryeqyteti për të ngritur nivelin e gazetës së vendlindjes, si sakrificë që shoqëria e kërkonte prej tij. Sa e besonin, është tjetër çështje.

Rasimi u ul midis Tonit dhe Gjon Valshit.

- Këta janë kolegët që çmoj më shumë, shokët më të mirë që kam në kryeqytet. - Këto shpjegime Rasimi ia jepte Gjon Valshit. - Kemi patur shoqëri të ngushtë dhe mirëkuptim të shkëlqyer, për shkak se shijet tona, kuptohet dhe preferencat, i kemi patur të njëjta. Folë Toni, nuk është kështu?

Toni e gjeti të arsyeshme t'ia shpërblente lavdërimet me sende në natyrë.

- Ç'do të marrësh? - e pyeti, meqë Rasimi nuk kishte as gotë, as pjatë mezesh përpara tij.

- Nuk dua asgjë! - deklaroi vendosmërisht. - Asgjë!

Ta merrnim seriozisht atë deklaratë, apo si shprehje etike të një njeriu që ulet në tryezë pa qenë i ftuar? Qëndrimi i tij binte në kundërshtim flagrant me thashethemet që qarkullonin për të si qylaxhi.

- Një gotë do ta marrësh, - ngulmoi Toni, - qoftë edhe sikur ta mbash kot përpara.

- Për hatrin tuaj, sa për t'ju uruar, - pranoi Rasimi, - për shoqërinë e ngushtë që kemi patur.

Duke e ngritur në lartësi stratosferike miqësinë tonë, donte t'i mburrej Gjonit, apo të tregonte sa shumë na çmonte. Sa për vete, nuk e llogarisja as shok, as mik, sepse ishte njeri me shumë faqe dhe karakterin e tij s'mund ta përcaktoje, ndofta nga që s'kishte karakter. Herë hiqej parimor që luftonte pa mëshirë çdo dukuri negative, herë militant konformist. Tani shëmbte me kritika të rrepta persona me pozitë duke treguar se si i kishte kryqëzuar me argumentet e tij, tani lavdëronte shokun iks që kishte urdhëruar të mbyllej gjyqi kundër gruas së tij, proceduar për deficit mjaft të madh.

- Unë, që ta merrni vesh ju, tani sapo kthehem nga fshati. Jam deri në fyt - vazhdoi sqarimin duke vënë dorën në mjekër, sikur të ishte një fuçi e mbushur plot e përplot. - Të ngrëna e të pira sa nuk e merrni dot me mend. E nisëm gostinë mbrëmë dhe e përfunduam, kur thoni ju? Sot në drekë...

Posa ishte i ngopur, duhej besuar se drejt tryezës sonë e kishte shtyrë malli për shokët.

- Motër, na sill një gotë, - iu lut Gjoni kamarieres.

Gryka e shishes së verës gurgulloi dhe xhami i gotës po merrte flakërimë të kuqe, ndërsa Rasimi nuk ia ndante sytë.

- Sa për ta përpjekur me ju, - tha duke ngritur gotën me një lëvizje djaloshare. - Të presin mirë fshatarët, janë zemërbardhë, bujarë, të pastër nga shpirti, ndërsa qyteti i ka humbur traditat... Nuk dua ta përgjithësoj, por gjithsesi... E po gëzuar! Toni, sa kohë ka që s'jemi parë?

- Ndoshta dhjetë, dymbëdhjetë vjet.

- Edhe më shumë. Ta dish, më ka mbetur hatëri që nuk më ke takuar kur ke ardhur në qytetin tonë. Adresa ime gjendet lehtë, gazeta lokale. Kush nuk e njeh Rasim Haxhiun këtu? E këndshme kjo vera!

- Merlot, i cilësisë së parë, - e sqaroi Toni.

- Veç jo si ajo e fshatit... - u kthye sërish në gjirin e fshatarësisë.

- E besoni? Vishej gota nga brenda. As në kantinën e Durrësit s'e gjen më të mirë. Pa le mezetë! S'kishim ku vinim pirunjtë e thikat.

- Shtriu të dy duart përpara e filloi t'i lëvizte sikur po notonte me pashë në det, për të dhënë idenë e bollëkut. Me atë rast dora e tij e djathtë peshkoi një cigare nga paketa e Gjonit.

- Merr edhe një meze, - e luti Toni, - se vera nuk përcillet thatë.

- Meze nuk dua, thashë jam deri këtu, - sërish vuri dorën në gushë.

- Krahët e mi janë lodhur mbrëmë duke shqyer mish qengji, gjoksa gjel deti e duke ngritur zamzanet me raki, ndaj mezet e lokalit nuk më shijojnë.

- Po ti ishe i ftuar, apo shef guzhine? - e pyeti Gjoni me kunj.

- Në fakt, shkova për një reportazh, - pohoi duke e anashkaluar ironinë e Gjonit.

- Me ç'rast kjo festë kaq e madhe?

- A! - U mendua pak, pastaj tha. - Me rastin e ... more vërtet, sa mirë që ma kujtuat. Më duket për një hero të punës socialiste, - ia mbyti kot. - Duhet të pyes.

Toni e dëgjonte me interes, duke ia patur zili darkës gargantuane, ndërsa unë e kundroja si fantazi. Një episod i vogël më kishte ndihmuar ta njihja karakterin e tij. Sa herë takoheshim rastësisht në Tiranë, më lutej "eja më tako, kur të vish në qytetin tim, do të kënaqemi, njoh kushedi sa përgjegjësa restoranti, se gazeta... mmm... e kupton ti."

Një ditë të acartë dimri ia plotësova lutjen. U ktheva te redaksia e gazetës dhe për fat e gjeta në zyrë.

- Ulu! - më tha. - Kam një artikull në dorë për ta dorëzuar urgjent... - Ndërkohë filloi të më fliste për telashet e gazetës, problemet që mendonte të trajtonte, pengesat që gjente nga kryeredaktori konformist, etj. etj.

Atë ditë u tregua bujar me drutë e zyrës dhe ndërkohë shpalosi pikëpamjet e tij rreth nxehtësisë.

- Atmosfera e gazetës duhet të jetë e ngrohtë që të buisin mendimet më me vrull. E ftohta, i than. Ç'kemi andej nga kryeqyteti? Na thuaj ndonjë të re.

Qe e kotë të rrija më gjatë dhe ta lija pa punë. Më përcolli deri te dera me një lloj mërzie sikur nuk po i pritej sa të largohesha.

- Të mos ishe kaq i zënë, do të propozoja të shkonim në ndonjë klub, - i thashë duke i shtrirë dorën.

- Njeriu duhet të sakrifikojë për shoqërinë, - tha Rasimi duke u kthyer të merrte xhakëtën. - Po nuk u botua nesër, herës tjetër.

Tani po vëreja sjelljen e Rasimit në tryezën tonë, ku i duhej të harmonizonte dy kundërshti: t'i binte qylit dhe ndërkohë të ruante një farë dinjiteti.

Një pjatancë me mëlçi viçi të sapofërguara u vendos mbi tryezë. Aroma e rignonit dhe e piperit të zi mbushi lokalin. Flegrat e hundës së Rasimit u hapën pak më shumë.

- Viçi apo derri? - pyeti. La të kuptohej se po të ishin prej derri nuk do t'i vinte në gojë.

- Derri, - i tha Gjoni qëllimisht për t'i prerë hovin.

Rasimi si njeri me përvojë, e mori kthesën menjëherë.

- Të fërguara me pak gjalpë, mbi mëlçitë e derrit nuk vë asgjë. Natyrisht varet nga kuzinieri. Si i gatujnë këtu? - Futi një llokmë në gojë dhe duke u përtypur shfaqte miratimin me sy, vetulla, lëvizje koke e mërmërima. - Të mira, shumë të shijshme, por jo si ato që hëngra mbrëmë.

Sapo krijohej ndonjë pauzë, Rasimi pyeste:

- Mos kishit ndonjë takim pune dhe ua prisha padashur me ardhjen time?

E siguruam se s'kishim asnjë punë, veç të hanim e të pinim dhe Rasimi u ndie krejt i barabartë, qëkur filloi të na mbushte edhe gotat.

- Më falni një minut, - tha duke u ngritur. Shkoi futi kokën në sportelin e kuzhinës dhe kur u kthye na shkeli syrin. - E njoh

kuzinierin, e kam mik, do të na vinë meze speciale...

Pasi u zbraz pika e fundit e verës nga shishja, Rasimi na kujtoi të merrnim një shishe tjetër për të shoqëruar mezet që kishin tepruar.

- Ne mbaruam, - i tha Gjoni, - po për hatrin tënd do ta pinim nga një gotë.

Rasimi e dinte, se po ta porosiste, duhet ta paguante vetë, prandaj dredhoi.

- Unë për vete, s'dua asgjë, jam deri në fytyrë!

S'kishim pse ta vinim në dyshim deklaratën e tij, pasi kishte përllarë dy pjata me meze dhe një të tretën e pjatancës me mëlçi. U ndamë me të në trotuarin jashtë rostiçerisë. Toni dukej mjaft i pezmatuar.

- Si qenka transformuar kështu? E pra, dikur ka qenë gazetar i talentuar.

- As tani nuk i mungon talenti, por e derdh jashtë shtyllave të gazetës, - e sqaroi Gjoni. - Sa herë mbetet pa një dyshkë në xhep-dhe kjo i takon shpesh, - shkon vizitë te ndonjë veteran dhe i lutet. "Xha Emrush, ma thoni edhe njëherë si e organizuat pritën në filan vend? Se ti tregon bukur..." Dhe ndërsa veterani nxjerr shishen e rakisë për gazetarin dhe gruaja e tij, ose e reja, gatuan mezet e rastit, vazhdon biseda për betejën. Rasimi dëgjon duke u përtypur. Sapo shishja zbrazet, i lë shëndenë, duke i premtuar se do të vijë sërish të vjelë kujtimet e tij, që brezi i ri të mësojë si u fitua lufta dhe dëngla të tjera. I gënjen, i shqep me premtime se do t'ua botojë kujtimet dhe ata qyrymykët e besojnë.

- Edhe ata gënjeshtrojnë, - shtoi Toni me zë të ulët.

- Kështu po vete kjo punë, dushk për gogla, - e mbylli bisedën Gjoni.

ETIKETANGJITËSI

Një muaj me radhë e kisha parë Izidor Timarin në sallën e Bibliotekës Kombëtare mëngëpërvëshur, duke shkruar me shpejtësi mbi tabakët e letrës, të cilët shtoheshin kapticë në krahun e tij të djathtë. Frymëzim balzakian e përcaktova me mend. Meqë Izidori ishte pensionist, pandeha se po hidhte në letër kontributin e tij për muzeun e fshatit, a për ndonjë a për ndonjë artikull me kujtime për seritë e broshurave të Komitetit të Veteranëve. Një ditë kureshtja më shtyri t'i afrohesha dhe ta pyesja me se po merrej.

- Po shkruaj një roman, - m'u përgjigj me modesti.

- Romaaan? - padashur më doli një pasthirmë habie, ngase e dija mirëfilli se Izidori gjithë jetën e tij kishte botuar vetëm një tregim dhe atë pas redaktimit të shkrimtarit Spiridhon Tomori, që ruajti idenë dhe emrin e protagonistit, ndërsa të tjerat i vuri vetë.

- Pse, çdo romani? - më pyeti me seriozitet. - Bojë e letër dhe unë ato i kam siguruar me kohë. Besoj se për një muaj i dal mbanë.

Shpejtësia me të cilën mbushte faqet, më la të kuptoj se mund ta përfundonte edhe para afatit.

- E di ç'dua unë prej teje? - më pyeti duke më kapur kopsën e xhaketës. Në atë lloj intimiteti shfaqej një lutje e thukët. Pa dashur sytë më shkuan mbi dosjen voluminoze. - Të ma lexosh romanin, jo komplet, se nuk dua t'ju ha shumë kohë, vetëm dy kapituj. Dyzë...

Meqë ma lehtësoi ndjeshëm barrën e rëndë, i thashë "po."

- E dija që do të pranoje, - tha duke më rënë miqësisht supeve, - se ti je popullor, jo si ca e ca. Ehu! Sa kam njohur unë...

Pas dy ditësh më sollli në shtëpi 50 faqe të dorëshkrimit. Faqet kalonin shpejt me shkrimin e tij të madh e të hapur. Tek po lexoja kapitujt e romanit, më erdhi ndërmend aforizma e një humoristi anglez: "Romani s'është gjë tjetër, veçse një shishe bojë e shpërndarë me mjeshteri në letër." Por meqë Izidorit i mungonte mjeshteria, romani i tij ishte safi bojë mbi letër, prognoza ime për të ishte paksa e zymtë. Parashikoja vranësira, shpërthime e gjëmime ndërmjet autorit dhe shtëpisë së vetme botuese për letërsi artistike.

Sapo erdhi për të vjelë mbresat e mia, më drejtoi një pyetje jo dhe aq modeste.

- Si t'u duk? Sa shkrimtarë lë prapa unë me këtë roman?

- Mua po e po, se nuk kam shkruar ende roman...- dredhova.

Qeshi. I urova sukses dhe me aq u ndamë.

Shtëpia Botuese "Naim Frashëri" pranoi t'ia daktilografonte dorëshkrimin gati falas, me 3 lek të vjetra faqen, para se t'ua kalonin recensentëve. "Më pritën shumë mirë, më tha Izidori, por gjeta belanë me rrethin familjar. Asnjë prej tyre nuk beson te talenti im. Kot paratë që po harxhon, më qortoi gruaja. Dymijë e dyqind e shtatëmbëdhjetë lekë, asaj i duken shumë, kurse mua asgjë. Ndërkohë pyet vazhdimisht shoqet e saj: "a ka patur në botë raste shpërthimesh talenti në këtë moshë, apo unë jam përjashtim?"

Shtëpia Botuese për të shmangur çdo ngatërresë e keqkuptim, e pyeti Izidorin nëse pranonte recensorë historianin Vladimir Gjonbaba, si njohës i periudhës historike para pavarësisë dhe kritikun Ardian Kaleshi.

- I njeh? - më pyeti.

- Kritikun po, historianin nuk e njoh.

- Është djali i ... si e quajnë dreqin. Të atin e tij ne e kemi mobilizuar, gjatë luftës, pa le të hiqet tani sikur doli vetë partizan.

- Të atit apo të birit ia dhanë për recensionin? - e pyeta.

- Të birit, atij me emrin e Leninit, si specialist për periudhën e Tanzimatit, po unë di dhjetëfish më shumë se çdo historian, se jam

rritur në Stamboll. Neise, prej tij nuk pres ndonjë sugjerim me vlerë, ndërsa për Ardian Kaleshin kam respekt, se është kapacitet, njeri i zoti që ka fituar emër me aftësitë e tij, kritik i mprehtë.

Disa kohë më pas Stathi Krishti, shefi i redaksisë së prozës, e thërriti në redaksi. Ndërsa Izidori priste urime për veprën e tij, ai i tha se redaksia nuk e konsideronte të denjë për ta botuar, për shkak



të nivelit të ulët artistik dhe fragmentarizimit. Kapituajt ende s'kishin lidhje midis tyre.

Izidori filloi të protestonte se ishte e padrejtë të hidhej poshtë një roman patriotik prej 739 faqesh. Ai u kap pas fjalisë së Stathit, se material kishte boll, por duhej më shumë art, prandaj iu përvesh:

- Po ti përse je këtu, përse ta ka dhënë këtë karrige shteti ynë? Përse i ke radaktorët? T'u pëlcasë koka dhe ta rregullojnë, se për atë punë i paguan qeveria.

Stathi e vuri në dijeni se veprat që hidheshin poshtë nga të dy recenzentët nuk mund të ktheheshin për rishqyrtim, veçse me urdhër të Drejtorit ose të kolegjumit. Kështu e përcaktonte rregullorja dhe ata ishin të detyruar ta respektonin pikë për pikë.

Çështjen e nivelit artistik Izidori e trajtonte si marinim të gjellës me kopër e majdanos, pasi mishi dhe zarzavatet kanë zierë. Me romanin nën sjetull Izidori u fut në zyrën e drejtorit të Shtëpisë Botuese duke iu ankua që mbanin si shef, një njeri me mbiemër Krishti, në kohën kur besimi fetar ishte hequr me ligj.

Drejtori, njeri me përvojë të gjatë, i ra shkurt duke i dhënë kopjet e daktilografuara të recensave.

- Lexoji më nge, merr prej tyre çka të duket e mirë dhe sille romanin të ripunuar që ta shqyrtojmë sërish.

* * *

Izidori më mori në telefon dhe më tha se donte të këshillohej për një problem urgjent shumë të rëndësishëm.

- A mund të vij tashti? - më pyeti.

- Pse jo? Kur të duash... - i thashë.

Ç'mund të ishte kjo urgjencë kaq e madhe?

- Kësaj here jam i vendosur ta ndjek çështjen deri te zogjtë e zes, - tha i vendosur, sapo hyri te dera. - Nga Ladi s'prisja ndonjë, se ai s'merr vesh nga letërsia. Se ç'dërdëllit për kuadrin historik, se gjoja përzihet stili letrar me kujtimet dhe ca dëngla të tjera. Kjo sipas tij na qenka gabim. Ç'ke ti mor vëlla, derisa unë e dua kështu? Të

merrte erë Ladi nga letërsia, shkruante vetë romane. Për mua atij i mungon pjekuria politike, derisa rrëzon një roman me temë patriotike, - e mbylli kapitullin e recensës së historianit Vladimir Gjonbaba. - Kurse ai kritikoi i dëgjuar Ardian Kaleshi, qenka pykë në diell!

- Ju sikur e lavdëruat herën e fundit...

- S'e kisha njohur, - ma preu. - Si nuk përtoi hiç burri i dheut, po mbushi katërmbëdhjetë faqe plot me vërejtje dhe sugjerime? Mendjendrituri! Pse keq për vërejtje isha unë? Do ta shohë se me kë ka të bëjë. Jam i luftës unë... - tha duke nxjerrë nga xhepi një zarf. - I kam drejtuar një letër... Aman, po s'e lexove. Nuk është e gjatë, vetëm shtatë faqe.

Çfarë mund t'i shkruante autori kritikut recensent? E dija se Ardiani i lexonte veprat pa kaluar asnjë rresht, me synimin të zbulonte gjithçka që vlente. Atë e shquante dashmirësia për çdo autor, qoftë edhe debutant. Sipas meje Ardiani, veç shpërblimit në të holla, meritonte medaljen e durimit që lexoi shtatëqind e ca faqe lëtyra dhe mbushi katërmbëdhjetë faqe me vërejtje konkrete për të bindur një profan si Izidori.

Shpërthimi i inatit ndihej qysh në fillim të letrës. Aty s'kishte asnjë nga formulat etike të zakonshme, i dashur, i nderuar, madje as emër, as mbiemër.

“Shoku kritik i dëgjuar!

“A është e drejtë që çfarë u pëlqen ju të quhet letërsi dhe të tjerat të hidhen në kosh? Po ua them hapur, pa asnjë rezervë, se kot u mbajnë si kritik të madh, ndërsa për mua jeni llosh, nuk vleni një grosh.”

“Po të ishe kritik me mend dhe i devotshëm, e po t'ia doje të mirën letërsisë dhe popullit, uleshe këmbëkryq mbi roman dhe atje ku s'të pëlqente e rregulloje me kalem në dorë. Kuptohet se juve u mungon humanizmi proletar, ose ju bren cmira mos ua rrëmbejnë lavdinë të tjerët.”

I tërhoqa vërejtjen se e kishte rënduar me epitete që nuk i përkisnin. I thashë se Adriani kurrë nuk ka patur dhe nuk ka pretendime letrare.

- Kjo është si meze, sa për të hapur oreksin, - ma preu Izidori. - Ai djalë ka gabime të rënda, ideore! - i mëshoi fjalës pastaj hoqi dhe një vijë me dorë në ajër, sikur donte ta nënvizonte. - Paskam gjuhë të papunuar, folklorike. A nuk është folklori pasuria jonë më e çmuar? Në e kam gjuhën asisoj, më lumtë! Ai del açik kundër folklorit. - Pastaj më pyeti sikur po kërkonte llogari. - E ke dëgjuar ndonjëherë Ardianin të këndoje këngë popullore?

- Me atë zë që ka, shyqyr që s'këndon, - ia preva.

- Ou! Ti e kthen në shaka çdo gjë, kurse unë po flas seriozisht. - Vështrimi i tij u mërrtye si për të më paralajmëruar se nuk duhet ta mbroja. - Lexo më tutje të shohësh një gabim akoma më të rëndë.

- Këtu ku shfaq rezerva për trimëritë e pabesueshme të kalit? - e pyeta.

- Pikërisht aty! Shqiptari gjithë jetës kë ka patur shok besnik, veç shpatës dhe kalit? Shpërfillja e tij kundër kuajve do analizuar thellë, se pushteti edhe sot bën thirrje të shtohen kafshët e ngarkesës. Pardje gazeta "Zëri i Popullit" kishte një artikull rreth këtij problemi.

- Sikur janë dy gjëra të ndryshme, - vërejtja.

- Mos u mundo ta lehtësosh... Kritiku nuk i çmon kuajt, sepse nuk i njeh traditat tona. A mund të më gjesh ndonjë citat të Marksit ose të Leninit për kuajt? Një e kam këtu në bllok, se kuajt janë makina pa benzinë, po s'di kush e ka thënë...

U mërzita nga këto gjykime stropio dhe e lashë letrën mbi tryezë. Nga shkronjat çapraze dukej se ishte shkruar nën ndikimin e një mllefi të papërmbajtur, me synimin t'i ngjiste etiketa politike.

- Lexoje dhe fundin, - më nxiti, - të shohësh si Kaleshi bie me të dy këmbët brenda ku thotë se romani është i mbingarkuar me fraza gazetareske dhe propagandistike. Aty ka gabuar rëndë. Nuk qenka dakord me gjuhën e gazetës shoku kritik, nuk i pëlqejnë gazetat tona, paska vërejtje dhe për propagandën, e dashka ndryshe.

Konceptet e tij duhen analizuar thellë nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe nga...

Letra do ta shqetësonte Ardianin dhe rrezik ta linte pa fjetur. Po ia shpërblenin keq mundin dhe sinqeritetin e tij.

- Ai shfaqti mendimet e tij për romanin dhe ju po t'u duken me vend, merrini parasysht, po qe se nuk u pëlqejnë, lerini mënjanë. Nuk ka arsye t'i dërgoni letër.

Prëzoi qepallat dhe një hije serioziteti iu shtri mbi fytyrën e gjerë. Diçka po bluante në trurin e tij të tallazitur.

- E dini që po më pëlqen këshilla juaj? E çdo të nxjerr duke ia dërguar letrën me postë?

Për herë të parë gjatë asaj bisede, m'u duk i arsyeshëm dhe i logjikshëm. Dukej se dinte t'i vinte fre zemërimit që e kishte pushtuar. Mirëpo interpretimi im ishte i pasaktë, se pas një grime, shtoi:

- Do ta lexojë dhe do ta hedhë në kosh... Letra i duhet dërguar institucionit ku punon, që të analizojnë konceptet e tij të shtrembëra. Atje do të ketë një a dy armiq dhe ata pastaj e dinë vetë si ta tjerrin. Një kopje do t'ia dërgoj edhe Lidhjes së Shkrimtarëve dhe një tjetër... ta mendoj se ku. Nuk të lexova fundin, -shtoi,- i përpirë nga vrulli i krijimit. "Po të jap dhe një këshillë si më i vjetër. Recensione të tilla as i duhen kurrkujt, se ato nuk nxitin, por pengojnë, u presin hovin të rinjve, qofshin edhe me moshë të thyer, por jo mua, se unë do të shkruaj dhe pjesën e dytë, po kaq sa të parën dhe ndoshta më të gjatë, që t'ua lë kujtim brezave." Mirë e kam mbyllur?

- S'ka më mirë. Po e di se Ardianin e emëruan shëf të redaksisë së prozës, në vend të Stathit?

Më shikoi me dyshim e mosbesim se mos bëja shaka.

- Ma tha Natasha, redaktorja e Shtëpisë Botuese.

E palosi letrën dhe duke e futur në xhepin e brendshëm, tha me hidhërim të sinqertë:

- Tani e mori lumi letërsinë.

GËRVISHTJET PRAPA DERËS

Mirush Kallami më ftoi të shkonim së bashku në zonën e Çermenikës. Meqë doja ta stakoja pak trurin nga punët letrare dhe njëkohësisht të vizitoja një krahinë të panjohur, ftesën e pranova menjëherë. Më pëlqente të hyja në zona të thella, për të përfutur mbresa të freskëta.

Veteranët e kishin për nder ta prisnin ish komisarin e batalionit ndër shtëpitë e tyre, nga malli për të kujtuar episode të ndryshme nga koha e luftës dhe nga pasioni për të komentuar rreth ngjarjeve e personave, disa të harruar, disa të mënjanuar e disa të dënuar.

Pas pesë ditësh, ndërsa po mrizonim duke pirë kafe, nën hijen e gështenjave të Met Balliut, Mirushi tha:

- Sonte besoj ta ndërrojmë temën e bisedave, se do të jemi midis të rinjve. Ne veteranët, sapo takohemi me njëri tjetrin, harrohemi pas kujtimeve të luftës dhe e kemi të pamundur të dalim nga ajo kohë...

I zoti i shtëpisë ku kishim bujtur atë natë, e miratoi pa fjalë. Mirushi vazhdoi:

- E lodhëm edhe këtë mikun me bisedat tona monotone, - tha me shaka në formë autokritike duke u kthyer nga unë, si të më kërkonte të falur. - Sonte na ka ftuar për darkë Kujtimi.

- Cili Kujtim? - e pyeti bujtësi ynë.

- Kryetari i këshillit të bashkuar, - e sqaroi Mirushi. - Ai që ishte mbrëmë këtu.

- Aha! Kujtim Qaniu.

- Ekonomist me shkollë të lartë, apo jo? - deshi të sigurohej Mirushi.

- Të lartë posi... - e pasoi Meti.

M'u duk sikur te fytyra e tij u ravijëzua një ironi e lehtë. Mos vallë Kujtimi ishte nga ata universitarë që i mbyllin librat me



provimin e fundit dhe tani bënte gjumin dimëror me diplomën nën jastëk?

- Ka ardhur koha t'ua lirojmë vendin të rinjve, shoku Met. Boll urdhëruam ne të luftës tridhjetë e ca vjet me radhë. E di, unë gëzohem kur shoh një të ri kryetar komiteti, drejtor institucioni a kryetar kooperative. Për mendimin tim e nisëm pak si vonë këtë reformë. Më shpejt duhet t'i kishim hyrë. Pse? Sepse një agronom me shkollë të lartë e drejton kooperativën më mirë se një veteran. I riu ka kulturë, horizont, i gjykon dukuritë nga një lartësi më e madhe. Kujtimi, për shembull, e sjell të renë më shpejt se Meti, - tha Mirushi duke dashur ta thyente formën e leksionit që mori biseda.

Meti nisi të qeshte nën hundë.

- Të jetë sa për Kujtimin... - tha duke tundur kokën, pa e parë të nevojshme të shtonte fjalë të tjera.

- E pata fjalën për brezin e tij, - e sqaroi Mirushi. -

- Ashtu, po, e pranoj, por do të thosha se nga njeriu jo nga mosha, - vërejti Meti duke rruftur kafënë.

U ngritëm të iknim. Te kapërcyelli i gardhit të oborrit, ai sërish iu lut Mirushit:

- Rrini edhe sonte këtu tek unë, mos na e prishni këtë gëzim...se ti e di proverbin tonë: "kur vjen miku, qeraset edhe i zoti i shtëpisë."

- I dhamë fjalën që mbrëmë dhe ai mund të jetë përgatitur, - kundërshtoi Mirushi.- Po ju nuk do të vini? - e pyeti Mirushi. - Edhe ju jeni i ftuar.

- Do dërgoj djalin, - u përgjigj Meti. - Besimi kthehet sonte nga kantieri i sharrave dhe le të vijë të gostitet me ju. I riu me të riun ujdís më mirë, apo jo?

U ndamë duke marrë rrugën drejt shtëpisë së Kujtimit. Ndërsa ecnim, Mirushi më tha:

- Kam vënë re se veteranëve u mbetet hatëri kur dal nga rrethi i tyre, po unë dua të njoh edhe brezin e ri, se këta janë e ardhmja. Mendimet e Metit, të Faikut, të Isakut, i di prej kohësh. Kjo që arsyeya që e mirëprita ftesën e Kujtimit.

Një grua e panjohur me një fëmijë për dore na përshëndeti dhe vazhdoi rrugën e saj.

- A nuk ju lë mbresë që tani femrat nuk ndërrojnë rrugë sapo shohin ndonjë të huaj? - më pyeti.

- Mos vallë qëllonin të zbuluara dhe e kishin për turp t'ua shihte fytyrën një i huaj?

- Jo, gratë e kesaj ane për çudi nuk mbanin ferexhe, ama fanatizmi dhe prapambetja shoqërore ishin të skajshme. Veshja e tyre, zhele, s'kishte ku t'i zinte qeni. E beson që s'kam parë grua këtu, as nuse, as plakë në kohën e luftës? Gratë e çdo moshe, bile edhe plakat, sapo dallonin një të huaj, ndërronin rrugë, fshiheshin prapa avllive a drizave si kafshët e egra, - theksoi Mirushi. - Edhe atje ku bujtnim, gratë përgatisnin ushqimet, gatuanin bukën, po vetë nuk shkelnin kurrë në odën e burrave. Ishin dy botë krejt të ndara e të veçuara. Tani e zonja e shtëpisë vjen takon miqtë, u uron mirëseardhjen, bisedon me ta, shtrohet në një sofër, sikurse e ke parë dhe vetë. E them me bindje se me rrugë normale do të duhej një shekull për të arritur këtë nivel. Nusja e djalit të Petritit punon dhëmbës mjeke, vajza e madhe vazhdon shkollën pedagogjike në Berat për mësuese, pa zënë ngoje profesionet e tjera, agronome, infermiere, llogaritare, brigadieret.

* * *

Shtëpia e Kujtimit mes pemëve, parcelave me misër dhe livadheve, ngjante si vilat e dikurshme të çifligarëve. Nuk ishte as e tipit të vjetër me teliza, as moderne, por e shartuar njëfarësoj në mënyrë të nxituar e jo fort të harmonizuar. Shkallët jashtë të shpinin në katin e dytë, çka linte të kuptoje se vëllezërit a pjesëtarët, s'kishin mundur të binin në ujdin midis tyre. Në ballkonin prej druri kacavirreshin lastarët e pjergullës dhe nëpër gjethet e zverdhura të saj dukej tek-tuk ndonjë verigë rrushi me kokrra të thara. Përballë ballkonit, në oborr, një barakë e vogël prej druri shërbente për të gatuar a për të larë rrobat. Ca pendë të freskëta në prag të saj, dëftenin

se vizitën tonë e kishte paguar me kokë një pulë pendëkuqe.

Kujtimi na priste në krye të shkallëve, i përzemërt, i qeshur, i gëzuar nga vizita jonë.

- Mbrëmjet e tetorit janë pak të ftohta, prandaj të marrim një afsh pranë zjarrit, sa të vinë dhe miqtë e tjerë, - tha duke na udhëhequr nga kati i dytë, te i pari.

Dhoma përdhese, mbuluar me shkorsa e postiqe ruante tiparet e lashta tradicionale. Mbi një sepete anash dallohej juku i rrobave të gjumit sipër, ndërsa televizori "Butrinti" vendosur mbi tryezën e bukës, dukej i panatyrshëm në atë mjedis arkaik.

- E mbajmë në dhomën e zjarrit, meqë këtu rrijnë pleqtë, - na sqaroi Kujtimi.

Kujtimi, ndryshe nga disa të rinj të tjerë, që tregohen egoistë, duke i futur televizorët në dhomat e tyre të gjumit, mendonte edhe për argëtimin e prindërve. Sjellja e tij meritonte lavdërime nga çdo anë që ta kundroje.

Plaku, babai i tij, kumbisur pranë këndit të oxhakut, pinte duhan me një pipë të gjatë duke soditur zjarrin. Njeri i përmbajtur, fjalëpakë, që përgjigjej vetëm kur e pyesnin.

Pas pak erdhi edhe Besimi, djali i Met Balliut, tok me dy fshatarë të tjerë. Kujtimi ndërkohë, për të uruar mirëseardhjen, mbushi disa gota me raki dhe na i serviri me radhë. Mirushi u interesua të pyeste për gjendjen sociale të Kujtimit dhe sapo mësoi se ishte i martuar, e pyeti:

- Ke ndonjë fëmijë?

- Jo, akoma, - u përgjigj Kujtimi buzëqeshur, - por e kam vënë në plan.

- Shefi edhe "ato punë" i bën me plan, - ndërhyri Besimi.

Shakaja e tij ngjiti mjaft mirë.

- Na është bërë shprehi nga profesioni, - u shfajësua Kujtimi.

- E po gëzuar dhe me një djalë! - uroi Mirushi duke ngritur gotën e rakisë. Pas tij edhe ne e uruam me shprehjen tradicionale "me një djalë."

- Interessant, - ndërhyri Kujtimi, - pse urojnë me një djalë dhe jo me një vajzë? Mua, për vete, kjo shprehje më duket e gabuar, mbeturinë nga kohët e kaluara. Tani që emancipimi i femrës ka

arritur një shkallë të lartë dhe ajo i ka fituar të drejtat në çdo fushë, pse të urohet akoma me këtë mënyrë?

Vërejtja e tij më la mbresë. Shembull konkret i të riut me koncepte të përparuara, i cili edhe urimet tradicionale i shihte me sy kritik, kurse ne, brezi i vjetër, të mësuar me to, i pranonim pa analizuar përmbajtjen.

- Ashtu ka mbetur, - arsyetoi Mirushi, - po sigurisht njëlloj janë, si vajzat, si djemtë. Bile vajzat janë më të mira për prindërit. Ime shoqe çdo hall që ka, me vajzën e bisedon.

Tregoi anekdotën e njohur se ku e pinin kafën kategoritë e ndryshme të pleqve në Tiranë. Ata me pensione të larta, mblidhehin te kafe "Arbëria," ku ishte më e shtrenjtë, njëzetë lekë; ata që kishin vetëm vajza, shkonin te "Peza," ku çmimi ishte dhjetë lekë, ndërsa ata që kishin vetëm djem, uleshin te kafe "Gjirokastra." Këtë emër u kishin ngjitur sofateve prej guri rreth lulishtes mes ministrive, ku ata kalonin kohën duke u rrezitur në diell, pa një lek në xhep.

Darkën e shtruan në katin e dytë, te dhoma e pritjes a e gjumit, nuk di si e quanin bashkëshortët Qaniu, sepse i kryente të dy funksionet. Tryeza që zmadhohej në vartësi të mysafirëve, divanletoja, karriget sfungjeroze, kontrabufeja ku vezullonin kompletet e serviseve prej fajance, dy palë perdet e dritareve, disa qendizma nëpër këndet e mureve, tregonin shijet moderne të amvisës, nuses së Kujtimit. Çdo gjë ishte rregulluar hijshëm si në qytet dhe s'mbetej asnjë dyshim se familja ishte në gjendje të mirë ekonomike. Stononte në atë mjedis një pikturë e bojatisur në xham, me një shtëpi buzë liqenit, disa pemë, malet më tej e në qendër një grua buçkane që luante me kitarë. Qe një peizazh idilik, i kopjuar nga piktorët amatorë të Elbasanit prej kartolinave të paraluftës. Të tilla vepra "artistike" shiteshin në sheshin e Bezistanit ditën e pazarit dhe bliheshin nga fshatarët se ishin mjaft të lira dhe se u krijua një si farë mode. E kisha parë të njëjtën panoramë edhe në disa shtëpi të tjera çermenikase. Më kishin lënë pa mend kumritë në degët e pemëve, të cilat dëftenin se piktori amator nuk merakosej aspak për ligjet e perspektivës.

- Të pëlqen? - më pyeti plaku kur më pa se po e soditja. - Bukur e ka pikturuar.

- Sidomos kumritë, - shtova duke buzëqeshur.

- Ne për ato e mbajmë, - tha plaku, - se kumritë sjellin mbarësi.

I biri i nguli një vështrim të rreptë.

- Ato janë paragjykime, baba, - e qortoi faqe nesh.

- Si the? - e pyeti plaku duke zgjatur qafën që ta dëgjonte më mirë.

- Janë bestytini të mbetura nga koha e kaluar, kur njerëzit nuk e njihnin shkencën, as materializmin dialektik.

- Këta me shkollë, unë nuk i marr vesh fare, - u ankua plaku duke u kthyer nga ne.

Mirushi deshi të dinte prej nga ishte bashkëshortja e Kujtimit.

- Nga Bërzeshta, nëse ia keni dëgjuar emrin. E bija e Asim Koçiu.

- Vërtet? - u habit Mirushi. - Unë e njoh Asimin, madje kam genë te shtëpia e tij.

- Tani shpejt? - e pyeti Kujtimi që po dilte mik me një të panjohur pasi e kishte ftuar në shtëpi.

- Jo, në kohën e luftës. Derë trimash, - shtoi Mirushi. - A mbahet vjehëri?

- Shëndoshë e mirë, si molla në degë, - tha Kujtimi duke dalë në verandë. Kujtova

se do të thërriste bashkëshorten për t'i prezantuar mikun a të njohurin e babait, sikurse e donte etiketa, por hamendja ime nuk ishte e saktë. Dëgjova zërin e tij që iu shkreh dikujt:

- A ndive moj? Edhe sa do të presim akoma? Luani duart!

Kjo mënyrë adresimi ishte një formë e vjetër, e mbetur që nga kohët patriarkale, kur burrat e kishin për turp t'i thërrisnin gratë me emrin e tyre. Si ishte e mundur që edhe Kujtimi me shkollë të lartë, vazhdonte ta përdorte. Po ku ta dish, ndoshta i kishte shpërthyer nga vonesa. I zoti i shtëpisë u kthye pranë nesh duke buzëqeshur.

- E kemi pak ters kuzhinën... jashtë shtëpisë, - u shfajësua. - Po s'kemi ç'bëjmë, kushte rrethanore, si thuhet sot.

Gratë pritëshin të vinin në tryezë, pasi të mbaronin së gatuari.

Disa minuta më pas u dëgjua një gërvishtje e lehtë, si ato të maceve kur mbeten jashtë derës. Kujtimi kërkoi lejë dhe vrapoi të hapte një flegër të derës. U kthye duke mbajtur ndër duar dy pjata me sallatë mikse.

- A doni t'ju ndihmoj, - e pyeti Besimi, i gatshëm të ngrihej.

- Jo, jo, jo, asnjë të mos shqetësohet! - urdhëroi i zoti i shtëpisë. - Çdo gjë është gati.

Tryeza u mbush me meze dhe sallata të stinës dhe natyrisht me fergesën tradicionale, gjizë të skuqur me gjalpë, që nuk mungonte kurrë në tryezat çermenikase.

- Të ngrejmë një shëndet për Kujtimin dhe bashkëshorten! - propozoi Mirushi.

- E rregulloi gabimin komisari, - vërejti Besimi.

Në Çermenikë dollitë i quajnë "mirësi," gjetje mjaft e bukur, thjesht shqiptare.

- Dhe një mirësi për Asim Koçin dhe familjen e tij, - vazhdoi Mirushi duke u kthyer nga Kujtimi. - Do t'i thuash ke shumë të fala nga Mirush Kallami, se e di që më mban mend, - e porositi. - Si more, vajzën e Asimit paske marrë ti? Po si u pleksët? Me dashuri, besoj?

- Ja ca ashtu, ca kështu, - dredhoi kryetari mbyturazi, pa ndonjë dëshirë të jepte shkoqitje.

- Nga anët tona dashurisë i vjen radha pas fejesës, - këputi një romuz tjetër Besimi.

- Me ç'punë merret bashkëshortja? Ka ndonjë profesion? - e pyeta.

- Arsimitare në shkollën tonë tetëvjeçare, - u përgjigj Kujtimi.

Në derë u dëgjua një gërvishtje tjetër me majat e thonjëve dhe Kujtimi u ngrit menjëherë nga karrigia. Kanati i derës u hap përgjysmë dhe munda të shoh një tabaka me disa pjata pilafi, mbi të cilat avullonin llokma pule të pjekur. U duk sikur personi që i solli, deshi të hynte brenda, por Kujtimi e zuri hapësirën e lirë me trupin e tij dhe ia mori tabakanë nga duart. Disa përplasje takash që u dëgjuan nga salloni.

- Gruaja sot është forcë e madhe, - tha Kujtimi duke vendosur pjatat përpara të ftuarve. - Çuditë se si regjimet e kaluara nuk e çmonin vlerën e saj, kurse shoqëria jonë i dha vendin që meriton. - Përmendi me shifra përqindjen e grave në kooperativën e tyre si kuadro dhe si forca pune, po si e pa që shifrat s'e kishin vendin aty, e përfundoi me një shëndet hokatar: - E po të na rrojnë gratë!

Duke ngrënë e duke pirë, vërejtëm si me shaka se emancipimi ua kishte dyfishuar ngarkesën grave, mbasi tani punonin edhe jashtë shtëpisë. Kafetë i pimë vonë, pas mesit të natës.

- E prishim tani? - pyeti Mirushi, - se nesër ju e keni ditë pune dhe ne jemi për rrugë.

Të ftuarit nga fshati ikën, kurse ne miqtë e largët do të flinim aty. Tryeza u zbraz prej Kujtimit, i cili i shpinte deri te dera dhe aty dikush tjetër i mirrte.

Ndërkohë që i zoti i shtëpisë na pyeste nëse donim nga dy jastëkë, munda të shoh në gjysmë errësirën e sallorit kokën e një gruaje me flokë të dendur krela-krela që i sillte Kujtimit jorganët. Vura re se ekonomisti ishte i stërvitur për të hapur dhe për të shtruar çarçafët.

Në mëngjes u ngritëm herët për të kapur autobuzin urban të Librazhdit. Kujtimi na pyeti nëse donim të hanim mëngjes.

- Veç kafesë, asgjë tjetër, - iu përgjigj Mirushi.

Sa pa zbritur në dhomën përdhese, kryetari i këshillit zgjati kokën jashtë dritares dhe bëzani: "A ndive? Më duket se je vonë." "E di vetë orarin," u dëgjua një zë gruaje së jashtmi.

U përshëndetëm me babain e tij dhe dolëm në rrugë. Na erdhi pak si gjyq që s'mundëm të takonim as Nënë, as gruan e Kujtimit, po ku t'i dijë miku hallet e shtëpisë? Kujtimi u tregua i gatshëm të na përcillte deri te stacioni i urbanit, edhe pse Mirushi e luti të shkonte në punë se ndoshta e prisnin.

- E dinë që kam patur mysafirë, - e sqaroi Kujtimi.

Te sheshi dalluam Besimin që po vraponte drejt nesh. Mos vallë dhe ai kishte dalë të na përcillte?

- Drejtoresha ju fton për një takim me nxënësit me rastin e muajit të letërsisë, - na kumtoi Besimi.

Po të humbnim autobuzin urban për në Librazhd, duhet të rrinim gjithë ditën në pritje të ndonjë makine të rastit, të mos e përfillnim ftesën e tyre, do të binte keq në sy nga ana etike, do të na quanin mendjemëdhenj, mospërfillës. Na vuri në pozitë të ngushtë. Mirushi e gjeti zgjidhjen duke kthyer vështrimin nga unë. "Vendos!" thoshin sytë e tij.

- Tek ne nuk ka shkelur asnjë shkrimtar, - ngulmoi Besimi. - Nga Tirana jo e jo, por as nga rrethi s'na ka vizituar kush, prandaj do t'ju lutesha të na nderonit. Tetori ka disa detyrime, - vazhdoi Besimi.

Mirë. Le të ikte autobuzi. Po të kishim fat, mund të gjenim ndonjë kamion të tregëtisë, a të ndërimit. Vështrimet kureshtare të nxënësve e mësuesve po na shoqëronin në çdo hap, si të kishim ardhur nga një planet tjetër. Plani i takimit u ndryshua. Takimi do të zhvillohej në oborr, ngaqë personeli mësimor, pa përjashtim dhe gjithë nxënësit nuk donin ta humbnin rastin, të takoheshin me dy shkrimtarë. Këto fjala na kumtoi drejtoresha në drejtori.

Kaluan si në paradë arsimtarët e rreshtuar te dera e jashtme, duke i takuar me radhë. Pas nesh Kujtimi na prezantonte emrat e tyre dhe lëndët që jepnin. T.S. mësues fizike, B.T. mësuese biologjie, L.G. mësues gjeografie. Sapo i zgjatëm dorën një arsimitareje me flokë të zez krela-krela, dëgjuam pas zërin e Kujtimit:

- Myzejen Qaniu, bashkëshortja ime, mësuese e klasës së tretë.

Ajo e shigjetoj me një vështrim mbushur me xixa inati dhe pastaj iu shkreh:

- Tani u kujtove të më prezantosh? - Nuk po merakosej nëse dëgjonin koleget e saj. - A nuk i kishim këta miqtë mbrëmë mysafirë në shtëpinë tonë? - shfryri zemërimin që i vlonte përbrenda qysh prej çastit që i shoqi ia preu hovin të hynte në dhomë dhe të përshëndeste mysafirët.

Kryetari i Këshillit të Bashkuar, intelektual i ri me shkollë të lartë, u skuq deri rrëzë veshëve dhe mezi mundi të shqiptonte se Jeni ishte pak si e pamundur mbrëmë.

LETRA NGA BUZA E VARRIT

- **E**rdhi miku Sotirit, - tha Rubeni me ironi, posa diktoi Eqerem Brinjën te dera e kafenesë. - Shihe tani, kur të vijë këtu, - tha me zë të ulët.

Parashikimi i tij nuk doli. Eqeremi u drejtua te një grup tjetër, me të cilët ndoshta kishte lënë takim, ose ngaqë shoqëria e tyre i pëlqente më shumë se jona. Ndoshta edhe ai nuk e honepste praninë e Sotir Shurasë.

- Ç'lloj njeriu është ky Eqerem Brinja? - pyeta Ruben Budinën. - Ti duhet ta njohësh mirë se ke punuar nja pesë vjet tok me të.

Rubeni u ngërdhesh paksa mëdyshas.

- Nuk ka burrë nëne ta njohë Qaren deri në fund sikur të punojë tërë jetën me të. - E zbunonte qëllimisht emrin e tij, për t'iu qasur sa më afër karakterit të mbartësit. - Kam arritur në përfundim se ka karakter të rrëshqitshëm, si ekrani i televizorit kur nuk e mban figurën dhe s'mund të fiksohë asnjë tipar.

- Përcaktim origjinal, fytyrë e rrëshqitshme, - e komplimentoi Sotir Shuraja, pastaj menjëherë shtoi: - Dyshoj se ky surrat shkruan edhe letra anonime.

Pohimi i tij qe befasues dhe trallisës. Të kap një ndjenjë neverie kur zbulon një ves të tillë te shokët a të njohurit, sepse të duket më shumë se pabesi, denoncim politik.

- Mos fol marrëzira! - e qortoi Rubeni. - Ç'përfitim mund të nxjerrë prej tyre Qarja? Punën e ka të mirë, rrogën mesatarisht të lartë, problemet familjare të zgjidhura...

- E shihni sa naiv ka mbetur Rubeni? - tha sikur donte ta ndante befasinë e tij me ne. - Ku jeton ky? Letrat anonime sot shkruhen për të dëmtuar të tjerët, jo për të përfutur vetë. Ke dëgjuar të lavdërohet dikush në ndonjë letër asisoji?

- Uau! Mos do të thuash se shkruan letra edhe kundër shokëve të tij? - e pyeti me ironi.

- Eqeremi nuk ka shokë, por vetëm të njohur. Me shokun do të takohesh, të këmbesh dy fjalë, t'i besosh një intimitet a një sekret, t'i qash një hall, ndërsa për të njohurit kujtohesh veç kur të dalin përpara. Ndoshta më quan shok edhe mua, kurse unë nuk e fut as në rrethin e ngushtë, as në të gjerin. Edhe sikur të më ftojë të pimë një gotë, gjë që ai s'e bën kurrë, do të shpik një shkak të mos pranohet, se e di si më duket? I ftohtë dhe i pështirë, si salamandrat që dalin nga zgavrat kur bie shi.

- E tepron! - e qortoi Rubeni.

- E ka shpirtin të zi, për këdo vjell vrer, secilit i gjen gabime e të meta. Mjaft të nisë dikush ndonjë kritikë a pakënaqësi për X njeri dhe Eqremi ka borxh ta amplifikojë me shembuj konkretë nga përvoja e tij, ose nga ato që ka dëgjuar prej të tjerëve. Kur s'di asgjë, tund kokën duke buzëqeshur në mënyrë enigmatike, që ngërthen nënkuptimin se ia din ca gjëra të fshehta, po për natyrën e tyre diskrete, rezervohet t'i thotë hapur.

- Analiza juaj është e bukur si ese, por jo e saktë, - replikoi Rubeni, - Edhe fjalët e mira nuk i kursen.

- Po, për shefat, për sa kohë i ka mbi krye, ndërsa kur bien nga pozita, apo transferohen, i shëmb me kritika. Atëherë nis rrëfen konfliktet që ka patur me ta, për çështje pune, sigurisht. Martiri i cilitur dhe luftëtari parimor bashkëjetojnë për bukuri brenda lëkurës së tij. Theofrasti i ndante karakteret e njerëzve sipas përngjasimit që kanë me kafshët. Fytyrëmprehtët i karakterizonte dhelparakë, fytyrëgjerët të duruar dhe të butë, si buajt. Po ta kishte njohur

Eqeremin do t'i kishte shtrirë analogjitë edhe me botën e insekteve. Eqeremin shulak e qafëshkurtër kishte për ta futur në rendin e zhuzhakëve të bajgave. Nuk di, po sa herë e shoh, më ngjan si brumbull i veshur me kostum.

Qeshëm me krahasimin e tij të goditur.

- Je tepër kategorik. Si t'u shkrep të dyshosh për Qaren?

- E kam një indeks të fortë, - pohoi Sotiri. - Kur punoja në prokurori, erdhi një letër anonime kundër meje me këtë përmbajtje: "I ati polic i FBI në Amerikë, i biri prokuror i pushtetit popullor." Shefi i kuadrit me letër në dorë erdhi më pyeti. "E vërtetë?" "Po, i thashë, veçse i përket një kohe të perënduar dyzet a pesëdhjetë vite më parë. Im atë u kthye nga Amerika në vitin 1929 dhe në kohën e luftës e zgjodhën kryetar të këshillit të fshatit." Shefi tha se atë letër do ta kishte shkruar ndonjë nga miqtë a shokët e tu, që e dinte biografinë e familjes." Fillova të vras mendjen, të qëmtoj burimin. U kujtova se gjatë një bisede shoqërore i kisha thënë Eqeremit, se po ta dinte kush që im atë ka qenë polic në Amerikë do të më denonconte si armik. Madje dhe fjalët "i ati polic amerikan, i biri prokuror i pushtetit," ishin të miat. A nuk kam të drejtë të dyshoj?

Në atë minutë, ashtu siç ngjet rrallë në jetë, Eqerem Brinja u afrua në tryezën tonë, sa për të tymosur një cigare me shokët e vjetër, sikurse u shpreh. Pandeja se Sotiri do ta ndërronte temën e bisedës, kurse ai vazhdoi:

- Rubeni do të dijë shkaqet pse janë shtuar letrat anonime. Sociologët mund t'i renditin më mirë arsyet dhe shkaqet, kurse unë mendoj se letrat anonime vijnë nga të paafët, ambiciozët, smirzestë, të cilët i bren zilia sapo dëgjojnë se dikush ngrihet në përgjegjësi apo zë një farë posti. Këta janë shpirtërisht ekstremistë të majtë, ose hiqen të tillë, sepse nuk kanë kurrfarë ideali, veç të demaskojnë "armiqtë" e fshehur dhe t'i rrëzojnë. Pasi postojnë letrën presin veshëngrehur ç'do t'i ndodhë "të shenjuarit." Pasi dështon përçapja e parë, nisin letër tjetër, akoma më të fortë, me argumente më bindëse, mirëpo Rubeni s'do ta pranojë.

- Letrat anonime nuk janë pa vlerë. Ato ndihmojnë të dalë e drejta në shesh, - theksoi Rubeni.

Eqeremi e miratoi me sy e me kokë.

- Të isha unë pushtet, jepja urdhër të hidheshin në kosh pa i lexuar fare, - vazhdoi argumentimet Sotiri. - Derisa i mungon guximi të kritikojë hapur, ka karakter të dobët. Na qenka i zoti prapa ferrës, hedh gurin dhe fsheh dorën, natën vjell vrerë, ditën ju buzëqesh, - tha me duf.

- Nuk ka faj se prepotentët hakmerren edhe ndaj kritikave të drejta, prandaj detyrohen ta mbrojnë veten. Ama si qytetarë ata e kryejnë detyrën duke informuar instancat për çdo shkelje të ligjit, hatër, nepotizëm. Meqë u trembet pasojave, nuk e vë emrin. Letrat anonime goditin dukuri negative, - arsyetoi Rubeni.

- Edhe shoku Sotir e pranon këtë, - shtoi Eqeremi.

- Jo dukuri negative, - kundërshtoi Sotiri, - por individë të veçantë, ku shfryn ambicja, inatet personale, tarafet, rivalitete fisesh. Për mendimin tim ata mbjellin urrejtje, ndaj duhen izoluar si bartësit e mikrobeve të sëmundjeve ngjitëse.

- Sikur të zbulohet ndonjë autor letrash anonime dhe të demaskohet në shtyp, të tjerëve do t'u pritët hovi, - vërejta unë.

- Një thua ti? - ma priti Sotiri. - Sa të duash! Kur punoja në hetuesi, zbuluam një delenxhi nga rrethi i Burrelit që niste letra anonime çdo muaj. Ekspertiza e vërtetoi autorin. E thërritën dhe i kërkuan llogari për shpifjet. U mbrojt duke thënë "Unë kështu e dija. E shkrojta për të ndihmuar partinë." Struken pas kësaj fraze djallëzore dhe eja të heqësh vijën ndarëse midis militantizmit dhe ambicies, intrigues dhe shpifjes.

Eqeremi ngriti mëngën e xhaketës për të shikuar orën.

- Ka edhe njerëz që gënjejnë, ose shtrembërojnë faktet me qëllim diskreditimi, - pohoi Eqeremi.

- Qareja e di mirë, - e shigjetoi Sotiri, - se ai ç'do gjë ta thotë në sy, jo prapa krahëve...

Ironi, sa e lashtë je, aq e freskët mbetesh.

- Gjithsesi letrat me emra kanë më shumë peshë se anonimet, - ngulmoi Sotiri.

- Kush mund t'i shkruajë ato? Veç ndonjë që ndodhet buzë varrit,
- tha Rubeni, - se ai s'ka pse t'u trëmbet pasojave.

Qeshëm me replikën e tij.

- Mendo sa efekt do të kenë fjalët e tij, "Po ju shkruaj që nga buza e varrit..." Fillim mbresëlënës, tingëllon si amanet edhe sikur t'i ketë gënjeshtër, - e zhvilloi më tej idenë Sotir Zhurka.

* * *

Pas disa muajsh Rubeni më tha se Eqeremi ndodhej në spital në gjendje të rëndë.

- Kancer në mëlçinë e zezë, - shqiptoi ngadalë me pikëllim. - Duhet t'i shkojmë për vizitë, si thua?

- Pa tjetër. Mund të shkojmë që tani, po të jesh i lirë.

Ndërsa shkonim për në spital, e pyeta:

- E di Sotiri?

- E lajmërova, - tha dhe papritur filloi të qeshte. - E di ç'më tha? "Paska qenë kancer i zgjuar, po Qareja edhe atij do t'ia hedhë." Nuk pranoi të vinte. Cinik u tregua.

Qaren e gjetëm në gjendje kritike, të dobësuar tej mase. Hunda e holluar dhe veshët si gjethe të zverdhura i jepnin pamjen e një kufome të gjallë. I thamë shprehjet e zakonshme, kujtuam disa ngjarje komike dhe pas disa bisedave formale, u ngritëm të iknim duke i uruar shërim të shpejtë.

Ai buzëqeshi trishtueshëm.

- Iku jeta ime, - tha i pajtuar me fatin e tij të zi. - S'ka shpëtuar njeri nga kjo sëmundje që të mbaj shpresa unë... - Nuk ndihej në zërin e tij as mallëngjim, as keqardhje, si të fliste për dikë tjetër. - Guxho, - m'u lut, - dua ca zarfe të mirë. Po m'i solle më bën nder.

- Që sot, - i premtova.

Eqeremi po i përballonte çastet më të vështira të jetës me vetëpërmbytje fisnike. Mbase kjo vinte ngaqë vdekjen e dinte që s'mund ta shmangte. Tani donte t'u dërgonte letra miqve dhe dashamirësve të tij, si t'u thoshte "ma bëni hallall ndonjë fyerje a

ndonjë shprehje të pamatur.” Po njihja një anë tjetër të atij njeriu dhe pata një ndjenjë lehtësimi.

Bleva zarfet dhe në mbrëmje shkova sërish në spital. E gjeta kërrusur mbi krevat, me një copë karton mbi gjunjë, duke shkruar. I kredhur në botën e tij, nuk më vuri re kur iu afrova. Tabakë letre qenë shpërndarë mbi kuvertë, mbi komodinë, madje njëra kishte rënë në dysheme. E ngrita dhe padashur lexova: “Që nga shtrati i vdekjes ku po lëngoje e s’do të ngrihem më, e quaj detyrë morale t’ju vë në në dijeni se ...” Padashur kujtova fjalët e Sotirit te kafeneja.

- Ou! Paske ardhur ti? - Ma mori menjëherë letrën dhe e futi tok me të tjerat në një farë dosje.

I zgjata zarfet. Buzëqeshi me cepat e buzëve.

- Qumështin e nënës kam për t’u nxjerrë të gjithëve, - tha me mllef.

Në sinqeritetin e tij kishte urrejtje atavike për të gjithë “ata” që do të gjallonin pas tij duke gëzuar të mirat e jetës. Zbulimi më tronditi dhe më pezmatoi. S’kisha më asnjë dyshim se ai ishte një prej atyre smirzinjve të përjetshëm, ambicioz dhe hileqar pa skrupull, një njeri që ndërroi kushedi sa vende pune dhe askund nuk mundi të konfirmonte aftësitë e tij.

Më nuk shkela në spital. Nuk doja ta shihja. Prisja të dëgjoja lajmin e vdekjes. E merrni me mend habinë time sapo Rubeni më kumtoi se Qarja kishte dalë i shëruar prej spitalit. Diagnoza paskesh qenë e gabuar. Kishte patur ekinokok dhe pasi nxori nga goja ca si vezë të flashkëta pa lëvozhgë, e operuan dhe ai u kthye në shtëpi me këmbët e veta.

Miq e shokë u dyndën në shtëpinë e tij për ta uruar, njësoj si t’i kishte ikur vdekjes nga thonjtë. Ndërkohë letrat e tij drejtuar zyrave të kuadrit, ishin protokolluar dhe njëkohësisht ishin vënë në lëvizje për të verifikuar përmbajtjen e tyre. Denoncimet e Eqerem Brinjës “nga buza e varrit” sollën një pështjellim që s’mbahej mend në historinë e atij qyteti. Pastaj rrezja e verifikimeve pushtoi edhe rrethe të tjera. Njerëz që deri atëherë, s’u dihej ndonjë cen në biografi po dilnin të përlyer mos më keq. Natyrisht hetuan nëse personi në buzë

të varrit kishte shkarë tërësisht brenda tij, apo regëtinte akoma në shtratin e vdekjes. Një inspektor i Kryeministrisë, sapo mori vesh se autori i letrës ishte gjallë erdhi kastile nga Tirana për të kërkuar sqarime plotësuese rreth S.T. zëvendës ministër i ndërtimit që akuzohej se kishte njerëz të arratisur jashtë shtetit, me të cilët mbante lidhje të fshehta. Mirëpo pas hulumtive doli se ata ishin larguar qysh në kohën e Zogut. Inspektori u skandalizua kur mori vesh se S.T. Eqeremi e kishte kushëri nga ana e nënës. Pa marrë fare parasysht se Eqeremi ishte në periudhën e konvaleshencës, e shëmbi me kritika dhe qortime. I tha delenxhi, ambicioz, njeri pa moral, pa karakter, derisa shpifte për kushëririn e vet.

- Të isha në vend të tij do t'ju hidhja në gjyq për shpifje, - bërtiste ndërsa zbriste shkallët e verandës.

Eqeremi e ndiqte prapa duke lëpirë buzët e thara e duke iu lutur:
- Prit të sqarohemi, se nuk është tamam ashtu...

Ata që u ndodhën në dhomë e dëgjuan të fliste me vete. "Ja futa gozhdën vetes kësaj radhe... Po ç't'u desh or hajvan të vije emrin? Vazhdoje si më parë... Më mori në qafë diagnoza..."

A nga shkaku i tronditjes, a nga që ashtu e pati të shkrojtur, një atak kardiak e përcolli në botën e përtejme pas dy muajsh, megjithëse kurrë nuk ishte ankuar. Kësaj here shpalljet në muret dhe shtyllat e rrugëve nuk linin dyshim se kishte vdekur vërtet.

Në qytetin tonë të ndjerët përcillen në banesën e fundit, edhe prej atyre që s'kanë relata miqësore. E quajnë si detyrë morale, apo vrasin kohën, vështirë të përcaktohet. Për çudi e pamë edhe Sotirin t'i bashkohej kortezhit. Veç të shihje shprehjen e fytyrës së tij duke dëgjuar nekrologjinë e të ndjerit, mbushur me lavdërime e merita, të thoshe se burrë më të mirë nuk gjeje në këtë faqe dheu.

Pas vendosjes se kurorave mbi varrin e tij, lexova rastësisht emrat te gurët e varreve më të majtë dhe më të djathtë të tij. Një quhej Selfo Kurteshi, tjetri Koço Dhjaku.

Sotiri më ra lehtë me bërryl dhe më pëshpëriti në vesh:

- Këta do ta pësojnë të parët prej Qares. Prite tani kur të vijë ndonjë letër anonime nga ajo botë...

DISKUTIMI QË NGRITI SALLËN NË KËMBË

Në sheshin pa njerëz të atij farë qyteti, syri më kapi një fytyrë të njohur, tiparet e së cilës ishin rezervuar diku në skutat e trurit tim. Nuk isha plotësisht i sigurt nëse ai ishte Janush Kaleshi, shoku im i gjimnazit, prandaj për t'u siguruar e thërrita me emër. Sapo ktheu kokën, renda drejt tij

- Janush, të kapa!
- Po ti nga dole këtu? - u habit ai.
- Me shërbim prej gazetës.

Pas vitesh që nuk ishim parë, takimi ynë ishte i përmallshëm. Janushin e kisha njohur në fillimet e viteve '50, qysh kur ishim të dy letrarë të rinj. Ai kishte botuar nja dy skica poetike në faqen letrare të gazetës "Rinia" dhe për hir të tyre e kishin pranuar në listën e kufizuar të letrarëve të rinj. Sa herë takoheshim më rrëfente subjektet e tregimeve, novelave, romaneve që i buisnin në mendje dhe unë e shihja si shkrimtar me perspektivë. Planet e tij krijuese më mrekullonin me larminë dhe gjerësinë e tyre, aq sa ia kisha zilinë. Pasi mbaroi fakultetin, e kishin emëruar mësues në një rreth të veriut dhe që asaj kohe firma e tij humbi nga faqet e shtypit letrar. Nuk arrija ta kuptoja se si iu tret pasioni i zjarrtë për letërsinë dhe pse hoqi dorë. Dëgjova se pasi ishte martuar dhe stabilizuar në R. nuk po bënte asnjë përpjekje të transferohej në Tiranë a në vendlindjen e tij. Tani, pas një çerek shekulli pamja e tij fizike ishte pak më ndryshe nga ajo që mbaja mend. Ishte mbushur, rrumbullakosur,

kishte lëshuar pak bark, po ndërkohë fytyra e tij ruante po atë shprehje çiltërsie dhe humori të viteve të rinisë. I dashur sinqerisht

- Sonte do të vish nga "kulla" ime, - më ftoi përzemërsisht.

Apartamentin e quante "kullë" njësoj si vendasit, por pas njëzet e pesë vjetësh ishte e natyrshme t'i përvetësonte disa shprehje tipike. Sapo vuri re mëdyshjen time, shtoi:

- Mos e diskuto, edhe po të kesh ndonjë detyrim, a takim tjetër, anulloje. Të lutem mos ma prish. Nuk bezdisemi, mbasi gruaja të njeh nga përshkrimet e mia dhe domosdo, nesër do t'u mburret shoqeve se mbrëmë kemi patur për darkë një mysafir të nderuar, një gazetar nga Tirana. Provinca i ka këto, ti e di. Kam kënaqësinë t'ju vë në dijeni se si familje gëzojmë standardin më demokratik, domethënë dy dhoma e një kuzhinë për katër veta, pra për një mysafir, kemi vend boll.

- Nuk dua t'ju ngushtoj. Për të fjetur do të kthehem në hotel, - ngulmova.

- Derisa dhomën e ke të paguar nga shteti, pse jo. Me shërbim nga gazeta?

Pohova me kokë.

- Për të parë sukseset e rrethit tonë? - pyeti. - Si i mbushni ato gazeta me reportazhe idiote? Po megjithatë faleminderit për kohën që na kurseni; asnjëri s'e merr mundimin t'i lexojë. Kjo gjini, falë ndihmesës së gazetarëve të rëndomtë, u diskreditua tej mase, sa tani duhet një emërtim i ri, se i vjetri e humbi kuptimin. Mendoj se mbresat më të rëndësishme dhe më të vyera janë ato që nuk botohen, apo jo?

Kishte ruajtur po atë mënyrë të foluri, ku ironia ishte krejt organike. Po më vinte paksa çudi që po më fliste pa drojtje, sikur të ishim ndarë para pak kohësh, pa u orvatur të tatonte pulsën politik sikurse ngjet zakonisht midis atyre që janë ndarë prej vitesh.

Në darkë e pyeta si po shkonte krijimtaria e tij letrare, ç'u bë me projektet e tij të shumta?

- Mbeta letrar i ri, nuk munda të ecja më tej, s'kisha forca, - tha pa ndonjë lloj pezmatimi. - Tani që kam mundësi ta gjykoj

veprimtarinë time letrare nga një distancë kohe e largët, dyshoj se më kanë çmuar më tepër nga sa meritoja. Më mungonte talenti i vërtetë.

- Ndoshta ju la pasdore provinca, - e justifikova.

- Nuk ka faj provinca. E kam analizuar veten gjatë këtyre viteve dhe zbulova se i përkas kategorisë shoqërore më amorfe, që nuk ka pasion për asgjë të veçantë. Disa nga shokët e mi që u emëruan në Institutin e Folklorit, sot janë etnografë, ndërsa ata që i shpuri kalemi te pallatet e pionierëve, sot i ke shkrintarë për fëmijë. Shembull kemi Stafën, ti e njeh. Sa ishte drejtor në Teatrin e Kukullave, shkruante pjesë për të, iku prej andej, as i bie më ndërmend për to.

- Së paku, a ju jep kënaqësi profesioni juaj? - e pyeta.

- Po, - tha Janushi, - jo se po përhap dritën e arsimit në zonat e thella, siç rokanisin gazetatat për propagandë. Ndiej kënaqësi kur vë re dy tre nxënës që kanë etje për dituri, që duan të shkojnë tej programit të ngushtë të librit dhe të shkollës. Sa janë ata? Në rastin më të mirë përbëjnë një të dhjetën e nxënësve, por në shkallë rrethi a republike janë një forcë e aftë për ta nxjerrë shoqërinë tonë nga paragjykimet ku është zhytur sot. Historikisht sistemi socialist është shumë i ri, po ndërkohë është rutinizuar, plakur, sklerotizuar jashtëzakonisht shpejt. Ti si mendon? Jo, nuk ka nevojë ta thuash me fjalë, se çdo njeri që ka dy fije mend, në këtë konkluzion arrin. Pas çlirimit, Shqipëria kishte ministrat me moshën mesatare më të re në gjithë Evropën, sot raporti është përmbysur krejt në anën e kundërt, sundon gjerondokracia. Ne kemi udhëheqësit më të plakur se çdo vend tjetër i botës. Shembëm patriarkalizmin fshatar e ndërkohë vendosëm një lloj patriarkati partiak dhe etatist. A mund të priten mendime të reja nga kokat e vjetra? Ky është realiteti ynë i "mrekullueshëm."

- Mjaft tani, me këto biseda, se e mërzite këtë mikun, - e qortoi Ida, - thuaji ndonjë gjë të gëzuar.

- Faleminderit Ida, - i tha Janushi duke përpjekur gotën me timen.

- Na mori përpara vrundulli i diskutimit politik dhe harruam gjërat e tjera. E di Naim, unë ndihem i qetë, madje krenar se detyrën time

ndaj shoqërisë e kreve, qëkur i fala partisë një kuadër të lartë. Dhe çfarë kuadri? S'e gjen dot me qiri në gjithë kampin socialist! - ai ngriti dorën sipër kokës për të dhënë idenë se kuadri ishte pjesë e sferave të larta.

Për kë e kishte fjalën? Fëmijët e tij ishin ende të mitur, gruaja arsimitare e thjeshtë, ndonjë fis i tij me mbiemrin Kaleshi nuk ishte ngjitur në shkallët e larta të burokracisë. Nuk më la të mendohesha gjatë.

- Nuk ke si ta gjesh. Edhe Edipi të ngjallej, nuk do të arrinte ta zbërthente enigmën, - tha duke e vënë theksin logjik mbi pjesën e fundit. - A propo, a keni qenë në Konferencën Kombëtare të Grave? Më duket sikur ju kam parë në Tv.

- Po, isha i dërguar special i gazetës.

- E mbani mend Daven, një malësore veshur me kostum folklorik?

- Si jo? Diskutimi i saj e ngriti sallën në këmbë, - i thashë dhe menjëherë kujtesa më shpuri në sallën e Konferencës Kombëtare të Grave disa vite më parë.

- Po nuk besoj ta dini se diskutimin e saj e përgatita unë?

- Ju? - e pyeta i habitur. - Ah, domethënë vazhdoni të shkruani...

- Produkte burokratike me ngjyrimet letrare, - i ra shkurt Janushi, - përshëndetje, diskutime, përrurime, dekorime e të tjera kësilloj. Me sa duket shijet primitive të autoriteteve lokale kënaqen nga zhgarravinat e mia. Një farë përfitimi e kam edhe unë, sepse marr një a dy ditë pushim. Nuk pyes kurrë se për kë e duan, a kush do ta lexojë, mbasi kjo s'më përket mua. Më porositën të shkruaja një diskutimin për një delegate në Konferencën Kombëtare të Grave dhe unë u tregova i gatshëm. Ta kisha ditur se diskutimin po e përgatisja për një bibë si Davë Prençi, do më ishte shterur frymëzimi që në paragrafin e parë. A e njuh "shoqen Davë?" Më mirë që nuk e paske njohur. Edhe pesëqind vjet pas Kopernikut Dava nuk beson se toka rrotullohet rreth diellit. Disa vite pasi kishte kryer shkollën tetëvjeçare, më takoi në rrugë e më pyeti: "Presor, a përnjimend rrotullohet toka, si na mësonit në shkollë? Po unë e shoh, he burrë, diellin që lind në shkrep të Lumit, ecën për qiell e perëndon në

Ndërfan.” Kurse tani rri e ngrëfosur dhe çka është më e bukura ka filluar të marrë poza prej udhëheqësi. Mban kostum dopiopetë, vesh funde të gjata dhe bluza, dhe këpucë të sheshta, ashtu si shoqet e nomenklaturës. S’ke ide sa e shkathët është për të kopjuar. Mendova se trajektorja e Davës do të ishte e shkurtër, trashësia e Davës do të zbulohet shpejt dhe rënia do të ishte e befte, mirëpo u gabova. Pësova shgënjim llahtarisës. Dava nuk stonoi aspak midis tyre, madje vazhdon ngjitjen. Pse? Sepse administrata jonë, ka të njëjtën kuotë me Davën, dua të them nën nivelin e detit.

* * *

Delegatja e veshur me kostum folklorik u ngjit në foltore, pa tërhequr vëmendjen e sallës, sepse ishte krejt e panjohur dhe emri i saj s’u ndillte kurrëgjë. Diskutimin e nisi me fraza të zakonshme për jetën e lumtur që gëzojnë femrat e krahinës R. nën diellin jetëdhënës të partisë duke sjellë ca shifra që nuk ngjallën asnjë interes. Theksoi se gratë duhet t’i ruanin me vigjilencë fitoret e arritura, mbasi ka armiq të jashtëm dhe të brendshëm. Shtoi se po të guxonte armiku të shkelte tokën tonë “gur e strall do marrë zjarr, me ua djeg tokën nën kambë, me i ba shkumb e hi, sa pa lindur dielli i ri.” Fjalët e saj të rimuara i entuziazmuan delegatet sa breshëri i duartrokitjeve e mbushi hapësirën e sallës nga dyshemeja në tavan dhe folësja mbeti pakëz e nemitur nga e papritura. Sapo vala e duartrokitjeve u shua ca nga ca, anëtari i Byrosë Politike që drejtonte seancën, nisi t’i përplaste edhe njëherë pëllëmbët fort me shikimin nga foltorja, salla shpërtheu në ovacione, duke u ngritur në këmbë e duke këngëzuar parullën e njohur se ata përherë ishin gati, po për çfarë, nuk përcaktohej qartë dhe mund ta interpretoje si të doje.

Dava mori krahë nga ovacionet dhe e vazhdoi diskutimin me zjarr, duke lëvizur duart, sa me gishta hapur e sa me grusht, sikurse e donte përmbajtja. Duartrokitje në formë marshi luftarak e shoqëruan delegatën nga tribuna deri sa përshkoi tre të katërtat e sallës për t’u ulur në vendin e vet. Përskuqja e fytyrës dhe djersa e

lehtë tregonin se emocionet i kishin shpërthyer edhe mbi lëkurë. Ndjenja e suksesit e ndihmoi të përballonte shndritjen e flasheve dhe shkrepjet e aparateve të fotoreporterëve pa shfaqur tronditjen më të vogël.

Shoku P.P. që drejtonte seancën, e ndau entuziazmin me Presidenten e Bashkimit të grave që kishte në krah.

- Diskutim i bukur, më i bukuri që kemi dëgjuar deri tani!

Shoqja Teuta ia veshi suksesin punës së madhe që kryente organizata e tyre për ngritjen e nivelit të grave nga ana ideologjike.

- Nga ç'rreth vjen kjo delegatja? - u interesua P.P.

Presidentja, falë përvojës së pasur në kësi çështjesh, i hodhi një sy të shpejtë listës që kishte përpara.

- Nga rrethi R. - dhe pastaj t'i shpjegonte se atje kishte diferenca të theksuara midis ndërgjegjes politike të përparuar dhe ndërgjegjes shoqërore patriarkale.

Nga zhurma që vinte prej sallës, drejtuesi i seancës shoku P.P. u kujtua t'ia jepte fjalën delegates që vinte në radhë pas Davë Prençit. Në foltore doli një shoqe me veshje qytetare dhe me flokë të prerë shkurt. Nuk ishte as moderne, as folklorike, por diçka e ndërmjetme. Diskutimi i saj me fraza retorike për rolin e grave në shoqëri, e humbi interesin shpejt. Kollitje, teshtitje, kërcitje karrigesh e zhurma këmbësh nisën të vinin me zhaurimë të pandërprerë si dallgë deti. Ndoshta u duk edhe ca më i dobët për shkak të kontrastit me diskutim e zjarrtë dhe origjinal të shoqes Davë.

- Njëzet minuta pushim, - deklaroi shoku P.P.

Pas gjithë atij entuziazmi, delegatët dhe të ftuarit ndienin nevojë të shkreheshin, të zbraznin emocionet dhe qeskat e urinës. Ndërsa delegatët e platesë dolën në oborr të ngroheshin në diell, ata të presidiumit u tërhoqën prapa skenës, ku ishte sajuar një farë salloni shlodhës me kolltuqe të butë, me pije freskuese, bufë të pasur dhe kafë ekspres.

- Emancipimi i femrës po sjell frutet e veta dhe si shembull mund të sjell diskutimin e shoqes Davë, - tha Ministri i Arsimit Manol Hëna.

- Emancipimi ka disa dhjetëvjeçarë që ka filluar, - replikoi Presidentja e Grave, pa e lejuar ministrin të mohonte ose të zbehte meritat e organizatës.

- Emancipimi ynë vazhdon në formë spiraleje, vjen duke u zgjeruar dhe njëkohësisht duke u ngritur...- u mbrojti Ministri i Arsimit duke shikuar vjedhurazi reagimin e anëtarit të Byrosë Politike.

Sapo ai pohoi me kokë, shoqja Teuta nxitoi të konformohej me ministrin, sepse fërkimi përtej atij caku, nuk i interesonte. Në shtator do t'i kërkonte disa bursa për miqtë e saj nga fondi i tij i veçantë dhe ai pa mëdyshje do t'ia plotësonte kërkesat.

- Të tilla diskutime na duhen, - vazhdoi mendimin shoku P.P. - Sa bukur i tha ato fjalët për barutin. Më pëlqeu edhe si mendim - sapo thoshte fjalën mendim, ai bashkonte majat e gishtave dhe cekte tëmthin ku besonte se ndodheshin mendimet. - Hë, si e tha atë fjalë, se do ta mbajnë barutin të thatë dhe nuk do të lejojmë t'i vijë igrasi nga asnjë anë. Fjalë me kuptim të thellë, shoku ministër. Si i quani ju...

- Metaforë, - shpjegoi ministri dhe nga frika se mos nuk kuptohej, shtoi, - ose e folur e figurshme.

- Jo, kjo nuk është e folur e figurshme, as ... si e thatë ju atë fjalë? Metaferrë? - kundërshtoi anëtari i Byrosë duke e quajtur për detyrë të jepte ndihmesën e vet në fushën e estetikës. -Pse e them këtë? Sepse aty kemi kuptim me vlera politike dhe ideologjike. Duhet bërë ky dallim, apo jo? - e qortoi ministrin që tjetër herë të thellohej si duhej.

- Po, - u akordua ministri menjëherë.

- Dhe patriotike, - shtoi shoqja Presidente.

- Po, edhe patriotike, sidomos patriotike, - ndërhyri zëvendëskryeministri MN që mbulonte arsimin, kulturën dhe shëndetësinë. - Në gjirin e popullit ka thesare, na mëson partia, por duhen zbuluar, duhen evidencuar, duhen ngritur, u duhet dhënë dora. Posi.

- More po ishte bilbil nga goja! Çfarë shkollë ka kryer? - pyeti P.P.

Sadoqë ai pyeti në përgjithësi, të gjitha vështrimet u kryqëzuan mbi Manol Hënën, sikur i ziu ministër i arsimit duhet të dinte përmendësh arsimimin e çdo delegateje.

- Të pyesim sekretarin e rrethit, shokun Fatmir. - Ministri trupdrejtë e i shkathët si sportist, iu afrua banakut.

Ndërkohë shoku PP. dërgoi një nga rojet e tij personale të thërriste pak atë delegaten, sepse donte ta takonte dhe ta uronte.

Raporti i Fatmirit ishte paksa i zyrtë. Pasi ngeli në klasën e shtatë, Dava e lehtësoi barrën duke ndjekur shkollën e natës, ku nuk mbahet mend të ketë ngelur ndonjë nxënës që nga çlirimi e këtij, me përjashtim të atyre që e kanë lënë vetë. Ministrit iu duk pak shkolla tëtëvjeçare prandaj raportoi se ajo vazhdonte vitin e dytë apo të tretë të shkollës bujqësore.

- Kështu shoku Fatmir? - pyeti ai.

Fatmir Shukja e miratoi me kokë.

- Shkollat e mesme bujqësore po hapin perspektivë të ndritur për zhvillimin e pentarisë, vreshtarisë, blegtorisë, - ndërhyri zëvendëskryeministri MN. - Frutin e kësaj shkolle e pamë konkretisht me diskutimin e delegates mbushur me flakë baroti dhe devotshmëri.

- Mendoni pak sikur t'i kemi të gjitha mjelëset me shkollë të mesme, - tha PP duke vënë gishtrinjte e mbledhur te tëmthi. - Atëherë qumështi do rrjedhë lumë, se ato me shkollë dinë t'i trajtojnë lopët. Nuk thotë kot partia se bujqësia jonë ka perspektiva të ndritura.

- Na nderoi shoqja... shoqja... sa... si e quanin? Se më doli nga mendja, - u ankua Presidentja e gjithë grave.

- Davë Prençi, - tha Fatmiri.

- Ç' përgjegjësi ka? - U interesua zëvendëskryeministri.

- Brigadiere, në brigadën e fushës, - i sqaroi shoku i rrethit.

- Mrekulli! - u entuziazmuva Presidentja e Grave. - Pa shih, një kooperativiste e thjeshtë dhe arrin të shfaqë të tilla mendime.

- Jo, shoqja Teuta. Çfarë mrekullie? Për faqe të zezë thuaj, derisa nuk dinë të çmojnë kuadrot, - kundërshtoi me mllef shoku PP, që

nga kolltuku sfungjeroz, veshur me belluz ngjyrë mjalti. Fytyra e tij e vrenjtur tregonte se ishte vërtet i indinjuar.

- Desha të them...

- Më falni shoqja Presidente, por si Sekretari i parë, si Kryetari i komitetit, na hëngër veshët, kërkojnë vazhdimisht kuadro prej Tirane, ndërkohë që i kanë para syve dhe nuk i çmojnë. Kur thotë partia gratë janë forcë e madhe, duhet të dijmë ta zbërthejmë këtë pohim të mos e themi në hava, si papagall, - tha ai.

Dave Prençi erdhi dhe qëndroi para shokut PP me duart mbi bark, si nuse fshati që nusëron.

- Çdo të na thoni shoqja Davë? - e pyeti shoku PP duke buzëqeshur.

- Hiç! - sepse vërtet s'kishte për të thënë kurrjë.

- Si hiç?! - e pyeti paksa i habitur që tani ajo ishte ngulfatur e s'po ligjëronte si në foltore.

- Kurrjë, ça po di vetë? - tha me sinqeritet Dava.

Presidentja e Grave i hodhi gomën e shpëtimit për ta nxjerrë nga situata e vështirë, duke e justifikuar Davën se ishte ende nën peshën e emocioneve.

Pasi e falënderoi në emër të Byrosë për zjarrin e saj revolucionar, ai e pyeti:

- Ku punoni ju shoqja Prençi?

- Ne? Në fushë, - tha shkurt ajo.

- Desha të di çfarë pune? Me se mereni konkretisht?

Dava iu përgjigj me shenja se i binte shatit.

- Shoku Fatmir sikur tha që jeni brigadiere, - u kujtua presidentja.

- Po, jo, se brigadier kena Nrecën. Nrec Gjoni e quajnë, - shtoi ajo.

- Në fakt ne e kemi propozuar dhe sapo të mblidhet kryesia, do të vendosë, - i sqaroi shoku i rrethit. Tani u kuptua mirëfilli se atë farë pozite e sajoi aty për aty, për të zbutur përshtypjen e keqe të shokëve udhëheqës.

- Shiheni pak këtë problem, bisedo me shokët kur të kthehesh, - e porositi PP Fatmirin.

- Jo, po s'e deshët ju, e marrim ne, - tha me të qeshur Presidentja, për të rregulluar gafën e lëshuar pak më parë.

Ra për së treti zilja për fillimin e seancës tjetër.

- Modeste dhe shumë e përmbajtur, - e cilësoi shoku PP, i cili edhe vetë nuk shquhej për zgjuarësi, veç besnikërisë ndaj udhëheqësit. - Të tillë njerëz na duhen.

Duke shkuar drejt vendit të saj, Dava ndiente shikimet përpirëse të meshkujve, ndërsa nga zonat e gjinisë femërore vinin shkëndija përçmimi, mbushur plot zili dhe hipokrizi.

Kolegët e mi gazetarë, duke u mbështetur në ngjarje analoge, parashihnin se malësorja me veshje folklorike do t'u ngjitej shpejt shkallëve burokratike. I atij mendimi isha edhe unë.

* * *

Janushi vazhdoi:

- Telefonat kërcitën pa mbaruar ende Konferenca e Grave. Fatmiri dhe damazët e tjerë që shoqëronin delegatet, raportuan se shokët udhëheqës u mahnitën nga diskutimi i Davës me figura luftarake, ku spikaste dashuria e pakufishme për partinë dhe përbetimi për ta derdhur gjakun rrëke. Autoritetet e vendit i buzëqeshnin njeri-tjetrit që delegatja kish lënë nam për pjekuri ideore dhe politike, refleksi i punës së tyre. Shokët udhëheqës në sallonin e rezervuar e kishin përgëzuar dhe ishin befasuar nga zgjuarësia e saj. Tani duhej shpënë në vend porosia e shokut PP, që t'i tregonin se dinin t'i çmonin kuadrot Mirëpo ku ta shpinin Davën? Ta ngrinin brigadiere, u dukej pak, ta emëronin kryetare kooperative, e dinin që nuk ishte e aftë. Duhet t'i gjenin një punë në përshtatje me paaftësitë e saj. Instrukto e organizatës së grave në rreth, punë pa punë, ndihmëse e Djellës. Pas gjashtë muajsh Davë Prenci e transferuan në Tiranë, drejtoreshë të Arsimit pranë Kryeministrisë. Pandeha se aq e pati apogjeun, sepse aty do t'ia diktonin kapacitetin e trurit dhe do tëllonte të tatëpjetën. U gabova rëndë. Pas një viti e ngritën zëvendës ministre të Industrisë ku gjendet edhe sot, falë diskutimit që i përgatita unë... një mësues fshati.

- Ti po bën humor...

- Jo, për nder! E kam kopjen këtu, do ta shohësh? Tani që kam përvetësuar sistemin figurativ të baladave dhe elegjive, mbushur me strall, shkrep, agzot e barot, këto lloj hartimesh i kryej lehtësisht, pa u zoritur, si duke ngrënë bukë e djathë. Ai diskutim e ndihmoi Davën të ngrihej, të hynte në radhën e atyre emri i të cilëve paraprihet nga epiteti "shoku," Filan ose "shoqja" Fëstëku. Shpesh kam menduar për transformimim e hatashëm që pësoi kuptimi i fjalës shok tek ne gjatë këtyre dyzet vjetëve. Në Shqipëri këtë fjalë e prunë komunistët për të shprehur konceptin e barazisë midis masës dhe prijsave, por edhe si kundërshti ndaj titujve të trashëguar aga, bej, bajraktar, arkond, pasha, shkëlqesi, hirësi, madhëri, që përdorshin gjatë regjimit të vjetër. Mirëpo guxo të thuash tani emrin e një udhëheqësi pa vënë përpara epitetin "shok" dhe menjëherë e ndien si të kryqëzojnë me vështrime armiqësore, ose të kundrojnë me habi si njeri jo normal. Pse? Sepse tani fjala shok, ka zëvendësuar titullin shkëlqesi, lartësi. Ndërsa fjala zotni apo zotëri, sot ruhet vetëm në një segment të administratës, në proceset gjyqësore. Si ngjau kjo? Gjyqtarët protestonin, tërboheshin, sa herë i pandehuri, për forcë zakoni u adresojë me epitetin "shok." Nga dyshimi a drojtja se mos implikoheshin si shokë të tij, pra kundërshtarë të regjimit, apo keqbërës, i bërtisnin: "Nuk jam shoku yt, nuk jam shok me ty, prandaj rrudhe gojën!" Kështu pra, tani titullin zotëri e gëzojnë vetëm gjyqtarët tanë popullorë.

Më befaso! Mprehtësia e tij për disa dukuri të jetës sonë të përditshme, si analiza për fjalën "shok," me të cilin na ishte mësuar veshi, ose e pranonim si të mirëqenë pa u thelluar te kuptimi i ri. Buzëqeshjen time miratuese ai e mori sikur po vija në dyshim thëniet e tij.

- Nuk e beson trajektoren e Davës, më fal, të shoqes Davë? - më pyeti Janushi. -. Se mos është e vetmja që ngrihet në post me diskutimet e të tjerëve? Në një vend ku njerëzit vlerësohen nga fjalët dhe ngrihen në përgjegjësi nga opinionet e udhëheqësve, dukuri të

tilla do të ketë vazhdimisht, - tha i pezmatuar. E meriton plotësisht postin, madje mund të shkojë edhe më lart

- Mos ju ka pushtuar një lloj pesimizmi?

- Jo, nuk besoj, por e shoh realitetin me sy të zhveshur. Jam i zhgënjyer, sepse prej më se katër dekadash intelektualët shqiptarë, po udhëhiqen nga një grup injorantësh, nga njerëz pa shkollë, duke filluar që nga ... nuk po themi emra, - e ndërpreu mendimin.

- Sidoqoftë dole i fituar, - i thashë. - Me një diskutim që nuk deshi veçse dy tri orë punë, sigurove mirënjohjen e shoqes Davë dhe tani mund t'i trokasësh në shtëpi, a në zyrë në mes të ditës a në mes të natës.

Nisi të qeshte me zë të lartë.

- Mirënjohje the ti? Oh, ç'më kënaqe! Mos prit mirënjohje nga injorantët. Nuk më sheh dot me sy, madje më urren, sepse unë i kujtoj periudhën kur e mbështillte tërvokun me shami dhe i binte shatit në arë. A mund të pranojë mendja e flashkët e Davës se pozitat i fitoi nga diskutimi im? Tani e ka parë se edhe ata rreth saj, janë të një niveli me të, një okë e pesë, një okë pa pesë. Se mos është përjashtim? Ne gjithandej jemi të rrethuar nga Davet... Gëzuar. Sa mirë që u takuam! Sa mirë që erdhe! Shkarkova mllefën e brendshëm, sepse ndryshe kisha rrezik të pëlcisja si gështenja e paçarë në prush.

Kisha mbetur një nga konfidentët e tij edhe pas shumë vite ndarjesh.



LISTA E GJATË E BORXHLINJVE

Klubi i gazetarëve të kryeqytetit, një hangar i shëmtuar, i kredhur në gjysmë errësirë, ngaqë drita natyrale hynte vetëm nëpërmjet xhamllëkut të portës, i mbante dritat elektrike ndezur edhe ditën me diell. Matanë banakut fytyra e vrenjtur e Vandush Shtëmbarit, hetonte sallën dhe kërkesat e klientëve. Ai kryente detyrën e barmanit, të kafexhiut dhe të kuzhinierit për meze e ushqime të gatshme, si vezë, djathë e turshi, kur klientët donin t'i shoqëronin.

Sado që vidhte ngapak në gramaturë, prej klubit fitonte pak, për shkak të xhiros së kufizuar. Nga kafet pesë lekshe nuk kishe asnjë leverdi, mbasi mundin e kishin të madh, fitimin të vogël dhe nuk ngrinin peshë në xhiron ditore. Syri i mprehtë i Vandushit vuri re se gazetarët në përgjithësi e kishin oreksin mjaft të mirë, hanin çdo lloj mezeje, i fshinin pjatat me tulin e bukës, pinin çdo lloj pije, me ngjyra e pa ngjyra dhe birrën e rrëkëllenin daç me shishe, daç me kriklla. Kur vinin në banak të paguanin me para të thata, mroleshin, bubronin nëpër xhepa, numëronin qindarkat dhe kur nuk u arrinin thoshnin se kusurin do ta sillnin më vonë. Sa herë i shihte ngushtë, Vandushi ua lehtësonte barrën duke u thënë: “nuk priset asgjë, të hollat sillini nesër.” Kjo sjellje u çmua nga klientët e rregullt që e hanin sillën në klub dhe sidomos nga ata që vinin me grupe pas. Asnjë tregtar i ndershëm nuk i beson kujtesës dhe kësisoj Vandushi filloi të shënonte në një fletore borxhet e tyre të vogla, sadoqë kjo

binte në kundërshtim flagrant me parimet dhe ligjet e ushqimit social. Në çdo faqe ai shënonte emrin dhe mbiemrin e gazetarit, datën, çeshitet që kishte konsumuar dhe çmimet e tyre.

Xhiroja u rrit në mënyrë të befashisme. Gazetarët paskeshin qenë të thekur për të ngrënë, e sidomos për të pirë veresie. Madje as klubi nuk u dukej më i shëmtuar, as fytyra e vrerosur e Vandushit aq e zyrtë. Ishte kënaqësi të shkoje në klub vetëm, ose me shokë, të haje e të pije pa asnjë metelik në xhep sa të mufateshe dhe pastaj të largohesh duke i dhënë shenjë bufetieri: "shkruaji në defter!"

Në datat 2 dhe 17 të çdo muaji, ditët e bekuara të rrogave, shumë prej tyre ktheheshin në klub për të larë borxhet e vjetra. Askush nuk mbante mend me saktësi sa kafe e sa gota raki kishte konsumuar, po ata me ndërgjegje të pastër e pranonin se edhe Vandushit i takonte një shpërblim i vogël në pajtim me logjikën tregtare.

Mirëpo pas disa muajsh Vandushi vuri re se disa gazetarë të shquar, e ndërkohë konsumatorë të zellshëm si Kanan Rodoni, Adriatik Shpuza, Masar Tafili, Themë Thëngjilli, Mersin Tashuli, etj. nuk kujtoheshin t'i shlyenin detyrimet, as ditën e rrogës, as më vonë. Vandushi i paralajmëroi se pa larë borxhet e vjetra, nuk do t'u jepte më veresie. Si përfundim ata filluan t'i përvidheshin klubit të gazetarëve dhe kujdestarit të tij Vandush Shtëmbarit. Madje një prej tyre, Masar Tafili, i propozoi Drejtorit të Ushqimit Social, ta zëvendësonin Shtëmbarin me një banakier tjetër që ta kishte fytyrën më simpatike në harmoni me emrin e klubit.

Vandushi nuk dinte si të vepronte. Po t'ua ndërpriste kredinë, ato të holla s'kishte për t'i shtënë kurrë në xhep, të vazhdonte më tej me veresie, kishte rrezik të fundosej më thellë. Mendoi t'i vinte në sedër, duke iu lutur shokëve të tyre më të ngushtë: "Thuaji Masarit të paguajë ato që më detyrohet, se vetë s'po kujtohet." "Hidhi ndonjë fjalë Kananit për llogarinë që ka lënë hapur." "Kujtojeni Cekon se ai qeras shokët me paratë e mia." Mirëpo i ziu Vandush nuk e dinte se gazetarët e rëndomtë janë faqerrogoza dhe as skuqen, as zverdhen nga ndonjë veskull virtuti.



Revizorët e ushqimit social, së paku njëherë në vit, e kalonin çdo lokal nën sitën e kontrollit. Deri atë kohë Vandushi ishte ndarë si s'ka më mirë me çdo kontroll, sepse suficitet dhe deficitet kishin genë të papërfillshme, me shuma që nuk arrinin as tre shifra, kurse po t'i vinin tani befas, deficitet arrinte disa mijëra lekë, aq sa ligji parashihte procedim penal. Frika e kontrollit të befasishëm ia nxirrte gjumin natën. E keqja ishte se nuk mund t'u thoshte të vërtetën se

shuma e të hollave që mungonte, praktikisht gjithë deficitin ishte aty, në fletoren e veresijeve, mbasi edhe ashtu do të binte brenda me këmbët e tij. Do t'ia hiqnin bluzën e bardhë duke e pushuar nga puna, më e pakta, ose do ta proçedonin për abuzim e përvetësim të pasurisë socialiste. Sa më shumë kalonin javët, aq më shumë rritej shqetësimi i tij. Si të dilte nga gjendja kritike?

Më së fundi iu duk se e gjeti zgjidhjen. Do të shkonte t'i ankohej kryeredaktorit të "Zërit të Popullit," shokut Sedat, nën huqmin e të cilit ishin gjithë gazetarët. Vandushi kishte respekt të madh për të, sepse ai xheku i linte ndonjë bakshish të vogël, duke i thënë: "E di që ua ka ndaluar drejtorja, por ju personalisht s'keni ndonjë kundërshtim." Xhanan njeri, kot ishte vonuar duke iu lutur gazetarëve a duke u rropatur të prekte sedrën e tyre. Ata e donin me urdhër. Dhe ai do t'i shtrëngonte, detyronte gazetarët borxhlinj të paguanin detyrimet e tyre pa një pa dy. Listën e borxhlinjve e hartoi sipas logjikës tregtare duke vënë në krye ata me shumatat më të larta dhe pastaj me radhë të tjerët. I pari doli Masari, pas tij Kanani, Themiu dhe të tjerët me radhë.

Me listën në dorë, hyri te zyra e shokut Sedat Locaj. Ia parashtrio problemin shkurt e qartë, ndërsa kryeredaktori njësoj sikur të kishte folur me murin, e pyeti se ç'kërkonte prej tij,

- Të paguajnë borxhet që i kanë klubit, domethënë mua. Gjë e thjeshtë.

- Mirë çfarë kërkoni konkretisht prej meje? - e pyeti kryeredaktori

- T'u thoni të paguajnë ato që kanë ngrënë e pirë veresie, - tha Vandushi.

- Kujt t'i them? - e pyeti ai.

- Gazetarëve të tu. Kujt tjetër?

Drejtori buzëqeshi me naivitetin e bufetierit.

- Dëgjo Vandush, unë u kërkoi llogari gazetarëve për artikujt, por sa kafe kanë pirë dhe ku i kanë pirë, nuk më duhet, - ia preu shkurt.

- Në s'doni ta bëni vetë, mirë, jepini urdhër llogarisë t'ua mbajë nga rrogat dhe ja u lamë, - i propozoi Vandushi.

- Llogaria nuk mund t'i mbajë askujt të holla pa vendim gjyqi. Kështu thotë ligji!

Sapo dëgjoi fjalën gjyq, Vandushit i shkuan disa rrëqethje, si ta kishte zënë korenti. Mos po e këshillonte të ngrinte padi kundër gazetarëve? Të shkonte në gjyq me këmbët e tij si cjapi te kasapi? Atë do ta kapnin të parin për shkelje. Kush ia dha të drejtën ta përdorte ushqimin social si pronë personale? Kush e lejoi të shiste me kredi? Tregëtia socialiste mirrte në dorë për çdo pjatë e gotë monedha tingëlluese ose nga ato letrat me ngjyra ku në njerën anë shkruhet: "I paguhen prurësit me të parë."

- Të vijë sot revizionimi, më kap për bythe e më dërgon në gjyq, shoku Sedat. Dhe gjyqi më vërvit në burg. Pse ta ha unë pa futur gjë në xhep? E drejtë është kjo, të shkoj unë belesh? Jam me grua, katër fëmijë shoku Sedat...

- Më vjen keq, por nuk mundem, - e prapësoi kryeredaktori pa luajtur nga karrikja e duke iu kthyer leximit.

- Mirë, derisa ti nuk do, le të dënohem... - Vandushi mori rrugën e kthimit. Sa nuk qante.

- Pa prit pak, prit pak, - e ndaloi kryeredaktori, sapo Vandushi preku dorëzën e derës. - Ankesa juaj ka karakter shoqëror. Me zgjidhjen e problemeve të këtij lloji, merren bashkimet profesionale, jo unë. Prandaj do t'ju këshilloja të shkoni menjëherë te kryetari dhe t'i parashtroni ankesën.

Një rreze shprese ndriti në fytyrën e vrenjtur të bufetierit.

- Mirë, shumë faleminderit, po vete në çast. Kush është kryetari? - pyeti.

- Masari, - i kumtoi Sedati.

- Cili Masar? - pyeti Vandushi me që ishin dy persona me emër të njëjtë.

- Masar Tafili, pra.

Vandushi afroi para fytyrës listën e borxhlinjve dhe picërroi sytë.

- Oh, po unë atë e kam të parin në listë, ai më ka borxhe më shumë se kushdo tjetër... Obobo! - tha me fuqi të prera duke përpjekur duart pas kofshëve.

KARAKTERISTIKA MË OBJEKTIVE

Drejtori i Teatrit Ram Shtanga dhe sekretari i organizatës bazë të partisë, Florin Bakon, rrinin në këmbë para tryezës së shokut Xhemal, derisa ai të kujtohej të ngrinte kokën nga shkresa që po lexonte. Paksa skiç, anës tryezës, Viktor Limani, me bllok në dorë priste porositë e shefit.

Portreti i Xhemal Bashkurtit, për shkak të vijave të thelluara oralo-nazale përngjasonte me një luan të zemëruar gati të hungërojë. Gjithmonë i vrenjtur, kurdoherë mospërfillës, përçmues, u shtinte drithmat gjithë atyre që i lidhte puna me të. Së fundi sekretari i propagandës e ngriti kokën, u hodhi një vështrim shpërfillës mysafirëve dhe në vend t'u drejtohej atyre, pyeti instruktorin e kulturës,:


- Çfarë duan këta që pa gdhirë?

- Ata erdhën sipas porosisë suaj, - e kujtoi Viktori.

- Unë? - U mllëfos Xhemali. - Ç'nevojë kam unë për ta? S'më duhen aspak.

- Sikur u thatë të sillnin karakteristikën e aktores Violeta Kamberi, - i tha Viktori.

- Ou! Po. Mirë që nuk e harruat porosinë, se këta të mitë, që nga Viktori që rri tani me sytë përdhe si nuse fshati, duhet t'ua thuash nga tre herë dhe pa të shohim a kujtohen, - iu ankua atyre. - Bjereni këtu! - i urdhëroi duke vendosur bërrylin mbi tryezë e duke zgjatur pëllëmbën drejt tyre.



Ram Shtanga nxori prej dosjes një fletë të daktilografuar dhe ia zgjati duke u përkulur lehtë.

Sekretari nisi të lexonte karakteristikën, ndërsa Ram Shtanga dhe Florini hetonin fytyrën e tij për të kapur ndonjë nuancë sado të vogël miratimi, ose mosaprovimi. Me të nuk mund t'i harmonizoje telat, për shkak të kthesave të befta që pësonte gjendja e tij shpirtërtore. Si Flori, si Rama nuk e dinin nëse Violeta Kamberin e fuste ndër aktoret e talentuara, apo ndër ato që merrnin rrogën kot? Sikur ta dinin, do të ishin komportuar me të, sepse ndryshe duhet të duroje palavitë e tij. E dinin të gjithë se shoku Xhemal ishte tip i vështirë.

Fytyra e shefit të propagandës mbeti po aq e padepërtueshme sa edhe ajo e sfinksit. Asnjë muskul nuk u rruhd me pezmatim, asnjë vezullim nuk përshkënditi sytë e tij, derisa arriti në fund. Pastaj ngriti kokën pa vështruar asnjëri, qëndroi pak çaste me buzë të

shtrënguara, sikur po përmbante me zor pakënaqësitë që i gurgullonin përbrenda, pastaj e flaku fletën mbi tryezë.

- Kur do të mësoni të hartoni karakteristika të sakta, objektive, xhanëm? - shpërtheu me një sulm të furishëm. - Me ty e kam mor shoku Florin, shoku sekretar i organizatës bazë, përçues i vijës partisë në teatër, - duke ia sëritur pozitën dhe detyrën me ironi të sertë. Nisi të lëkundej mbi kolltuk sikur të mos gjente rehat dhe të trokiste ritmikiisht stilolapsin mbi tryezë. - Sa herë duhet t'ua themi të jemi parimorë, objektivë, të paanshëm? Na thoni që ta dimë edhe ne. Dhjetë herë, shtatëmbëdhjetë, njëqind e shtatëdhjetë, apo sa? Përse i japim porositë, përse e lodhim gojën, kur fjalët tona nga një vesh u hyjnë, nga tjetri u dalin, sikur ta kishit kokën fyle.

- Jo, shoku Xh...

Xhemali i ra tryezës rrëmbimthi me pëllëmbë, pastaj e ngriti lart, përpara fytyrës së Florinit.

- Mos më ndërprisni, ju lutem. Ç' tregon ndërhyrja juaj? Mungesë respekti.

Florini përkuli kokën ngadalë duke buzëqeshur përvuajtshëm, që t'i tregonte se e mirëpriti kritikën pa asnjë rezervë.

Shoku Xhemal vazhdoi të shtjellonte mendimin e tij.

- Keni renditur një mori lavdërimesh e virtytësh për Violetën si të ishte Heroinë e Punës Socialiste... - Sërish fytyra e tij shprehte një pakënaqësi të përzier me zemërim.

- Ne e lexuam në kolektiv dhe kolektivi... - e sqaroi Florini.

- Florin. Mos m'i shit mua ato! - e ndërpreu Xhemali me ironi. - Sikur s'e dimë ne se ç'forcë ushtron kolektivi! Ta them unë: pesë me hiç. - U kthye nga Viktori, sikur ndiente nevojë për mbështetjen e instruktorit. - E dëgjon ç'budallallëqe po flet? Kolektivi e miratoi. Doemos që do ta miratonte, pse ka ngjarë ndonjëherë që kolektivi të kundërshtojë vendimet e organizatës bazë dhe të drejtorisë?

Shpërthimet e befta të shokut Xhemal, zakonisht arrogante, të ashpra, shpesh dilnin nga kornizat e dogmave strikte. Ironia për forcën fiktive të kolektivit binte ndesh me ato që servirte propagandën zyrtare në faqet e gazetave, në radio e në ekran.

Shpërthime të tilla sinqeriteti nuk ishin aspak në natyrën e zyrtarëve të mesëm, prandaj ato ngjallnin një farë simpatie në rrethet intelektuale. Sipas traditës socialiste edhe atij ia tjetërsonin të metat e karakterit, për shkak të postit: arroganca quhej çiltërsi, gojështhurja sinqeritet, prepotenca autoritet.

- Ti shoku Florin je tyryfç nga mendja. - Inati për karakteristikën e shkëlqyer të aktores, vazhdonte t'i jepte vrunduj inatit të tij. - S'paska asnjë të metë kjo Violeta juaj? E pranoj, desha të them e besoj se i paska gjithë këto cilësi të shkëlqyera morale-politike që keni sëritur këtu, po ndonjë të metë sado të vogël nuk e ka? Kristal i kulluar qenka? Nuk e kuptoni se vënia në dukje e ndonjë të mete e ndihmon të përmirësohet? Ky është qëllimi i karakteristikës dhe jo për të mbushur dosjet me një copë letër! - Dhe duke theksuar ato fjalë i ra edhe njëherë tryezës me pëllëmbë.

- E drejtë, - pohoi Viktor Arrëza.

- Si the ti? - iu kthye pjerrtas instruktorit të vet pa ia ndarë vështrimin qortues.

- E drejtë thashë, - pohoi ai për të larguar çdo keqkuptim.

- Zotësi e madhe të pohosh ato që them unë, - e ironizoi ai. - U takonte ju t'i udhëzonit për kriteret e karakteristikës, jo mua dhe t'i thoshe këtij tuafit të ishte objektiv. Viktor, ti ose nuk di të punosh, ose nuk do. Mos u përdridh në karrige. Oportunizmi nuk ka brirë, kështu fillon, me lëshime të vogla. Nuk mund t'u thoshe ndonjë të metë të Violetës, ta zemë, nuk bën përpjekje për të zgjeruar dijet tekniko-profesionale, ose diçka tjetër.

- E dr... - u mat të thoshte Viktori, po shpejt u kujtua se për atë shprehje sapo e kishte ngrënë një fshikull.

- Nuk do të na vinin karakteristika të tilla po ta kishe ti të qartë çfarë kërkohet. Unë e ngrah si problem, si dukuri negative të praktikës sonë. - Ai filloi t'i rrokëzonte fjalët si tekst telegrafik, që të kuptohej pa mëdyshje. - Ka-rakte-ri-sti-kat-ja-në-të-një-an-shme-o-se-me-të-rë-të-mi-rat,-ose-me-të-rë-të-kë-qi-at.-Pi-kë! Se ç'bëjnë këta? E nuhasin që më parë përse e kërkon komiteti karakteristikën dhe pastaj e kanë lehtë. Dhe sekretet prej këtej i nxirrni ju, - e sulmoi

instruktorin, - dhe le të llapim ne për vigjilencë, sa na thahet fyti.

- Unë jo, - u mbrojt Viktori.

- Nuk je ndryshe nga shokët e tu, prandaj lëri xhiblat. Kam të drejtë apo jo?

Edhe sikur të mos kishte të drejtë, kush guxonte t'i thoshte jo.

- Atëherë po e marrim dhe po e riformulojmë, - ndërhyri drejtori qetësisht duke zgjatur dorën drejt letrës ku ishin renditur virtutet e larta të shoqes Violeta.

- S'ka nevojë, se e njohim Violetën sa i vlen lëkura dhe ç'aftësi ka edhe pa karakteristikën tuaj. - Zëri i Xhemalit nuk kishte ngarkesa inati, as tone mllefi. - Fjalën e kam për parimet që duhen zbatuar. Edhe ministër të jetë, madje dhe anëtar i Komitetit Qendror, karakteristika duhet formuluar me objektivitet. Për shembull, në rast se e ndjek gotën, s'ka pse të mos i shënohet. - u tha shoku Xhemal duke u zgjatur dorën.

Në sallon, Florini hapi jakën e këmishës dhe nisi të bënte fresk me zarfin bosh.

- Më duket sikur sapo kam dalë nga dushi, - shfryri me duf.

- Sot ishte i butë, - e mbrojti Viktori, duke i ftuar artistët të pinin një kafe së bashku në bufenë e Komitetit të Partisë.

- Mua o vëlla, sa herë më thërret në zyrë, më shkojnë shtatë, - vazhdoi Florini.

- Pamjen e ka të rëndë, kurse zemrën e ka flori, - argumentoi drejtori.

- Drejtor, unë s'e di si e ka zemrën, ndërsa gojën, gjezap.

- Ne të rretheve artistike jemi zemerbutë, kemi familjaritet, druhemi ta kritikojmë shokun se mos i mbetet hatri, - tha Viktori si të nxirrte konkluzione nga përvoja e tij.

Në oborr përshëndetën Refatin, shoferin e shokut Xhemal, që atë çast po pastronte suprinën e Volvos ngjyrë qumështi nga njollat e pluhurit dhe të baltës.

* * *

Ende pa hapur derën, drejtori dëgjoji tingëllimin e paprerë të ziles së telefonit. Kush mund të ishte ai që e kërkonte pa shkelur mirë në zyrë?

- Alo? Po, drejtori. Urdhëroni!

- Nuk më njohët?

- Si jo, shoku Viktor...

- Një porosi nga shefi. Shoku Xhemal kërkon karakteristikën e aktorit Emil Dodona. Na duhet urgjent, për nesër, shumë-shumë pasnesër. Kështu tha shoku Xhemal!

- Si urdhëron. Nesër e keni aty. Po ua sjellim dorazi, - i premtoi Drejtori.

Ishte rasti më ideal të shlyenin gabimin e parë, duke hartuar një karakteristikë modelore, me të mirat dhe të metat e aktorit të talentuar Emil Dodona. Ram Shtanga, Florini dhe Fredi, kryetari i bashkimeve profesionale u mblodhën kokë më kokë për të hartuar një karakteristikë sa më objektive, sipas udhëzimeve të shokut Xhemal.

Treshja Ram-Florin-Alfred theksoi se aktori Emil Dodona ishte i talentuar, se punonte seriozisht për rolet që i besoheshin, se kishte krijuar personazhe të paharruara në teatër dhe në kinematografi, se me kolektivin kishte krijuar marrëdhënie të mira, por në drejtim të disiplinës vëreheshin disa të meta, si ardhje me vonesë në provat. Një herë lajmëroi se nuk mund të vinte në shfaqje mbasi ishte sëmurë me raport mjekësor. Pas tre ditësh zhdukje pa gjurmë, policia e gjeti në plazhin e Shëngjinit duke gjuajtur peshk. Format e edukimit politik i ndiqte rregullisht, por rrallë diskutonte dhe nuk përpiqej të ngrinte nivelin kulturor. Përmendën se ishte nderuar nga Kuvendi Popullor me medaljen e Punës dhe urdhërin "Naim Frashëri" të klasit I.

Sipas rregullit karakteristikën duhet ta miratonte kolektivi. Ndryshe nga sa pritej, mbledhja nuk kaloi pa debate, mbasi shokët e Emilit, nuk pranonin t'i vihej asnjë e metë. Më së fundi kërkuan mendimin e Emilit. Ai nuk bëri asnjë asnjë vërejtje, qoftë se ia

përtonte, qoftë se e dinte që ishte e kotë. Menefregist si tiranas safi u përgjegj:

- Hë mër jahu, baheni si të doni, veç na lini të ikim se na u tha gabzheri për një gotë birra.

Sapo mbaroi mbledhja, dikush nga shokët e tij e pyeti nëse kishte nuhatur pse ia kërkonin karakteristikën.

- Ç'a ke mor vëlla? Pse e vret mendjen kot! Duan të gjinden në punë... ç'ka tjetër?

Karakteristika iu përcoll komitetit të partisë po atë ditë, sipas porosisë. Si drejtori, si Florini ndiheshin të qetë se porosinë e sekretarit të propagandës e kishin zbatuar pikë për pikë.

- Kësaj here shoku Xhemal do të kënaqet, - tha Florini.

Pasdite "volvoja" ngjyrë kremi qëndroi pranë kangjellave të teatrit. Ram Shtanga po hetonte nga dritarja se kush kishte ardhur me të, ndonjë instruktor, apo ndonjë nga shefat e komitetit të partisë? Nga dera e pasme doli shoku Xhemal me duart në xhepa dhe kokën në re. Ai u fut në oborr, ndërsa drejtori zbriti shkallët t'i dilte përpara. U takuan ballë për ballë te dera e hyrjes.

Xhemali nxori nga xhepi një zarf, ndërsa fytyra e tij sterronte. Dy vijat hundo- gojore ishin më të thelluara nga dufi që i vlonte përbrenda.

- Latë pa shënuar ndonjë të metë, apo kushedi mos ju ka mbetur peng diç? - pyeti me ironi.

- Ia ka qejfi gotën, por menduam të mos e rëndonim, - e sqaroi Ramku.

- Si? Paski akoma? - shpërtheu shoku Xhemal.

- Ne, sipas porosive...

- Sipas kokës suaj! Paska munguar njëherë rastësisht në prova dhe ju ia skuqët: i padisiplinuar, nuk paska diskutuar njëherë në mbledhje, menefregist, mungon për arsye shëndetësore, ia ngopni i pandërgjegjshëm. Jeni në terezi apo jo? - Ai i ra tëmthit të tij disa herë me gishtin tregues. - Karakteristikë për deputet është kjo paçavure? Hartoni një tjetër dhe silleni shpejt! - Ia la zarfin në dorë dhe iku drejt "volvos" ngjyrë qumështi.

SHTESA NË BIOGRAFI



Udhëzimi nga lart që i prerë. Shefat e kuadrit në çdo institucion, qendër pune a repart, duhet të organizonin mbledhje të posaçme të kolektivit për të azhurnuar biografite e tyre me ngjarjet e pesë viteve të fundit. Kërkesa ishte e logjikshme, demokratike, mbasi brenda secilës familje kishin ndodhur ndryshime, dikush ishte graduar, hipur në një pozitë më të lartë, shkarkuar, përjashtuar nga partia, dalë në pension, divorcuar, me një fjalë saktësimi i biografisë, plotësimi i saj me të rejat e freskëta ishte detyrë qytetare e gjithësecilit. Mirëpo kjo shërbente si mbulesë, si vello, ndërsa synimi ishte zbulimi i lidhjeve miqësore, krushqërore a të çfarëdo natyre me ish-kryeministrin që vrau veten dhe me kastën e sabotatorëve të dënuar viteve të fundit.

Ndërsa po ngjithnin shkallët për në katin e tretë, Abil Rasa e pyeti shokun e tij që kishte në krah:

- Di gjë ti? Përse po na ftojnë në mbledhje?
- Shtesa në biografî, me sa mora vesh nga shefja e kuadrit, - e sqaroi Tefa.

- Autobiografitë i kemi dorëzuar pa futur këmbët këtu, se askush nuk të pranon pa të, - u ankua Abili..

- Mirëpo ato janë vjetëruar, prandaj duhen saktësuar e plotësuar, - argumentoi Tefa.

- Po na hanë kohën kot... - murrroi Abili, - se ne ia njohim njëri-tjetrit dhëmbë e dhëmballë.

- Po ti mos u hiq sikur vjen nga Marsi, - e qortoi Tefë Përlala. Edhe pse nuk kishte njeri tjetër afër tyre, Tefa i gjatë vuri buzët afër veshit të shokut për t'i kumtuar të fshehtë. - Qëkur vrau veten kryeministri, apo e vranë, partia rreket të zbulojë rrënjët e "poliagjentit" në çdo institucion a qendër pune. "Deri te kushëriri i shtatë, do t'i spastrojmë," ka urdhëruar Dulla.

"Dulla" ishte pseudonimi përbuzës për Enver Hoxhën, i njohur në rrethet intelektuale të qyteteve. Abili u rrëngqeth nga udhëzimi absurd i Enver Hoxhës. Pse ky inat kaq i madh me Mehmet Shehun, të cilin e kishte mbajtur në krahun e djathtë si kryeministër për 27 vjet? Tollovi të madhe shkaktoi midis njerëzve të thjeshtë etiketimi "poliagjent" mbasi ata të shkretë nuk arrinin të konceptonin si mund të ishte kryeministri i një vendi agjent i një apo disa fuqive të huaja? Abili u kujtua se Dulla vetë e kishte propozuar për kryeministër, duke e cilësuar biri legjendar i Mallakastrës, trimi me fletë, besniku i partisë.

- Ke për të shtuar ndonjë gjë? - e pyeti Tefa.

- Asgjë! - deklaroi Abili vendosmërisht. - Do të qëndroj dëgjues.

* * *

Abil Rrasa dëgjonte deklaratat e mërzitshme të kolegëve, mbushur me fraza bajate të huajtura nga gazetatat dhe duke shkuar dorën mbi mjekër mendonte: "kushedi sa do të zgjatë kjo drej mbledhje." Si një kafshe që i ka zënë rrota bishtin dhe s'mund të luajë nga vendi, Abili kundronte peizazhin matanë dritares.

Përjashta dielli lëshonte një luzmë drite e ngrohtësie që binte pjerrtas mbi sipërfaqen e kaltër të Adriatikut. Deti përkundej si i giciluar nga rrezet e diellit të qershorit, duke dërguar puhiza freskie drejt brigjeve dhe tokës së lashtë. Nga harku i plazhit anës detit vinte grishja të preheshe disa orë në rërën e ngrohtë duke ndjerë flladin që të mbështjell kurmin si një vello e tejpashme.

Ramazan Varka deklaroi se nipi i tij ishte fejuar me vajzën e Ministrit të Brendshëm. Kumti u prit me shpërthime entuziazmi. “E sigurove udhëtimin jashtë Zano.” “Nuk e ka nip, por çunin e gocës së dajës.” “Edhe nip ta ketë, nuk përfiton kurrëgjë.” Të tilla përcaktime të raporteve familjare ishin karakteristikë e tiranasve dhe e Shqipërisë së mesme. Abilitiu desh pak kohë të shkokolepste se çuni i gocës së dajës, binte kushëri i tretë në vijë gjenealogjike. Pas tij u ngrit Vilma Tabaku. Atmosfera u gjallërua, sepse e dinin që sa herë hapte gojën do të lëshonte ndonjë broçkull.

- Familjen time e njohin të gjithë. Babi im ka shkuar kushedi sa herë jashtë shtetit me marinën tregtare. Sa herë kthehej, na sillte në kalamajve bonbone dhe çokollata. (U dëgjuan zëra: “Ndikime të huaja!” “Mos vazhdo më! “Ktheje timonin!”) - Hë mo pushoni, ju! - i qortoi Vilma duke shtrirë drejt tyre. - Tani babi është kapiteni vaponi. (Zëra nga salla: “I kujt vaponi?” “Thuaj emrin!”) - Ua them herës tjetër se tani nuk po më kujtohet, - e mbylli diskutimin Vilma.

Tomor Tabaku, të cilin e bija e kishte ngritur në rangun e kapitenit, ishte peshkatar në një peshkarexho të vjetër që gjuante natën sardele në det. Pas saj, duke mos patur çfarë të thoshin për veten e tyre, bijtë dhe bijat e epokës socialiste filluan të sillnin fakte trimërie, vetmohimi e patriotizmi nga etërit, gjyshët dhe stërgjyshët e tyre.

- Shoku Abil, a doni të shtoni diçka në biografi? - iu drejtua shefja e kuadrit.

Pyetja i erdhi krejt e papritur, aq sa u hutua, por shpejt e mblodhi mendjen të përgjigjej sikurse e kishte vendosur.

- Jo, kurrëgjë! Njato që dihen ma, shtresë e varfër fshatare, i shfrytëzuar deri në palcë nga regjimet antipopullore dhe nga

çifligarët. - Sapo vuri se fjalët e tij nuk patën pikë jehone mbi dëgjuesit, shtoi: - Fakti që kam mbetur imcak, vërteton shfrytëzimin e pamëshirshëm feudal dhe kapitalist.

Shokët e tij qeshën, kurse shefja e kuadrit i tha se aty nuk qe vendi për humor.

Paksa i prekur nga qortimi i shefes, Abili qëndroi në këmbë sikur t'i ishte kujtuar diçka e rëndësishme.

- Kishe gjë për të shtuar? - e pyeti shefja.

- Po, një ngjarje të vogël që ma ka rrëfyer tata. - Me një pamje krenare shtoi: - Mbase nuk ka ndonjë peshë të madhe, por unë kam dëshirë ta them.

Auditori e shfaqti mërzinë duke iu drejtuar t'i binte shkurt.

- Shkurt, fare shkurt, - pranoi Abili. - Një herë tata u grind me Abaz Kupin. Ju e dini kush ishte Abaz Kupi. Feudali më i madh në krahinën tonë dhe mik i ngushtë i mbretit Zog. Donin t'u vinin një taksë të re, prandaj e mbështollën popullin te sheshi i mullirit, nën hijen e ullinjve.

Qetësia u vendos menjëherë se historitë ishin si pushime çlodhëse mes mbledhjeve të mërzitshme. Nga përvoja skenike Abili e ndieu se auditori po e ndiqte me vëmendje.

- Disa ditë më parë, trimat e Bazit blenë prej babës një dash të majmë, se Abaz Kupit do t'i vinte një mik prej Tirane dhe donte t'i shtronte drekë. Plaku priti të merrte të hollat e premtuara, por sejmenët s'po e çanin trapin, me nder. Në mes të mexhilizit, faqe burrave, tata protestoi për taksën e re, disa kilogram ullinj për çdo familje. "Nuk janë mjaft ato që rrëmbejnë sejmenët e tu, - i tha ai, duke e hedhur fjalën për dashin, - por tani u dashka t'ua sjellim mbi shpinë edhe ullinjtë? Pasha të madhin Zot, pa ma paguar dashin, unë nuk jap asnjë kokërr ullini." Abaz Aga ia priti: "Hasan Rrasa, nuk i solle ullinjtë për njëzet e katër orë, unë të fus dy pashë nën dhe!" U grindën me fjalë dhe së fundi Bazi e kërcënoi: "Do të ma paguash shtrenjtë!" Dhe tata i tha: "Po ta paguaj qe tash!" Dhe e ka qëlluar me shpullë Abaz Kupin, në mes të kuvendit sa u bind dreqi.

- Krutan i çmendur paska qenë, - shprehu admirimin e tij Pjerin Doda, i cili entuziazmohej shpejt nga çdo akt trimërie.

- E mori vdekjen në sy, - shtoi Tefa. - Çudi si e la gjallë Abaz Kupi?

- Abilo, e paske patur plakun trim e shkuar trimit. Unë kaq di të them, - e mbylli Gjergji komentin.

- Po, po, kështu si e rrëfeva ka ngjarë. Plaku është gjallë, po s'më besuat, pyeteni vetë, - tha në fund Abili, duke drejtuar dorën nga malet e Krujës.

Nëse u mbajt mend diçka nga mbledhja për shtesat e shumta të devotshmërisë ndaj partisë, të rrënjëve të thella të patriotizmit të prindërve qysh në kohën e Princ Vedit, kjo që shpulla dhënë Abaz Kupit, nga një fshatar i varfër, trim e guximtar, në kohën kur bajraktarët dhe çifligarët ishin zotër të tokës dhe të jetës.

* * *

Pas nja katër muajsh, grupi artistik doli turne në disa qytete të afërta ku përfshihej edhe qyteti historik i Krujës. Grupi vizitoi kështjellën e lashtë, bedenat, sheshet dhe rrugicat me kalldrëm, gurët e të cilave janë lëmuar nga shojet e banorëve të lashtë dhe të rinj. Doemos mendon se mbi ata gurë ku po ecën tani, ka shkelur dhe Skënderbeu me luftëtarët e tij. Më tej dyqanet me taraba druri, kafeja me stola e mindere, rruga e ngushtë të shpijen nga shekujt e mesjetës te epoka moderne, hotel Turizmi.

Pjerini u kujtua për trimërinë e dikurshme të babait të Abilit dhe duke e marrë kolegun për krahu e pyeti si mbahej plaku.

- Si molla në degë, - u përgjigj Abili.

- A mund t'i shkojmë për një vizitë të shkurtër, pa harxhe? - iu lut Pjerini.

- Kur të doni. Edhe ai vetë më ka thënë: "m'i sill njëherë ata shokët e tu, se dua t'i njoh."

- Vetëm shokët? - e thumboi Arta.

- Shokë e shoqe, ç'të jenë, ma.

- Shoqet i pret më me qejf, - shpotiti Pjerini. - Hë, Abil?
- Mos këndon dhe ai me pleqtë e Krujës? - e pyeti Arta me djallëzi.
- Për fat të mirë jo, pra nuk hyn te kategoria e pushtëve, - këputi një kunj Abili.

Para pak kohe, një udhëheqës i lartë partie, kishte urdhëruar të mos dilnin më në ekran pushtat pleq të Krujës.

- Po me ta ç'pati? - pyeti Pjerini. - Ata ishin një grup popullor shumë simpatik. Duket nuk merr vesh nga arti.

- As nga folklori, - shtoi Abili.

Babai i Abilit, mbahej për bukuri. Faqekuq e i shëndetshëm të kujtonte mollën në degë. Fytyra buçkane dhe sytë e zgjuar e tregonin njeri gazmor. Pas qerasjes nga amvisa, Hasani e mbajti shishen e rakisë pranë vetes.

- E di që nuk e pini, por nga pak, edhe mjekët e këshillojnë. Kështu ka dëgjuar baba, po ju e dini ma mirë, se jeni ma të qut se unë.

- Dajë Hasani, a ka mundësi të na rrëfesh si i re me shpullë Abaz Kupit te sheshi i mullirit, në mes të kuvendit? - e pyeti Pjerini i etur për të dëgjuar nga goja e vetë personit ngjarjen me të gjitha hollësitë.

Plaku ktheu kokën nga i biri. Cepat e syve iu rrudhën dhe një buzëqeshje e lehtë u duk te buzët e holla.

- Ky ua paska rrëfyer? - pyeti duke treguar Abilin.

- Dëfteju këtyre miqve si ia këpute me shpullë, - e nxiti Abili duke i shkelur syrin.

Plaku fërkoj me gishta mjekrën si të mendohej nga e si ta niste.

- Po besa, - tha i gjallëruar. - Se ka kris një shpullë e fortë në atë mejdan, kjo më kujtohet mirë, por se e kam pa qeleshen time njëzet metra tej, në bythë të ullinit, edhe këtë s'mund ta harroj.

Mars 1982

MILIONERI

Ndrioja, duke ngrohur duart mbi mangallin pa zjarr, hetonte herë pas herë derën e dyqanit me shpresë të shihte ndonjë blerës. Në mëngjes dhe pasdite klientët ishin të rrallë. Tek-tuk vinte ndonjë plakë gërmuqe për ndonjë rrotkë penjesh, kopsë a karficë, a për çikërima të tjera që nuk ngrinin peshë. As Mimi, vëllai i tij më i vogël, nuk ishte kthyer nga Korça, ku kishte shkuar një ditë më parë për të blerë mall për dyqanin. Kali e kishte zakon të hingëllinte posa i afrohej dyqanit, si për të lajmëruar arritjen e tij.

Tre vjet pas lufte, tregëtia private ishte rrudhur mos më keq, për shkak se tregtarët që shisnin me shumicë, ku furnizoheshin zakonisht tregtarët e fshatrave, ose i kishin mbyllur dyqanet ose ua kishin shtetëzuar. Atë fat kishte pësuar edhe “Vëllazëria Ako”, kreditori i Ndrio dhe Mimi Prushit. Pronarin e firmës, Prokon, pasi ia sekuestruan dyqanet dhe depot e mëdha mbushur dinga me turli mallrash, e rrasën në burg, gjasme se nuk kishte shlyer tatimfitimet. Tregtia e jashtme ishte monopolizuar prej shtetit, ndërsa sigurimi i mallrave brenda po bëhej gjithmonë e më i vështirë. “Dyqanet e shtetit” kishin urdhër të mos u shisnin tregtarëve privatë asgjë. Horizonti po mbyllej nga të katër anët dhe rrebeshi po afrohej. Po Ndrioja kishte një stëngë tjetër të fortë. Ai kishte vënë mënjanë para të thata, qysh në kohën e luftës dhe tani donte të dinte nëse Banka e Korçës këmbente monedha të huaja me lekë shqiptare. Kjo ishte arsyeja kryesore që e kishte nisur me ngut Mimin në qytet, prandaj

dhe kthimin e tij po e priste më me padurim se kurdoherë. “Vëllezëria Prushi,” e thënë ndryshe Ndrijoja dhe Mimi, ishin milionerë, por këtë askush nuk e dinte, as gratë e tyre. Ata e kishin mbajtur gojën kyçur, sipas parimit popullor se ishte më mirë ta hiqje bastunin zvarrë, se sa të mburreshe me të.

Thesarin me kartmonedha të emetuara nga “Trapeza tis Elladha,” e ruanin te një çantë shpine në tavanin e odës së mirë. Tufat e banknotave të dhrahmive me prerje të rënda prej pesë, gjashtë e shtatë shifrash në cepat e tyre, rrinin brenda çantës, duke pritur t’u vinte dita. Ndieje ngazëllim kur i hapje si erashkë dhe soditje figurat mbi to; Homeri, Perikliu, Demosteni buzëqeshnin me mirëdashje. Sa tërheqës ishin, të vinte t’i puthje si ikonat.

Milioner! Ç’tingull fantastik ka kjo fjalë e vetme! Mbyll sytë, ëndërro çfarë të duash, hap gojën dhe çdo dëshirë plotësohet si me urdhërin e peshkut. Paratë e thata janë më praktike se çfarëdo lloj tjetër pasurie. Malli, toka, ndërtesat, nuk mbarten me vete, kurse paratë po. Fut dorën në xhep, paguaj dhe fli rehat. Milionave, para nga ato që “i paguhen prurësit më të parë,” nuk u del fundi, sado që të harxhosh.

Ndrios iu kujtua një ngjarje nga udhëtimi përmes Greqisë më 1937. Duke udhëtuar me tren nga Athina në Selanik, e mori etja dhe sapo treni qëndroi në një stacion të vogël, ai zbriti të pinte ujë. Hetoi rreth e rrotull për ndonjë krua a burim, po vendi dukej i thatë gur. Pak anash platformës disa gra fshatare shisnin zarzavate të freskëta. Ndrios i shkrep mendimi ta shuante etjen me tranguj, prandaj pa pyetur për çmimin, i zgjati shitëses së parë pesë dhrahmi, për dy tre sallatorë të freskët. Fshatarja mbushi një krah me kastraveca dhe ia zgjati Ndrios. Me to u fut në kabinë, ndërsa bashkëudhëtarja, një zonjë fisnike nga sjelljet dhe veshja, po e vërente me habi. Që të dukej i fismë dhe njeri që merrte vesh nga bota, Ndrijoja nxori nga xhepi biçakun dhe nisi t’u qëronte lëkurën kastravecave duke i ngrënë me lezet të madh një nga një. Pas të katërtit zonja fisnike e pa të arsyeshme ta këshillonte:

- Zoti Ndrio, kam frikë se po të hani më shumë do të sëmureni.

Ndrioja e përmbajti nepsin duke i futur kastravecët e tjerë në çantë, ndërsa me vete thoshte: "Zonjë, ua qërova lëkurën se më vinte turp nga ju, pa përndryshe i kisha kullufitur siç ishin dhe e dija që s'më gjente gjë."

Lirësi e madhe. Pesëmbëdhjetë kastraveca për pesë dhrahmi, ishin thuajse xhaba, prandaj ngjarjen e kujtonte me kënaqësi. Pas lufte zia e bukës dhe inflacioni pllakosi Greqinë. Flitej se një karvele, kushtonte 500.000 dhrahmi. Kudo që vije për të blerë diçka, duhet të merrje pas një trastë me para.

Ndrioja sajoi disa plane qysh gjatë kohës së luftës për të investuar me leverdi milionat. Me dyqanin e fshatit s'mund të shpresonte për fitime të majme për shkak të klientelës së kufizuar. E mira që të hapte një dyqan tjetër në Korçë ose në Follorinë. Korça kishte peshkacenë të mëdhenj, të cilët nuk do ta lejonin të ngrinte kokë, as të dilte mbi ta, kurse në Follorinë do të kishte më shumë hapësirë. Me një taksi mund të shkonte brenda katër pesë orësh. Milionat e dhrahmive mund t'i prishte pa kaluar nëpër dyert e bankave dhe të sarafëve makutë ku duhej paguar përqindje për t'i shkëmbyer. Mirëpo Follorina mbeti vetëm ëndërr, sepse pas lufte kufiri me Greqinë u mbyll shumë shpejt dhe vajtje-ardhjet u prenë. Gjendjen e keqësoi akoma më shumë lufta civile ndërmjet komunistëve dhe monarkistëve, e cila vazhdonte prej disa muajsh. Tani komunistët ishin zbythtur në zonat malore të Pindit dhe disfata e tyre dukej e afërt. Paratë le të qëndronin edhe disa kohë fshehur në tavan; do t'u vinte dita të përdroreshin.

U dëgjuan hapa te dera dhe Ndrioja e mori me mend se dikush po hynte në dyqan. U ngrit në këmbë t'i shërbente klientit. Sapo dalloi Xhel Dadakun iu teratis dëshira për t'i shërbyer mbasi ai kishte mbushur një faqe defteri me veresie dhe s'po kujtohej t'i shlyente. Po që se kishte ardhur të blinte pa të holla në dorë, do t'ia priste shkurt: "Pa shlyer të parat, s'ke për të marrë asgjë."

- Zoti Ndrio, erdha unë, - tha Xheli.

- Të shoh, - ia priti me ironi tregtari. - Përse u mundove?

- Çatia, sikur donit të zinit ca pika... - e kujtoi ustai.

Një javë më parë Ndrioja e kishte porositur ustain të vinte ndonjë ditë, kur të ishte i ngeshëm, të zinte pikat e çatisë sa pa filluar shirat e vjeshtës. Mirëpo tani u mëdysh, nga që ortakun nuk e kishte aty dhe atij i duhet të mbyllte dyqanin për të shoqëruar ustain deri te shtëpia, duke lënë fitimin t'i ikte nga duart. Mirëpo usta Xheli ishte si era e mezi kapej, të premtonte dhe ta kthente fjalën, pa iu skuqur faqja, prandaj e gjykoi të arsyeshme t'i kushtonte pak kohë meremetimit.

I vuri drynin dyqanit dhe të dy shkuan drejt shtëpisë.

- Pikon faqja nga ana e jugut, - i tha Ndrioja duke ia treguar me gisht.- Po përpara unë dua të merremi vesh për hakën. Sa kërkon?

- Haka dihet. Një napolon. Mëditjen. - Xheli fliste me fjali telegrafike.

- Tani po vete mes i ditës, kurse ti e dashke mëditjen të plotë. Je në vete? - kundërshtoi Ndrioja.

- Kaq bën. Po deshe, - ia ktheu Xheli.

Ndrioja në atë çast u kujtua se mund t'ia ulte nga veresijet. Rast më të volitshëm s'kishte si të priste.

- Mirë, një napolon, - i tha, - Merr një shkallë dhe ngjitu sipër.

- Njëherë në tavan, ta shoh ku yjëzon çatia, pastaj sipër.

Ndrioja u mrol, ngaqë në tavan kishte çantën mbushur dinga me lartmonedha. Nuk mund të lejonte të futej atje një i huaj, kushdo qoftë ai. Kurrën e kurrës.

- Pikat zihen nga sipër, jo nga poshtë, - kundërshtoi Ndrioja.

- Puna ka sërë. Do të zësh pikat apo do t'i ndërrosh faqen çatisë? Ajo punë e ndryshon hesapin.

Ustai kishte të drejtë. Nuk mund t'i gjente vendet që duheshin arrnuar, veçse duke hetuar vrushkujt e dritës në errësirën e tavanit. Për të mënjanuar çdo të papritur, Ndrioja vendosi të rrinte aty si roje, derisa Xheli të zbriste nga tavani. Çdo shtëpi ka rrangullimat e saj nëpër qilare e tavane dhe ustai s'kishte pse të bubronte nëpër hedhurinat.

Xheli zbriti nga tavani, shkundi duart nga pluhuri dhe deklaroi:

- Tani i di vendet ku duhet punuar. Mos ki merak!

Dolën të dy në oborr. Ustai hipi mbi çati, Ndrijoja i uroi punë të mbarë dhe u kthye të hapte dyqanin.

* * *

Dyqanet e shtetit po i fiknin tregtarët privatë me anë të konkurrencës. Ata i shisnin mallrat pesë deri dhjetë fish më lirë se shitoret private, mbasi për to s'kishin harxhuar as një dheqare. Të gjitha ishin mallra të sekuestruara nga dyqanet apo depot e tregtarëve të mëdhenj, të dënuar nga ligjet e pushtetit popullor. Ta marrësh mallin falas dhe ta shesësh me para, sado lirë, me përfitim është. Ky qe shkaku që privatëve u ngelej malli batall me javë e muaj, ndërsa në dyqanet e shtetit radha e klientëve, për shkak të dyndjes, mbahej me polic. Dyqani i Ndrios u kthye dalëngadalë në gjendjen e mjeruar të paraluftës, me ndryshimin se atëherë sundonte stanjacioni, qesatllëku, sikurse e quanin blerësit, pra kishte mall, por s'kishte para dhe rrota e xhiros mezi vërtitej.

Koha e lulëzimit të tregtisë, që filloi menjëherë pas pushtimit Italian, nuk zgjati veçse një vit e gjysmë, prill 1939 - nëntor 1940. Në fund të prillit, Ndrijoja shkoi në Korçë për të hetuar gjendjen dhe për të blerë mall për dyqanin të "Vëllazëria Ako." Fytyra e shëndetshme e tregtarit grosist vezullonte nga kënaqësia.

- Shyqyr që erdhi Italia dhe tregtia mori pëpjetë, po lulëzon si asnjëherë. Janë të mirë, Zoti t'i ruaj, se këta shikojnë çfarë të sjellin, jo çfarë të rrëmbejnë, - tha zoti Proko.

Zoti Proko kishte lidhje të forta me firmat Italiane qysh para lufte. Gati çdo muaj shkonte në Itali për të blerë mall, prandaj ishte e arsyeshme t'i gëzohej pushtimit, se tani nuk paguante doganë. Ai u tregua i gatshëm t'i hapte Ndrios një kredi mjaft të madhe, ashtu si edhe tregtarëve të tjerë të vegjël të fshatrave. Me ardhjen e Italisë u ndërrua edhe paraja. U futën në qarkullim kartmonedha prej letre që frushullinin në dorë dhe ca të tjera prej metali, ku dukej një ulkonjë, te sisët e së cilës pinin qumësht dy fëmijë, Romuli dhe Remi,


themeluesit e Romës. Letrat e mëdha ishin zbukuruar me portretet e pararendësve të dinastisë “Savoia,” disa me helmata mbi kokë, disa me kapela ushtarake. Vërtet plaku Victor Emanuel III e kishte fytyrën të rreshkur e të vrerosur, ama për tregti ishte i papërtuar, plot energji, ikte vrullshëm nga një dorë te tjetra, ndryshe nga çuni me qeleshe i dollarit shqiptar që mezi tundej nga vendi, edhe pse që djalë i ri.

Qeveria fashiste donte të ripërtërinte lavdinë e dikurshme të Perandorisë Romake, prandaj i vuri si qëllim vetes ta kthente Mesdheun në “Mare nostrum,” deti ynë, me një fjalë det Italian. Pas pushtimit të Libisë dhe Etiopisë nga ana e jugut, Musolini mendoi të shtrihej edhe në lindje, prandaj zbarkoi në brigjet shqiptare. Po kjo ishte vetëm etapa e parë, se ai synonte të shkonte edhe më tej. Me qëllim që ushtarët të mësoheshin me klimën e Ballkanit, Perandoria e re dërgoi disa regjimente e divizione për të veruar përgjatë kufirit me Greqinë. Vera e vitit 1940 që mjaft e nxehtë dhe ushtarët u kënaqën me banja dielli dhe manovra luftarake. Mirëpo si çdo ushtri tjetër edhe ajo kishte nevojë të hante e të pinte. Perandoria shtrydhi burimet financiare për t’u paguar oficerëve dhe ushtarëve rrogat e prapambetura, toptan. Festë e madhe ndër repartet ushtarake. Paratë duheshin harxhuar dhe ata pa mënuar u sulën nëpër mejhanet e osteritë, nëpër mezeritë e restorantet. Ishte provuar historikisht se pijet alkoholike e ngrinin moralin e ushtrisë disa shkallë më lart. Qëkur arabët zbuluan procesin e distilimit të frutave, alkoholi e gjeti shpejt rrugën drejt Evropës dhe u përqaftua nga të gjitha kombet e fiset, pa dallim, ndoshta për shkak se mbarte diçka nga bota fantastike e Orientit, nga mirazhi i shkretëtirës. Vaporë ngarkuar me fuçi vere, me arka vermuti, liker e fërnjet arritën deri në skajet më të largëta të vendit të vogël, që bashkoi “vullnetarisht” fatet me Perandorinë fashiste. Raftet e dyqaneve në qytete e fshatra u mbushën me fiasheko “Chianti,” me shishe të gjata e të holla, katrore e si t’i doje, me emra pijesh që nuk ishin dëgjuar kurrë, si Dopiokumel, Maraskino, Fiori Alpini, Marsala al’Uovo, e “vino, vino, vino.”

U provua se ujët e Gramozit përziej shkëlqyeshëm me verën, sidomos me të kuqen, mbasi e ruante ngjyrën në përpjesëtime të larta. Një gazetar ushtarak i revistës "Messagero," duke pirë verë në dyqanin e Ndrios, arriti një zbulim interesant. Pas gotës së tretë, iu afrova banakut dhe plot ëmbëlsi i tha pronarit:

- Më duket se ky ujë ka edhe pak verë.

E po domosdo, duke kaluar mbi detin Adriatik a Jon, ishte e natyrshme që vera të thithte pak lagështirë. Pastaj edhe rruga nga Durrësi, deri në malet e Gramozit, plot përrenj, lumenj e kroje, i ftonte transportuesit të freskoheshin nën hijet e pemëve duke gustuar pak nga vera e fuçive, sa për të përcaktuar llojin e saj dhe fortësinë. Natyrisht vëllimi ndër fuçitë nuk pësonte asnjë firo, se verën që kishin rrëkëllyer poshtë gurmazeve, e zevendsonin sakaq me ujë të kulluar.



Kapitali i Vëllazërisë Prushi filloi të rritej në mënyrë të vrullshme. Të ishte gjallë ndonjë nga dijetarët e mëdhenj të ekonomisë politike, do të kishte zbuluar veti të tjera të ligjit të mbivlerës. Ndrijoja dhe Mimi, pa patur haber aspak nga ligjet e ekonomisë, e kuptuan se fitimet rriteshin në harmoni me qarkullimin e mallit. Në darkë, nën dritën e një llambe vajguri, Ndrijoja numëronte “lëpushkat.” Kështu quheshin kartmonedhat një napolonshe për shkak të ngjyrës jeshile dhe të madhësisë me atë lloj lakre të egër, që mbinte vetvetiu livadheve e ledheve, ndryshe nga paratë që fitoheshin me mund. Ndërkaq edhe gjuha shqipe u pasurua me një sinonim të ri.

Mirëpo me të ardhur vjeshta “lëpushkat,” i zuri bryma e luftës, ndaj u venitën dhe u rralluan. Një mëngjes, - qe fund tetori e vesonte pak shi,- ushtria italiane e la fushimin, prishi çadrat dhe kolonat me mushka e ushtarë marshuan drejt kufirit grek. Gjashtë orë më parë, në mesnatën e 27 tetorit, ambasadori italian i dha ultimatum Greqisë të dorëzonte portet dhe aeroportet, përndryshe do t’i shpallnin luftë. Oficerët fashistë madhorë e subalternë, me pendë në kapele e pa pendë, parashihnin se lufta do të përfundonte pas dy javësh, prandaj nxituan t’u linin “rendes vous” dashnoreve të tyre në kafenetë e Athinës. Mirëpo llogaritë e strategëve i prishi një lumë malor, një përrua që nuk figuronte në asnjë hartë serioze e në asnjë enciklopedi. Po pikërisht ai lumë apo përrua ndali sulmin e ushtrisë zulmëmadhe të Duçes sepse qe e pamundur të kapërcehej, sikur të ishte Amazona dhe Mississipi bashkë. Italianët e kërkonin nëpër harta civile e ushtarake dhe pasi nuk e gjenin, bërtisnin të nervozuar: “Ma dov’e questo cazzo fiume?” Për shkak të atij përroi të mallkuar kushedi sa baste humbën dhe sa shpulla hëngrën oficerët e perandorisë nga damat e tyre për shkeljen e premtimit se do ta pinin kafenë të këmbët e Akropolit.

Dy batalionet shqiptare, që shkuan në front, do takishin vazhduar sulmin edhe më tej, sikur të mos u kishin dalë përpara disa tufa me dhën, që po kullotnin azat çaireve, pa çoban e pa pronar mbi krye. “Kësmeti ynë” thanë me vete luftëtarët dhe pa mënuar i rrethuan, i vunë përpara dhe me aq e konsideruan misionin e tyre të përfunduar.

Të gëzuar që nga ajo luftë ishin ndarë shëndoshë e mirë, pa asnjë të vrarë, pa asnjë të plagosur, u kthyen në tokën mëmë, me goxha trofe. Ajo fitore e vlente të festohej, prandaj ata ndezën zjarre, u shtruan lëndinavet dhe nuk u shkulën prej andej derisa shkuan në hell edhe berrin e fundit, pa lënë të shkonin dëm as zorrët e mëlçitë me të cilat akçinjtë përgatitën kukurecë që të lëshonte goja lëng kur i shihje mbi prush. Le të bërtisnin oficerët italianë, se dezertimi i shqiptarëve shkaktoi disfatën e ushtrisë glorioze në frontin grek, atyre s'u bëhej vonë, se e kishin parë që ushtarët italianë ngrinin bythën përpjetë që të iknin nga beteja si të plagosur.

Më tej dezertimi u përhap si epidemi në radhët e italianëve dhe ata iknin, pa pritur të plagoseshin tuleve e pa marrë pa marrë me vete as dhën, as dhi. Vrapin e tyre s'mundi ta ndalte as shiu, as lloha, jo më lutjet dhe urdhërat e komandantëve. Pyesnin ku binte Vlora dhe suleshin teposhtë pa përfillur zabel, dushkajë, zallishte e hone, baltovinë e moçalishte. Iknin nga sytë këmbët drejt Adriatikut, duke zbuluar monopate, të cilat nuk i dinin as fshatarët shqiptarë, që ishin lindur e rritur atyre anëve. Fronti u thye, ushtria italiane "u tërhoq në pozicione më të forta, u tha në komunikatën e Radioxhornalet. Tre katër ditë, Arrëza, fshati i Ndrios, mbeti tokë e askujt. Përcaktimi "tokë e askujt" asnjëherë nuk është fare i saktë, po të marret parasysh se toka, arat, livadhet, çaiet, kullotat kishin pronarët e tyre, nuk ishin mall pa zot, mirëpo ushtarakët kanë një logjikë të mbrapshtë, jo gjithmonë të kuptueshme për civilët.

Kullotat, arat, lëndinat dhe fshatrat shqiptare u shkelën nga këmbët e ushtarëve grekë. Ata mbanin llogo se na kishin çliruar nga italianët dhe ne duhet t'i kundronim si shpëtimtarë, mirëpo banorëve nuk u mbushej mendja se edhe ata njëlloj si italianët urdhërat i jepnin me përkthyes. Madje ushtarët e Imperios ishin të qytetëruar, sepse paguanin me para në dorë, çdo mall që merrnin nga tregtarët a fshatarët, ndërsa evzonët grekë, e quanin të natyrshme të rrëmbenin çdo gjë që u pëlqente me të drejtën e grykës së pushkës. Disa prej tyre, hajdutë të regjur, të liruar nga burgjet për motive patriotike, dukej sikur vinin nga një botë e lashtë, ku ende nuk njihej

paraja si mjet këmbimi. Mimi u skandalizua kur ata hynin, merrnin nga raftet çfarë u pëlqente dhe pastaj zhdukeshin pa paguar asnjë metelik, pa thënë as “efkaristo.” Vëllazëria Prushi e pa të arsyeshme t’i vinte drynin dyqanit përkohësisht.

Deshi Zoti, pushtimi grek nuk zgjati veçse disa muaj. Gjermanët u treguan të gatshëm t’u vinin ndihmë aleatëve të tyre në një çast kritik. Në vend t’u delnin ballas, ata u gjëmuan prapa, duke iu futur Greqisë nga Bullgaria. Ushtarët nuk kishte kurrkund, sepse ata luftonin në Shqipërinë e Jugut me synimin t’i hidhnin italianët, ndaj kolonat gjermane marshuan si për piknik, pa gjetur kurrkund rezistenë. Kësisoj ngjau hataja e madhe. Ndërsa grekët luftonin në një tokë të huaj, gjermanët u ulën këmbëkryq në qytetet dhe fshatrat e tyre. Raportet u përmbysën; pushtuesit u kthyen në të pushtuar. Vazhdimi i luftës me italianët s’kishte më kuptim, ndaj fronti u shtur dhe u braktis së dyti kësaj here në sens të kundërt. Ishin ushtarët grekë që shanin “gamuti Panagjia,” “gamuti Pandokrator” dhe pasi flaknin armët e zjarrit, vargan-vargan ktheheshin të dëshpëruar drejt kufirit për të gjetur mysafirë të pafuar në vatrën e tyre.

Pas këtij pushtimi, që meriton të quhet ii dyti, erdhi pushtimi ii tretë nga ana e gjermanëve, në shtator të 43, pas kapitullimit të Italisë fashiste. Ata thanë se nuk po vinin të na pushtonin dhe as nuk u shkonte ndëmend një gjë e tillë, po derisa erdhën me tanke e artileri, me autokolona ushtarësh të armatosur deri në dhëmbë, njerëzit e thjeshtë nuk para i besonin.

Gjermanët thanë mos na goditni, na lini të shkojmë lirisht në rrugët e komunikacionit dhe ne nuk do t’u ngasim, mirëpo ata që i kishin hedhur armët krahut, nuk donin të dukeshin sikur i mbanin për bukuri, a për të pozuar dhe kështu vazhduan me taktikën godit dhe mbathja këmbëve. Gjermanët ishin të mendimit se raprezaljet mbi popullsinë civile, pranë çdo vendi që pësonin goditje, ishin të domosdoshme për të rivendosur qetësinë. Për shkak të këtyre raprezaljeve, popullsia e shumë fshatrave afër xhadesë Korçë-Janinë u ngrit me kuç e maç e mori arratinë nëpër male, pyje e zona të

thella të Pindit. Edhe familja e Ndrios dhe e Mimit u shpërngul në një fshat shqiptar matanë kufirit.

* * *

Dyqani i grekut, një qymez i errët, i mbajtur mos më keq, ia ngacmoi Ndrios mendimin të sillnin aty një pjesë të mallit dhe të hapnin dyqanin e tyre.

Tregtari tregtar mbetet kudo. Këtë e dëshmon barceleta që qarkullonte para luftës së Dytë Botërore. Diku e dikur u mbyt në det një vapor ngarkuar me portokalle, mall të cilin e kishte blerë për tregti një çifut. Brenda pak orësh, gjithçka që pluskonte sipër valëve të detit, arkat me portokalle dhe pasagjerët i gëlltiti një balenë që u ndodh aty afër. Pas disa ditësh balena u kap nga një anije peshkatarësh, të cilët e tërhoqën mbi bordin e anijes për ta rjepur e për t'i marrë dhjamët dhe mishin. Kur i hapën barkun, për çudi gjetën çifutin duke u shitur portokalle pasagjerëve të tjerë. Përfundimi: tregtari tregtar mbetet kudo, edhe në barkun e balenës.

Mimi, skeptik si gjithmonë, nuk e miratoi idenë e të vëllait.

- Bota s'dinë ku kanë kokën, ti dashke të hapësh dyqan.

- Sa të zhezhitet malli nëpër bimca e depo, më mirë ta sjellim këtu.

Lufta zhvleftësoi mobiljet, peliçet, veshjet luksoze, bizhuteritë, gjerdanet, stolitë e grave, ndërsa ngriti çmimet e disa mallrave të zakonshme e të papërfillshme si kripa, sapuni, vajguri, xhamet, shojet.

- Mos kujton se tani njerëzit nuk duan kripë e sheqer? - e thumboi Ndrioja. - Ne duhet t'u ndihmojmë, aq sa mundemi. Më ndih, të të ndih, kështu thotë edhe Zoti.

- Veç ndonjë i marrë lakmon për fitime në këto kohë, - e vazhdoi diskutimin Mimi në planin moral.

- Prifti dhe tregtari vendin e kanë pranë grigjës, - u mbrojt Ndrioja.

Mimi e dinte se aforizma e lashtë ishte për çobanin dhe priftin, jo për tregtarin. Ndoshta atë e kishte shtuar Ndrioja nga xhepi i tij, por nuk e zgjati më tej.

- Nëse e provojmë, nuk humbim asgjë, - shtoi Ndrioja, pa iu kundërvënë hapur arsytimit të tij.

Ditët e para xhiroja nuk po ecte dhe Ndrioja i dha të drejtë skepticismit të vëllait. Blerës pothuaj s'kishte fare. "Dyqani i shqiptarit" e mori veten sapo blerësit e rrallë i përhapën namin se aty gjeje çdo gjë, si në kohët e para, kripë, vajguri, fitil, sapun, qirinj, patkonj kafshësh, shkrepse. Nisi të tërhiqte blerës nga zonat më të thella, Vurbjani e Pisoderri. Aty vinin aty dhe nga padurimi për ta shtënë mallin në dorë, nuk futeshin në pazarllëk me pronarin, por e blinin aq sa i hapej goja tregtarit. Si të mos i ngrije çmimet kur blerësit pranonin ta blinin mallin me çdo çmim që u propozohej? Në darkë, pasi mbyllte dyqanin, Ndrioja kishte dëshirë t'i ndante kartmonedhat pas shifrave dhe t'ii paloste mbi banak. Atëherë i dukej vetja si Prokoja i firmës Ako, veçse paret nuk mund t'i fat numëronte aq shpejt sa ai. Nëpër gishtrinj të trashë të Ndrios, gishtrinjtë bujku, që i kanë mëshuar sëpatës, kazmës, belit, paret mezi shkisinin dhe ai pështynte vazhdimisht mollzat e gishtit të madh dhe treguesit.

Një mbrëmje, pasi numëroi kartmonedhat, deshi ta ndante ngazëllimin me të vëllain.

- Tregëtia po na ecën mirë, vëlla. Sonte mblodhëm 280.000 dhrahmi!

Mimi, i ftohtë si gjithmonë, shihte mospërfillës tufën e parave pa shfaqur kurrfarë gëzimi. Fytyra e tij e verdhë prej asketi mbeti e pandryshuar.

- A ka njeri të mos gëzohet kur fiton para me grushte? - e ngacmoi Ndrioja.

- Para lufte këto..., - tha me përçmim Mimi, sikur të ishin copëra letre të ngjyrosura nga fëmijët dhe jo kartmonedha të emetuara nga Banka Kombëtare e Greqisë.

Për Ndrion që e njihte mirë karakterin e tij, pamja e jashtme si oshënar që predikon shpëtimin e shpirtit me lutje të pambaruara

dhe jetë asketi, ishte maskë që fshihte dëshirat dhe pasionet e zjarrta që i vlonin përbrenda. Fytyra e tij prej pendestari kërthndezej sapo në dyqan hynte ndonjë femër e kolme. Duke nxjerrë nga togu një kartmonedhë fringo të re ngjyrë violet okër, që lëshonte fërshëllima krisafi nëpër gishtrinë, Ndrioja tha:

- 10.000 dhrahmi, ej kokë! Me këtë ia ngre fustanin çdo gruaje, sa t'ia tundësh para syve.

E vështronte tinëzisht për të hetuar kundërveprimin e Mimit, mirëpo rrinte si mumje, sikur të mos e kishte kuptuar aludimin e vëllait të madh. Një javë përpara, Ndrioja e kishte kapur në flagrancë me një vejane të kolme. Për të prerë shkurt, iu afrua dyqanit nga dericka e pasme dhe pasi dëgjoji zëra që vinin nga brenda, e qepi veshin pas flegrës. Shqoi zërin e Mimit. “Eja këtej, futu brenda banakut dhe mbushe qeskën vetë daç me oriz, daç me makarona.” “Rrofsh Mimi, për zemrën që ke!” u ndie zëri i një gruaje. “E mbushe? Tani eja të ta mbush dhe unë, se nuk po më durohet. Tregëtia kështu e ka, më jep, të të jap. Hipë këtu mbi banak. E di sa mirë është? Më mirë se në dyshek.” Gruaja i kundërshtoi. “Kam frikë mos vjen njeri.” “Nga do të vijë? Unë e kam mbyllur derën me kyç e me lloz. Ajde, hipë. A do të të ndihmoj?” “Sa i nxituar që je mor Mimi...” e qortoi gruaja e panjohur. “Hipe? Mirë je. Aty më rri. Tani ngrije dhe pak fustanin. Unë mbaroj punë shpejt e shpejt. Nesër eja prap të marrësh oriz, sheqer, makarona. M’i paske këto shalët tullupan të bardha!” Gruaja shprehu një lloj habie, nga sa i panë sytë. “Uh mor Mimi, sa një hu për të lidhur gomarin e paskel! Do më ndash më dysh,” komentoi ajo. “Hajt, hajt, mos u bëj merak se e ka vendin e tij ky.” U ndienë disa ofshamje, ahe e uhe të ndërprera dhe pastaj një rrapëllimë. Banaku u shemb. Ndrioja hyri menjëherë r’i ndihmonte viktimat e pasionit, mos ishin shemkosur a plagosur. E panjohura ishte Neta, një meso grua, vejushë me tre fëmijë. Ajo u ngrit menjëherë në këmbë duke kopsitur jelekun e duke u përpushur si pula pasi i ka hipur këndezi sipër.

- Ua! Ua! Ç’është kështu? S’guxon njeriu të hyjë në dyqan, të blejë atë që do, se po e panë vetëm, ia ngjitin duart në tulet. Janë

hazdisur burrat nga lufta, - konkludoi Neta duke justifikuar veprimet morale të meshkujve nga pasiguria që kishte sjellë lufta. - Tjetër herë s'kam për të shkelur këtu, - iu kërcënua Mimit, po ndërkohë nuk harroi ta mirrte qeskën me oriz.

Ndrioja po shihte me sy kritik banakun e shembur.

- Rregullohet shpejt, - tha Mimi. - Nuk u thye. - Pas pak sikur të justifikohesh përpara vëllait të madh shtoi: - Më vjen keq për gratë vejane me fëmijë.

- Për vejushat apo për fëmijët jetimë? - u interesua Ndrioja.

- Për të dy palët, - tha Mimi pa ngurrim.

Duke ecur nëpër atë gjysmë terr këpuca e Ndrios shkeli diçka të butë. U përku! ta shihte më nga afër.

- Dreq! Paska harruar brekët këtu...

- Vjen i merr nesër, - tha qetësisht Mimi.

Ndrioja, me kartmonedhën dhjetë mijëshe në dorë, buzëqeshi sapo iu kujtua udhëtimi me tren nga Selaniku dhe zonja e panjohur e kabinës. Sa kuintalë kastravecë mund të blinte me të? Një vagon treni plot.

- Zoti Proko do të mahnitet kur t'ia vërvit paratë mbi banak, jo një nga një e duke lëpirë gishtrinjtë si plakati e fshatit, por tufatufa.

- Tani të gjithë kanë nga këto, - vazhdoi Mimi mendimin e tij.

Ky njeri të bënte akull kur të doje. Asgjë nuk e gëzonte, për asgjë nuk entuziazmohej. Një ortak i tillë nuk durohej, por asesi s'mund ta largonte se e kishte vëlla të një barku, nga nëna e babai. Ai qe mallkim i firmës tregtare Prushi, që po ideonte me mend. Sa herë mërзитеj prej tij, Ndrioja pyeste me mllef. "O Zot, çfarë gjynahu paskam bërë që më dhe një vëlla të tillë?"

* * *

Një ditë prej ditësh, në dyqanin e tij, papritur e pakujtuar hyri një fshatar buçkan me rroba shajaku dhe kapele me strehë si ato të

zanatçinje. Ndrios iu duk si fytyrë e njohur. Sapo i huaji buzëqeshi dhe në gojën e tij vezulluan këllëfët e florinj të dhëmbëve, ai njohu zotin Proko, pinjollin e vëllazërisë Ako.

- Ti këtu? - e pyeti Ndrioja i habitur sikur të shihte Lartmadhërinë e Tij, Zogun e Parë.

- Eh, lufta, ku nuk të shpie? - tha Prokoja në mënyrë të vagëlluar.

Po priste një farefis nga Janina, i cili punonte si qeraxhi me një karvan mushkash. Ndrioja i ra hilesë se Prokoja merrej me kontrabandë. Duke mbajtur paanësi politike të përkryer, ata u shisnin mall si forcave mbretërore, si komunistëve grekë, sapo tingëllonin monedhat e arta.

Gjatë bisedës pa temë, zoti Proko tha kot së koti:

- Sot lum ata që kanë flori. E di sa ka vajtur çmimi i një napoloni ar?

Ndrioja mprehu veshët.

- Katërqind e dyzetë mijë dhrahmi. - Vështrimi i tij si i shqarthritis u ngul në fytyrën e Ndrios. Ky tregtar i vogël fshati mund të kishte mënjanë disa dhjetëra copë nga ai metal me vlerë.

Ndrioja bëri një hesap të shpejtë me mend. Pesë napolonat, tre të tiat dhe dy të Mimit, kapnin shumë marramendëse dy milion e ca dhrahmi. Milion! Milioner! Kjo fjalë drodhi neuronet në brendësi të trurit të tij duke ndezur vezullime të flakta ngjyrash. Ishte milioner. Jo, akoma nuk ishte, por do bëhej. Çasti i lumtur nuk qe larg.

- E kush t'i merr me aq? - pyeti Ndrioja duke fërkuar qafën. Ndiente se koka i pulsonte vrullshëm nga vezullimi i fjalës: "Milioner, milioner, ...er, ...er, er."

- Me katërqind e njëzet t'i marr unë, - tha tregtari grosist ftohtë, si të fliste për një blerje të zakonshme zarzavatesh.

Ndrioja u step. Prokoja e vuri re, prandaj nxitoi t'i thoshte:

- Tregëtia kështu e ka. Ti fitimin tënd, unë timin.

Ndrioja nuk foli, ndërsa Prokoja e pyeti papritur:

- Sa copë keni?

- Pesë, - u përgjegj ngadalë, si i kapur në kurth.

Tregtari grosist rrudhi buzët i zhgënjyer. Megjithatë nxitoi t'i shtinte në dorë sa më parë. Për të mënjanuar përsëdytjet e Ndrios, nxori një tufë kartmonedhash dhe ia vendosi ngadalë mbi banak.

- Kur të vij t'i marr?

- Nga darka.

Ai u largua nga dyqani pa kërkuar as dëftesë. "Ka besim tek unë," mendoi Ndrioja i vetëkënaqur. "Doemos, e di që jam burrë esnaf, më njeh prej kohësh." Ndërkohë llogariti me mend fitimin e menjëhershë të Prokos, njëqind mijë dhrahmi me një dorë dhe ia pati zili. Iu duk e saktë sentenca engleze që pohonte se paratë e pakta fitohen me zor, të shumtat me lehtësi.

Sapo shtiu në dorë florinjte, Prokoja e porositi:

- Po pate edhe të tjera mos i mba fshehur, se s'dihet si vete kursi i këmbimit. Sot blihet me këtë çmim, nesër mund të ngrihet, por edhe mund të ulet. Englezët po i futin sterlinat me arka në Greqi.

- Kam edhe një sahat, - tha Ndrioja.

- Ari? - i shndritën sytë Prokos.

- Jo, nuk besoj.

Prokoja as denjoi ta mirrte në dorë.

- Mund t'ia shesësh dikujt. Dëgjo këtu, asnjë fjalë partizanëve tanë, as atyre të EAM-it. Po të pyetën pse erdha këtu, thuaj kishim një llogari të prapambetur.

I lezetuar që kishte kryer transaksionin më të madh në jetën e tij, Ndrion nuk e mbante vendi. Ja pra më fund ishte milioner, me kartmonedha të vërteta, me shifra e shkronja, me numër serie, me portrete të figurave të njohura të botës antike, të lulëzimit të qytetërimit helen. Perikliu me përkrenare, sadoqë ai vetë nuk zhvilloi asnjë luftë, Sokrati me ballin e rrudhur nga mendimet filozofike, Homeri i zymtë me vështrimin bosh, Aleksandri ii Madh mbi kalë, Demosteni duke folur me pergamen në dorë, me objekte antike si ndërtesa e Akropolit, Parthenoni me shtyllat e larta prej mermeri, firma të ngatërruara te drejtorëve të thesarit. Dhe kudo mbishkrimi lakonik: "I paguhen prurësit me të parë," çka donte të thoshte se

paratë garantoreshin nga shteti, ndaj nuk ishte nevoja të verifikoheshin si çetë privatë. Mezi po priste ardhjen e Mimit që t'i kumtonte te renë befasuese se tani ishin milionerë.

- Sot mora dy milion e dyqindmijë dhrahmi për pesë napolona flori. - i tha Ndrioja duke vënë këmbën mbi këmbë, sikurse e donte çasti madhor. I mëshoi me qëllim fjalës milion për të parë mbresat në fytyrën e Mimit. - Punë me leverdi të madhe, apo jo?

- E quake me leverdi se e ktheve floririn kartë? - e pyeti Mimi me ironi duke lëpirë buzët e thata.

- Tregtia e madhe do miliona, jo llafe, Mimi. Tani e vumë festen mbi sy, e lamë pas fukarallëkun, - vazhdoi Ndrioja për të thyer pakënaqësinë e të vëllait. Kësaj here do të gëzohej pa çare.

- Do të na mbeten batali në derë! - Parashikimi ogurzi i Mimit, me fjalët që i gurgullonin në grykë, sikur të shkonin midis një hapësire mbushur me pështymë e mukus, e akulloi Ndrion.

- Me se e mbante tregëtinë "Vëllazëria Ako," "Pogoni," "Fara" e... djalli me të birin? Tregtarët e fuqishën devizën e huaj ndjekin, - e sulmoi ai.

Ky argumentim që do të kishte shtrirë barkas këdo, nuk u pranua prej Mimit, sepse ai vazhdoi tragën e tij.

- Pse po rend zoti Proko pas floririt tani? Kot kujton ti?

Jo, s'kishte grusht ta rrëzonte atë njeri, sikur s'qe lëndor, por hije.

- Si nuk u gëzove njëherë o vëlla, si nuk the njëherë të lumtë!? Gjithmonë ters, pis e katran, bunacë e terr.

Ndrioja zbuloi se edhe milionerët kanë telashet e tyre. Të linte Mimi të gëzoheshë? Që në çastet e para, në vend të hidhej përpjetë nga gëzimi, të përqafonte vëllain, a të thyente ndonjë gotë për hair, kishte ndejtur si mumje duke u rropatur t'i fuste krimbin e dyshimit me pandehma të frikshme. Ai njeri ta bluante shpirtin si tenja drurin.

- Pooo, se pas lufte s'do ketë nevojë askush për para, gjithçka do ta marrin falas, do hamë me lugë të florinjta, sikurse thotë nipi ynë partizan, Nas Kovaçi... - Ndrioja po përdorte ironinë që ta sillte në vete vëllain e tij të barkut.

- Njëherë përnjëherë të dalim gjallë nga kjo fesfele, për të tjerat shohim e bëjmë, - e mbylli Mimi diskutimin, pa i kërkuar llogari për dy napolonat e tij.

I vendosur të ecte në rrugën e pasurimit, Ndrioja ia shiti sahatin një oficeri monarkist për një shumë fantastike dhrahmish. Të vije në pjatë të hollat, në anën tjetër sahatin, sqepat e peshores do të barazoheshin. Mund të thoshte me ndërgjegje të qetë se e kishte peshuar me para. E pyeti Mimin si e gjykonte shitjen e sahatit, duke pritur që ai ta kritikonte si zakonisht, mirëpo ndryshe nga sa pritej, ai tha:

- Edhe pa sahat, koha njëlloj ikën.

Një thënie të tillë me karakter filozofik ai nuk e priste të dilte nga koka e Mimit, prandaj ai e kundroi me buzëqeshje mikluese, paksa i habitur.

- Nga koke jote e nxore këtë? - e pyeti kureshtar.

- Jo, nga goja - ia ktheu Mimi.

- E di që këto kohët e fundit je bërë më i zgjuar? - e shigjetoi i vëllai.

- Kështu kam qenë kurdoherë, po ti s'e ke vënë re, - ia ngjeshi Mimi.

"Një herë në njëqind herë edhe budallai thotë një fjalë të zgjuar," kujtoi Ndrioja një urti popullore të moçme, sadoqë Mimin nuk e fuste kurrsesi në kategorinë e tyre.

* * *

Ndrioja pa matanë dritares. Dielli e kishte kapërcyer zenitin dhe tani po shkiste drejt maleve të Radomit. Tani usta Xheli duhet ta kishte mbaruar zënien e pikave dhe nga çasti në çast pritej të vinte në dyqan për të kërkuar hakën e punës. Ndrioja e mirrte me mend si do t'i thartohej fytyra ustait, sapo të dëgjonte se të hollat, - një napolon rrumbullak, - po ia ulte nga borxhi. Po Mimi si nuk qe kthyer nga Korça? "I shtëni, gjithmonë sorollatet, gjithmonë i dyzuar, të vete, të mos vete, ta blej, të mos e blej, të shoh dhe gjetkë se mos e gjej më lirë."

Kaloi edhe një orë. Ustai nuk u duk në dyqan. Të ishte akoma mbi çati? Kurrsesi, se zënia e pikave kryhej shpejt, brenda dy tre orësh. Mos vallë Xheli kishte hipur sërish në tavan për të kontrolluar punën dhe e kishte përparë thesarin? E kapërtheu shqetësimi dhe menjëherë brofi në këmbë. Sa budalla ishte treguar. Në vend të vigjëlonte mbi thesarin, u ngul në dyqan të priste klientët, duke lënë milionat në mëshirën e fatit.

Mbylli dyqanin dhe vrapoi drejt shtëpisë. Ustai nuk dukej mbi çati. U fut në oborr. Shkallët dukeshin të varura në vendin e tyre, te murit i furrës së bukës. U ngjit me vrull në katin e dytë, te dhoma e mirë. Qepeku mbyllur, tryeza në vend. Me vrull Ndrijoja afro tryezën, vuri një karrige sipër saj, hipi mbi të, shtyri qepëkun mënjandë dhe zgjati dorën në errësirë. Boshllëku ia drithtëroi zemrën. Çanta e mufatur me banknota nuk ndodhej më aty... Djersa shpërtheu nga çdo por ii lëkurës dhe ai u ndje si squllur si sfungjer i mbingopur me ujë. E ftohta drithmuese ii hyri deri në palcë. Për ta kthjelluar dyshimin e kobshëm u ngjit në tavan me ndihmën e bërryleve, ndezi çakmakun dhe kërkoi cep më cep. Çanta s'dukej gjëkund. Milionat kishin fluturuar...

"Po tani? Ej, pikë e zezë!" Ecte mbi tavan pa e patur mendjen dhe tre herë e përplasi ballin pas qeprave. Zbriti me rrëmbim prej tavanit dhe rendi në guzhinë. Pyeti gruan nëse e kishte parë usta Xhelin të hipte në tavan.

- Isha jashtë, duke nxehur furrën, - ia priti Zoica pa e kthyer kokën, sepse ii duhej ta ndante brumin në pjesë të barabarta dhe t'i vendoste mbi pinakotë.

- Kishte gjë me vete kur iku?

- Nuk e vura re...

- E humbur! - e shau ai. - Të vjedhin në mes të ditës dhe ti s'kupton asgjë?

E shoqja u ngjit lart e vërejti dhomën rreth e qark. Çdo send ishte në vendin e tij. Asgjë s'mungonte.

- E ç'ka këtu për të marrë? - pyeti Zoica.

Që të mos niste një sherr tjetër, nuk i tha asgjë për thesarin.

Ia dha vrapit drejt mëhallës së mesme ku ndodhej shtëpia e Xhel Dadakut. I shpërfytyruar nga makthi, rente duke marrë frymë me zor. Në vesh i shungullonte fjala katastrofë, falimentim, varfëri. Brenda pak çastesh ishte rrokullisur nga maja e piramidës së milionave në një tregtar fshati, që ha drekë me shtatë kokrra ullinj. Mundimet, përpjekjet, lodhjet, rropatjet mes vapës e të ftohtit, fitimet e disa viteve, ishin asgjësuar krejt si të mos kishin qenë kurrë. I vinte t'ii binte kokës së tij me grushta që ishte treguar aq ii pakujdesshëm. Ishte i sigurt se ia kishte torrovatur Xheli, veç nuk po dinte çfarë do të ndodhte kur të përballohej me të. Çfarë t'i thoshte e nga t'ia fillonte që ta gozhdonte? Fjalët e frazat dyndeshin brenda trurit të tij si një kope e tërbuar, që rreh të dalë nga një derë e vogël dhe në atë rropatje ngulfatet mos më keq. Mos ishte më mirë t'i sulej duke e zhdëpur me grushta, ose t'ia hidhte duart në grykë e ta gurgulloste sa t'i kërcenin kokërdhokët jashtë. Po sikur ta kërcënonte me gjyq? Mënyrat ndryshonin, kurse qëllimi final mbetej ii njëjtë: të shtinte çantën në dorë.

Të shoqen e Xhelit e gjeti në oborr, duke mjelë lopën.

- Brenda është usta Xheli? - e pyeti me ankth.

- Brenda, - iu përgjegj ajo e qetë.

- Ka kohë që ka ardhur?

- Nuk e di. Unë tani sapo erdha nga ara, solla disa misrishtat të njoma për lopën.

Ndrioja ngjiti shkallë dhe hyri me vrull brenda dhomës së zjarrit. Usta Xheli, mbështetur pas oxhakut, po dridhte një cigare duke vështruar nga dritarja si njeri më i ngeshëm në botë. Në jatakun e anës tjetër, djali i tij luante pranë një stoli druri.

- Paratë! - tha Ndrioja, në mënyrë kërcënuese, i kënaqur që e kishte gjetur fjalën e vetme që duhej thënë.

- Ç'para? - e pyeti usta Xheli i qetë, po ndërkohë buza e poshtme iu drodh dhe flegrat e hundës i fërgëlluan nga një lëvizje e pavullnetshme, si të nuhaste diçka të keqe. As as nuk mori mundimin të ngrihej në këmbë për të nderuar mysafirin, sipas traditës.

- Ato që more në tavanin tim, - ulëriti Ndrioja.

- Mos ke parë ëndërr apo si? - e qesëndisi ai.

- Ato ia shit ndonjë tjetri, jo mua, - uluriti Ndrioja.

- Ngadalë, se nuk ta ka njeri frikën, - e qortoi Xheli. - Dhe mos bërtit, se s'je në shtëpinë tënde! E di apo jo? Të marr për bythe e të vërvit jashtë. - Ustai mori vrull të ngrihej në këmbë dhe Ndrioja u bë gati të ndeshej po qe se do të orvatej ta nxirrte me forcë. Mirëpo Xheli papritur e preu vrullin dhe nuk luajti nga jataku.

- Nxirr ato që rrëmbeve, se ndryshe bëhet gurguleja! - e paralajmëroi Ndrioja duke e kërcënuar me grusht.

- S'po të marr vesh fare, - i tha Xheli duke ndezur cigaren.

- Çanta ishte atje kur hipe në tavan, - gjëmoi Ndrioja.

- Cila çantë? - e pyeti Xheli pafajësisht.

- Ajo që përlave kur hipe së dyti. Pse, qorra kërkon të na bësh ti?

- S'di gjë, - tha Xheli duke shfryrë një shtëllungë tym duhani. -

Ku e mbolle, shko e korr! Me mus s'ke dava.

- Nxirre shpejt! Hajdut! Çitak! Delenxhi! Tjetër njeri veç teje, nuk hipi në tavan.

- Ti flet përçart. Mos ke pirë gjë? Pa qëromu nga shtëpia tani! Mjaft dërdëllite!

Ndrioja shikoi këpucët e tij, nëse ishin në gjendje të shkelmonin kërcinjtë e kundërshtarit dhe të mos pësonin gjë.

Nga mënyra si merrte frymë e nga vështrimi i çakërdisur i Ndrios, Xheli parashikoi se kacafytja me grushte ishte e afërt, ndaj e urdhëroi djalin të dilte nga dhoma.

- Vangjo, shko luaj përjashta!

Vançi duke ndjellë hundët, mblodhi letrat që t'i mirrte me vete. Me bisht të syrit Ndrioja ndiqte lëvizjet e ngathëta të djalit. Një kartmonedhë 100.000 dhrahmish, vezulloi në dorën e tij, midis letrave të tjera. Ndrioja iu sul si skifter, ia rrëmbeu monedhën dhe duke u kthyer nga Xheli iu gërmush:

- Po kjo? Nga erdhi këtu? - Duke valëvitur në erë kartmonedhën fringo të re, si "corpus delicti" Ndrioja s'kishte asnjë dyshim se çanta ndodhej diku aty pranë.

- Di unë ku i ka gjetur djali? - u mbrojt Xheli duke shtypur me inat bishtin e cigares.

Ndrioja e kapi dorën Vançit dhe duke e ngritur peshë në erë, e pyeti egërsisht:

- Ku e gjete? Nga e more?

- Ma dha babi, - tha djali duke u skinjur nga frika.

- E dëgjon tët bir?

- Gjepura, - tha Xheli ftohtë sikur biseda nuk i interesonte më dhe u shtri më kurriz mbi dyshek me duart prapa kokës,

pozicioni i Xhelit paksa i lakuar, sikur jataku ishte me gungë, i ngjalli dyshime Ndrios. Gjithë dyshekët e botës janë të sheshtë, qofshin të mbushur me lesh, pambuk, a fleta misri, kurse ai ngjante si të ishte mbi një kukumal. Si mund të flije rehat mbi një dyshek gungaç? Për të sqaruar enigmën e asaj anomalie, Ndrioja e zuri përfundi dyshekun me të dy duart dhe e ngriti lart rrëmbimthi me gjithë të zotin sipër. Usta Xheli ii ndodhur papritur kokëposhtë e këmbëpërpjetë, u rropat ta ndalonte inspektimin duke goditur me shkelme duart e Ndrios, mirëpo dysheku i amortizonte goditjet. Poshtë stromës Ndrioja dalloi çantën me thesarin e tij. E tërhoqi rrshanë me vrull me dorën e lirë dhe pastaj lëshoi anën e dyshekut, i cili u sheshua për bukuri, pa xhumba e brigje të dyshimta, me të zotin sipër që po vazhdonte të turfullonte nga inati, duke goditur fundin me thembra.

- Po tani ke sy e faqe ta mohosh?- e pyeti triumfator, duke shtrënguar çantën me të dy krahët. - Faqezi!

Xheli, paksa i topitur nga zbulimi i hajnisë, po mundohej ta zotëronte veten. Ishte treguar kalama, i pakujdesshëm. E gënjeu mendja se Ndrioja nuk do ta pikaste mungesën e çantës, ndaj me t'u kthyer në shtëpi, hapi çantën dhe filloi të numëronte paketat e banknotave sipas vlerës. Aritmetika e tij e shkollës fillore shkonte deri te njëmija, kurse më tej mendja e tij humbte në labirinthin e shifrave. I vetëdijshëm se ii kishte rënë në dorë një pasuri e madhe, ii fali Vançit një 10.000 për ogur. Pse nuk priti deri të nesërmen a më vonë, pse nuk gjeti një vend të fshehtë, larg syve të njerëzve? Në

vend ta katiste çantën sa më larg për të humbur gjurmët, e mbajti në shtëpi, si ta kishte tunduar djalli. Sapo dëgjoi zërin e Ndrios në oborr, Xheli i mblodhi shuk kartmonedhat e shpërndara, i rراسi në çantë dhe meqë e gjykoi të rrezikshme të dilte nga dhoma, se mos përplasej me të zotin e saj, e futi nën dyshek. Mirëpo vuri re se në mes të jatakut, u formua një gungë që dukej mysybet. Për ta fshehur sadopak, Xheli u shtri sa gjatë gjerë duke e mbuluar xhumbën me trupin e tij. Ndrioja s'kishte pse të dyshonte për ndonjë rreng, mbasi ustai kishte punuar gjithë pasditen mbi çati dhe tani kishte nevojë të prehej. Mirëpo për shkak të asaj xhumbe, Xheli s'mund të luante nga jataku, kurse tani që dobiçllëku i doli në shesh, mund të lëvizte lirisht. Brofi në këmbë ii vendosur të mos e lëshonte aq lehtë pasurinë e rrëmbyer. Ndërsa nga sytë gjak të kuq dilnin shkëndia inati, përparoi drejt Ndrios dhe e urdhëroi:

- Lëre çantën atje ku e gjetel! Dëgjove?

Ndrios as ii shkonte ndërmend t'ia dorëzonte thesarin hajnit. Si guxonte ta quante të tijne pasurinë e tjetrit dhe ca më keq t'ii jepte urdhër? Në vend të futej shtatë pashë nën dhe nga turpi, tani jepte urdhër tamam si torollak. Krahët e Ndrios e mbërthyen çantën si mengene mbi gjoks, sa askush s'mund t'ia shkulte me forcë. Xheli e dinte se përballë s'mund t'ia shkulte çantën, ndaj i doli nga prapa dhe u përpoq t'ia përdridhte të dy krahët prapa kurrizit. Po të arrinte atë gjë, çanta do të binte në dysheme si llokume. Kur e pa se ishte e pamundur t'ia merrte të dy krahët njëherësh, provoi t'ia shkulte krahun e majtë. Ia shpuri llërën prapa kurrizit dhe duke ii mëshuar me tërë forcën ia ktheu bërrylin lart.

- Më theve dorën, mor hajvan! - bërtiti tregtari nga dhimbja, duke e shkëlmuar kërcinjve.

Njëri nduk e tjetri shty, plasi grushti. Ndrioja hapi krahun e djathtë dhe ia ngjeshi një grusht drejt në sy. Nga goditja e fortë dhe e papritur Xhelit ndjeu sikur kokërdhoku ii kërceu nga orbita, prandaj vuri menjëherë dorën mbi sy. Kokërdhoku ishte në vend, mirëpo hapësira e dhomës u mbush me njolla të kuqe e portokalli, të cilat vej e vinin nga të gjitha anët. U luhat nëpër dhomë dhe duke

ecur me duar pas murit si ii qorrUAR, u mënjanua nga beteja për rimarrjen e çantës. Duke fërkuar pa pushim syrin e mbushur me njolla ngjyrash të ndryshme, tha si të donte të pajtohej me tregtarin.

- Ehu, sa ke ti nga këto... Punë e madhe se mora unë njëckë...

- Kam, s'kam, punë për mua.- Ndrioja iu ruajt deklaratave financiare nga frika e ndonjë denoncimi. Mbylli me ngut kopsat e çantës, pasi futi atje edhe kartmonedhën që ia rrëmbeu Vançit.

- Lermë nja dy tufa të paktën! - e luti Xheli sikur të ishte fjala për disa qindarka.

- Kur të shohësh majën e veshit, - turfulloi Ndrioja. Paturpësia e këtij hajduti s'njihte cak. E kishin kapur me duar në presh dhe hiqej sikur s'kishte ngjarë asgjë, madje rropatej të shkulte diçka. Tregtari doli me rrëmbim duke përplasur derën.

I lumtur që e shtiu në dorë thesarin shumë shpejt, ndjeu nervat t'i liroheshin nga ngërçi dhe muskujt po e rifitonte qetësinë e përhershme. Krahu i ndrydhur vazhdonte t'i dhimbte, por as që e përfillte. Në krahasim me dhimbjen shpirtërore të humbjes së milionave, ai qe si një pickim mushkonje.

Sa u kthye në shtëpi, Ndrioja e futi çantën me kartmonedha poshtë karrikes, me mendimin se tani duhet t'ii gjente një vend tjetër, mbasi tavani nuk ishte më i sigurt. Ajo skutë u ekspozua dhe Xheli mund të provonte të hynte nga çatia për të rrëmbyer thesarin. Për një usta nuk ishte asoak e vështirë të hiqte rrasat prej guri, petavrat dhe të shkiste brënda në tavan.

Dikur Mimi e kishte qortuar që ii ktheu ata pak florinj, në kartmonedha, po për shak të rrethanave që u krijuan pas lufte, Ndrioja nuk u pendua kurrë. Florinjtë u bënë monedha të rrezikshme, të cilat u shkaktuan telashe të pasosura atyre që i kishin, ose dhe atyre që dyshoheshin se zotëronin "këndeska" ose shufra. Ai çmeritej nga ndryshimi i shpejtë që kishin pësuar komunistët për atë metal. Ata që dikur e urrenin floririn, si burimin e gjithë të këqiave të botës, posa morën pushtetin në dorë, filluan ta gjëmonin vrimë më vrimë, me pasion më të madh se kërkuesit e arit në

Perëndimin e Largët. Nepsi i tyre për atë metal u kthye në obsesion dhe vazhdoi shumë gjatë. A nga tingulli kristalor, a nga shkëlqimi, tërheqja drejt tij ishte manjetike. Në fillim thoshin se ii donin për të mbushur arkat e zbradura të shtetit, mirëpo ato të flamosura nuk u mbushën kurrë, sikur të ishin të shpuara nga poshtë. Tonelata me flori u harxhuan për të paguar agjentët e sigurimit jashtë shtetit për spiunime të kota, një pjesë u tërhoq nga thesari në zërin “për situata të jashtëzakonshme të Partisë dhe qeverisë dhe një pjesë e majme iku nëpër llogaritë e bankave të botës me kode sekrete të familjeve të nomenklaturës që s’ka zot t’ua gjejë tragën. Fati i florit të Shqipërisë, Kështu ka qenë gjithmonë i zi katran, sikur e ka mallkuar Pluti të mos qëndrojë mbi atë tokë. Ligji i parë që dekretuan komunistët ishte ai i ndalimit të shitblerjes së arit. Atë e blinte vetëm shteti me një çmim qesharak. Aty komunistët e treguan veten ashtu sikurse ishin, injorantë në fushën e tregtisë. Po të kishin caktuar një çmim të arsyeshëm, sa një e katërta e vleftës në tregun botëror, do të kishin mbledhur sa tonelata më tepër. Po nga ana tjetër pse ta blinin me lek kur mund ta siguronin falas nga tregtarët, sarafët, reshperët, bejlerët e natyrisht edhe nga qytetarët e thjeshtë, me metodat e provuara të shtrëngimit, dajakut dhe arrestimit?

Qeveria e çfardo sistemi të jetë, ka nevojë për para dhe në këtë mes nuk bën përjashtim as pushteti popullor, sikurse e vërtetoi historia. Bile sa më popullor të jetë, aq më të madh e ka nepsin dhe oreksin. Tregtarëve të mëdhenj që ishin pasuruar gjatë luftës, tani u duheshin hequr disa fasha që të lehtësoheshin disi nga superpesha. Për këtë arsye u thërritën financierët më të kualifikuar që të hartonin dekretin përkatës “Mbi tatimet e jashtëzakonshme të luftës.”

Pas konsultimesh me ligjet analoge të disa shteteve të tjera, juristët dhe financierët e formuluan ligjin në pesë faqe të daktilografuara me 20 nene, ku renditnin arsyet madhore për jetësimin e tij tok me sanksionet përkatëse. Të vetëdijsëm se kishin nxjerrë nga duart një akt juridik me vlerë historike, ia dorëzuan për firmë Ministrisë të Financave, që shkonte në zyrë me revole në brez. Ai pasi e shfletoi diagonalisht, vërejtë se duhej përmbledhur. Pas diskutimesh e

debatesh me karakter profesional, komisioni mundi ta shkurtonte gjysmë për gjysmë me 10 nene në dy faqe e gjysmë të daktilografuara. Sipas tyre ky ishte kulmi i kondensimit të dekretit dhe më tej s'kishte ku shkonte. Mirëpo ministri me revole, edhe për variantin e dytë rrudhi buzët. "Bjerini më shkurt, më shkurt," tha vendosmërisht. Kryetari i grupit të ekspertëve u kthye te bashkëpunëtorët e tij dhe u tha: "Tani e kam të qartë çfarë kërkohet prej nesh. Ligji duhet përmbledhur në dy nene. 1. Gjithë tregtarët detyrohen të paguajnë tatime të jashtëzakonshme për fitimet gjatë luftës. 2. Kush nuk paguan i q... nëna."

Gazeta "Bashkimi" botonte çdo ditë lista të gjata me emrat e tregtarëve të njohur dhe krahas tyre shumat që duhet të paguanin, sipas vendimeve të komisionit për tatimin e jashtëzakonshëm. Vëllazëritë tregtare, etër e bij, dorëzuan shuma kolosale me shtatë e tetë shifra, në zyrat e tatimeve, që të shmangnin sanksionet e ligjit. Disa tregtarë më pak të zgjuar, apo tepër naivë, guxuan të ankoheshin nëpër seksionet e financave duke i quajtur shumat e tatimit absurde, të paarritshme për mundësitë e tyre monetare dhe betoheshin për gjithë shenjtorët e pejkamberët se vlerësimet e komisioneve ishin të gabuara, të pambështetura nga librat e llogarisë. Mirëpo komunistët ateistë nuk besonin shenjtër e pejkamberë, kuran e ungjill, shehitë e meleqë dhe ua prisnin shkurt: "A do t'i sillni vetë, apo doni të kalbeni në burg duke humbur edhe gazet, edhe shtëpinë?"

Disa tregtarë të tjerë, i mbyllën dyqanet duke deklaruar falimentimin e firmës. As atyre nuk u besoi qeveria popullore. Me pretekst se kishin deklaruar falimentim fals, ua konfiskoi pa shpërblim mallrat e shitoreve dhe depove, ndërsa pasurinë e paluajtëshme ua shtetëzoi. Tregtarët e vegjël të kategorisë së Ndrios panë me sytë e tyre shëmbjen e tregtarëve grosistë, idhujve të tyre. "Vëllazëria Ako" e pësoi keq. Pas konfiskimit të shitoreve dhe depove, zotin Proko e futën në burg, mbasi nuk besonin se e kishte dorëzuar arin që zotëronte. Zonja e tij u detyrua të sillte arturinat e prikës së saj të shpëtonte burrin, po kusuret s'kishin mbaruar. Zotin Proko e dërguan në Vloçisht të jepte ndihmesën e tij për ndërtimin

e socializmit duke punuar mes llucës e baltës për të tharë kënetën e Maliqit. Përsëritej shpesh thënia popullore se tani u ulën malet dhe u ngritën kodrat, mirëpo kjo s'kishte pikë kuptimi, as si metaforë se edhe kodrat ishin rrafshuar. Ndryshe nga sa kishte parashikuar Mimi, edhe ata që rendën pas floririt nuk dolën të fituar. Shembulli më i spikatur ishte Prokoja dhe firma e tij.

Kur do të vinte koha t'i shtinte në punë milionat? Boll i kishte mbajtur batall disa vite në tavanin e shtëpisë. Kur do të mbaronte ajo dreq lufte civile brenda Greqisë, të hapej kufiri dhe njerëzit të vozitnin lirisht?

* * *

Mimi u fut në oborrin e shtëpisë duke tërhequr kalin për kapistre. Barrën e vogël e shkarkoi vetë pa ndihmën e askujt. Si gjithmonë fytyra e tij shprehte pakënaqësi dhe mërzi, si maskë tragjike e teatrit antik. Ndrijoja e kishte porositur të blinte edhe disa gazeta, të cilat i lexonte më nge për të marrë vesh lajmet nga vendi dhe nga bota.

- Ç'ka ndonjë të re? - e pyeti Ndrijoja sapo Mimi u fut në vatrën që shërbente si dhomë ndenjeje e kuzhinë.

- Qeveria jonë, thotë gazeta, hedh poshtë akuzat se shqiptarët ndihmojnë komunistët e Greqisë me ushqime dhe armatime. Mirëpo ne, që shohim përditë kamionët që sjellin në Taç cigare, ushqime, armatime, rroba, të cilat ii marrin ata të EAM-it me mushka e kuaj, kjo deklaratë nuk ka kuptim. Kjo është njëllë sikur t'u thonë mbyll sytë se dua t'u gënjej..., - tha Mimi me mllef.

- Mos prisje të kundërtën? - e pyeti Ndrijoja

- Jo, jo, po do të bënim mirë që këtë gazetë, me këtë përgënjeshttrim të mos e sillnin në anët tona, se kështu qeveria del gënjeshtare, - tha Mimi. - Le ta shpërndajnë gjetkë, andej nga s'i sheh njeri kamionat dhe ndihmat...

- Aman o Mimi, lëre politikën e madhe mënjanë dhe na trego të rejat nga Korça, - e luti Ndrijoja. - Si dole atij pazari?

- Po të them se kalin e mora kot, mbasi ato plaçka mund t'ia ngarkoja një këndesi. Krizë e madhe... malli po zhduket me shpejtësi, shitoret private po mbyllen njëra pas tjetrës. Do të mbetemi si peshku në zall.

Atë çast, Zoica, e shoqja e Ndrios, solli një legen, shtiu ujë të valuar nga gjymi që valonte, pastaj edhe ujë të ftohtë, duke e provuar me dorë derisa e solli në temperaturën që duhej. Ndrioja përveshi mëngën e këmishës dhe futi llërën në legen.

- Ku u shëmkose? - e pyeti Mimi.

Ndrioja duke buzëqeshur nisi t'i rrëfente aventurën e asaj dite me Xhel Dadakun që nga zënia e pikave të çatisë, zhdukja e thesarit nga tavani, zbulimi i xhumbës nën dyshek, deri te ndeshja me grushte.

- Për pak na la tertebull, - i tha pa e fshehur ngazëllimin që ndiente.

Atë çast dera u hap me vrull e shkëlmuar nga dikush. Hyri rrëmbimthi Xhel Dadaku duke mbajtur në dorë një bombë të kuqe të markës "Breda," mbetur që koha e luftës Italis-Greke. Syri i nxirë nga grushti i Ndrios nuk dukej aq i tmershëm sa syri tjetër i kuq gjak nga zemërimi dhe egërsia.

- Kthe ato që more! Përndryshe rripin bombës dhe ... fërtele, zorrët në tavan, - uluriti e ndërkohë afroi dorën te goja, gati për t'i hequr me dhëmbë rripin e siguresës.

Mimi pyeti qetë-qetë :

- Çfarë kërkon nga ne?

- Ta thotë yt vëlla! - iu ktheu Xheli. - Mos e kujton Xhelin ndonjë llosh, ndonjë humbameno? Koka ime, teslim! Ju ama do t'ua shkërdhej nënën, - tha vendosmërisht

Ndrioja, për çdo të papritur, e mbërtheu çantën mes këmbëve pa u trembur nga kërcënimet e ustait.

- Ka mundësi ta heqësh bombën nga dora dhe të thuash shkoqur çfarë kërkon? - e pyeti Mimi.

- Çantën! - uluriti Xheli duke ia treguar me dorën ku mbante bombën.

- Jepja dhe le të këputë qafën, - iu lut Mimi të vëllait.

Ndrion e shikoi të vëllain me tallje e përbuzje si një njeriu të cilit ii kishin luajtur vidat dhe fliste marrëzira. Ky njeri gjithmonë të ngrinte nervat me gjykimet e tij stropio.

- Mos e di çantën mbushur me lëpjeta e labot? - ironizoi Ndrioja.

- Si thua ti? Të lemë kokën për to? Le t'i marrë dhe të këputë zverkun, se na ngriu gjakun, - tha Mimi. Pa pritur miratim nga ii vëllai e tërhoqi çantën nga këmbët e tij Ndrios dhe ia hodhi Xhelit përpara. Xheli futi bombën në xhep tashmë që konflikti ishte zgjidhur urtë e butë, mori çantën dhe sakaq u zhduk tatëpjetë shkallëve.

- Ti do vrrarë me bukë në gojë, - shpërtheu Ndrioja duke u ngritur në këmbë. Ishte gati t'i hidhej në grykë që ia kishte falur gjithë pasurinë e tyre një delenxhiu si Xhel Dadaku. Ti, ti e bën tjetrin të pëlçasë. Po unë s'kam për të ndejtur duarkryq. Që tani do të shkoj ta denoncoj në polici për grabitje me armë dhe tentativë vrasje, - deklaroi Ndrioja.

- Si do t'u thuash atyre të sigurimit? Që ke mbajtur para fshehur, pa i deklaruar? - e pyeti Mimi. - Ngadalë, mos e merr rrëmbyer! Po e denoncove, ty do të futin të parin në burg si kundërvajtës, si armik të pushtetit. Ulu, ulu! - e qetësoi ai. Mimi fliste me logjikë dhe kishte plotësisht të drejtë. Ishte njëlloj sikur sikur të denonconte vetveten për shkelje ligji.

- Janë miliona, more Mimi, janë miliona, - zuri të qante Ndrioja.

- Nuk vlejné asnjë dyshkë se Greqia e ka ndryshuar monedhën para tre vitesh, - ia plasi Mimi.

- Ndryshuar? - pyeti i sterrosur Ndrioja. - Kur? Sa kohë ka?

- Që në 46. Kartmonedhat ii paskan prerë gjermanët, jo Banka greke, - e sqaroi Mimi.

- Nga i shpikë këto biftanaqe? Kush t'i tha këto habere ogurzeza?? - u interesua Ndrioja.

- Një miku ynë, e njeh dhe ti. Filip Totoni, që punon në Bankën e Korçës. Vajta e pyeta siç më porosite dhe më tha se bankat shqiptare nuk pranojnë kartmonedha të tilla.

- Kot i paskemi mbajtur ne? Kot u qënkemi gëzuar milionave? - e pyeti i dalldisur Ndrioja.

- Tani e ka radhën Xhel Dadaku t'u gëzohet, - tha Mimi duke buzëqeshur, ndërsa fjalët i gurgullonin në grykë.

Nga zemra e Ndrios doli një psherëtimë e thellë. Dy herë ishte rrokullisur nga lartësitë e togut të milionave. Siguria që ndjente prej thesarit kishte avulluar përfundimisht. Shpesh i dilte gjumi natën dhe zgjimi ishte i tmerrshëm.

* * *

Tre ditë më vonë një lajm befasues tronditi fshatin. Xhel Dadaku e kishin kapur rojet e kufirit teksa orvatej të arratisëj në Greqi, me një çantë shpine mbushur dinga me dhrahmi. Flitej për shuma marramendëse, për disa miliona. Pak e çuditshme se si ii kishte vënë ato para mënjanë duke punuar me çekan e mistri? Pse jetonte e vishej si mos më keq kur kishte miliona mënjanë? Hamendësime të llojlojshme qarkullonin në fshatin. Mos ishte marrë me kontrabandë, apo ishte futur në shërbim të agjunkturës greke?

Sigurimi raportoi menjëherë Tiranë dhe prej andej erdhën udhëzime të hetohej me hollësi misioni i tij, sepse kishte të ngjarë të ishte hallka e një agjensure të rrezikshme. Metoda më praktike e sigurimit që ta trembnin të pandehurin se ata "dinin gjithçka" prandaj më mirë ta lehtësonte veten duke pohuar fajet e tij. Kjo metodë nuk dha rezultate me Xhel Dadakun se ai i mbante dhëmbët shtrënguar dhe kur e hapte gojën përsërishte se s'kishte asgjë për të thënë. Kokëderr ii tillë nuk ishte parë në qelitë e hetuesisë. Për ta detyruar të ligjëronte, kombinuan metodën klasike të drurit me atë të etjes. Pas një jave torturash Xheli deklaroi se paratë inuk ishin të tiat. Zotëruesi ii tyre ishte tregtari i fshatit, Ndrio Prushit. Mos vallë ai e kishte nisur me mision për t'i shkëmbyer në bankat greke kundrejt një shpërblimi të majmë? Xheli tha "po" ngaqë nuk donte të pohonte se i kishte vjedhur a rrëmbyer.

E fshehta rrodhi shpejt jashtë mureve të Degës së Brendshme. Nipi i Ndrios, Nas Kovaçi, që ishte emëruar ndihmës prokuror i

rrethit, i alarmuar nga thashethemet shkoi natën te shtëpia e dajës, për të mësuar të vërtetën nga goja e tij. Ndrioja zuri të belbëzonte e të dridhej nga frika, sapo mësoi rrezikun që i kanosej. Le milionat që avulluan, po tani duhet të dergjej edhe në burg për shkak të tyre.

- Ka vetëm një rrugë, - e mësoi nipi. - Po të thirrën në Degë, dhe do të thërresin pa tjetër, se Xheli të inkriminoi, thuaj që paratë s'janë të tuat dhe ti as e di ku i ka gjetur.

- Si t'ia bëj hasha kur u kërlëshëm me grushte? Si t'i mohoj kur ai m'i rrëmbeu me bombën ndër dhëmbë? - protestoi Ndrioja.

- Ju pa njeri kur u zutë? Jo! Ka fakte ai për këtë? Jo! A mund të sjellë ndonjë dëshmitar? Jo. Atëherë, ç'ke? Vepro si të thashë, përndryshe të pret procedimi dhe burgu, - e paralajmëroi nipi.

- Shteti duhet ta dënojë Xhelin për vjedhje dhe përpjekje për vrasje...

- Ty s'të duhet Xheli, ti shih si të heqësh këmbët nga ky lak, - e këshilloi i nipi.

Para hetuesit Ndrioja deklaroi se çanta me dhrahmi nuk ishte e tij dhe as e kishte parë ndonjëherë. Xhel Dadakut sa nuk i kërcyen kokërdhokët nga gropat e syve. Nisi të protestonte, të tregonte ngjarjen qysh nga pikat e çatisë, deri te zënia me grushte te shtëpia e tij, mirëpo hetuesi ia preu të mbyllte gojën se ato përralla i kishin dëgjuar disa herë. Hetuesi u bind se Xheli akuzonte tregtarin mbasi nuk donte të shlyente borxhin që ii detyrohej.

Gjyqi i popullit e dënoi Xhel Dadakun me katër vjet burg për tentativë arratisje, ndërsa neni i akuzës për kontrabandë parash ra, pasi ekspertiza vërtetoi se ishin të skaduar.

Pas gjyqit, kartmonedhat e përdorura nga prokurori, mbetën në zyrën e tij, meqë gjykata nuk i pranoi si provë faji. Nas Kovaçi e gjykoi të arsyeshme t'ia kthente të zotit.

- Pse m'i solle? - e pyeti Ndrioja.

- Thashë se mos doje të çmalleshe, - i tha Nasi me kunj, po pas pak shtoi: - T'i kesh kujtim, a ku di unë?

Ndrioja tani e shihte çantën si një gjë të huaj, të kotë. Si avulluan ato drithtërima gëzimi kur mendonte se zotëronte miliona, se ishte

milioner dhe do t'i lejonte vetes çdo tekë njerëzore? E hapi, nxorri disa kartmonedha dhe i kaloi ndër gishtrinj. Letra frushullinte, fytyrat e filozofëve dhe dijetarëve të lashtë grekë, ishin po ato, mirëpo tani krejt pa jetë, të mumifikuara. Brenda disa javësh ishte tëhuajtur prej dhrahmive me ca shifra kot në cepat e tyre. I stërgënjyer një ditë prej ditësh mendoi se çanta mund t'i hynte në punë, prandaj e liroi nga kartmonedhat duke i zbrazur në oborr, e mbushi me tagji dhe ia vari kalit në qafë.

Zoica po vinte rrotull të gjente ndonjë copë letër për të ndezur ashkëlat e furrës.

- Merr nga këto, - i tha Ndrioja duke i treguar togun me kartmonedha.

- Këto duken si para, - vërejti Zoica me një farë drojtje të vetvetishme.

- Duken po nuk janë, - shtoi menduar Ndrioja.

Tufat e dhrahmive Zoica i flaku në furrë. Nga nxehtësia portretet e mbretërve, perandorëve, filozofëve e dijetarëve përdridheshin një çast, sikur t'i trembeshin zjarrit, pastaj tiparet e tyre vijëzoheshin nga shirita të kuq e të zinj aq sa ngjanin sikur kishin marrë plagë në fytyrë. Portretet, arabeskat, ndërtesat, lulkat, firmat e shifrat e mëdha me pesë, gjashtë zero pas njëshit, digjeshin me shpejtësi. Copëzat e imta lodronin në kubënë e furrës një çast, pastaj delnin me vrull nga gryka e saj, sikur të mos u durohej të shpërndareshin në hapësirën e qiellit dhe të binin mbi tokë si hi i bardhë.

PËRMBAJTJA

SKICA	3
<i>As Miço, as Muço</i>	5
<i>O zot, na ruaj mbretin!</i>	8
<i>Çakalli i mullisit</i>	11
<i>Gomari me ikonë</i>	13
<i>Papa sakoja mëson si lexohet ungjilli</i>	15
<i>Ngushëllimi</i>	17
<i>Lehje per solidaritet</i>	19
<i>Pse s'duken djajtë tani?</i>	21
<i>Leter një miku të Shqipërisë në Skandinavi</i>	25
<i>Brohorima "Made in Albania"</i>	30
TREGIME	35
<i>Ku jeni ju, shqiponja?</i>	37
<i>U gjetën nallanet e Ali Pashait</i>	50
<i>Fyelli "magjik" i shqiptarit</i>	55
<i>Marksisti në analizën e sportit</i>	61
<i>Reportazh i frymëzuar nga dietat</i>	68
<i>Takime në shkallët e pentagramit</i>	73
<i>Sa për vitrinë</i>	84
<i>Ngushëllimtarët e panjohur</i>	91
<i>Mungestari më i rregullt</i>	98
<i>"Danteja dhe Shekspiri në Hallvaxhijas"</i>	104
<i>I plotfuqishmi ndan këshilla dhe shpulla</i>	110
<i>Xhakoja, shoku im i stanit</i>	115
<i>Varianti i 13</i>	121
<i>Ngjala</i>	130
<i>Nuk dua asgjë - jam deri në fyt</i>	137
<i>Etiketangjitesi</i>	143
<i>Gërvishtjet prapa derës</i>	150
<i>Letra nga buza e varrit</i>	160

<i>Diskutimi që ngriti sallën në këmbë</i>	<i>167</i>
<i>Lista e gjatë e borxhlinjve</i>	<i>179</i>
<i>Karakteristika më objektive</i>	<i>184</i>
<i>Shtesa në biografi</i>	<i>191</i>
<i>Miloneri</i>	<i>197</i>